



**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

**Shkakësia si kategori logjike dhe gjuhësore në shqip dhe në  
gjermanisht**

Punim për gradën shkencore “Doktor”

Kandidati  
MA. Gentian Sadiku

Udhëheqës shkencor  
Prof. Dr. Emine Teichmann

Tetor 2013

## **Tabela e përmbajtjes**

<b>Hyrje</b> .....	<b>i</b>
<i>0.1 Përlijgja e punimit</i> .....	<i>i</i>
<i>0.2 Objekti i studimit dhe hipotezat</i> .....	<i>iv</i>
<i>0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit</i> .....	<i>iv</i>
<b>Kreu I „Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht“</b> .....	<b>1</b>
I.1 Koncepti filozofik mbi shkakësinë .....	1
I.1.1 Edmund Husserl-i: “Ich bin, alles Nicht-Ich ist bloß Phänomen.” (Unë jam; gjithçka jo-unë është veç fenomen.) .....	2
I.1.2 Martin Heidegger-i.....	4
I.1.3 Përfundime.....	11
I.2 Ç’është shkakësia në gjuhësi? .....	11
I.2.1 Mbi kuptimin e fjalisë shkakore .....	11
<b>Kreu II Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore</b> .....	<b>14</b>
II.1 Në shqip.....	14
II.1.1 Ndajfolja.....	14
II.1.2 Parafjala.....	15
II.1.3 Lidhëza .....	16
II.1.4 Pjesëza.....	17
II.2 Në gjermanisht .....	17
II.2.1 Ndajfolja.....	17
II.2.2 Parafjala.....	18
II.2.3 Lidhëza .....	18
II.2.4 Pjesëza.....	19
<b>Kreu III Lidhëzat shkakore në shqip</b> .....	<b>21</b>
III.1 Shprehja gjuhësore e raporteve shkakore në gjuhën e sotme shqipe .....	22
III.1.1 Lidhëza se .....	22
III.1.2 Lista e lidhëzave shkakore dhe e shprehjeve lidhore shkakore .....	23
III.1.3 Mjete të tjera gjuhësore – shprehëse të raporteve shkakore në shqip .....	23
III.1.4 Parafjalët që përdoren për shprehjen e marrëdhënieve shkakore.....	25
III.1.5 Ndajfoljet shkakore .....	26
III.1.6 Format e pashtjellura foljore me funksion shkakor .....	27
III.2 Përfundime .....	27
III.2.1 Lidhëzat shkakore .....	27

III.2.2 Mjete të tjera gjuhësore-shprehëse të raportve shkakore .....	28
<b>Kreu IV Panoramë e përdorimit të lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe .....</b>	<b>30</b>
IV.1 Lidhëzat shkakore në „Mesharin“ e Buzukut .....	30
IV.1.1 Lidhëzat nënrenditëse .....	30
IV.1.1.1 Pasqyrë përmbledhëse e lidhëzave nënrenditëse .....	31
IV.1.1.2 Lidhëzat nënrenditëse shkakore .....	32
IV.1.2 Përfundime .....	33
IV.2 Lidhëzat shkakore në librin e Th. Mitkos “Vepra” .....	34
IV.3 Përdorimi i lidhëzave shkakore në veprën “Dhiata e re dhe psalmet” .....	37
IV.3.1 Lidhëzat bashkërenditëse .....	37
IV.3.2 Lidhëzat nënrenditëse .....	38
IV.3.3 Lidhëza nënrenditëse kohore që shprehin raporte shkakore .....	38
IV.3.4 Shkaku i fshehur në ndërtimet me pjesë të varur rrjedhimore .....	40
IV.3.5 Përfundime .....	41
IV.4 Mbi një përdorim të veçantë të lidhëzave shkakore .....	41
<b>Kreu V Shprehja gjuhësore e raporteve shkakore në gjuhën gjermane .....</b>	<b>44</b>
V.1 Kuptimi semantik dhe komunikativ .....	44
V.2 Mjetet gjuhësore shprehëse të marrëdhënieve shkakore .....	45
V.2.1 Foljet kauzale .....	46
V.2.2 Lidhëza kohore me vlerë shkakore .....	48
V.2.3 Ndajfoljet lidhore .....	50
V.2.4 Ndajfoljet pyetëse .....	52
V.2.5 Lidhëzat .....	52
V.2.5.1 Lidhëza <i>weil</i> , <i>sepse</i> ‘ .....	54
V.2.5.2 Lidhëza <i>da</i> .....	57
V.2.5.3 Lidhëza <i>zumal</i> .....	59
V.2.5.4 Lista e lidhëzave shkakore në gjermanisht .....	59
V.2.6 Parafjalët që përdoren si mjete lidhëse me kuptim shkakor .....	60
V.2.6.1 Parafjalët <i>aus</i> (për/ nga)/ <i>vor</i> (prej/nga) .....	61
V.2.6.2 Parafjala <i>wegen</i> (për shkak/ nga shkaku) .....	61
V.2.6.3 Parafjala <i>aufgrund</i> (në bazë) .....	62
V.2.6.4 Parafjalët <i>dank</i> dhe <i>mangels</i> (falë dhe për mungesë) .....	63
V.2.6.5 Parafjalët e pasvendosura .....	63
V.2.6.5.1 Parafjala <i>zuliebe</i> (për hir/ për hatrin) .....	64
V.2.6.5.2 Parafjala <i>zufolge</i> (sipas/ si rrjedhim) .....	64
V.2.6.6 Circumpositionen .....	64
V.2.7 Përfundime .....	65
<b>Kreu VI Një ballafaqim i mjeteve kryesore lidhore shkakore në shqip dhe në gjermanisht .....</b>	<b>69</b>

<b>Kreu VII Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ .....</b>	<b>74</b>
VII.1 Lidhëzat shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ .....	74
VII.2 Lidhëzat shkakore në përkthimin gjermanisht “General der toten Armee” .....	78
VII.2.1 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës sepse .....	79
VII.2.2 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës se .....	84
VII.2.3 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës ngaqë .....	87
VII.2.4 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës që .....	89
VII.2.5 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës pse .....	90
VII.2.6 Lidhëza kohore me kuptim shkakor .....	90
VII.2.7 Përfundime .....	90
<b>Kreu VIII Një përdorim i veçantë i lidhëzës „weil“ (se/ sepse) në gjermanishten e folur .....</b>	<b>94</b>
VIII.1 Veçori sintaksore të fjalive hipotetike ku përdoret lidhëza “weil” (sepse) .....	94
VIII.1.1 “Weil” (sepse) në fjali me folje në fund të pjesës së varur .....	94
VIII.1.2 Fjalitë e varura shkakore me folje në vendin e dytë .....	95
VIII.2 Një vështrim semantiko-pragmatik i fjalive me weil (sepse) .....	96
VIII.3 Përfundime .....	99
<b>Kreu IX Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale) .....</b>	<b>101</b>
IX.1 Gramatika e foljes .....	102
IX.1.1 Mbi konceptin valencë .....	102
IX.1.2 Çështje konceptuale dhe terminologjike .....	103
IX.1.3 Plotësat në gjuhën shqipe .....	105
IX.1.3.1 Rolet semantike .....	105
IX.1.3.2 Rolet tematike/semantike në kuadrin e gramatikës gjenerative .....	106
IX.1.4 Kombinimi i roleve semantike me funksionet sintaksore .....	108
IX.1.5 Përfundime .....	112
IX.2 Principi kauzal .....	112
IX.2.1 Përfundime .....	115
IX.3 Shkakësia implicite .....	115
IX.3.1 Foljet „psikologjike“ përmbajnë gjithnjë dhe kauzalitet implicit .....	116
IX.3.2 Variacioni kombinues i roleve semantike me funksionet sintaksore të foljet psikologjike .....	118
IX.3.2.1 Teoria Belletti/ Rizzi (1988) .....	119
IX.3.2.2 Teoria e Grimshaw-t .....	120
IX.3.2.3 Teoria e Dowty-t .....	121
IX.3.2.4 Përfundime .....	122
IX.3.3 Stimuli si shkak .....	123

IX.3.4 Përjetuesi si komponent i domosdoshëm i raporteve shkakore implicite .....	124
IX.3.5 Përfundime.....	126
IX.4 Paragraf - eksperiment.....	126
IX.4.1 Eksperimenti .....	126
IX.4.2 Rezultatet e eksperimentit.....	127
IX.4.2.1 Veprues – Pësues (Agent – Patient).....	127
IX.4.2.2 Veprues – Evokues (Agent – Evocator) .....	129
IX.4.2.3 Stimul – Përjetues (Stimulus – Experienter).....	130
IX.4.2.4 Përjetues – Stimul (Experienter – Stimulus).....	131
IX.4.2.5 Përfundime.....	132
<b>Kreu X Kausaliteti dhe foljet që shprehin veprim .....</b>	<b>133</b>
X.1 Foljet ndërvetore që shprehin veprim. Një vështrim teoriko- empirik .....	133
X.1.1 Ç’është veprimi? .....	133
X.1.2 Kausaliteti i foljeve që shprehin veprim.....	136
X.1.2.1 Mbi dallimin kuptimor midis termave arsye dhe shkak.....	137
X.1.3 Përfundim.....	138
<b>Kreu XI Kausaliteti implicit në foljet e komunikimit .....</b>	<b>139</b>
XI.1 Foljet e komunikimit.....	139
XI.1.1 Intensionin dhe kausalitetin (qëllimshmëria dhe shkakësia) në foljet e komunikimit .....	141
XI.1.2 Veçori të përgjithshme të foljeve të tipit them (verba dicendi).....	144
XI.1.2.1 Klasifikimi i foljeve të tipit them (verba dicendi) dhe veçori specifike të paradigmatave .....	144
XI.1.2.2 Jo gjithnjë them, them... Mundësi të shumta të shprehjes së një akti ilokutiv foljor.....	148
XI.1.3 Përfundime.....	149
<b>Kreu XII Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kausalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll .....</b>	<b>150</b>
XII.1 Shprehja e raporteve shkakore në ligjërimin e Böll-it.....	150
XII.1.1 Ndërtime shkakore me lidhëza shkakore.....	151
XII.1.2 Ndërtime shkakore me parafjalë shkakore: .....	152
XII.1.3 Folje psikologjike .....	152
XII.1.4 Folje të veprimit .....	155
XII.1.5 Fjalë që kanë lidhje prejardhjeje me folje psikologjike .....	159
XII.1.5.1 Fjalë emërore .....	159
XII.1.5.2 Fjalë mbiemërore.....	160
XII.1.5.3 Fjalë ndajfoljore .....	162
XII.1.6 Përfundime .....	163
XII.2 Format e dhënies së ligjëratave të përdorura nga Böll-i.....	164
XII.2.1 Sinjalet referuese .....	164

XII.2.2 Monologu i brendshëm.....	167
XII.2.3 Përfundime .....	168
<b>Përfundime të përgjithshme.....</b>	<b>170</b>
<b>Bibliografia .....</b>	<b>178</b>

## **Falenderime**

Me këtë rast dua të falenderoj të gjithë ata që më shoqëruan gjatë punës sime me këshilla teorike-gjuhësore dhe që më mbështetën miqësisht e njerëzisht. Mendimi për të trajtuar këtë temë më lindi gjatë orëve të leksioneve e të seminareve të Prof. Engel-it në departamentin e gjermanistikës në Universitetin e Bonit. Udhëheqëse e këtij punimi është Prof. Dr. Emine Teichmann-i. Ajo ka qenë gjithnjë e gatshme për të më ndihmuar me vërejtje, sugjerime, literaturë e gjithçka që më është dashur. Për ndihmën e saj bujare e falenderoj veçanërisht.

Zotin Prof. Dr. Tomorr Plangarica dhe zotin As. Prof. Dr. Mustafa Karapinjalli i falenderoj për leximin e kujdeshëm të të gjithë materialit të këtij punimi.

### Hyrje

*Marrëdhëniet shkakore përbëjnë, pa diskutim, strukturat qendrore në procesin e të menduarit. Njohja dhe analiza e shkaqeve luajnë një rol të madh në përjetimet dhe në qëndrimet e njeriut. Njerëzit kanë në natyrën e tyre një prirje të përhershme për ta njohur botën reale, për të parashikuar ndodhitë e për t'i vënë ato nën kontroll. Në këtë kuadër njeriu zbulon dhe shkaqet që kushtëzojnë lëvizjen dhe zhvillimin e dukurive.*

*Konceptimi i botës, duke zbuluar në të raporte dhe lidhje shkakore, është një princip themelor njohës. Principi kauzal është „i montuar“ në aparatën njohës të njeriut.*

*Prandaj paraqet interes të veçantë paraqitja dhe analiza e tërë rretheve problemore që kanë të bëjnë me dukurinë e shkakësisë.*

#### 0.1 Përligjja e punimit

*Objekt i këtij punimi janë marrëdhëniet shkakore në rrafshin e gjuhës së shkruar e të folur. Synimi ynë kryesor është përshkrimi i mjeteve dhe mundësive gjuhësore që shërbejnë për paraqitjen e raporteve shkakore në ligjërim. Realizimin e këtij synimi do ta lidhim me trajtimin e kauzalitetit si kategori logjike dhe gjuhësore në dy gjuhë: shqip dhe gjermanisht.*

*Në literaturën gjuhësore shqiptare kjo temë është trajtuar gjerësisht në Gramatikën e Gjuhës Shqipe II (më pak në vëllimin I), në dy artikuj të S. Floqit e në ndonjë material tjetër. Si në Gramatikën e Gjuhës Shqipe, ashtu dhe në artikujt e S. Floqit objekt hulumtimi është gjuha e shkruar. Shembujt ilustrues janë marrë kryesisht nga letërsia artistike.*

*Në letërsinë tonë gjuhësore mungojnë ose ka shumë pak punime që kanë si objekt një korpus unik, një vepër të plotë letrare ose jo letrare. Kjo është një nga arsyet që ne bëjmë si objekt hulumtimi dhe disa korpuse të plota veprash të ndryshme për nga përmbajtja, stili, koha etj. Ndër të tjera jemi marrë hollësisht me analizën e bllokut të lidhëzave shkakore të përdorura në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ të I. Kadaresë, në origjinalin shqip dhe në përkthimin gjermanisht. Një vend të rëndësishëm zë në punimin tonë dhe kapitulli i fundit, kapitull me natyrë empirike, mbi kauzalitetin implicit dhe funksionet e tij në një tekst letrar-artistik. Është fjala për romanin e H. Böll-it “Ansichten eines Clowns” (“Me syrin e një kllouni”).*

*Gjithashtu në gjuhën shqipe mungojnë studimet mbi realizimin gjuhësor të shkakësisë në nivelet e ndryshme të gjuhës së folur. Punimi ynë përmban një kapitull të veçantë për ndërtimin dhe funksionimin e konstrakteve shkakore në ligjërim dhe në dialog.*

*Ndër mungesat e tjera të studimeve në këtë fushë mund të përmendim mospasqyrimin e arritjeve më të fundit të teorive botërore mbi kauzalitetin si kategori gjuhësore. Edhe lidhja midis shkakësisë gjuhësore dhe asaj logjike mund të përfshihet më shumë ose të trajtohet më gjerësisht në studimet tona gjuhësore.*

*Shkakësia implicite prezantohet shkurt, kryesisht me ndërtimet shkakore asindete dhe me foljet kauzative.*

*Duke “rremuar” nëpër tekste letrare të njohura për analizat dhe përshkrimet e holla dhe të thella të gjendjeve psikologjike, siç është, p.sh. “Me syrin e një kllouni”*



*(Ansichten eines Clowns) e H. Böll-it<sup>1</sup> për të vjelë ndërtimet dhe mjetet lidhëse shkakore, hasa në një dukuri të çuditshme. Faqe të tëra nuk përmbanin asnjë lidhëz, as një fjali shkakore. Rrallë e tek shfaqej ndonjë weil. Akoma më rrallë da ose denn.*

*Iu ktheva përsëri leximit, u hodha në përkthimin e mrekullueshëm shqip. E njëjta gjë. Në diskutime me kolegët më thanë që përdorimi i lidhjeve shkakore nuk është tipik për letërsinë artistike. Merr ndonjë tekst shkencor. Unë nuk hoqa dorë nga letërsia artistike me idenë dhe ndjenjën fikse se atje jo vetëm gjëllinë, por edhe vlojnë shkakësitë. Ti e ndien me intuitë, me logjikë e ndjenjë se një tekst letrar me shprehësi të spikatur përmban shumë emocione, luhatje dhe luftëra shpirtërore. Ka personazhe që “sa nuk plasin” nga densiteti i mendimeve, ndjenjave dhe përjetimeve, si Hansi-klouni i Heinrich Böll-it. Dhe, ndjenja intensive, emocione, gjendje mendore të tendosura etj. pa shkaqe nuk ka (përveç gjendjeve patologjike). Shkakësia është diku. Po ku? Te folja, implicit.*

*Duke kërkuar shpjegime për dukurinë, që m’u shfaq, dola te shkakësia implicite së cilës i kushtova disa kapituj. Kjo dukuri, kauzaliteti implicit, meriton të trajtohet gjerësisht në gjuhësinë tonë, sidomos në kuadrin e studimeve në fushën e gramatikës së shqipes, gramatikës gjenerative, të teorisë së valencave, të gjuhësisë filozofike, semantikës etj.*

*Mbi të gjitha mungon një trajtim unik, gjithëpërfshirës, monografik i tërë mjeteve e mundësive gjuhësore që shprehin raporte shkakore.*

*Këto mungesa dhe të tjera kanë qenë nxitja e parë që më bënë të ndërmarr një hulumtim të tillë. Në këtë punim do të trajtohen tërë mjetet e shprehjes gjuhësore të raporteve shkakore (jo vetëm lidhëzat). Do të trajtohen gjithashtu foljet ndërvetore që përmbajnë në semantikën e tyre shkakësi implicite.*

*Punimi ka rëndësi teorike, praktike/pragmatike dhe didaktike. Vlera teorike e tij ka të bëjë, para së gjithash, me informacionin e gjerë që ofron. Nga ana tjetër, grumbullimi nën një titull, përfshirja në një koncept të përgjithshëm e çështjeve që janë trajtuar deri më tani (çështje të përgjithshme ose të veçanta, fragmentare, të shpërndara nëpër literaturë), ose që nuk janë trajtuar, është, pa dyshim, me interes teorik. Studime të tilla bëjnë akoma më të qartë përmbajtjen e konceptit shkakësi. Referimi në teoritë e reja lidhur me shkakësinë, mbështetja, citimi, formulimi i koncepteve të reja janë gjithashtu një prurje në kuadrin teorik të kësaj dukurie.*

*Punimi ka dhe interes pedagogjik - didaktik. Gjithnjë e më tepër shtohen sot kritikant në adresë të nxënësve, nganjëherë dhe të studentëve, që paraqesin dobësi të theksuara në rrokjen e koherencës, organizimit të tekstit. Ata nuk janë në gjendje të interpretojnë një tekst, ca më pak të konceptojnë dhe të hartojnë një tekst koherent. Marrëdhëniet shkakore, krahas atyre kohore dhe hapësinore, zënë një vend qendror në koherencën e tekstit. Kuptimi dhe realizimi i drejtë i tyre ndihmojnë së tepërmi në kuptimin e mbarë tekstit dhe në hartimet tekstore. Punimi në vijim tregon, ndër të tjera, se problemi i paraqitjes së raporteve shkakore është më i komplikuar se përshkrimet e dhëna në gramatikat shkollore.*

---

<sup>1</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963

*Metoda kontrastive e punimit vë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë e dy gjuhëve (në rastin tonë pa afri gjenetike). Analiza të tilla mund të integrohen në çdo formë e nivel të mësimdhënies së gjermanishtes.*

*Përvetësimi i lidhëzave kauzale të gjuhës gjermane nuk rrjedh pa probleme. Me anë të një krahasimi konsekuent midis shkakoreve në gjuhën shqipe dhe përgjegjëseve të tyre në gjuhën gjermane lehtësohet shumë ky përvetësim. Edhe analiza krahasuese korpusore, hetimi i lidhëzave në korpus, ndihmon në përmirësimin e kompetencës praktike në gjuhën e huaj, forcon vetëdijen gjuhësore dhe qëndrimin kritik ndaj literaturës. Trajtime të tilla janë interesante dhe ndihmësjellëse edhe në fushën e teorisë së përkthimit.*

*Përsa i përket vlerës dhe rëndësisë pragmatike të leximit, perceptimit dhe interpretimit të dukurive shkakore qoftë në botën që na rrethon, qoftë të realizuara gjuhësisht, do të ndalem vetëm në një fushë veprimtarie dhe përdorimi. Kjo nuk do të thotë që shkakësia shfaqet ose është e përqëndruar vetëm këtu. Është fjala për botën e krimin, të shkeljeve, të ligjeve dhe ligjërimit juridik. Këtu vlen ajo thënia që më ka rënë shpesh në sy gjatë hulumtimit të shkakësisë implicite: „Një folje flet sa për 100 fjalë“. Një kapacitet të tillë logjiko-semantik kanë foljet ndërvetore (interpersonale) që do t'i trajtoj në një kapitull të veçantë. Folje të tilla përdoren rëndom në ligjërimit juridik. Zakonisht ato janë dyvalente, domethënë hapin vend për dy argumente (gjymtyrë të detyrueshme). Njëra gjymtyrë shënon shkakun – shaktarin, tjetra pësuesin – përjetuesin. Është me rëndësi jetike të saktësohen dy madhësitë: shaktari dhe viktima. Folja vetë emërton procesin, gjendjen, referon te dy argumentet e saj, më tej hesht. Shpesh duhet një lexim e një interpretim për t'i dalluar dy gjymtyrët ndërvepruese.*

*Punime e studime të tilla kanë rëndësi dhe në pikëpamje letraro-artistike, për hartuesit e teksteve letrare dhe për lexuesit e tyre. Analiza të tilla mbi përdorimin e mjeteve, që shprehin shkakësi eksplicite ose implicite, ndihmojnë shumë në analizën tekstore, në receptimin e përmbajtjeve, në interpretimin e thellë të veprave letrare, ku letërsia dhe gjuhësia janë në unison.*

*Punimi jep dhe modele metodologjike, të cilat kanë të bëjnë, sidomos, me paragrafët mbi konceptin filozofik të shkakësisë. Shumë teori gjuhësore mbështeten fuqimisht mbi teori filozofike. Nga punimi ynë mund të përmendim si të tilla: teorinë e kauzalitetit implicit në foljet psikologjike, në foljet e veprimit, në ato komunikative e ndonjë rast tjetër.*

*Përshkrimi filozofik i dukurisë dhe ligjësisë mbi shkakësinë mund të shërbejë si metodologji e metodë pune në hulumtime llojesh të ndryshme. P.sh.: Shpjegimi hajdegerian mbi shkakun e rikthyer ka dhe vlerën e një udhëzimi për çdo hulumtim. Ky shpjegim përmban kornizën e përgjithshme të një akti njohjeje të zakonshme dhe të një njohjeje ose zbulimi shkencor. Subjekti njohës qëndron para objektit, ose vendos para tij objektin, që do të njohë, duke i gjetur pse-në e ekzistencës.*

*Çdo tezë filozofike është metodë, metodologji, këndvështrim dhe shpjegim i objekteve studimore.*

### 0.2 Objekti i studimit dhe hipotezat

*Qëllimi i këtij punimi është që në kuadrin e një studimi përmasës e krahasues të përshkruajë një pjesë të rëndësishme të mjeteve gjuhësore që përdoren në shqip dhe në gjermanisht për realizimin e marrëdhënieve shkakore.*

*Duke pranëvënë dhe krahasuar mjetet shprehëse të realizimit të marrëdhënieve, shkakore në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën e folur në të dyja gjuhët – mjetet shprehëse eksplicite dhe mënyrat implicite të realizimit të marrëdhënieve shkakore – hidhet dritë mbi të përbashkëtat dhe ndryshimet midis tyre.*

*Gjatë hulumtimit dhe përshkrimit të objektit tonë jemi orientuar drejt sqarimit të çështjeve të tilla që përbëjnë edhe hipotezat e punës sonë:*

- *Hetimi dhe paraqitja shteruese e mjeteve gjuhësore, shprehëse të marrëdhënieve shkakore në të dyja gjuhët.*
- *Krahasimi i hollësishëm i mjeteve shprehëse për të vënë në dukje ngjashmëritë dhe dallimet në rrafshet morfologjike, sintaksore, semantike, pragmatike, stilistikore.*
- *Roli dhe ndikimi i konceptit filozofik mbi shkakësinë në teorinë dhe interpretimet gjuhësore.*
- *Shprehja implicite në të dyja gjuhët.*
- *Foljet ndërvetore si mjet i rëndësishëm i realizimit të shkakësisë implicite.*
- *Krahasimi i strukturave argumentore të foljeve interpersonale.*
- *Evidentimi dhe funksioni i mjeteve dhe mënyrave të realizimit të marrëdhënieve shkakore në korpuse të ndryshme në shqip dhe në gjermanisht.*

### 0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit

*Punimi ynë është, para së gjithash, një trajtim kontrastiv sinkronik. Sipas konceptit tonë kontrastues janë evidentuar jo vetëm ndryshimet, por dhe ngjashmëritë e mjeteve lidhore shkakore në shqip e në gjermanisht. Ndryshimet kryesore janë në fushën e sintaksës, por nuk duhen shpërfillur dhe ndryshimet në veçoritë semantike-pragmatike. Një mënyrë e tillë analize është me interes për gjuhësinë teorike dhe për gjuhësinë e aplikuar.*

*Metoda kontrastive shtrihet dhe në një prej analizave korpusore që përbën një kapitull të rëndësishëm në punimin tonë. Dy korpuse paralele krahasohen për sa i përket llojit dhe përdorimit të lidhëzave shkakore. Në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“, në origjinal dhe në përkthimin gjermanisht janë qëmtuar tërë lidhëzat shkakore, janë analizuar ato në kontekstet ku shfaqen, duke vënë në dukje veçoritë e tyre sintaksore, semantike, pragmatike. Krahasimi midis konstrukteve shkakore në shqip e në gjermanisht ndriçon më mirë semantikën dhe vlerat përdorimore të lidhëzave.*

*Metoda historiko-diakronike zë një vend të vogël në mënyrën e vëzhgimit dhe në analizën e objektit tonë. Është fjala për trajtimin e lidhëzave shkakore në përmbledhjen „Vepra“ të Th. Mitkos dhe në „Meshar-in“ e Buzukut. Edhe për*

*gjuhën gjermane është dhënë një informacion i shkurtër historik mbi zhvillimin semantik të disa lidhëzave shkakore në rrjedhë të kohës.*

*Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe metodën ilustrive statistike. Statistikat janë gjithnjë një argument i fortë në përshkrimin e veçorive të një dukurie, në rastin tonë të shkakësisë. Në metodën statistike mund të përfshijmë dhe listat (pothuaj shteruese). Pas trajtimit të çdo klase me funksion lidhor shkakor është dhënë lista e tërë përbërësve të kësaj klase, si p.sh.: lista e lidhëzave shkakore në shqip e në gjermanisht, parafjalët me kuptim shkakor në shqip e në gjermanisht, ndajfoljet lidhore shkakore etj.*

*Ky punim shpaloset në sfondin e disa teorive. Hetimi dhe paraqitja e raporteve dhe e lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe, trajtuar në kapitullin e katërt, mbështetet në teorinë shqiptare të paraqitura në Gramatikën e Gjuhës Shqipe I, II dhe në artikujt e S. Floqit, botuar në „Studime Filologjike“. Sipas këtyre teorive dallohen dy lloje raportesh shkakore: raporte shkakore konstatuese dhe raporte shkakore arsyetuese.<sup>2</sup> Edhe vështrimin e lidhëzave të Th. Mitko e kemi mbështetur në këtë bazë teorike.*

*Trajtimin e mjeteve të tjera lidhëse shkakore, si parafjala, ndajfolja, foljet kauzative e kemi mbështetur teorikisht në një nga veprat e pakta që i kushtohet tërësisht dukurisë gjuhësore të shkakësisë dhe që titullohet „Kausalität als linguistische Kategorie“ të B. Schmidhauser-it. Në teorinë e trajtuara ose të zhvilluara nga ai, si dhe në trajtime të tjera teorike jemi mbështetur për të analizuar mjetet gjuhësore që shërbejnë për lidhjen e gjymtyrëve të një raporti shkakor në gjuhën gjermane. Vlen të përmenden dhe punimet tejet interesante të R. Pasch-it dhe E. Rudolf-it, të cilat i kemi pasur parasysh në trajtimin e lidhëzave shkakore në gjermanisht. Lidhur me teorinë e përdorura në këtë rast kemi dhënë informacion në kapitullin përkatës. Ka qenë një nga synimet tona grumbullimi dhe referimi në teori nga më të ndryshmet. Kjo ndihmon në zbulimin dhe vështrimin e objektit nga kënde të ndryshme vëzhgimi, ndihmon kështu, përshkrimin më të plotë, më domethënës dhe dobiprurës të tij.*

*Një teori tjetër interesante që ka të bëjë më shumë me rrokjen dhe interpretimin e marrëdhënieve shkakore është ajo e M. Pit-it mbi subjektivitetin dhe shkallën e tolerancës në përdorimin dhe leximin e ndërtimeve shkakore.<sup>3</sup>*

*Në analizën e dy korpuseve paralele („Gjenerali i ushtrisë së vdekur“) jemi mbështetur dhe në teorinë e sapopërmendur. Njëkohësisht kemi shfrytëzuar teorikisht tezën e njohur të Sweetser-it mbi tri mënyrat e leximit/ interpretimit të ndërtimeve shkakore, i cili dallon, të paktën, tri mënyra parafrazimi të së njëjtës fjali shkakore: dispozicionale, epistemike, deontike.*

*Si koncept bazë në shpjegimin e semantikës së elementeve të fushës shkakore kemi pasur mendimin e Lang-es mbi kuptimin operativ (operative Bedeutung) të këtyre elementeve. Lang-e dallon tri lloje kuptimesh: kuptimin nocionor, kuptimin referencial dhe kuptimin operacional. Ai shpjegon me terma të logjikës formale llojet e ndryshme të kuptimeve. Kuptimi nocionor është veçori e emrave, foljeve, mbiemrave, ndajfoljeve. Kuptim referencial manifestojnë përemrat dhe fjalët përemërore. Ndërsa kuptimi operacional është veçori e lidhëzave dhe mjeteve të tjera lidhëse. Lidhëzat nuk referojnë në sende, dukuri, veprime, cilësi të botës reale, por*

---

<sup>2</sup> Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Tiranë, 2002, f. 563.

<sup>3</sup> Pit, Marina, *How to express yourself with a causal connectiv*, Amsterdam, 2003.

kryejnë një funksion, sinjalizojnë për një lidhje midis elementesh gjuhësore (fjalë, fjali etj.)

Vlen të përmend veçanërisht teoritë e shumta mbi shkakësinë implicite. Dukuria dhe shpjegimi i shkakësisë implicite kanë pamjen e një fushe të pafund studimi. Ndër zërat më të shquar në studimin e foljeve psikologjike në kuadrin e teorisë së valencave, me të cilët jam njohur gjatë punës sime, janë: Dowty, Gramschaw, Primus, Kutscher, Rudolpf etj. Duke hetuar dukurinë e shkakësisë implicite për të gjetur burime të tjera të saj, dola në fushën e gjerë të foljeve të veprimit, të foljeve performative-komunikuese e të disa mjeteve të tjera gjuhësore, si emra, mbiemra, ndajfolje, që rrezatojnë shkakësi e që lidhen me foljet përkatëse për nga formimi dhe kuptimi. Në trajtimin e këtij grupi m'u desh disa herë herë të jap mendime e të mbaj qëndrime vetiake. Literatura që përdora si pikënisje ose si mbështetje është, përgjithësisht, e fushës filozofike ose filozofike gjuhësore. Meqë ligji i shkakësisë është ligj themelor në zhvillimin e ndryshimin e botës, („Nihil est sine ratione“. Asgjë nuk ndodh pa shkak)<sup>4</sup> nuk mund të merresha me këtë dukuri në planin gjuhësor pa e përqasur atë me konceptin filozofik mbi shkakësinë. Madje, teoritë mbi kauzalitetin implicit të foljeve ndërretore kanë një mbështetje të dukshme në literaturën filozofike. Në këtë fushë ndodh që të fshihen kufijtë midis gjuhësisë dhe filozofisë. Dihet që foljet/thëniet performative janë objekt studimi i teorisë së aktit ligjërimit, që përfshihet në rrymën e filozofisë analitike gjuhësore. Rruga më nxori kështu te Austin-i dhe Searle. Krahas veprave të tyre („Zur Theorie der Sprechakte“ dhe „Sprechakte“) përdora si literaturë dhe vepra autorësh të tjerë që janë marrë me shpjegimin, komentimin dhe përpunimin e kësaj teorie. Një zbulim dhe një surprizë për mua në rrugën e gjatë dhe të vështirë të hartimit të temës së ndërmarrë ishte Gizela Harras-i, një lingviste par excellence në fushën e aktit ligjërimit (gjuhësi filozofike-analitike). Në librin e saj „Handlungssprache und Sprechhandlung“<sup>5</sup> ajo analizon qartë dhe plotëson bindshëm Austin-in dhe Searle-n. Ishte për mua një dritare e hapur në botën e kauzalitetit implicit. Sa herë jam gjendur para vështirësish të ndryshme gjatë punës për kapitujt mbi kauzalitetin implicit të foljet e veprimit dhe të foljet komunikative, jam kthyer dhe rikthyer tek ajo për të gjetur shpjegime dhe konfirmime.

Ndihmë e madhe për mua ka qenë dhe njohja me „Textgrammatik der deutschen Sprache“, botim i „Dudenverlag“, vepër e Harald Weinrich-ut. Në analizat e ndryshme tekstore jemi mbështetur jo rrallë në teoritë e H. Weinrich-ut, të cilat i kam interpretuar ose ndonjëherë dhe plotësuar me mendime vetiake. Një sfond interesant teorik për mua ka qenë teoria estetike receptive e Dietrich Krusche-s. Ajo më ka ndihmuar në interpretimin e disa dukurive letrare-tekstore.

Lexuesi i këtij punimi do të verë re që janë përdorur dhe shumë teori, qëndrime dhe interpretime të tjera. Shumica e literaturës është në gjuhë të huaj, sepse, siç kemi thënë, në letërsinë tonë gjuhësore ka mungesë studimesh në këtë fushë, sidomos në lëmin e shkakësisë implicite.

Përsa i përket strukturës ky punim përmban dymbëdhjetë kapituj:

---

<sup>4</sup> Shih, Heidegger, M., *Der Satz vom Grund, Gesamtausgabe, II. Abteilung, Band 24*, Frankfurt am Main, 1997, f.37.

<sup>5</sup> Harrasi, G., *Handlungssprache und Sprechhandlung*, Berlin, de Gruyter, 1993.

*Në kapitullin e parë paraqitet kuadri i përgjithshëm në të cilin përfshihet objekti ynë i vëzhgimit. Një vend të veçantë në këtë kapitull zë paragrafi që trajton konceptin filozofik mbi shkakësinë.*

*Principi kauzal ka një rëndësi të veçantë në perceptimin dhe konceptimin e botës nga njeriu. Ky princip bazohet në pranimin e një shkakut për çdo ngjarje. Nuk ndodh asgjë pa një arsye, pa një shkak.*

*Principi kauzal ka gjetur në linguistikë një truall të përshtatshëm zbatimi. Teoritë dhe përshkrimet e ndryshme që merren me foljet “psikologjike” (Psychverben) mbështeten të gjitha në principin filozofik kauzal. Disa e shprehin hapur mbështetjen, të tjera ndjekin implicit linja, ide dhe koncepte filozofike.*

*Në paragrafin kushtuar konceptit filozofik ne jemi ndalur veçanërisht te Husserl-i dhe te Heidegger-i, dy nga filozofët më të mëdhenj të kohës sonë. Teoria e reduktimit fenomenologjik të Husserl-it është një substrat i mirë edhe për mendimin gjuhësor, zbatimi i saj si këndvështrim i objektit të studimit përbën një metodë dhe një metodologji interesante, që premtonte rezultate të padiskutueshme. Heidegger-i e fillon veprimtarinë filozofike si nxënës i Husserl-it. Më vonë ai doli në rrugë të tjera dhe disa herë iu kundërvu mësuesit të tij. Në rastin tonë ne nuk jemi marrë me të gjithë veprën e Heidegger-it, por me dy vepra, ku ai trajton konceptin e tij filozofik mbi shkakësinë. Edhe pse në princip koncepti i shkakësisë është ai, që formuloi Platoni, ai që shpjegoi Aristoteli, edhe pse Heidegger-i në veprën e tij “Der Satz vom Grund” (Ligji i shkakësisë) përshkruan dhe analizon hollësisht ligjin e shkakësisë të formuluar nga Leibniz-i, mendimi i tij origjinal përshkon tejprtej dhjetë leksionet që përmban vepra në fjalë. Ideja e shkakut të “rikthyer” është çelësi për të hapur portën e botës së shkaqeve dhe për të kuptuar çdo ekzistencë e çdo ekzistues.*

*Konceptit filozofik mbi shkakësinë i jemi kthyer e rikthyer disa herë gjatë punimit tonë. Ka qenë diçka e domosdoshme për të shpjeguar çështje semantike, sidomos dukuri semantike implicite. Filozofia me teorinë e saj na ka ndihmuar në interpretimin e shumë dukurive që përbëjnë tematikë të re në gjuhësinë shqiptare dhe në atë joshqiptare. Mund të përmendnim këtu dukurinë e foljeve psikologjike, foljeve të veprimit, të komunikimit, të cilat përmbajnë shkakësi implicite.*

*Pastaj kalohet në shkakësinë si kategori gjuhësore, ku jepen veçoritë e kësaj kategorie duke e dalluar atë nga shkakësia filozofike.*

*Kapitulli i dytë merret gjithashtu me një paraqitje të zonave periferike të objektit tonë. Këtu jepen zonat gjuhësore që e furnizojnë me elemente shprehjen e shkakësisë. Janë disa klasa fjalësh, elemente të të cilave shërbejnë për ndërtim raportesh shkakore. Të tilla janë: lidhëzat shkakore, disa lidhëza kohore, paraafjalët, ndajfoljet, pjesëzat, një grup i caktuar foljesh në formë të shtjelluar, forma të pashtjelluara foljore.*

*Në kapitullin e tretë vihen në fokus realizimet e marrëdhënieve shkakore në gjuhën shqipe. Duke hetuar shprehjen e shkakësisë në gjuhën e sotme nuk jemi ndalur vetëm në lidhëzat shkakore, por kemi analizuar tërë arsenalin e mjeteve që përdoren në gjuhën shqipe për të shprehur marrëdhëniet shkakore. Në paragrafë të veçantë janë paraqitur foljet kauzale, lidhëzat nënrenditëse shkakore, lidhëzat kohore me vlerë shkakore, paraafjalët me kuptim shkakor, ndajfoljet lidhore, ndajfoljet pyetëse, format e pashtjelluara pjesore dhe përcjellore, fjalitë përcaktore. Kapitulli përmban dhe listat e lidhëzave, paraafjalëve, ndajfoljeve me kuptim shkakor si dhe përfundimet përkatëse.*

*Kapitulli i katërt titullohet „Një panoramë e përdorimit të lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe“. Për të realizuar këtë përshkrim-panoramë të përdorimit të lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe kemi përdorur korpuse të ndryshme. Në zgjedhjen e korpusit jemi nisur nga kriteret kohore, tematike, stilistike, tekstore.*

*Ciklin e paraqitjes së peisazhit lidhëzor-shkakor të gjuhës sonë e kemi hapur me një ekspozitë të sistemit lidhëzor, dhe në këtë kuadër të atij lidhëzor-shkakor, të përdorur në „Mesharin“ e Gjon Buzukut. Pas kësaj vijojnë përshkrime të sistemit lidhëzor-shkakor të „Vepra“ e Th. Mitkos, të „Dhiata e re dhe psalme“ etj.*

*Kapitulli i pestë i kushtohet paraqitjes së mjeteve gjuhësore që përdoren për realizimin e marrëdhënieve shkakore në gjuhën gjermane. Në një pamje të përgjithshme mund të flitet për një lloj simetrie midis gjermanishtes dhe shqipes në shprehjen e raporteve shkakore. Edhe gjermanishtja ka në dispozicion mjete si: lidhëzat shkakore, parafjalët me kuptim shkakor, ndajfoljet lidhore e pyetëse, pjesëzat, foljet kauzale, disa lidhëza kohore, forma të pashtjelluara foljore, fjali përcaktore.*

*Por brenda klasëve të marra në veçanti ka dallime të dukshme midis mjeteve në gjermanisht e në shqip. Dallimet janë jo vetëm sasiore, por dhe sintaksore e përdorimore.*

*Për të vënë më mirë në dukje këto dallime kemi hartuar një kapitull, kapitullin e gjashtë, ku ballafaqohen mjetet shprehëse shkakore të të dyja gjuhëve. Me anë tabelash e shpjegimesh jepem veçoritë e përbashkëta dhe dallimet midis tyre.*

*Kapitulli i shtatë ka për objekt një korpus letrar. Është fjala për romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“. Në këtë roman, në origjinal dhe në përkthimin gjermanisht janë hulumtuar lidhëzat shkakore. Me anë të hulumtimit është vërtetuar se ndërtimet shkakore kanë specifikën e tyre në tekstet letrare. Në tekstet letrare mbizotëron tipi modal i ndërtimeve shkakore, tipi epistemik dhe deontik. Përsa u përket gjymtyrëve të ndërtimeve shkakore, gjymtyra shkak është më tepër një motiv, një argument, ose një shkak subjektiv, në dukje i tillë. Ndërsa gjymtyra pasojë është, në shumicën e rasteve, një rrjedhim, si në të gjitha marrëdhëniet shkakore modale.*

*Përkthyesit e romanit, albanologët e njohur O. Buchholz-i dhe W. Fiedler-i, në rrëfimin e tyre në gjermanisht ndjekin relievin konceptor-emocional të origjinalit.*

*Në këtë kapitull analizohen me hollësi tërë lidhëzat shkakore të përdorura nga I. Kadareja dhe përgjegjëset e tyre në përkthimin gjermanisht. Lidhëzat nuk vështrohen si segmente të izoluar, por vështrohet tërë ndërtimi shkakor, ndonjëherë vështrimi hidhet dhe përtej ndërtimit, në kontekst. Mënyra jonë e shpjegimit dhe e interpretimit të ndërtimeve shkakore të përdorura në romanin e I. Kadaresë është, në princip, një mënyrë hermeneutike, me anën e së cilës synohet zbërthimi dhe paraqitja e domethënies së lidhjeve shkakore. Krahas kuptimit është vëzhguar dhe vlera emocionale-stilistike e ndërtimeve shkakore.*

*Kapitulli i tetë përmban disa paragrafë që trajtojnë shfaqjen dhe përdorimin e lidhëzave shkakore në ligjërimin e folur.*

*Kapitulli i nëntë i kushtohet kauzalitetit implicit. Në pika e në paragrafë të veçantë trajtohet gramatika e foljes, grupi i foljeve ndërretore, foljet që tregojnë gjendje shpirtërore si pjesë përbërëse e grupit të foljeve interpersonale, struktura argumentore e këtyre foljeve etj.*

*Pjesë përbërëse e këtij kapitulli, lidhur ngushtë me të, duhet parë dhe ekspozita e fundit e këtij kapitulli. Në të paraqiten rezultatet e një pune eksperimentale kolektive*

ku është synuar të aplikohen teoritë e ndryshme në një terren të gjerë dhe konkret gjuhësor. Në një listë që përmban afro 700 folje të gjuhës shqipe janë evidentuar foljet ndërvetore-psikologjike. Ato janë hartuar më tej në tabela duke vënë në dukje strukturën e tyre argumentore dhe sidomos realizimin/leksikalizimin e roleve semantike. Krahas foljes në gjuhën shqipe është dhënë dhe përgjegjësja në gjuhën gjermane.

Kapitulli i dhjetë ka si objekt kauzalitetin implicit në foljet e veprimit. Një veprim i shprehur mund të sqarohet duke dhënë një arsye ose një justifikim. Si arsye, si shkaqe të veprimeve, ndodh të jenë qëllimet, qëndrimet, preferencat etj. Çështja e raportit midis veprimeve dhe shkaqeve të tyre trajtohet në disa paragrafë. Kjo çështje shtrohet kështu: a janë foljet e veprimit folje kauzale apo jo? A e përmbajnë foljet e veprimit në semantikën e tyre kuptimin e shkakësisë? Kapitulli rreh t'u përgjigjet këtyre pyetjeve. Përdoren shumë referenca dhe argumente për të arritur në përfundimin që foljet e veprimit përmbajnë kauzalitet në semantikën e tyre.

Nga argumentet, që na u dukën më bindëse në trajtimin e dukurisë në fjalë, është formulimi i Davidson-it: arsyet, që japim për të shpjeguar veprimet tona, duhen marrë, konceptuar si shkaqe të tyre. Është dhe një thënie proverbiale që paraqet thelbin e shkakësisë në foljet ndërvetore të veprimit duke e dalluar nga shkakësia natyrore: Natyrën ta shpjegojmë, shpirtin ta kuptojmë.<sup>6</sup>

Kapitulli i njëmbëdhjetë merret me foljet e komunikimit. Nën këtë emërtim, në këtë koncept, përmbledhen foljet e tipit them, flas, tregoj (verba dicendi), foljet e mendimit, gjykimit gjykoj, arsyetoj, konceptoj, mendoj (verba cigitandi), si dhe folje të tjera performative. Ndërsa foljet konstative përshkruajnë ose, thjesht, konstatojnë diçka, foljet performative shprehin dhe qëndrimin e folësit mbi domethënien konstatauese të foljes.

Në gjuhësinë e sotme analiza e tyre bëhet në zonën e përbashkët, ku takohet gjuhësia tradicionale me pragmatikën. Foljet performative kanë dy funksione: a) janë folje të zakonshme që shënojnë një veprim a proces; b) shprehin njëkohësisht një qëllim, synojnë të arrijnë diçka. Lista e foljeve performative është e hapur, se në këtë grup përfshihen sasira të ndryshme nga autorë të ndryshëm: them, konstatoj, njoftoj, përgjigjem, falenderoj, lutem, zitoj, precizoj, përcaktoj, përjashtoj etj.

Foljet performative luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien e ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë. Ato, si dhe foljet e tjera ndërvetore (psikologjike, të veprimit) fshehin brenda tyre kauzalitet, domethënë nënkuptojnë shkakësi: Po ku e mbështesim në këtë konsideratë?

Foljet e komunikimit si folje performative, që synojnë një ndikim mbi bashkëbiseduesin me anë të shprehjes foljore, kanë tipare të përbashkëta me foljet e veprimit. Synimi/qëllimi që ato shprehin vlen si arsye për pasojën që rrjedh në aktin perlokutiv.

Kapitulli i dymbëdhjetë përmbledh hulumtime dhe analiza në kuadrin e interpretimit të tekstit nga pikëpamja e përdorimit të foljeve (dhe elementeve të tjera) që përmbajnë në semantikën e tyre shkakësi implicite.

Foljet ndërvetore (psikologjike, të veprimit, të komunikimit) përdoren në tekstet letrare me funksione të ndryshme. Një ndër funksionet është ai i paraqitjes autentike të botës dhe të rrethanave njerëzore. Ato janë një rrugë nga hyjnë qëllimet dhe arsyet

---

<sup>6</sup> Jung, M., *Dilthey zur Einführung*, Hamburg, Junius Verlag, 1996, f. 38.



*që i shoqërojnë bëmat e personazheve. Edhe nëse në tekst e në kontekst nuk jepet eksplisit shkakun ose arsyeja, mjafton folja për ta nënkuptuar atë.*

*Në romanin e Böll-it raportet shkakore të dhëna implicit përbëjnë përftesa interesante që e bëjnë tekstin më ndikues dhe lexuesin më aktiv e të interesuar. Në shtjellimet tona ne kemi prezantuar dhe shpjeguar rastet e manifestimit të shkakësisë implicite, lokalizimin e saj në foljet psikologjike, foljet e veprimit, foljet performative-komunikative, në fraza emërore, mbiemërore, ndajfoljore.*

*Sigurisht jemi ndalur gjatë dhe në funksionet e kauzalitetit implicit në tekstin letrar të Böll-it. Nga mënyra e konceptimit dhe e prezantimit teksti letrar, në fjalë, mund të klasifikohet i llojit psikologjik. Kështu në përmbajtjen e romanit mbizotërojnë përjetimet psikologjike ndaj aksionit. Kjo shprehet me një përdorim të dendur të foljeve ndërvepruese që shënojnë gjendje psikologjike. Foljet psikologjike, emrat, mbiemrat, ndajfoljet me vlerë psikologjike, që kemi qëmtuar në hulumtimin tonë, kanë si funksion kryesor dhënien e emocionalitetit si komponent shumë i rëndësishëm në një tekst letrar.*

*Analiza të tilla mbi përdorimin e mjeteve, që shprehin kauzalitet implicit, ndihmojnë shumë në analizën tekstore, në receptimin e përmbajtjeve, në interpretimin e thellë të veprave letrare, ku letërsia dhe gjuhësia funksionojnë të lidhura ngushtë.*

*Punimi mbyllet me përfundimet.*

## Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht

### Kreu I „Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht“

#### I.1 Koncepti filozofik mbi shkakësinë

Shkakësia (nga latinishtja: causalitas) është lidhja, marrëdhënia e shkakut me pasojën. Nocioni që shpreh termi shkakësi ka përmbajtje të ndryshme në fusha të ndryshme të dijes. Gjithashtu përmbajtja e termit në sferat e ndryshme të veprimtarisë njerëzore ka ndryshuar historikisht, nga koha në kohë. Kështu në lashtësinë greke Aristoteli dallon katër lloje shkaqesh. Kjo ide e Aristotelit mund të ilustruhet me shembullin e thjeshtë: Një shtëpi përbëhet nga gurë (shkak material), shtëpisë i jepet një formë e caktuar (shkak formal), shtëpia vihet në përdorim (shkak ndikues), shkak i katërt emërtohet shkak i qëllimit që ka të bëjë me qëllimin, destinimin e ndërtimit. Të katër llojet e shkaqeve formojnë një përmbajtje unike, shkakun në përgjithësi.<sup>7</sup>

Mendimin e Aristotelit mbi konceptin shkak po e paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Emërt. tradicional	Shpjegimi	Shembull: <i>shkaku i një shtëpie</i>
Shkak material	Causa materialis	Diçka, nga e cila ndërtohet/bëhet një gjë dhe që përmbahet në të	Tulla, gurë, dërrasa etj.
Shkak formal	Causa formalis	Struktura e diçkaje, ndërtimi, përbërja e saj, forma	Plani i ndërtimit etj.
Shkaku ndikues/i lëvizjes	Causa efficiens	Diçka nga e cila vjen shtypja lëvizëse, vendosja e qetësisë, vlera ndikuese	Arkitekti etj.
Qëllimi, përdorimi	Causa finalis	Qëllimi, arsyeja përse ndodh diçka	Mbrojtje nga moti i keq etj.

Më vonë, në kohën e re, shkencat e natyrës zhvilluan një koncept mekanik të shkakësisë (një shkak vepron mekanikisht dhe prodhon pasojën), ndërsa Hjum e vështron shkakësinë si mënyrë të vështrimit të botës nga njeriu. Sipas tij shkakësia nuk ekziston në botën e jashtme, por në shpirtin konceptues të njeriut. Njeriu, duke vërtetuar botën e jashtme, vë re se dukuri e ngjarje të ndryshme rrjedhin duke ndjekur njëra-tjetrën në kohë. Nga përsëritja e shpeshtë e këtij fenomeni njeriu e ka konceptuar këtë rrjedhë njëra pas tjetrës në kohë si lidhje shkakore.

Kanti e përcakton kauzalitetin si kategori. Për të marrëdhënia shkak-pasojë ekziston a priori. Çdo objekt i njohjes njerëzore është në princip pasojë e një shkak.

Principi i shkakësisë në fizikë ka pak a shumë këtë përkufizim: Çdo ndryshim që ndodh në kohë dhe në hapësirë ka shkakun e vet. Në këtë kuadër konceptual Lajbnic

<sup>7</sup> Shih, Aristoteles, *Metaphysik*, Reclam, 1970, V. Buch, f. 113- 116.

## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

bën fjalë për një koncept vazhdimësie të shkaqeve dhe pasojave. Ky është princip zotëruar në fizikën klasike.

Në vijim ne do të merremi me dy nga filozofët më të mëdhenj të kohës së sotme, teoritë e të cilëve i kanë kapërcyer prej kohësh kufijtë e vendeve, ku janë lindur, duke bërë epokë e jehonë kudo, ku janë shfaqur.

I.1.1 Edmund Husserl-i: “Ich bin, alles Nicht-Ich ist bloß Phänomen.” (Unë jam; gjithçka jo-unë është veç fenomen.)

Koncepti huserlian mbi kauzalitetin shprehet qartë në thënien e tij:

„Unmittelbar gegeben ist mir nur mein Bewusstsein; die äußere Welt ist mir nur mittelbar durch Erscheinungen im Bewusstsein gegeben. Schlüsse von unmittelbar Gegebenen auf mittelbar Angenommenes vollziehen wir als Wahrscheinlichkeitschlüsse auf dem Boden der natürlichen Erfahrungswelt. Es sind Kausalschlüsse.“ (Direkt mua më është dhënë vetëm ndërgjegjja; bota e jashtme më jepet në mënyrë indirekte me anë të fenomeneve në ndërgjegje. Përfundimet e nxjerra nga konceptimi i fenomeneve në ndërgjegjen tonë mbështeten në truallin e eksperiencës sonë të natyrshme mbi botën. Këto kanë natyrë kauzale.)<sup>8</sup>

Në vitin 1918 Europa gjendej në gërmadha, e shkatërruar nga lufta më e keqe në historinë njerëzore. Nga mbarimi i kësaj katastrofe kontinenti u përfshi nga një valë revolucionesh sociale. Vitet 1920 do të përjetonin ngjarje të tilla si kryengritjet në Berlin, grevën e gjeneralëve në Vjenë, themelimin e këshillave të punëtorëve në Mynih dhe Budapest, pushtimin e fabrikave nga masat në tërë Italinë. Tërë këto lëvizje u shtypën me dhunë. Por rendi kapitalist europian u trondit gjer në rrënjë nga lufta gjakderdhëse e nga kryengritjet politike që pasuan. Ideologjitë në të cilat mbështetej ky rend, vlerat kulturore që e karakterizonin atë u gjendën dhe ato në tronditje të thellë. Shkenca e dëmtuar sa më s’ka mbështetej në një pozitivizëm steril, në disa bindje dritëshkurtëra mbi kategorizimin e fakteve. Filozofia anonte herë në një pozitivizëm të tillë, herë në një subjektivizëm jo solid. Morën hov forma të relativizmit e të irracionizmit. Kjo krizë e përgjithshme pasqyrohej dhe në art.

Në këtë kontekst të krizës ideologjike filozofi gjerman, Edmond Husserl-i, përpiquej të zhvillonte një metodë të re filozofike e cila do të mund t’i sillte siguri qytetërimit të shkatërruar. Në veprën e tij „Kriza e shkencës europiane“ (1936) Husserl-i shkruante se ai duhej të zgjidhte midis barbarisë irracionaliste, nga njëra anë, dhe rilindjes shpirtërore me anë të shkencave shoqërore, nga ana tjetër. Ashtu si pararendësi i tij, Rene Deskart-i, Husserl-i e fillon kërkimin e sigurisë duke iu referuar asaj që ai e quan *rregullim i natyrshëm i konceptimit të përditshëm të botës nga njeriu*. Sipas tij njeriu rrok sendet dhe dukuritë që ekzistojnë në botën përreth. Dijet tona mbi to janë të sakta. Një koncept i tillë e sheh mundësinë njohëse si diçka që vetëkuptohet.

Megjithëse ekzistenca e pavarur e sendeve nuk mund të jetë e sigurtë për ne, mënyra se si ata paraqiten në ndërgjegjen tonë është e sigurtë, pavarësisht në formë intuitive ose jo. Objektet nuk mund të shqyrtohen si sende në vetvete, por si sende që rroken nga ndërgjegjja. Ndërgjegjja është gjithmonë ndërgjegje e diçkaje. Nëse unë mendoj, jam i ndërgjegjshëm që mendimi im drejtohet në një objekt. Vetë mendimi dhe objekti ku ai drejtohet lidhen me njëri-tjetrin së brendshmi, varen nga njëri-tjetri. Ndërgjegjja nuk është vetëm një regjistrim pasiv i botës, por e krijon atë aktivisht.

---

<sup>8</sup> Husserl, E., *Gesammelte Werke, Volume 36*, Berlin, 2003, f. 174.

## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

Për të qenë të sigurtë na duhet, së pari, të injorojmë gjithçka gjendet përtej eksperiencës sonë të drejtpërdrejtë, botën e jashtme ta reduktojmë në përmbajtjen e ndërgjegjes sonë. Dhe ky i ashtuquajtur "reduktim fenomenologjik" është hapi i parë i rëndësishëm i Husserl-it. Çka është jo imanente, e jashtme për ndërgjegjen duhet përjashtuar. Çdo realitet do vështruar mbi bazën e shfaqjes së tij në ndërgjegjen tonë, si fenomen i pastër. Këto shfaqje janë të vetmet realitete nga të cilët mund të nisemi. Fenomenologjia është shkencë e fenomeneve të pastra. Fenomenet e pastra që trajton Husserl-i janë diçka më tepër se dukuri të rastit. Ato janë një sistem përgjithësimesh universale. Fenomenologjia e mban objektin në shqyrtim derisa zbulon se ç'është e pandryshueshme në të. P.sh. dukuri si ngjyra e kuqe ose xhelozia në shfaqjet e tyre konkrete nuk janë njohuri fenomenologjike, por tipi universal, esenca e këtyre dukurive, e kuqja dhe xhelozia në vetvete përbëjnë elemente fenomenologjike. Të rrokët një fenomen në tërësinë dhe në pastërtinë e tij do të thotë të kuptohet ç'është esencialisht e pandryshueshme në të.

Qëllimi i fenomenologjisë është e kundërta e abstraksionit, kjo teori është kthimi në konkretin, në një bazë solide, gjë që jepet dhe me devizën e saj „te vetë sendet“.

Me që fenomenologjia u ngrit në eksperiencën tonë të sigurtë, ajo mund të ishte një bazë për dije të sakta. Ajo mund të ishte shkencë e shkencave që mund të ofronte metoda për studimin e çfarëdo objekti. Ajo shpallej si shkencë e ndërgjegjes njerëzore, ku ndërgjegjia njerëzore nuk shihej si eksperiencë empirike e njerëzve të veçantë, por si një strukturë e thellë e vetë mendimit.

Filozofia kantiane para saj ishte një mënyrë transcendentale kërkimi. Subjekti ose ndërgjegjia individuale që qëndronin në qendër të saj ishin transcendentale. Fenomenologjia nuk vështronte thjesht atë që rrokej me një shikim, p.sh. një lepur, por esencien e përgjithshme të tërë lepujve dhe procesin e konceptimit të tyre. Me fjalë të tjera ajo nuk ishte as formë e empirizmit që merrej me eksperiencë fragmentare të individëve të veçantë, as lloj i psikologjizmit që interesohej për proceset mentale të këtyre individëve. Ajo pretendonte të paraqiste strukturat e ndërgjegjes dhe njëkohësisht vetë fenomenet.

Nga kjo paraqitje e fenomenologjisë del se ajo është një lloj idealizmi që synon të studiojë ndërgjegjen njerëzore dhe botën e fenomeneve të pastra. Sipas fenomenologjisë bota është ajo që unë shoh ose synoj, ajo konceptohet në relacion me mua, si korrelat i ndërgjegjes sime dhe kjo ndërgjegje është transcendentale.

Pozitivizmi i shkencave të shekullit 19- të e kërcënonte botën ta privonte nga subjektiviteti, filozofia neokantiane që diçka e pakët; që nga shekulli i 19-të në truallin e shkencave europiane lindi dyshimi serioz në teoritë tradicionale që pranin se njeriu mund ta kontrollojë fatin e vet, se ai është qendra krijuese e botës së vet.

Si reaksion ndaj këtij qëndrimi dyshues, fenomenologjia e vendoste subjektin përsëri në fronin e vet të ligjshëm. Subjekti duhej parë si burim e si origjinë i tërë kuptimeve. Ai vetë nuk ishte pjesë e botës, me që ai e kishte krijuar këtë botë. Në këtë kuptim fenomenologjia realizonte ëndrrën e vjetër të filozofisë klasike borgjeze dhe e shikonte atë në një dritë të re. Duke e përqëndruar botën në subjektin soditës fenomenologjia sillte zgjidhjen e shumë problemeve në fusha të ndryshme.

Megjithë pretendimet e saj për të shpëtuar „botën e gjallë“ të veprimit njerëzor e të eksperiencës humane nga thatësira e filozofisë tradicionale, fenomenologjia fillon e mbaron si një shpirt pa botë. Ajo premtun një botë të sigurtë, por këtë e realizon me çmimin e lartë të sakrificimit të historisë njerëzore.

## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

### 1.1.2 Martin Heidegger-i

Nxënësi i Husserl-it, Martin Heidegger-i, e refuzon këtë pikënisje e në vend të saj fillon me një refleksion mbi faktin absolut të ekzistencës njerëzore. Kjo është arsyeja që vepra e tij në kundërshtim me esencializmin e theksuar të mësuesit të tij është katakterizuar „ekzistencialiste“. Rruga nga Husserl-i te Heidegger-i kalon nga një fushë e intelektit të pastër në një filozofi që mediton mbi vetë jetën. Kryevepra e Heidegger-it „Qenia dhe koha“ (1927) i drejtohet vetë ekzistencës, më saktë, mënyrës së ekzistencës që është veçori specifike njerëzore. Kjo ekzistencë, argumenton Heidegger-i, është një ekzistencë në botë. Ne jemi qenie njerëzore, jemi të lidhur me të tjerët e me botën materiale. Këto lidhje janë të qenësishme për jetën tonë dhe jo diçka rastësore. Bota nuk është një objekt jashtë nesh që mund të analizohet në mënyrë racionale nga një subjekt soditës që i qëndron përballë. Ne nuk mund të dalim kurrë prej saj e ta sodisim nga jashtë. Ndërsa Husserl-i mendon që njeriu e formon botën sipas ideve të tij, Heidegger-i e largon subjektin njerëzor nga ky pozicion dominues. Për të ekzistenca njerëzore është një dialog me botën dhe pozicioni njerëzor është së pari ai i dëgjuesit, pastaj ai i folësit. Dijet njerëzore vijnë gjithmonë nga jashtë dhe vënë në lëvizje atë element të brendshëm që Heidegger-i e quan paradije. Shkenca dhe teoria janë abstraksione të lidhjeve konkrete me botën, njëlloj siç paraqet një hartë abstraksionin e një relievi real. Të kuptuarit nuk është një veprim i subjektit të izoluar, por pjesë e vetë ekzistencës njerëzore. Njeriu nuk është asnjëherë identik me vetveten. Ekzistenca njerëzore nuk është asnjëherë diçka e përfunduar, por gjithnjë në ndryshim. Për kohën ai shprehet se koha nuk është rrjedha ku ne zhytemi si shishja në ujë. Ajo është pjesë përbërëse e vetë jetës dhe mund të matet.

Të kuptuarit para se të jetë të kuptuarit e diçkaje të përcaktuar, është një aftësi e qenies njerëzore. Të kuptuarit është dukuri historike, ai është i pandashëm nga situatat historike ku ne jetojmë. Ekzistenca njerëzore përmban dhe gjuhën. Për Heidegger-in gjuha është dimensionin në të cilën lëviz jeta njerëzore. Vetëm ku ka gjuhë, ka botë. Gjuha ekziston para individit folës. Ajo zbulon të vërtetën jo aq në kuptimin që ajo është një instrument preciz për këmbimin e informacionit se sa në kuptimin që ajo është vendi ku zbulohet realiteti, ku shfaqen mendimet tona.

Në këtë koncept mbi gjuhën, pothuaj si një dukuri objektive që ekziston para individëve të veçantë, mendimi i Heidegger-it ecën paralel me teorinë strukturaliste.

Në qendër të teorisë së Heidegger-it nuk qëndron individi, subjekti, por vetë ekzistenca. Me këtë pikëpamje Heidegger-i kthehet pas, në mendimin filozofik para Sokratit, para dualizmit subjekt/ objekt dhe e shikon qenien si diçka që i përfshin të dyja.<sup>9</sup>

Mendimet e tij mbi filozofinë e shkakësisë Martin Heidegger-i i ka shprehur në vepra të ndryshme. (Çështja e shkakësisë ka qenë dhe është në qendrën e çdo filozofie dhe çdo filozofi.)

Ne menduam te merrnim në shqyrtim dy prej traktateve filozofike të Heidegger-it ku kauzaliteti përshkruhet dhe analizohet herë në mënyrë krejt origjinale, herë si zhvillim i tezave të mëparshme filozofike, qofshin ato me burim antik, mesjetar, modern.

Është me interes të themi në fillim nja dy fjalë për mënyrën konceptuese, për formulimin logjik dhe gjuhësor të tij. Shkrimet filozofike të Heidegger-it karakterizohen nga thellësia e skajshme e mendimit, nga guximi tipik i ngërthimit dhe shtjellimit të çështjeve. Janë vepra tejet të vështira për t'u përkthyer, pasi që të gjitha i

---

<sup>9</sup> Shih, Teichmann, E., *Hapa në universin e ligjëritit*, Tiranë, 2010, f. 76.

## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

bashkon një gjermanishte krejt e veçantë, e cila mbart një shprehësi e dinamikë të tejskajshme. Formësimet gjuhësore të Heidegger-it shfaqen për lexuesin e huaj si shtigje të frikshme ku mund të bjerë në çdo hap në grackë. Në këtë kuadër e gjetëm me interes të citonim një thënie të Gianni Vattimo-s, një nga studiuesit dhe përkthyesit më të arrirë të veprës së Heidegger-it në Itali. Me këtë thënie ai hap parathënien e përkthimit të „Einführung in die Metaphysik“ (Hyrje në metafizikë): „L’impressa di tradurre uno scritto heideggeriano e sempre, almeno parzialmente, votata al fallimento“.<sup>10</sup> (Nisma për të përkthyer një tekst hajdegerian është e destinuar, të paktën pjesërisht, të dështojë.)

Megjithatë ne u morëm direkt me shkrimet origjinale të Heidegger-it. Sigurisht, qëllimi ynë këtu është të paraqesim mendimin e tij filozofik mbi shkakësinë, pa synuar përkthimin e veprave të plota. Kaluam nëpër duar disa nga veprat e tij. Do të ndalemi posaçërisht në : „Der Satz vom Grund“ dhe „Die Frage nach der Technik“. Përkthimi im në këtë rast, sidomos në rastin e parë, nuk ka të bëjë me lidhjen kuptimore të fjalëve përbërëse, por me kuptimin që del nga shtjellimi i çështjes nga Heidegger-i. Kështu kemi: „Principi/ligji i shkakësisë“ dhe „Mendimi filozofik mbi teknikën“.

Në veprën „Mendimi filozofik mbi teknikën“ Heidegger-i shtjellon dukurinë „teknikë“ në pikëpamje filozofike. Ai përcakton dhe thekson dy konceptime të teknikës:

- Teknika është një mjet për të arritur qëllime të caktuara.
- Teknika është një bëmë njerëzore.<sup>11</sup>

Sipas Heidegger-it këto konceptime janë të lidhura midis tyre. Kështu teknika vështrohet si një instrument që i shërben njeriut për të arritur një qëllim:

*„Auch das Kraftwerk ist mit seinen Turbinen und Generatoren ein von Menschen gefertigtes Mittel zu einem von Menschen gesetztes Zweck.“<sup>12</sup>* (Edhe hidrocentrali me turbinat dhe gjeneratoret është një mjet i ngritur nga njeriu për qëllimet e tij.)

Heidegger-i shpall se perceptimi i teknikës si instrument është plotësisht i saktë. Në çështjen mbi teknikën rëndësi parësore ka thelbi i saj dhe jo shfaqjet e ndryshme ku ajo manifestohet. Thelbi i teknikës është i lidhur gjithnjë me konceptin instrument. Instrumenti si nocion gjithnjë ka të bëjë me një mjet dhe një qëllim. Mjeti synon të arrijë diçka. Ajo (mjeti etj.) që ndikon në arritjen e diçkaje quhet shkak. Qëllimi, që përcakton mjetet, është gjithashtu shkak.

*“Wo Zwecke verfolgt, Mittel verwendet werden, wo das Instrumentale herrscht, da waltet Ursächlichkeit, Kausalität.”*(Atje ku ndiqen qëllime dhe përdoren mjete, atje ku zotëron ideja instrumentalizuese, atje gjendet dhe vepron shkakësia, kauzaliteti.)

Në këtë kuadër Heidegger-i i referohet teorisë tradicionale të katër llojeve të shkaqeve, i shpjegon dhe i vë ato në diskutim. Siç kemi thënë pak më lart tradicionalisht njihen këto lloje shkaqesh:

---

<sup>10</sup> Vattimo, G., *Presentazione: Introduzione alla Metafisica*, Milano, edizioni Mursia, 1990, f. 5.

<sup>11</sup> Heidegger, M., *Die Frage nach der Technik. Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000, f. 16.

<sup>12</sup> Heidegger, M., *Die Frage nach der Technik. Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000, f. 16.

## Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht

---

- causa materialis: lënda nga e cila prodhohet diçka
- causa formalis: forma, figura në të cilën paraqitet diçka
- causa finalis: qëllimi që kushtëzon formën dhe lëndën, destinacioni
- causa efficiens: ndikimi, veprimi, efekti që prodhohet.<sup>13</sup>

Në paraqitjen e mësipërme shkakujepet si ndikim dhe ndikimi ka kuptimin e arritjes së një synimi. Kështu “causa efficiens” përcakton, finalizon tërë raportet e tjera shkakore. Në kuptimin e saj ekstrem “causa finalis” nuk i përket më vargut të shkakësive.

Si dhe në shumë raste të tjera Heidegger-i u referohet përgjegjëseve greke të termave latine. Termi latin *causa* në greqisht ka kuptimin “jam fajtor” (gjerm.: Schuldsein). Heidegger-i operon me këtë term kur merret me teorinë e katër shkaqeve. Ai e ilustron shpjegimin dhe analizën e vet me shembullin e argjendarit në raport me një kupë argjendi. Argjendi është materiali, lënda ndërtuese e kupës. Kështu argjendi “është fajtor” për kupën, në lidhje me materialin e saj përbërës. Kupa vetë “është fajtoreshë” për formën dhe dukjen. Qenia e saj kushtëzon, prodhon, sjell formën dhe pamjen. Dhe përcaktuese në këtë ekzistencë është përdorimi, destinimi, vlera praktike.<sup>14</sup>

Heidegger-i shpjegon më poshtë se në dukurinë e kupës prej argjendi edhe argjendari ka rolin (“fajësinë”) e vet. Roli i tij nuk ka të bëjë thjesht me arritjen e një rezultati, një efekti, por në kombinimin e tri mënyrave për të arritur këtë rezultat. Këtu Heidegger-i thekson se teoria e Aristotelit nuk e njeh këtë komponente shkakësore në kuptimin që i jep ai, Heidegger-i.<sup>15</sup>

„Fajësia“ e argjendarit qëndron në realizimin, në nxjerrjen në dritë të kupës duke u mbështetur në tre komponentet e konceptuara si shkaqe. Heidegger-i sqaron gjithashtu se termi me origjinë greke „fajësi“ (causa= shkak) nuk ka të bëjë me konceptin moral shkelje, gabim, nuk ka të bëjë as me kuptimin „ndikim“ që i atribuohet shpesh këtij koncepti. „Fajësi“ do të thotë përgatitje, nxjerrje në dritë, përfundim i diçkaje. Katër mënyrat e „fajësisë“ sjellin diçka në dritën e realitetit, diçka vjen nga mosekzistenca në ekzistencë. Kjo procedurë quhej te grekët *poiesis*. Dukuria është karakteristikë jo vetëm e njerëzve, por dhe e natyrës. Edhe në natyrë kemi kalime nga mosdukja në dukje. Veç natyra, ndryshe nga njerëzit, zbulohet vetvetiu.

Dalja/nxjerrja në dritë është një proces gjatë të cilit diçka e fshehur shfaqet, ekspozohet. Këtë Proces Heidegger-i e kupton si zbulim (greqisht *aletheia*; latinisht *veritas*; shqip *vërtetësi*).

Heidegger-i arrin në një pikë ku i duhet të sqarojë lidhjen midis teknikës (dhe dukurisë *aletheia*) me procesin *zbulim*. Nxjerrja në dritë, e cila mbështetet në zbulimin e diçkaje, merr formë dhe shprehje me anë të katër mënyrave të sipërpërmendura të shkakësisë. Kauzaliteti ka të bëjë gjithnjë me një qëllim dhe një mjet, gjë e cila reflektohet dhe në teknikë:

„Die Technik ist also nicht bloß ein Mittel. Die Technik ist eine Weise des Entbergens. Achten wir darauf, dann öffnet sich uns ein ganz anderer Bereich für das Wesen der Technik. Es ist der Bereich der Entbergung, d.h. der Wahrheit.“<sup>16</sup>  
(Teknika nuk është thjesht një mjet. Teknika është një mundësi zbulimi. Nëse ne do ta

---

<sup>13</sup> Shih përsëri, Aristoteles, *Metaphysik*, Reclam, 1970, V. Buch, f. 113- 116.

<sup>14</sup> Heidegger, M., *Die Frage nach der Technik. Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000, f. 10.

<sup>15</sup> Po aty, f. 11.

<sup>16</sup> Po aty, f. 12.

## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

vështrojmë kështu, do të hapet para nesh një fushë tjetër mbi esencën e teknikës. Është fusha e zbulimit, domethënë domeni i së vërtetës.)

Në shpjegimin e termit *technikë* Heidegger-i sqaron se ky nocion ka prejardhje greke (*techne*). Në origjinë ky term ka një domethënie dyfishe: nga njëra anë do të thotë *ushtrimi ose aftësia për të ushtruar një zanat*, nga ana tjetër është emërtim për *artin*. Pastaj Heidegger-i shton se *techne* është mënyrë e nxjerrjes në dritë të diçkaje, shpreh gjithashtu dhe diçka poetike.

Në procesin e zbulimit, realizimit nxirret në dritë diçka, e cila nuk mund të shfaqet vetë, si p.sh.: një shtëpi, një anije, një kupë etj. Rëndësi nuk ka vetëm bërja me duar ose me mjete të tjera, por zbulimi, realizimi vetë. Në shpjegimin e tij Heidegger-i i referohet dhe filozofisë greke të Lashtësisë, ku *techne* dhe *aletheia* vështrohen të lidhura.<sup>17</sup>

Një hap më tutje Heidegger-i pranon, se kjo mënyrë kuptimi e termit *techne*, vlen vetëm për territorin antik grek dhe jo për teknikën e sotme në kuadrin e zhvillimit aktual të shkencave të natyrës. Për teknikën e sotme ai hedh dy pyetje:

1. A vlen sot, për teknikën e kohës së re, lidhja midis *aletheia* dhe *techne* ?
2. Cila është veçoria kryesore e teknikës së kohës tonë ?

Për pyetjen e parë Heidegger-i thotë se edhe teknika moderne është zbulim, nxjerrje në dritë. Ndërsa pyetja e dytë ka të bëjë me raportin e njeriut të përfshirë në teknikë me realitetin.

Zbulimi, nxjerrja, evidentimi në teknikën moderne nuk ka të bëjë me *poiesis* (poezinë, artin). Zbulimi këtu është më shumë një sfidë ndaj natyrës: hapësira të tëra përdoren për nxjerrjen e mineraleve, bujqësia e sotme është një *industri ushqimore e motorizuar*. Ujërat e Rinit shërbejnë për të prodhuar energji elektrike. Kështu Rini papritur është shndërruar në liferant energjie elektrike.

„*Das Wasserkraftwerk ist nicht in den Rheinstrom gebaut wie die alte Holzbrücke, die seit Jahrhunderten Ufer mit Ufer verbindet. Vielmehr ist der Strom in das Kraftwerk verbaut. Er ist, was er jetzt als Strom ist, nämlich Wasserdrucklieferant, aus dem Wesen des Kraftwerks...*“<sup>18</sup> (Hidrocentrali nuk është ndërtuar mbi Rin si ura e vjetër prej druri që lidh prej shekujsh dy brigjet e lumit. Përkundrazi rryma elektrike është integruar në hidrocentral. Ajo që tani është rrymë elektrike s’është veç furnizues i presionit të ujit nga vetë centrali elektrik.)

Nxjerrja në dritë gjeneron njohuri dhe vërtetësi. Një eksperiment p.sh. mund të kuptohet si formë e nxjerrjes në dritë. Meqë teknika është një mënyrë zbulimi, prodhon njëkohësisht njohuri dhe dije shkencore. Një veçori e teknikës moderne është pikërisht sfidimi i natyrës. Sfidat, sfidimi është, nga ana e tij, një mënyrë zbulimi. Me anë të sfidimit lind diçka që “funksionon”. Heidegger-i e quan këtë “Bestand”. Termi rrjedh nga gjuha e përditshme, ku ka kuptimin *qëndrueshmëri/fond/gjendje/rezervë*.<sup>19</sup> Si term ai i shmanget disi kuptimit të përditshëm, është më i gjerë dhe më abstrakt. Përmban në semantikën e tij dhe idenë e funksionit. Gjërat e zbuluara nga teknika nuk

---

<sup>17</sup> Heidegger, M., *Die Frage nach der Technik. Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000, f. 13.

<sup>18</sup> Po aty, f. 15.

<sup>19</sup> Shih, Simoni, Z., *Wörterbuch Deutsch-Albanisch*, Hamburg, Buske Verlag, 1997, f. 122.



## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

janë më objekte që i qëndrojnë njeriut përballë, por burime funksionale. Heidegger-i operon dhe me termin *Gestell* (skelë/skelet/karkasë).<sup>20</sup>

Edhe ky term nuk ka kuptimin konkret që ka fjala në gjuhën e përditshme. Termi shënon tërësinë e mënyrave që përdor teknika për të zbuluar e sfiduar natyrën. Sipas Heidegger-it këto mënyra e çorientojnë njeriun në rrugën drejt së vërtetës e njohjes. Përparimi teknik çon në harrimin e njeriut, përderisa ai shikohet, gjithashtu, si objekt që funksionon; çon në harrimin e mënyrave të tjera jo teknike të zhvillimit, siç është veprimtaria artistike. Teknika moderne do të bëhet problem, nëse do të shikohet si mënyra e vetme e zbulimit të botës. Teknika është metafizikë e përsosur dhe si e tillë, mospërfillje e përsosur e ekzistencës (*sein*). Kjo harresë e *sein* (ekzistencës) është rreziku më i madh, rreziku i asgjësimit universal. Heidegger-i nuk sheh ndonjë rrugëdalje nga një situatë e tillë, asnjë mbijetesë, asnjë shmangie nuk është e mundur. Në situata të tilla morali nuk ekziston. Heidegger-i e shpjegon kështu rrezikun e përmendur: gjithçka ekzistuese teknika e shndërron në produkt, që është gjithnjë i disponueshem. Bota zhvillohet në drejtim të teknizimit total, të totalizimit teknik. Teknika bëhet e vetmja mënyrë e zbulimit të botës. Teknika sundon dhe shoqërinë, të gjitha sferat e jetës teknizohen.

Në kapitullin „Die Kehre“ (Kthesa) pesimizmi i Heidegger-it fillon e zbehet. Mendimi i tij shkon deri atje, sa ai pranon me optimizëm se brenda teknikës moderne, brenda modernizimit teknik, përballë rrezikut qëndron dhe mundësia e shpëtimit. Edhe në situatat më të rrezikshme, njeriu e ka vetëdijen e rrezikut dhe kjo mundëson kthesën. Një mundësi për t'i shpëtuar mohimit, asgjësimit teknik, shndërrimit të njeriut në produkt, është arti. Heidegger-i i njuh artit një rang të lartë. Ai mendon se arti ka një lloj afërie me teknikën, por është njëkohësisht dhe krejt i ndryshëm nga ajo:

*„Weil das Wesen der Technik nichts Technisches ist, darum muss die wesentliche Besinnung auf die Technik und die entscheidende Auseinandersetzung mit ihr in einem Bereich geschehen, der einerseits mit dem Wesen der Technik verwandt und andererseits von ihm doch grundverschieden ist.“*<sup>21</sup> (Meqë thelbi i teknikës nuk është teknik, reflektimet esenciale mbi të dhe debatet e rëndësishme me të duhen bërë në një fushë, e cila, nga njëra anë është e afërt me teknikën dhe, nga ana tjetër është krejt e ndryshme nga ajo.)

Në fund Heidegger-i konfirmon dhe njëherë optimizmin për mundësitë e shpëtimit nga totalitarizmi teknik:

*„Je mehr wir uns der Gefahr nähern, um so heller beginnen die Wege ins Rettende zu leuchten, um so fragender werden wir. Denn das Fragen ist die Frömmigkeit des Denkens.“*<sup>22</sup> (Sa më shumë i afrohem rrezikut, aq më shumë fillojnë të ndrisin rrugët e shpëtimit, aq më shumë pyetje lindin brenda nesh. Se pyetja është shenjtëria e mendimit.)

*„Der Satz vom Grund“* (Ligji i Shkakësisë) titullohet vepra tjetër e Heidegger-it, ku ai shtjellon idetë e tij filozofike në fushën e shkakësisë. Ai merr rrugën për të depërtuar në brendësi e në thellësi të ligjit „Nichts ist ohne Grund“ (asgjë nuk është pa shkak).

---

<sup>20</sup> Heidegger, M., *Die Frage nach der Technik. Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000, f.17.

<sup>21</sup> M. Heidegger, *Die Frage nach der Technik. Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000, f. 19.

<sup>22</sup> Po aty, f. 36.

## Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht

---

Shtegtimi i tij filozofik fillon e mbaron në dhjetë ligjërata, që i mban para studentëve të degës Filozofi në Universitetin e Freiburg-ut gjatë semestrit dimëror 1955- 1956. Leksionet u botuan si libër në vitin 1957. Në këto leksione ai shtjellon çështje si: veprimi i ligjit të shkakësisë, kuptimi i tij, mendimet e tij mbi këtë ligj dhe mbi teoritë e filozofëve të tjerë në këtë fushë. Gjatë shtjellimit ai arrin shpesh në rrugë pa krye, në rrugë të gabuara, në plasa. Ndalet dhe reflekton përsëri për rrugën e përshkruar, pastaj vazhdon përpara. Filli i mendimit duket sikur çon në një hapësirë të qartë, por shpejt bie përsëri në errësirë. Dhe rruga zgjatet e zgjatet thellë, në një domen të panjohur. Me një përshkrim kaq ekspresiv dhe figurativ trajton Heidegger-i një nga ligjet më të rëndësishme të filozofisë ontologjike dhe të mendimit njerëzor në përgjithësi. Ai përpiqet të dalë në gjurmët e asaj që qëndron në bazën e çdo ekzistence. Cila është arsyeja e parë, origjina e gjithçkaje që ekziston (von allem Seienden)? Pse është gjithçka kështu siç është?

Figura e „udhës/ rrugës“ është lajtmotivi i leksioneve të Heidegger-it. Ai synon ta markojë, ta theksojë rrugën e mendimit që shpie në origjinën e dukurisë.

Leksionet përmbajnë dy blloqe tematike: një bllok trajton periudhën para hopit, blloku tjetër-atë pas hopit. Të dy pjesët lidhen njëra me tjetrën, edhe pse shprehin pikëpamje të ndryshme. Blloku i parë ndahet në pesë pjesë, secila pjesë përmbledh e trajton çështje të rëndësishme, siç shprehet vetë Heidegger-i.<sup>23</sup>

Njohuritë për ligjin mbi shkakësinë, që jepen në pjesën e parë, janë një parathënie dhe një përgatitje për bllokun e dytë. Këtu shtrohen çështje, bëhen pyetje, të cilat rimerren në pjesën e dytë, ku jepen dhe përgjigje për pyetjet e ngritura. Midis dy blloqeve ka një ndryshim në përmbajtje, për shkak të hopit, të kthesës në historinë e ligjit në shqyrtim. Ndërsa në pjesën e parë sqarohen formalitete që kanë të bëjnë me ligjin mbi shkakësinë, në pjesën e dytë analizohet përmbajtja e ligjit. Pjesa e dytë fut në shqyrtim dhe konceptin filozofik *sein* (ekzistencë). Reflektime mbi ekzistencën, shkakësinë, lidhjen midis tyre përbëjnë substancën e pjesës së dytë.

Heidegger-i shpall që në fillim të studimit se ligji i shkakësisë, pa u përhapur akoma mirë, u pranua pa kushte. Kjo ndodh se ekzistenca e tij është bindëse, ta “mbush mendjen”, sepse secili prej nesh pyet gjithnjë për shkaqet dhe kërkon shpjegime.<sup>24</sup>

Çdo njeri kërkon automatikisht shkaqet dhe arsyet për bëmat e tij dhe të tjerëve.<sup>25</sup> Nga një vëzhgim i çështjes në afërsi rezulton se çdo mendje njerëzore është e orientuar të kërkojë sqarime, përndryshe asgjë nuk kuptohet. „Sikur të ishte e vetëkuptueshme, sikur të ngjante vetvetiu, vepron e çan rrugën ligji i shkakësisë“.<sup>26</sup>

Heidegger- i e fillon bllokun e leksioneve të tij me vëzhgime dhe reflektime, që paraqesin përdorimin e ligjit në mendimin dhe sjelljen e njerëzve. Ai pranon që ligji receptohet si i vetëkuptueshëm dhe „ndriçues“, sepse parafytyrimi njerëzor lipset të mbështetet dhe të arsyetohet. Megjithë prezencën e përhershme, ky ligj u trajtua dhe u formulua filozofikisht shumë vonë. Vetëm në shekullin e 17- të Leibnitz- i e formulon ligjin shkurt: „*nihil est sine ratione*“ (asgjë nuk ndodh pa arsye).

„*Vielleicht ist der Satz vom Grund der rätselvollste aller nur möglichen Sätze!*“ (Ndoshta është ligji i shkakësisë më misteriozi i të gjithë ligjeve të mundshme.)

---

<sup>23</sup> Heidegger, M., *Der Satz vom Grund, Gesamtausgabe, II. Abteilung, Band 24*, Frankfurt am Main, 1997, f. 80.

<sup>24</sup> Shih, po aty, f. 3.

<sup>25</sup> Shih, po aty, f. 16.

<sup>26</sup> Shih, po aty, f. 17.

## Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht

---

Kështu shprehet Heidegger-i duke shfaqur çudinë e tij për një dukuri, që është e gjithgjendshme, e vetkuptueshme, por shumë vonë e eksploruar.<sup>27</sup>

Periudhën para Leibnitz-it Heidegger-i e quan „kohë e inkubacionit“, „e gjumit“.<sup>28</sup>

Emërtimi „inkubacion“ shënon zakonisht kohën, gjatë së cilës infeksioni zhvillohet deri në shpërthimin e tij. Me termin „inkubacion“ është i lidhur një zgjim i vetvetishëm, një shpërthim dhe jo një zgjim i stimuluar nga të tjerët, si në rastin e zgjimit nga gjumit. Heidegger-i pyet: *Pse u desh kaq shumë kohë që ligji të shprehet në këtë formë? Ku ishte ai kaq gjatë?*<sup>29</sup>

Këto pyetje trajtohen gjerë e gjatë në pjesën e dytë.

Me *Leibnitz-in* merr fund periudha e ashtuquajtur e inkubacionit të ligjit të shkakësisë, ai e formulon atë gjuhësisht duke e shpallur ligj themelor, princip: *principium reddendae rationis sufficientis* (principi i shkakësisë së mjaftueshme të rikthyer). Me këtë formulim ai jep jo vetëm përmbajtjen e ligjit, por dhe funksionin e tij si princip, si ligj themelor.

Në ligjëratat e tij mbi Leibnitz-in Heidegger-i e jep formulimin e ligjit në fjalë dhe në formë pouhuese „*Jedes Seiende hat einen Grund*“ (Çdo ekzistencë ka një shkak).<sup>30</sup>

Në të dyja formulimet përmbajtja e ligjit shfaqet njëllë domethënëse dhe ndikuese. Por vlen të vihet në dukje që ligji nuk merret vetëm me shkakun, i cili konsiderohet i mirëqenë, por me *seiende* (gjithçka ekzistuese). Ligji shënon diçka të domosdoshme, diçka me vlerë të përhershme. Heidegger-i shtron në këtë rast pyetjen: „*Was für eine Art von Satz ist er überhaupt?*“<sup>31</sup> (Po çfarë ligji është ai në të vërtetë?)

Ligji mbi shkakësinë nuk mund të vendoset në rrafshin e ligjeve të njohura, të zakonshme, as në rrafshin e ligjeve shkencore; ai i takon fushës së formulimeve që shënojnë diçka fundamentale, që nuk derivojnë nga diçka tjetër. Ai i takon fushës së aksiomave, principeve, ligjeve themelore.<sup>32</sup> Pastaj Heidegger-i merret me karakterizimet që Leibnitz-i i bën ligjit. Formulimi i parë i Leibnitz-it është, siç kemi thënë „*nihil est sine ratione*“ (Asgjë nuk është pa shkak.) Pastaj ai e plotëson formulimin me përcaktime si: *ligj themelor, ligj i shkakësisë së mjaftueshme, të rikthyer*. Përcaktimet, që bën Leibnitz-i, kanë të bëjnë me veçoritë, me ndikimin, për rrjedhim me kuptimin e ligjit. Heidegger-i i zbërthen dhe i shpjegon këto veçori. Ai fillon me termin *reddendae*, që e përkthen „zurück-geben“ (kthej). „*Arsyeja (shkaku) është shkak i rikthyer.*“<sup>33</sup>

Shkaku rikthehet, duhet të rikthehet. Nga kush? Te kush? Heidegger-i shpjegon: në aktin e njohjes njerëzore un-i soditës ballafaqohet me objekte të ndryshme. Ai kërkon t'i kuptojë këto objekte. Për këtë ai ndalet para tyre, ose i ndal ata para tij (siç thotë Heidegger-i). Qëndron ballëpërballë me ta me pyetjen në kokë „ç'është kjo/ky?“ Cili është shkaku që diçka është ashtu siç është? Dhe lind një dialog midis un-it dhe objektit (të njohjes). Në rrjedhë të këtij dialogu un-it i vjen përgjigjja; nga parafytyrimi, hetimi i objektit un-i soditës arrin te shkaku i tij. I vjen në kokë përgjigjja për shkakun. Heidegger-i thotë „shkaku rikthehet.“<sup>34</sup>

---

<sup>27</sup> Shih, Heidegger, M., *Der Satz vom Grund, Gesamtausgabe, II. Abteilung, Band 24*, Frankfurt am Main, 1997, f. 6.

<sup>28</sup> Po aty, f. 5.

<sup>29</sup> Po aty, f. 5.

<sup>30</sup> Po aty, f. 6.

<sup>31</sup> Shih, po aty, f. 8.

<sup>32</sup> Shih, po aty, f. 21.

<sup>33</sup> Shih, po aty, f. 34.

<sup>34</sup> Shih, po aty, f. 35.

## Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht

---

Ligji i shkakësisë përfshin brenda tij jo vetëm objektin e njohjes, por dhe njohësin vetë, i tillë është ai *ligj themelor i njohjes, princip për gjithçka ekzistuese*.<sup>35</sup>

Por përcaktimi i Leibnitz-it përmban edhe një veçori tjetër të ligjit: *principium reddendae rationis sufficientis* (princip i shkakësisë së mjaftueshme të rikthyer). Heidegger-i shpjegon se shkak, arsyeja duhet të jenë të mjaftueshëm që një objekt të justifikojë ekzistencën e vet.<sup>36</sup>

### I.1.3 Përfundime

Koncepti filozofik mbi shkakësinë ka një rëndësi të dyfishtë për studimet gjuhësore. Së pari: Shumë teori gjuhësore mbështeten fuqimisht mbi teori filozofike. Nga punimi ynë mund të përmendim si të tilla: teorinë e kauzalitetit implicit në foljet psikologjike, në foljet e veprimit, në ato komunikative e ndonjë rast tjetër.

Së dyti: përshkrimi filozofik i dukurisë dhe ligjësisë mbi shkakësinë mund të shërbejë si metodologji e metodë pune në hulumtime llojesh të ndryshme. P.sh.: shpjegimi hajdegerian mbi *shkakun e rikthyer* ka dhe vlerën e një udhëzimi për çdo hulumtim. Ky shpjegim përmban kornizën e përgjithshme të një akti njohjeje të zakonshme dhe të një njohjeje ose zbulimi shkencor. Un-i njohës qëndron para objektit, ose vendos para tij objektin, që do të njohë, duke i gjetur *pse*-në e ekzistencës. Me gjuhën e tij figurative Heidegger-i e paraqet këtë si dialog midis objektit ekzistues dhe subjektit soditës. Në rrjedhën e dialogut, dikur „ndriçon“ shkakun dhe objekti bëhet i kuptueshëm. Shkakun quhet „i rikthyer“ se ai ka ekzistuar me objektin vetë edhe para momentit e procesit të njohjes. Ai rishfaqet gjatë njohjes.

Po kaq interesante janë dhe thëniet fenomenologjike të E. Husserl-it, mësuesit të Heidegger-it.

Sipas tij objektet nuk mund të shqyrtohen si sende në vetvete, por si sende që rroken nga ndërgjegjja. Ndërgjegjja është gjithmonë ndërgjegjeje e diçkaje. Nëse unë mendoj, jam i ndërgjegjshëm që mendimi im drejtohet në një objekt. Vetë mendimi dhe objekti ku ai drejtohet lidhen me njëri-tjetrin së brendshmi, varen nga njëri-tjetri. Ndërgjegjja nuk është vetëm një regjistrim pasiv i botës, por e krijon atë aktivisht.

Duke e përqëndruar botën në subjektin soditës fenomenologjia sillte zgjidhjen e shumë problemeve në fusha të ndryshme.

*Çdo tezë filozofike është metodë, metodologji, këndvështrim dhe shpjegim i objekteve tona të studimit!*

### I.2 Ç'është shkakësia në gjuhësi?

#### I.2.1 Mbi kuptimin e fjalisë shkakore

Në gjuhësi termi shkakësi (kauzalitet) përdoret në një kuptim të gjerë dhe në një të ngushtë. Në kuptimin e gjerë kauzaliteti përfshin një sërë dukurish kauzale, si kushtin, qëllimin, lejimin. Në kuptimin e ngushtë termi shënon raporte të pastra shkakësie. Në rastin tonë termi do të merret në kuptimin e ngushtë. Raport shkakësie është lidhja midis dy ndodhive ose dy përmbajtjeve, ndër të cilat ajo që ndodh më parë në kohë, merret si arsye, shkak, premisë. Në pikëpamje gramatikore lidhje shkakore nuk është

---

<sup>35</sup> Shih, Heidegger, M., *Der Satz vom Grund, Gesamtausgabe, II. Abteilung, Band 24*, Frankfurt am Main, 1997, f. 36.

<sup>36</sup> Shih, po aty, f. 37.

## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

vetëm raporti midis dy përmbajtjeve, njëra prej të cilave është shkak për tjetrën, por dhe raporti midis përmbajtjeve ku njëra është arsye, argument, sqarim për tjetrën.<sup>37</sup>

Lidhur me kuptimin e fjalive shkakore mund të thuhet që pjesa e varur shkakore shpreh shkakun ose sqarimin e përmbajtjes që jepet në pjesën kryesore. Raportet kausale të shprehura në fjalitë shkakore mund të grupohen në tri lloje:

- Shkakësi reale (shkak real).

Në këtë rast shkakësi është i tillë që domosdoshmërisht pas një farë kohe prodhon një pasojë të caktuar. Shkakësi si të thuash është premisë e mjaftueshme për shfaqjen e pasojës. Pasoja është rrjedhojë e shkakut të dhënë në pjesën e varur të fjalisë shkakore. Në përgjithësi, fjali të tilla pasqyrojnë gjuhësisht ligjet objektive ose ligjësitë, rregullsitë qoftë në natyrë, në shoqëri, në fushën institucionale etj.:

*Meqë ai nuk shqiptonte qartë, ne nuk e kuptuam ç' tha.*

- Motivim.

Ky lloj raporti shkakësor përfshin rastet kur përmbajtja e pjesës së varur është një shpjegim, një argumentim e sqarim i asaj që thuhet në pjesën kryesore. Folësi e paraqet si argument përmbajtjen e pjesës së varur të fjalisë shkakore. Kjo është, si të thuash, një shkakësi gjuhësore. Shkakësi në këtë rast është i tillë vetëm në një situatë të caktuar, ose vetëm në një shoqëri të caktuar, mund të lidhet vetëm me një grup, ose vetëm me një individ.

*Megjithatë ndaloj ngaqë donte ta dëgjonte.*

Shkakësi i formuluar në pjesën e nënrenditur që fillon me lidhëzën shkakore ngaqë nuk është shkak real i veprimit të shprehur në pjesën kryesore megjithatë ndaloj. Pjesa e nënrenditur shpreh më shumë një sqarim, një argumentim për atë që ndodh në pjesën kryesore. Në gjuhë pjesa e nënrenditur e sipërpërmendur konceptohet dhe trajtohet si shkakore. Në raste të tilla vihet re mirë dallimi midis raportit shkak-pasojë në gjuhë dhe këtij raporti në logjikë, në fizikë ose filozofi. Në këto tri disiplina e sapopërmendura shkakësi dhe pasoja kanë një lidhje të brendshme, shkakësi është real.

- Shkakësi logjike.

Raportet shkakore në këtë rast mbështeten në ligjësitë logjike:

*Meqë shtëpia është më e madhe se Emili, natyrisht Emili është më i vogël se ajo.*

Është e rëndësishme të thuhet se këto lloje shkakësish, për rrjedhim llojet respektive të shkaqeve nuk mund të ndahen prerazi njëri nga tjetri. Dallimi midis tyre nuk është gjithnjë i qartë.

---

<sup>37</sup> Shih, Zifonun, G. /Hoffmann, L./ Strecker B./ Ballweg, J., *Grammatik der deutschen Sprache*, Berlin /New York, de Gruyter, 1997, f. 2296.

## **Mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore në shqip dhe në gjermanisht**

---

Në „Gramatika e Gjuhës Shqipe 2“<sup>38</sup> fjalitë që shprehin marrëdhëniet shkakore ndahen në dy tipa:

- Periudha me fjali shkakore konstatuese: Me këto fjali tregohet një shkak i afërt, i drejtpërdrejtë:

*E lëvdoj se është tamam burrë.*

- Periudha me fjali shkakore arsyetuese: Këto fjali shprehin një fakt real, një të vërtetë të mirënjohur, të pranuar a të supozuar si të tillë mbi të cilën mbështetet folësi për të nxjerrë një përfundim që shprehet nga fjalia kryesore:

*Meqë ishte dimër, ne binim herët në shtrat.*

Një teori tepër interesante mbi kuptimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve shkakore është ajo e Eve Sweetser-it “Teoria e tri rrafshëve të shumëkuptimësisë pragmatike“. Për këtë teori kemi folur në kapitullin e fundit që i kushtohet përdorimit të lidhëzave shkakore në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“.

Raporti shkak-pasojë mund të shprehet me mjete të ndryshme gjuhësore. Mjetet më të rëndësishme janë: parafjalët, ndajfoljet dhe lidhëzat (edhe disa pjesëza marrin pjesë në ndërtimin e fjalive shkakore). Këto mjete duhen parë si sinonime sintaksore. Në rastin tonë do të merremi kryesisht me lidhëzat shkakore, por do të hedhim dhe një vështrim mbi mjetet e tjera gjuhësore që realizojnë lidhje shkakore. Vështrimi i këtyre mjeteve do të bëhet në pikëpamje semantike, sintaksore, pragmatike. Kjo do të thotë, do të vështrohet dhe analizohet semantika, funksioni i tyre sintaksor si dhe pragmatika e tyre, përdorimi i tyre në ligjërim.

---

<sup>38</sup> Gramatika e Gjuhës Shqipe II“, Tiranë, 2002, f. 563.

## **Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

---

### **Kreu II Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

Në vijim do të paraqesim ato klasa fjalësh që ndihmojnë me elemente të tyre realizimin e marrëdhënieve shkakore. Po të niseshim nga thënia e B. Schmidhauser-it se në çdo pjesë të ligjëratës gjenden elemente që funksionojnë si fjalë lidhëse ose si fjalë korrelative në ndërtimet shkakore, atëherë do të pranohet se edhe emrat ose tërë grupi i fjalëve emërtuese furnizon me elemente të vetat shprehjen e raporteve shkakore. Për emrat kjo është krejt e dukshme në lokucionet lidhëzore të tipit: për shkak se, për arsye se, nga puna se, me besim se, me shpresë se, me frikë se etj. , ose në shprehjet parafjalore: nga shkak i, për arsye të etj. Në bashkime të tilla të qëndrueshme fjalësh emrat e ruajnë kuptimin e tyre fillestar, kuptim që e manifestojnë dhe si njësi të pavarura, jashtë këtyre lidhjeve. Por ata kanë humbur fleksionin, dalin në formë të ngurosur dhe zëvendësimi i kësaj forme me një tjetër është i pamundur. Njëkohësisht duhet thënë se funksionin lidhor shkakor ata e paraqesin vetëm në bashkëvajtje me elementet e tjera: për + shkak + se etj.

Edhe foljet mund të vendosin lidhje me lidhëzat shkakore e të funksionojnë si një njësi e vetme me to, p.sh.: se s'bën, s'di pse, ç'ka pse, s'ka pse etj.

Por klasat që vënë rregullisht dhe më shumë elemente në dispozicion të shprehjes së marrëdhënieve shkakore janë: lidhëzat, ndajfoljet, parafjalët, pjesëzat. Në vijim do të merremi me këto klasa duke u ndalur veçanërisht në nëngrupet me kuptim ose funksion shkakor.

#### II.1 Në shqip

##### II.1.1 Ndajfolja

„Ndajfolja është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që emërton një tipar të veprimit a të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim, ose tregon shkallën e një cilësie a të një rrethane ose intensitetin e veprimit.“<sup>39</sup>

Ndajfoljet ndahen në dy grupe të mëdha: 1. ndajfolje përcaktore; 2. ndajfolje rrethanore.

Ndajfoljet përcaktore emërtojnë tiparin e një veprimi të shprehur nga folja si dhe shkallën e intensitetit të këtij veprimi ose të një tipari. Brenda grupit të ndajfoljeve përcaktore dallohen:

- ndajfoljet e mënyrës: lehtë, ngadalë, keq etj.,
- ndajfoljet e sasisë: fort, shumë, tepër etj.

Ndajfoljet e mënyrës grupohen më tej në:

- Ndajfoljet e mënyrës të tipit mirë, keq...
- Disa ndajfolje të tjera përcaktojnë ecurinë e procesit të veprimit: ngadalë, papritur.
- Ndajfolje që tregojnë përmasa: cekët, gjerë, thellë ...
- Ndajfoljet e formuara me prapashtesën –isht: hollësisht, artistikisht, qenërisht
- 

Si ndajfolje mënyre merren dhe fjalët e tipit: rusisht, anglisht, etj.

---

<sup>39</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 357.

## **Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

---

Këtyre nëngrupeve mund t'u shtoheshin gjithashtu:

- ndajfolje që shënojnë shkallë, intensitet ose pasiguri: veçanërisht, thellësisht, gjithësej, afërsisht, pothuaj, pjesërisht, kryekëput ...
- ndajfolje që shërbejnë për ta përforcuar ose dobësuar përmbajtjen e thënies: sigurisht, pikërisht, tamam, së paku, të paktën...

Brenda klasës së ndajfoljeve të mënyrës mund të shtoheshin gjithashtu fjalët modale. Ndajfoljet e mënyrës dhe fjalët modale mund të kenë formë të njëjtë, por dallojnë në kuptim dhe në pikëpamje sintaksore. Fjalët modale lidhen kuptimisht me tërë fjalinë dhe jo me një gjymtyrë të vetme, ato janë ndajfolje për tërë fjalinë. Ja disa fjalë modale: siç duket, për të ardhur keq, patjetër, çuditërisht, fatmirësisht, ka të ngjarë, mezi, mundësisht, fatkeqësisht, ndoshta, natyrisht, gjoja, patjetër, vërtet etj. Fjalët modale mund të grupohen në pikëpamje kuptimore ose sintaksore.

Po japim disa shembuj për të bërë më të qartë dallimin midis ndajfoljeve të mënyrës dhe fjalëve modale:

Ata na përshëndetën *miqësisht*. (ndajfolje mënyre, lidhet kuptimisht me foljen)

*Fatmirësisht* të gjithë ishin në shtëpi. (fjalë modale, lidhet kuptimisht me tërë fjalinë).

Ndajfoljet rrethore emërtojnë rrethanat, në të cilat kryhet veprimi i shprehur nga folja. Ndajfoljet rrethore ndahen më tej në:

- ndajfolje kohe: sot, mbrëmë, vit për vit etj.,
- ndajfolje vendi: afër, këtu, atje etj.,
- ndajfolje shkak: përse, pse, etj.

Ndajfoljet e kohës emërtojnë rrethanë kohore. Ato mund të tregojnë:

- kohën e saktë të kryerjes së një veprimi: sonte, sivjet ...
- kohë të papërcaktuar me saktësi: së shpejti, dikur ...
- kohën e zgjatjes së një veprimi : përnatë, përditë ...
- një veprim të çastit: aty për aty, flakë për flakë ...
- sasinë e kohës që duhet për kryerjen e veprimit: motmot, një grimë ...

Këtyre nëngrupeve mund t'u shtonim: ndajfolje që shënojnë rendin e veprimeve në kohë: së pari, së dyti, për herë të parë, së fundi ...

### II.1.2 Parafjala

„Parafjala është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, që shpreh marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, një numërori ose një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyrë tjetër në një togfjalësh.“<sup>40</sup> Në këtë kapitull paraqiten imtësisht klasifikimi i parafjalëve sipas prejardhjes, sipas strukturës, sipas kriterit sintaksor.

Klasifikimi i parafjalëve sipas kriterit sintaksor është ndarja e tyre sipas rasave me të cilat përdoren. Në gjuhën shqipe, si rregull, një parafjalë përdoret vetëm me një rasë të

---

<sup>40</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 381.



## **Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

---

caktuar. Bëjnë përjashtim vetëm parafjala *ndaj* e *për*, të cilat përdoren me nga dy rasa.<sup>41</sup>

Mund të pohohet që ka dhe parafjalë të tjera (përveç *ndaj* e *për*) që drejtojnë dy rasa, të tilla janë lokucionet parafjalore: me anë, në vend, në mes, për punë. Ato përdoren para gjinorese ose rrjedhore: në mes të klasës (gjinore); në mes jush (rrjedhore); në vend të Agimit (gjinore); në vend teje (rrjedhore). Në gjuhën shqipe ka gjithashtu dhe parafjalë që nuk drejtojnë rasën e segmentit që pason. Parafjalët *për* dhe *si*: Le të krahasojmë përdorimet e tyre në fjalitë e mëposhtme:

U zgjodh si drejtues i grupit. (emërore)  
Ai mbahej për i aftë. (emërore)  
E zgjodhën si drejtues të grupit. (kallëzore)  
E mbanin për të aftë. (kallëzore)

Rasa në këtë rast nuk përcaktohet nga parafjala, por nga funksioni sintaksor (plotës kallëzuesor i kryefjalës ose i kundrinës së drejtë).

Edhe parafjalët midis dy emrave që përsëriten, si në shembujt e mëposhtëm, nuk kanë reksion rasor: Tren më tren arriti në Ballsh. Rregulloren e diskutuam pikë për pikë.

Do të ishte gjithashtu interesante të trajtohej trajta e emrave pas parafjalëve të caktuara. Pas parafjalëve të rasës emërore *nga* e *prej* emri që pason është në trajtën e shquar, si në njëjës dhe në shumës: nga qyteti, nga qytetet; te motra, te motrat.

Pas parafjalëve *në*, *mbi*, *nën*, *përmbi*, *nëpër* emri është në trajtën e pashquar. Po të shoqërohet me një atribut bëhet i shquar: në klasë por në klasën tonë.

Hartimi dhe paraqitja e listave me parafjalë (ose lista fjalësh të tjera) nëpër gramatika është sot një dukuri e përhapur. Dihet që listat nuk përmbajnë asnjëherë 100% të elementeve të një klase, por gjithsesi, (në pikëpamje didaktike dhe shkencore) synojnë ta paraqesin dukurinë në mënyrë sa më shteruese, të japin përgjigje për shumë pyetje.

### II.1.3 Lidhëza

Lidhëza është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, që lidh dy gjymtyrë fjalie ose dy fjali dhe shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore ndërmjet tyre.<sup>42</sup>

Lidhëzat grupohen sipas kriteresh të ndryshme, sipas prejardhjes, sipas strukturës, sipas funksionit. Në klasifikimin sipas funksionit lidhëzat ndahen në: bashkërenditëse dhe nënrenditëse. Sipas llojit të marrëdhënieve që shprehin, lidhëzat bashkërenditëse ndahen në lidhëza këpujore, veçuese, kundërshtore, përmyllëse dhe të shkallëzimit. Këtyre grupeve mund t'u shtoheshin: kufizuese : *veçse*, *vetëm(se)*, *prapë*, *mirëpo*, *me sa*, *për sa etj.*; sqaruese: *domethënë*.

Lidhur me lidhëzat nënrenditëse krahasore-mënyrore mund të shtohet se krahasimi mund të jetë real: E ku ka gjë më të bukur *sesa* të shëtisësh nëpër një pyll me borë.

Por krahasimi mund të jetë dhe irreal. Atëherë përdoret lidhëza sikur: Bën *sikur* nuk di gjë.

Lidhëzave nënrenditëse mund t'u shtohet dhe ajo e zëvendësimit të veprimit (si në Wahrig): *Në vend që* të shkonte në shkollë, shkoi në kinema.

Edhe për lidhëzat e shprehjet lidhore mund të përpiloheshin lista të rregullta, më të plota se vargjet e shembujve në Gramatikën e përmendur. Listat mund të paraqiteshin

---

<sup>41</sup> Po aty, f. 388.

<sup>42</sup> Po aty, f. 397.

## **Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

---

në rend alfabetik, me emërtimin e llojit të lidhëzës përbri. Madje akoma më mirë do të kishte qenë që për çdo lloj lidhëze të renditur në listë të jepej kuptimi, përdorimi të shoqëruar me shembuj. Një gjë të tillë ne e kemi bërë në kapitullin ku trajtohen lidhëzat shkakore. Kapitulli është shoqëruar me një listë që përmban lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore. Krahas kuptimit të tyre janë dhënë dhe ngjyrimet që ato paraqesin në kontekste të ndryshme.

### II.1.4 Pjesëza

Në familjen e pjesëzave janë përfshirë dhe fjalët pohuese : *po, posi, po që po, po se po, si urdhëroni*. Janë përfshirë gjithashtu dhe fjalët mohuese: *jo, mos, jo që jo, jo se jo*.

Në gramatikën „Wahrig“, në „Albanische Grammatik“ (Gramatika shqipe) e Fiedler-it – Buchholz-it, në „Kurze Grammatik der deutschen Sprache“ (Gramatikë e shkurtër e gjuhës gjermane) të U. Engel-it e në shumë gramatika të tjera grupi i fjalëve të sipërpërmendura nuk trajtohet më në klasën e pjesëzave, por emërtohen fjalë-fjali (Satzäquivalent).

Si fjalë-fjali shërbejnë ato fjalë që normalisht përfaqësojnë një fjali. Fiedler-i/Buchholz-i përmbledhin në këtë klasë: pasthrrmat (bashkë me onomatopetë), formula përshëndetjeje dhe falenderimi, fjalët mohuese (jo etj.), fjalët pohuese (po etj.). Edhe U. Engel-i bën të njëjtin klasifikim. Në „Wahrig“ pasthrrmat vështrohen si një grup më vete dhe jo bashkë me fjalët-fjali. Gjithësesi, ato që në Gramatikën e Gjuhës Shqipe grupohen si pjesëza pohuese, mohuese ose formulat përshëndetëse dhe falenderuese (në kapitullin e pasthrrmave), në shumë e shumë gramatika europiane dhe joeuropiane trajtohen si fjalë-fjali (Satzäquivalent = ekuivalent i fjalisë). Mendoj që një vështrim i tillë i shkon për shtat dhe gjuhës shqipe, siç e kanë provuar dhe Fiedler-i/Buchholz-i në gramatikën e tyre.<sup>43</sup>

Pra, në klasën e fjalëve-fjali do të përfshiheshin: *po, po se po, po që po, po si jo; jo që jo, jo se jo, jo, mos; faleminderit, mirëmëngjes, mirupafshim, gëzuar etj.*

### II.2 Në gjermanisht

#### II.2.1 Ndajfolja

Ndajfolja është kategoria më e vështirë dhe më ekuivoke e fjalorit të gjuhës gjermane. Vështirësia fillon me termin Adverbium ‚ndajfolje‘. Termi është i dykuptimshëm. Fjala e prejardhur ad verbium mund të ketë kuptimin e një fjale sqaruese pranë një fjale tjetër, një fjalë e varur kuptimisht ose mund të ketë kuptimin e një fjale që gjendet pranë foljes, që lidhet kuptimisht me foljen duke plotësuar kuptimin e saj (verbum në latinisht do të thotë: a. fjalë; b. formulë; c. fjalë bosh; d. folje). Kjo pasiguri terminologjike ka sjellë dhe probleme të kufinjve të saj. Edhe pse të kufizuara në sasi, ndajfoljet me kuptimet e tyre shtrihen në fusha të ndryshme:

- Kanë kuptime vendore: dort, hier, oben, rechts etj. ‚atje, këtu, lart, djathtas etj.‘
- Mund të kenë kuptime kohore: gestern, immer, niemals ‚dje, gjithnjë, kurrë‘
- Shënojnë mënyrë: schön, langsam, schnell ‚bukur, ngadalë, shpejt‘
- Kanë kuptim shkak: deswegen, warum ‚prandaj, pse‘
- Shënojnë shkallëzim: sehr, wenig ‚shumë, pak‘

---

<sup>43</sup>Shih, Buchholz,O/ Fiedler,W., *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, f. 402, 403, 404, 405.

## **Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

---

Në klasën e ndajfoljeve duhet të bëhet dallimi midis ndajfoljeve të vërteta, fjalë të pandrysheshme morfologjikisht (dort, jetzt ,atje, tani‘) dhe ndajfoljeve-mbiemra, ku kufiri midis mbiemrit dhe ndajfoljes fshihet. Kjo dukuri quhet dhe ,përdorim adverbial i mbiemrave‘:

Der Hund ist schnell. ,Qeni është i shpejtë.‘ (mbiemër)

Der Hund läuft schnell. ,Qeni vrapon shpejt.‘ (ndajfolje)

Në shqip ndryshimi është i dukshëm, kemi dy forma të ndryshme fjalësh. Në gjermanisht nuk ka asnjë ndryshim morfologjik midis mbiemrit dhe ndajfoljes. Zakonisht ndajfolja dhe mbiemri kanë distribucion të ndryshëm: mbiemri gjendet në vendosje normale para emrit, ndajfolja- pas foljes. Por në shembujt e mësipërm schnell gjendet në të dyja rastet pas foljes. Na vjen në ndihmë vetëm kriteri kuptim. Njëherë schnell jep një tipar të qenit, njëherë një tipar të veprimit/ vrapon. Problem përbën dhe kufiri i ndajfoljeve me pjesëzat modale.

Një grup interesant në klasën e ndajfoljeve përbëjnë ndajfoljet përemërore. Për nga formimi ato përbëhen nga një ndajfolje dhe nga një parafjalë, kështu që morfologjikisht vendi i tyre është midis klasës së ndajfoljeve dhe asaj të parafjalëve. Kuptimisht ato janë më afër përemrave. Ato mund të përfaqësojnë emra, gjymtyrë dhe pjesë fjali, të cilat janë përmendur më parë ose më pas. P.sh.: daran, darauf, dabei ,për këtë, mbi këtë, këtu pranë‘ etj. Një kategori e tillë nuk është e pranishme në gjuhën shqipe. Nganjëherë përkthimi i këtyre ndajfoljeve paraqet vështirësi.

### **II.2.2 Parafjala**

Parafjalët (Präpositionen) qëndrojnë para emrave, përemrave dhe përcaktojnë në çdo rast rasën e tyre. Kuptimisht ato ngjasin me lidhëzat, ato lidhin gjymtyrë fjali njëra me tjetrën. Nga vetë emërtimi shihet që parafjalët qëndrojnë para emrave etj., por në gjermanisht ka parafjalë që qëndrojnë pas emrit. Në këtë rast ato duhej të quheshin pasfjalë (Postposition). Një emërtim i tillë nuk ekziston. Ja një shembull parafjale të pasvendosur: die Straße entlang ,gjatë rrugës‘, përkthimi fjalë për fjalë do të ishte ,rrugës gjatë‘.

Ka parafjalë që kërkojnë vetëm një rasë të caktuar, ka të tilla që përdoren me dy rase, ka dhe parafjalë që nuk drejtojnë asnjë rasë.

Parafjalë me një rasë: durch, für, gegen ... ,nëpër, për, kundër‘ ... kërkojnë rasën kallëzore.

Parafjalët gegenüber, gemäss, mit ... ,kundrejt, sipas, me‘ ... kërkojnë rasën dhanore.

Parafjalët wegen, zugunsten, mangels ... ,për shkak, në të mirë, në mungesë‘ ... kërkojnë rasën gjinore.

Parafjalët: in, neben, über, vor ... ,në, pranë, mbi, para‘ kërkojnë herë rasën dhanore, herë rasën kallëzore.

Parafjalët që përdoren në ndërtime si: Zug um Zug ,tren më tren‘, Punkt für Punkt ,pikë për pikë‘ nuk drejtojnë asnjë rasë.

### **II.2.3 Lidhëza**

Lidhëzat shërbejnë për të lidhur fjalë, pjesë fjalish ose fjali të tëra njëra me tjetrën. Lidhëzat i ndajmë në: lidhëza bashkërenditëse, lidhëza që bashkojnë pjesë fjalish, lidhëza nënrenditëse. Gjermanishtja ka 70 – 80 lidhëza.

## **Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

---

Në pikëpamje semantike lidhëzat bashkërenditëse i ndajmë në:  
këpujore: und, sowie, sowohl ... als auch, nicht nur ... sondern auch ... ,dhe; si ... ashtu edhe; jo vetëm ... por edhe‘  
kausale: denn ,meqë‘  
alternative: entweder ... oder; weder ... noch , ose ... ose; as ... as‘  
kundërshtore: aber, sondern ,por, por‘  
konkretizuese: das heißt ,domethënë‘

Në grupin e lidhëzave që lidhin pjesë fjalish hyjnë ato lidhëza që shërbejnë për të lidhur pjesë fjalish të thjeshta (gjymtyrë fjalie ose attribute) dhe jo fjali të tëra. Të tilla janë als ,si‘ dhe wie ,si‘.

Er arbeitet als Ingenieur. ,Ai punon si inxhinier.‘  
Er ist klug wie seine Schwester. ,Ai është i zgjuar si e motra.‘

### - Lidhëzat nënrenditëse

Lidhëzat nënrenditëse lidhin fjali rendesh të ndryshme: një fjali kryesore me një të varur, ose dy fjali të varura njëra me tjetrën: lidhëzat nënrenditëse ndahen në disa grupe sipas përdorimit:

lidhëza shkakore: se, sepse  
kushtore: në, nëse  
lejore: megjithëse, meqenëse  
mënyrore: sikurse, ashtu siç  
kohore: kur, sa  
krahasore: si  
kundërshtuese: ndërsa  
qëllimore: që

Lidhëza që shënojnë zëvendësimin e një veprimi me një tjetër: Die Studenten verließen die Universität, *anstatt dass* sie die Vorlesung besucht hätten. ,Studentët u larguan nga Universiteti *në vend që* të shkonin në leksion.‘

### II.2.4 Pjesëza

Në klasën e pjesëzave janë trajtuar këto grupe: pjesëzat modale, pjesëzat e mohimit, pjesëzat e shkallëzimit.

Pjesëzat modale shprehin ngjyrimë kuptimore që lidhen me qëndrimin e folësit ndaj përmbajtjes së fjalisë: Das ist *ja* eine Katastrophe! ,*Po* kjo është një katastrofë.‘

Pjesëzat e shkallëzimit evidentojnë pjesë të veçanta të fjalisë duke bërë intensifikimin e tyre kualitativ ose kuantitativ: *Sogar* ich habe den Minister gesehen. ,*Madje* unë e pashë ministrin.‘

*Nicht* ,nuk‘ është pjesëza e mohimit në gjermanisht. Me të mund të mohohet krejt fjalia, ose vetëm një pjesë e saj: Jutta singt nicht. ,Juta nuk këndon.‘ Das ist nicht Paul Cezanne! ,Ky nuk është Pol Cezan!‘

Në rastin tonë, për objektin tonë paraqesin interes të veçantë pjesëzat *nämlich, doch, ja*. Fjalët-fjali. Nga vetë emërtimi kuptohet që këto fjalë mund të përdoren me vlerë fjalie. Kjo klasë përbëhet nga fjalët e mëposhtme: a) ja, nein, doch ,po, jo, po‘; b) bitte, danke ,të/ ju lutem; faleminderit‘

Wollen Sie das Buch kaufen? – Ja! (= Ja, ich möchte es kaufen.)

,Doni ta bleni librin? – Po! (= Po, unë dua ta blej librin.)

## **Klasat e fjalëve që furnizojnë me elemente shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore**

---

Möchten Sie noch etwas Kaffee? – Danke! (= Nein, ich möchte nicht.)

„Doni dhe pak kafe? - Faleminderit! (= Jo, nuk dua.)

Fjalët ja dhe doch përdoren rëndom në fjalitë e thëniet shkakore. Mbi përdorimin e tyre si elemente gjuhësore pjesëmarrëse në paraqitjen e shkakut do të bëhet fjalë më poshtë.

Kjo ishte një paraqitje e përmbledhur e klasëve të fjalëve prej nga rrjedhin mjetet gjuhësore që kontribuojnë në realizimin e marrëdhënieve shkakore, klasifikimit të fjalëve në pjesë ligjërata në gjuhën gjermane, klasifikim i bërë në Wahrig „Grammatik der deutschen Sprache.“<sup>44</sup>

---

<sup>44</sup> Götze, L. /Hess-Lüttich, E.W.B., *Wahrig Grammatik der deutschen Sprache*, Gütersloh/München, Wissen Media Verlag, 2002.

### Kreu III Lidhëzat shkakore në shqip

Pasi bëmë një ekspozitë paraqitëse të grupeve të fjalëve që furnizojnë me elemente gjuhësore shprehjen e marrëdhënieve shkakore, do të ndalemi, së pari, në grupin e lidhëzave shkakore.

Në një kapitull më vete do të trajtohen këto lidhëza dhe në gjuhën gjermane. Siç kemi përmendur objekt i këtij punimi krahas lidhëzave shkakore janë dhe mjetet e tjera gjuhësore (ose mungesa e këtyre mjeteve) që shërbejnë për të realizuar marrëdhënie shkakore.

Funksioni i grupit të lidhëzave shkakore do të vëzhgohet pastaj në një korpus, ose më saktë, në dy korpuse, në rastin tonë në tekstin letrar të romanit „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ të shkrimtarit I. Kadare (originali shqip si dhe përkthimi gjermanisht).

Raporti shkak-pasojë mund të shprehet me mjete të ndryshme gramatikore. Mjetet më të rëndësishme janë: parafjalët, ndajfoljet dhe lidhëzat (edhe disa pjesëza marrin pjesë në ndërtimin e fjalive shkakore). Këto mjete duhen parë si sinonime sintaksore. Në rastin tonë do të merremi kryesisht me lidhëzat shkakore, por do të hedhim dhe një vështrim mbi mjetet e tjera gjuhësore që realizojnë lidhje shkakore. Vështrimi i këtyre mjeteve do të bëhet në pikëpamje semantike, sintaksore, pragmatike.

Lidhëzat shkakore në gjuhën shqipe janë: *se, sepse, si, pasi (mbasi), derisa, gjersa, përderisa, kur, që, sapo, meqenëse, meqë, ngaqë, ngase, prejse, duke qënë se, nga frika se, nga shkakun që, për arsye se, për shkak se, posa që, sapo që* etj. Lidhëzat shkakore shërbejnë për të ndërtuar fjali që shprehin lloje të ndryshme marrëdhëniesh shkakore. P.sh.: Si s'kishte kamzhik, i ra kafshës me grusht.<sup>45</sup>

Lidhëzat shkakore mund të ndahen në tri grupe:

- lidhëza e lokucione lidhëzore konstatuese të shkakut: *se, pse, sepse, ngaqë, ngase, nga shkakun se, nga shkakun që, për shkak se, për arsye se, me pretext se, nga frika se mos;*
- lidhëza e lokucione lidhëzore motivuese, arsyetuese si *meqë, meqenëse, meqënëqë, duke qënë se, përderisa;*
- lidhëza e lokucione kohore si *kur, tek, si, mbasi, pasi, posa, sapo, gjersa, derisa, sakohë që, tani që, sot që, qëkur, qëkurse, qyshse.*

Trajtimi veças i lidhëzave shkakore paraqet interes për dy arsye kryesore:

*Së pari*, për rëndësinë e madhe që kanë këto lidhëza si element i domosdoshëm i komunikimit për të shprehur pse-në e gjërave.

*Së dyti*, për faktin që kjo temë nuk është shumë e rrahur nga gjuhësia jonë.

Klasa e lidhëzave shkakore është tepër e gjerë, prandaj ne jemi kufizuar në një grup të kësaj klase. Do të trajtohen veçanërisht lidhëzat (konstatuese): *se, sepse, që, pse, përse* (në tekstet e vjetra), *ngaqë, ngase*. Ato do të vështrohen, siç u tha më lart, në plan semantik, sintaksor dhe pragmatik.

---

<sup>45</sup> Shih, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 408.

### III.1 Shprehja gjuhësore e raporteve shkakore në gjuhën e sotme shqipe

#### III.1.1 Lidhëza se

Siç përmendëm pak më lart është një nga shkakoret më të përdorshme. Ajo përdoret në gjuhën e folur dhe në atë të shkruar. Në kohën e sotme, me zhvillimin e madh që kanë marrë të gjitha stilet, sidomos stili shkencor, politik, juridik dhe administrativ krahas shkakores *se* po gjen një përdorim të gjerë e të dendur dhe shkakorja *sepse*. Për vetë karakterin e këtyre stileve që kërkon saktësi, përpikmëri e një ngjyrim të theksuar arsyetimi shkakorja *sepse* po zë gjithnjë e më tepër vend, madje dhe në stilin e letërsisë artistike, në autorë dhe në vepra letrare, ajo po shfaq një denduri përdorimi here-herë më të lartë se shkakorja *se*.<sup>46</sup>

Edhe në gjuhën e sotme lidhëza *se* mund të përmbajë në semantikën e saj ngjyrimet kundrinore. Pra, ka raste që ajo nuk del si shakore e pastër, por paraqet një ndërthurje të kuptimit shkakor me ngjyrimet kundrinore: Gëzohuni *se* erdhi pranvera → Gëzohuni që erdhi pranvera. Në këtë rast lidhëza *se* është plotësisht e ndërkëmbyeshme me *që*.

Ndërthurja e ngjyrimëve shkakore me ato kundrinore ndodh zakonisht në fjalitë e varura shkakore të argumentimit të ndjenjës: Trembej *se* nuk do ta kuptonin.

Në fjalitë e varura shkakore të argumentimit të dëshirës ngjyrimet kundrinore janë tejet të zbeta: Dua të vete aty, *se* e bëjnë kafën të mirë.

Në fjalitë shkakore të drejtpërdrejta sot janë të rralla përdorimet e lidhëzës *se* me ndërthurje ngjyrimesh shkakore dhe kundrinore. Në rastet, kur ajo paraqet ngjyrimet kundrinore, është e ndërkëmbyeshme me shkakoren *që*: Fajin e pata vetë *se* u ktheva në mesnatë. Krahaso: Fajin e pata vetë *që* u ktheva në mesnatë.

Kur ngjyrimi kundrinor mungon ose është i zbetë, atëherë zëvendësimi i *se*-së me *që* është i pamundur: Po shkonte fshehur *se* s'donte ta merrnin vesh shokët.

Ndërtimi me *që* është i pamundur: Po shkonte fshehur *që* s'donte ta merrnin vesh shokët (?).

Në fjalinë shkakore argumentuese të urdhërit sot pothuaj nuk haset përdorimi i *se*-së me ngjyrimet kundrinore: Nisemi, *se* në orën 12 duhet të jemi në Tiranë.

Në disa raste pjesa e varur shkakore që fillon me *se* varet nga një pjesë kryesore që nuk është e pranishme:

Na ngatërrove, o djalë, *se* s'ta di as emrin.

I prishi prapë marrëdhëniet me turqit, *se* e shohim prapë në luftë me Sulltan Muratin II.

Në të dy këta shembuj pjesa e varur ka formë e kuptim shkakor, por pjesa kryesore nuk përbën pasojën e shkaqeve të përmendura.

Pamja tipike, në pikëpamje komunikative, e strukturave që lidhen me *se* është: pjesa e varur lidhet me një thënie modale të folësit. Modaliteti i kësaj thënieje mund të jetë shprehje urdhëri, dëshire etj.:

*Trego, se kemi dhe dëshmitarë.*

*Mos na bjerë ndonjë rrufe këtu, se e ndjell shumë ky plepi.*

---

<sup>46</sup> Shih, Buchholz, O., „Kausalkonjunktionen in der heutigen albanischen literarischen Sprache“, botuar në, *Zeitschrift für Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung*, Band 35/H. 4; Berlin 1982, f. 383- 391.

Ndodh që lidhëza *se* të paraprihet nga pjesëza të tilla si: pikërisht, vetëm etj. Pjesëza *pikërisht* e saktëson edhe më shkakun: Unë e kritikova, *pikërisht* se erdhi.

Ndërsa përdorimi i pjesëzës *vetëm* para lidhëzës shkakore *se* jo vetëm e dallon shkakun e dhënë nga të tjerët, por dhe e përcakton atë si të vetëm dhe si më kryesorin:

Unë humba, vetëm *se* u vonova pak.

Ka ndojnë rast ku shkakorja *se*, e përfshirë në fjalinë e nënrenditur shkakore, është kthyer në një shprehje të ngurosur: *se s'bën* ,domosdo, patjetër‘.

### III.1.2 Lista e lidhëzave shkakore dhe e shprehjeve lidhore shkakore

Kjo listë përmban tërë lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore shkakore. Si të tilla janë trajtuar jo vetëm ato që kanë kuptim të pastër shkakor, por dhe ato që përmbajnë ngjyrimë të tjera kuptimore krahas atij shkakor. Janë përfshirë gjithashtu dhe lidhëzat në të cilat kuptimi shkakor nuk është parësor ose kryesor. Jemi përpjekur që listën ta japim në rend alfabetik.

derisa: kohore, shkakore

jo se ... po se : shkakore

kur: kohore, kohore – shkakore, shkakore, kundrinore, kushtore

meqënëse/ meqënëqë: shkakore

meqë: shkakore

nga puna (se/që): shkakore

nga që: shkakore

nga se: shkakore

nga shkakun se: shkakore

pasi: kohore-shkakore, shkakore

për arsye se: shkakore

përderisa: kohore , shkakore

për shkak se: shkakore

po që: kohore, shkakore

posa: kohore, shkakore

posaqë: kohore, shkakore

prej se: shkakore

pse / përse: kundrinore, shkakore

që: kundrinore, shkakore, vendore

sa: kundrinore, kohore – shkakore, shkakore, krahasuese ...

sapo(që): kohore, kohore – shkakore, shkakore

saqë: kohore, kohore – shkakore

se: shkakore, kundrinore, krahasuese

sepse: shkakore

si: kohore – shkakore

tek: kohore – shkakore, shkakore

### III.1.3 Mjete të tjera gjuhësore – shprehëse të raporteve shkakore në shqip

*Foljet kausative (faktitive)*: janë një grup foljesh ose shprehjesh foljore, kuptimi i të cilave mund të parafrazohet me një shprehje ekuivalente ku është e pranishme folja bëj ose ndikoj. P.sh.: e deh ,bëj që të dehet‘; e studioi djalin ,ndikoi që djali të



studionte<sup>47</sup> etj. Po në këtë klasë fjalësh bëjnë pjesë edhe disa folje të prejardhura nga mbiemrat: i kuq – skuq , i bardhë – zbardh etj. Një nëngrup më vete përbëjnë foljet ergative. Ato dalin si kalimtare dhe si jo kalimtare. Në formën kalimtare ato kanë semantikë kauzative: Dielli shkrin akullin. Akulli shkrin. Në shembullin e parë kemi të bëjmë me një folje kauzative. Përdorim kauzativ kanë dhe shprehjet foljore të formuara me një folje ndihmëse kauzative: bëj, lë: E lashë brumin të vinte. E bëj të dridhet nga frika. Etj.<sup>47</sup>

Semantika e thënieve që përmbajnë folje kauzative mund të paraqitet skematikisht kështu: Vepruesi ndikon që të shfaqet një pasojë.

Vetë folja (ose shprehja foljore kauzative) e përmban në semantikën e saj shkakun dhe pasojën që rrjedh prej tij. Folje të tjera kauzative janë: justifikoj, shkaktoj, jam përgjegjës, ndikoj, ndikohem, çon, rrjedh, del, rezulton, varet, mbështetet etj.

*Shprehje lidhëzore*: Disa lidhëza shkakore herë-herë hyjnë në shprehje të ndryshme e bëhen pjesë përbërëse e tyre. Këto shprehje mund të jenë lidhëzore, por shpesh dhe ndajfoljore, madje dhe foljore.

Kështu lidhëza shkakore *se*, e përfshirë në fjalinë e nënrenditur shkakore, është kthyer në shprehje të ngurosur në rastin: *se s'bën*. Sot kjo shprehje ka kuptimin ‚domosdo, patjetër, medoemos‘. P.sh.: Ata do të vinë *se s'bën*.

Dikur ky ndërtim ka qenë fjali. Dëshmi për këtë është prania e foljes së shtjelluar *bëj* dhe lidhëzës shkakore *se*, kuptimi shkakor i së cilës ndjehet ende. Lidhëza *se* në këtë shprehje të ngurosur e ka humbur funksionin lidhëzor.

Lidhëza *se* shërben dhe si pjesë përbërëse e shprehjeve lidhëzore shkakore, si: *nga shkakun se, për arsye se, nga puna se, nga frika se mos, prej se, për shkak se* etj.

Kjo lidhëzë është pjesë përbërëse dhe e disa ndërtimeve të tjera, të cilat ende nuk janë konsoliduar si të tilla, ende nuk janë kthyer në shprehje të ngurosur. Por vihet re prirja e tyre për t'u ngurosur. Këto shprehje janë karakteristike për stilin libror: *me besim se, me shpresë se mos, me frikë se* etj. P.sh.:

Unë vajta në mëngjes *me shpresë se mos* e gjeja atë në shtëpi.

Ndaloi *me besim se* ajo do t'i fliste. *Nga frika se mos* e shihnin ndërroi rrugë. Etj.

Shprehjet lidhëzore të ngurosur: *nga shkakun se, për arsye se, nga puna se, për shkak se* etj. po përdoren gjithnjë e më shumë në gjuhën e shkruar. Por shpesh vihet re prirja për të përdorur në vend të lidhëzës se një emër (shpesh foljor) në gjinore: *për shkak se = për shkak të*:

Ai nuk erdhi *për shkak se* binte shi = Ai nuk erdhi *për shkak të* shiut. Edhe pse thëniet janë semantikisht sinonime, ka midis tyre një lloj dallimi, në planin stilistik. Ndërtimet me gjinore kanë karakter libror, janë veçori e gjuhës së librave.

Togu i qëndrueshëm *s'ka pse* (me element përbërës lidhëzën shkakore *pse*) ka marrë trajtën e një shprehjeje të ngurosur foljore: Propozimi im *s'ka pse* të mbetet sekret. Kuptimisht togu *s'ka pse* është i afërt me formën foljore *s'duhet* ( Propozimi im *s'duhet* të mbetet sekret). *Pse* në këtë ndërtim s'është më lidhëz, por pjesë e pandarë e shprehjes (ka pësuar një lloj desemantizimi). Elementi *pse* merr pjesë dhe në ndërtimin *çka pse*. Edhe këtu *pse-ja* e ka zbehur kuptimin shkakor dhe formon një njësi leksikore me elementin tjetër. Të dyja fjalët së bashku përbëjnë një njësi

---

<sup>47</sup> Shih, Steinitz, R., „Zur Semantik und Syntax der urativer, inchoativer und kausativer Verben“, botuar në, *Linguistische Studien* 35,1977, f. 85 – 129.

leksikore, që del me vlerën e lidhëzës lejore: Hani, pini, *çka se* të tjerët vdesin nga uria.

Interes paraqesin dhe ndërtime të tipit *s'di pse*. Edhe në lokucione të tilla pse nuk paraqitet si lidhëz shkakore. Në vështrim të parë duket se ka vlerën e ndajfoljes lidhore, por, në fakt, ndërtime të tilla funksionojnë në gjuhë si shprehje ndajfoljore plotësisht të zëvendësueshme nga ndajfolja *sepse*: Desha t'ia mbathja po *nuk di pse* këmbët s'më lëvizën.<sup>48</sup>

Nga zëvendësimi i *nuk di pse me sepse* do të kishim: Desha t'ia mbathja, po *sepse* këmbët s'më lëviznin. Sinonimia midis fjalive është pothuaj e plotë.

Shpesh në gjuhë përdoret dhe korrelacioni lidhëzor: *jo se ... por se* që shfaqet në trajtat: *jo se ... por sepse, jo se ... por pse, jo pse ... por se, jo sepse ... por sepse*. Ky korrelacion realizon lidhjen bashkërenditëse të dy fjalive të nënrenditura shkakore. Te fjalia e parë shkakore lidhëza shkakore *se* e shoqëruar nga pjesëza e pandarë dhe e pazëvendësueshme mohuese *jo* mohon një fakt si shkak, për të pohuar në formën e kundërshtimit një shkak të vërtetë të prirë nga *por se*. Te kjo e fundit *se* mund të mos përdoret:

Unë isha ndër të parët që e mora vesh lajmin, - vazhdoi ai, - *jo se* interesohesha për histori të tilla, *por* vetë puna ime në kafene më bënte të mësoja i pari çdo ngjarje të qytetit.<sup>49</sup>

Ka dhe raste kur shkak i vërtetë mund të pohohet nga një fjali tjetër pa përdorur lidhëzën *por*. Ajo nënkuptohet: Ajo nuk e lexoi atë letër. *Jo se* nuk ishte kurioze . Nuk donte t'i kthehej më së shkuarës. (*Por* nuk donte t'i kthehej më së shkuarës.)

### III.1.4 Parafjalët që përdoren për shprehjen e marrëdhënive shkakore

Parafjalët nuk mund të përdoren të izoluara, kështu që ato nuk funksionojnë si gjymtyrë fjalie. Ato janë vetëm pjesë përbërëse të gjymtyrëve të fjalisë. Parafjalët shërbejnë si elemente lidhëse midis fjalëve ose midis grupe fjalësh dhe sinjalizojnë marrëdhëniet sintaksore të tyre.

Fjalia: Ajo nuk erdhi *për shkak të* shiut., përmban në strukturën e saj një frazë parafjalore *për shkak të* shiut. Grupi parafjalor mund të transformohet në fjali shkakore: Ajo nuk erdhi, *sepse* binte shi. Transformimin e grupeve parafjalore me kuptim shkakor në fjali të varura shkakore e kemi trajtuar në paragrafin mbi parafjalët si mjete shprehëse të raporteve shkakore në gjuhën gjermane. Në përgjithësi ajo që është thënë për gjermanishten vlen edhe për shqipen. Kjo duket dhe në përkthimin e shembujve në gjuhën gjermane që kanë gjithnjë përgjegjës në gjuhën shqipe (në rastin e transformimit të fjalive shkakore në grupe parafjalore me kuptim shkakor ose dhe anasjelltas, në transformimin e grupeve parafjalore me kuptim shkakor në fjali të varura shkakore).

Numri i parafjalëve që përdoren për shprehjen e raporteve shkakore në gjuhën shqipe është relativisht i pakët. Disa prej këtyre parafjalëve përmbajnë në vëllimin e tyre semantik dhe ngjyrim të tjera përveç atyre shkakore, ose ngjyrimet shkakore u mbishtresohen ngjyrimëve të tjera: me pasuritë e saj natyrore... → *për shkak të* pasurive të saj natyrore (Parafjala *me* në rastin e dhënë ka kuptim instrumental dhe

---

<sup>48</sup> I. Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 98.

<sup>49</sup> I. Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 59.

shkakor njëkohësisht). Më poshtë po japim një listë të parafjalëve<sup>50</sup> që mund të shërbejnë për të realizuar marrëdhënie shkakore:

falë (+ rrjedhore): falë punës së tij ...  
në sajë (+ gjinore): në sajë të zellit të treguar ....  
nga (+emërore): nga uria; nga sëmundja; nga zemërimi ...  
nga shkak ( + gjinore): i vonesës ...  
për (+ kallëzor): fajin e tij; për këto fjalë ...  
për arsye (+gjinore): të situatës; të gjendjes ...  
për hir (+ gjinore): të shokëve ...  
për punë (+ gjinore/ rrjedhore): të seminarit; inati ....  
për shkak (+ gjinore): të largimit tënd ...  
prej (+ rrjedhore): frikës ...

### III.1.5 Ndajfoljet shkakore

Një mjet tjetër gjuhësor që mund të shërbejë për ndërtimin e raporteve shkakore janë dhe ndajfoljet shkakore. Në gjuhën shqipe ato japin në mënyrë shumë abstrakte dhe të përgjithshme shkakun ose arsyen e një përmbajtjeje të dhënë në fjalinë kryesore. Të tilla janë: *prandaj, rrjedhimisht, përndryshe, pse*:

Ata duan liri, *prandaj* e vazhdojnë luftën.

Ndonjëherë këto ndajfolje mund të funksionojnë dhe si lidhëza bashkërenditëse (prandaj janë quajtur ndajfolje lidhore ). Në këtë rast ato i bashkërenditen një fjalisë paraprirëse, e cila shënon shkak, arsye:

Treni u vonua, *prandaj* Agimi nuk arriti me kohë.  
Ti duhet të punosh më shumë, *përndryshe* s' do t'ia arrish qëllimit.

Ndajfoljet mund të përdoren dhe si fjalë korrelative në pjesën kryesore të fjalisë shkakore<sup>51</sup>:

*Prandaj* nuk erdhi, *se* ishte sëmurë.

*Ndajfoljet pyetëse*<sup>52</sup> → Me anë të tyre pyetet për shkakun, arsyen, motivin: *Pse* nuk e mbarove?

Këtu hyn dhe ndajfolja përse: *Përse* të shkojë ai dhe jo unë ?  
Ndajfoljet pyetëse përdoren në krye të një fjalisë pyetëse të drejtë ose të një fjalisë thirrrore. Ato mund të dalin dhe në pjesën e varur të një fjalisë pyetëse të zhdrejtë. Në këtë rast ato mund të shoqërohen dhe me lidhëzën *se*, e cila paravendoset: *Asnjë* nuk më qortoi, (*se*) *pse* nuk erdha dje në shkollë.

Ndonjëherë ndajfoljet pyetëse të shkakut mund të kenë të gërshetuara pyetjen për shkakun dhe pyetjen për qëllimin e kryerjes së një veprimi. Kjo ndodh zakonisht në pyetjet retorike: *Pse* duhej të ndodhte ky keqkuptim?

---

<sup>50</sup> Krahas parafjalëve është dhënë në kllapa dhe rasa që ato drejtojnë.

<sup>51</sup> Shih, Buchholz,O/ Fiedler,W., *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, f. 370.

<sup>52</sup> Shih, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 363 – 364; Buchholz,O/ Fiedler,W., *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, f. 369 – 370.

### III.1.6 Format e pashtjellura foljore me funksion shkakor<sup>53</sup>

Forma e pashtjelluar pjesore veprare mund të përfaqësojë pjesën e varur të fjalisë shkak:

*Lodhur e këputur nga rruga e gjatë, rashë në gjumë.*

Në vend të pjesës së varur të fjalisë shkakore mund të përdoret forma e pashtjelluar mohore:

*Mësuesi plak, pa ditur të vërtetën, vinte vërdallë për ta qetësuar.*

Edhe forma përcjellore veprare mund të përdoret me funksion shkakor:

*Ai më ka ndihmuar duke më vënë në dispozicion librat e tij.*

Një mjet tjetër gjuhësor që mund të përdoret për dhënien e raportve shkakore është dhe fjalia përcaktore. Në këtë rast pjesa e varur nëpërmjet karakteristikës që jep për sendin, frymorin e shprehur me emrin paraprijës tregon njëkohësisht shkakun, motivin, arsyen e asaj që thuhet në pjesën kryesore. Fjalia përcaktore me ngjyrim shkakor është gjithnjë fjali përshkruese. Në të pjesa e varur mund të vendoset pas kryesores, ose mund të hyjë në mes:<sup>54</sup>

*Krerët e vegjël, që nuk jepnin dot para, u ngarkuan të dërgonin më tepër ushtarë.*

## III.2 Përfundime

### III.2.1 Lidhëzat shkakore

Në gjuhën shqipe kanë pasë qenë përdorur lidhëzat shkakore *se, përse, pse, sepse, që, ngaqë, ngase*. Në gjuhën e sotme letrare shqipe përdoren shkakoret *se, sepse, ngaqë, që* dhe rrallë *pse*.

Ndër lidhëzat shkakore *ngaqë* dhe *ngase* janë krejt sinonime ndërmjet tyre. Kjo ka sjellë mënjanimin nga përdorimi të lidhëzës *ngase*.

Lidhëza *sepse* i mbulon pothuaj të gjitha përdorimet e shkakores *pse*. Ajo nuk mund ta zëvendësojë atë vetëm kur *pse* paraqet ndërthurje ngjyrimesh shkakore me kundrinore. Në raste të tilla *pse* mund të zëvendësohet prej shkakores *që*. Lidhëza shkakore *pse* dallohet për qartësi sintaksore, krahasuar me shkakoren *që*. Nga ana tjetër lidhëza *pse* ka një ngjyrim të theksuar arsyetimi, që i mungon shkakores *se*, e cila nga ana e saj mund ta zëvendësojë *pse*-në. (Pra, *pse* dhe *se* dallohen për nga ngjyrimi kuptimor i arsyetimit që *pse* e ka më të theksuar).

Lidhëza *se* e zëvendëson gjithnjë *që*-në, por nuk është krejt e njëllojtë me të. Nga vetë natyra e saj *se*-ja ka kuptim shkakor, ka dhe një lloj ngjyrimi arsyetues, ndonëse të zbetë.

---

<sup>53</sup> Shih, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 333 – 337.

<sup>54</sup> Shih, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Tiranë, 2002, f. 533; Buchholz, O/ Fiedler, W., *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, f. 523.

Kur lidhëza *që* paraqitet e paqartë nga ana sintaksore, atëherë në vend të saj mund të përdoret shkakorja *pse*, e cila paraqet ndërthurje ngjyrimesh, por e ka të qartë kuptimin e shkakut.

Shumica e lidhëzave kohore (siç duket dhe nga lista e dhënë më lart e lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe) dalin dhe me ngjyrimet shkakore. Me përjashtim të lidhëzave *sa* dhe *para se* gjithë lidhëzat dhe lokucionet kohore mund të tregojnë edhe shkak: Të tilla janë: *kur, tek, si, pasi, mbasi, që kur, posa, sapo, gjersa, derisa, sa kohë* etj.

I erdhi keq *kur* e pa në atë ditë.

Ngjyrimet shkakore shfaqen sa herë që përmbajtja e pjesës kryesore pason atë të pjesës së varur dhe sa herë që raportet kohore nuk ndihen më.

### III.2.2 Mjete të tjera gjuhësore-shprehëse të raporteve shkakore

- Foljet kauzative

Ato shprehin shkakun e një veprimi. Të tilla janë: *bëj, lë, skuq, zbardh*.

- Shprehjet lidhëzore

Shprehjet lidhëzore përbëhen prej dy a më shumë fjalësh të cilat kanë një kuptim të vetëm dhe kryejnë funksionin e një lidhëze. Lidhëzat e thjeshta (të parme ose të prejardhura) janë më abstrakte dhe shprehin një numër më të madh kuptimesh në krahasim me lidhëzat e përngjitura e lokucionet, të cilat kanë një kuptim leksikor më të qartë e më konkret. Kështu, p.sh., vlera e lidhëzës *se* (ftilluese, shkakore a krahasore) sqarohet vetëm brenda fjalisë ku është përdorur, ndërsa lidhëzat e përngjitura dhe lokucionet e formuara me pjesëmarrjen e saj, si: *sepse, ngase, për shkak se, duke qenë se, meqenëse* rroken menjëherë si lidhëza shkakore. Në shumicën e rasteve lidhëzat që marrin pjesë në formimin e një lokucioni janë *se* dhe *që*. Këto lidhëza mund të bashkohen:

me një emër: *për arsye se, nga frika se, nga shkak se, për shkak se*

me një formë foljore, para së cilës mund të vendoset ndonjë element tjetër:  
*duke qenë se...*

me një lidhëz tjetër: *sapo që, posa që...*

me përemrat *sa* dhe *çdo*: *sa herë që, çdo herë që ...*

me pjesëza: *jo se ... por se ...*

- Parafjalët

Parafjalët që përdoren për shprehjen e raporteve shkakore në gjuhën shqipe nuk janë shumë. Pak më sipër ne kemi dhënë një listë që përmban parafjalët me kuptim shkakor në gjuhën tonë. Ndër më të përdorshmet janë parafjalët *për arsye, për shkak*. Këto mund të merren dhe si sinonime, por kuptimi i shkakut është më i fortë tek e dyta, që ka në përbërjen e e saj vetë fjalën shkak. Pjesa më e madhe e parafjalëve që përdoren për të realizuar marrëdhënie shkakore drejtojnë rasën gjinore.

- Ndajfoljet

Ndajfoljet shkakore (lidhore) shprehin në mënyrë shumë abstrakte dhe të përgjithshme shkakun ose arsyen e një përmbajtjeje të dhënë në një pjesë të fjalisë shkakore. Ndajfolje shkakore janë: prandaj, rrjedhimisht, përndryshe, pse. Në fjalinë shkakore, ku bëjnë pjesë, ato funksionojnë si lidhëza bashkërenditëse; paraprijnë pjesën që shpreh pasojën e një shkakut të shprehur në pjesën tjetër të fjalisë, njëkohësisht e ripërmendin këtë shkak: Ishte ftohtë, *prandaj* nuk u nisa.

Ndajfoljet pyetëse shkakore shërbejnë për të pyetur për shkakun e kryerjes së një veprimi. Këtu hyjnë *pse* dhe *përse*. Ndonjëherë këto ndajfolje kanë të gërshetuara pyetjen për shkakun dhe pyetjen për qëllimin e kryerjes së veprimit. Kjo ndodh shpesh në pyetjet retorike: *Pse* të na mundonte aq shumë ?

- Disa forma të pashtjelluara në trajtën veprorë mund të shprehin gjithashtu raporte shkakore. Të tilla janë: pjesorja, mohorja, përcjellorja.
- Edhe fjalia përcaktore mund të përmbajë ngjyrimë shkakore: *Juve që na ndihmuat në ditë të vështira, s'ju kursej asgjë.*

### Kreu IV Panoramë e përdorimit të lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe

Për të realizuar këtë përshkrim-panoramë të përdorimit të lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe kemi përdorur korpusë të ndryshme. Në zgjedhjen e korpusit jemi nisur nga kriteret kohore, tematike, stilistike, tekstore.

Po e hapim ciklin e paraqitjes së peizazhit lidhëzor-shkakor të gjuhës sonë me një ekspozitë të sistemit lidhëzor, dhe në këtë kuadër të atij lidhëzor-shkakor, të përdorur në „Mesharin“ e Gjon Buzukut.

#### IV.1 Lidhëzat shkakore në „Mesharin“ e Buzukut

Për të përshkruar dhe analizuar përdorimin e lidhëzave shkakore që përdoren në veprën „Meshari“ të Buzukut<sup>55</sup> kemi vjelë në mënyrë shteruese të gjitha lidhëzat, bashkërenditëse dhe nënrenditëse, që gjenden në të. Këtë punë voluminoze e kemi bërë për t'i vështruar dhe trajtuar lidhëzat shkakore në kuadrin e tërë lidhëzave të hedhura në tekst nga Buzuku.

##### IV.1.1 Lidhëzat nënrenditëse

Sipas statistikave tona Buzuku përdor rreth 5769 lidhëza. Pjesa më e madhe e lidhëzave të përdorura nga Buzuku janë lidhëza bashkërenditëse. Ndër lidhëzat bashkërenditëse rreth 3670 janë këpujore, 36 janë lidhëza veçuese, 103- kundërshtore, 2- përmbyllëse, 9- të shkallëzimit. Statistika e lidhëzave nënrenditëse të përdorura nga Buzuku jep të dhënat e mëposhtme:

Ftilluese, rreth 316  
Vendore, rreth 27  
Kohore, rreth 250  
Shkakore, rreth 546  
Qëllimore, rreth 190  
Krahasore- mënyrore, rreth 458  
Kushtore, rreth 155  
Rrjedhimore, rreth 5  
Lejore, rreth 2

Numri i lidhëzave bashkërenditëse është shumë më i madh se ai i atyre nënrenditëse. Për mendimin tonë kjo ka të bëjë me natyrën dhe stilin kishtar të veprës dhe jo me faktin që në gjuhën e folur të kohës së Buzukut përdoren më shumë lidhëza bashkërenditëse nga nënrenditëse. Kjo për arsyen e thjeshtë se lidhëzat nënrenditëse shprehin një rreth shumë më të gjerë marrëdhëniesh semantiko-sintaksore se bashkërenditëset.

Siç del nga statistika e mësipërme lidhëza shkakore ka epërsi përdorimore ndër lidhëzat e tjera nënrenditëse. Në gjuhësi vlen deviza: *post hoc ergo propter hoc*, pas kësaj, domethënë për shkak të kësaj. Kjo do të thotë që në gjuhësi marrëdhëniet shkakore nuk kanë të bëjnë vetëm me lidhje dukurish që rrjedhin njëra nga tjetra (lidhje ontologjike shkak-pasojë), por me lidhje fjalish, të cilat shpesh nuk shprehin raporte reale shkakore. Në ligjërimin e asaj kohe, siç duket, strukturat shkakore të

---

<sup>55</sup> *Meshari i Gjon Buzukut*, USHT, Tiranë 1968, I, II.

## Panoramë e përdorimit të lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe

mendimit, ndërtimet sintaksore shkakore ishin shumë të përdorshme. Për më tepër tematika fetare e veprës e justifikon mënyrën argumentuese e motivuese të paraqitjes së materialit.

### IV.1.1.1 Pasqyrë përmbledhëse e lidhëzave nënrenditëse

Po japim një pasqyrë përmbledhëse të lidhëzave nënrenditëse të vjela në „Mesharin“ e Buzukut. Pasqyra përmban lidhëzat nënrenditëse të përdorura nga Buzuku . Në kollonën e djathtë „Shembuj“ jepen shembuj ilustrues të nxjerrë nga vepra në fjalë.

Lidhëzat	Shembuj
Ftilluese: <i>se, qi</i>	E tash vëllazënë, u e di <i>se</i> për të paditunë e batë <sup>56</sup> . ...por me gjithë oratë e të lutunë bani <i>qi</i> me vepërat të hirit të jenë ditënë të lypunatë tuaj <sup>57</sup> .
Vendore: <i>ku, tuk, tek, tekë</i>	Se të mi vëllazënë, thujnë, ty të lus <i>ku</i> ata kullosënë <sup>58</sup> . E si gjegj se aj ish sëmuni, mbet mb atë vend <i>tuk</i> ish dy dit <sup>59</sup> . ... e i sillido të ketë gjyq o gja qartë <i>tek</i> ta venë <sup>60</sup> .
Kohore: <i>kur, si, qi, se, sa, por sa, përse, sa ku, tuk</i>	E ti <i>kur</i> të ngjënosh, lyej kryetë tat e laj faqenë tande <sup>61</sup> ... E <i>si</i> këta tha, u dëftuo duortë e brinjëtë e ti <sup>62</sup> .
Shkakore: <i>se, për se përse</i>	Mos druaj, <i>se</i> mbaskëndaj ti të zash njerëz <sup>63</sup> . Na duomë atë, <i>përse</i> aj parë desh neve <sup>64</sup> . E këjo fjalë ish e fshehunë n sish, <i>përse</i> nukë mundë mernjinë përse ai flit <sup>65</sup> .
Qëllimore: <i>përse, qi</i>	Uroni <i>përse</i> mos banetë tikunitë taj ndë mot të dimënit, o të shëtundenë <sup>66</sup> . Me kapistrët e me fret shtrëngo fëlqinjëtë e tyne, <i>qi</i> të mos mundë afëronetë ty <sup>67</sup> .
Krahasore-mënyrore: <i>porsi, si, se, sa</i>	Ky anshtë ordhëni em, ju të duhi mirë njani tjetërinë, <i>porsi</i> u desha juve <sup>68</sup> . Ju i kini kujdes për të ruojtunë; ecëni e ruoni <i>si</i> dini ju <sup>69</sup> . <i>Sa</i> janë qielltë n dheut të nalta, <i>aq</i> janë udhëtë e mi n suojshtit <sup>70</sup> ... A s ini ju ma të vëjyeshin <i>se</i> ata <sup>71</sup> ? E shekulli në do keq, ju të dini se parë muo më desh keq <i>se</i>

<sup>56</sup> Meshari i Gjon Buzukut, USHT, Tiranë 1968, I, II, f.245.

<sup>57</sup> Po aty, f. 87.

<sup>58</sup> Po aty, f.145.

<sup>59</sup> Po aty, f.183.

<sup>60</sup> Po aty, f. 127.

<sup>61</sup> Po aty, f. 113.

<sup>62</sup> Po aty, f.251.

<sup>63</sup> Po aty, f. 281.

<sup>64</sup> Po aty, f. 275.

<sup>65</sup> Po aty, f. 113.

<sup>66</sup> Po aty, f.315.

<sup>67</sup> Po aty, f. 43.

<sup>68</sup> Po aty, f. 353.

<sup>69</sup> Po aty, f.211.

<sup>70</sup> Po aty, f. 253.

<sup>71</sup> Po aty, f 295.



	juve <sup>72</sup> .
Kushtore: <i>në, n, në kloftë se, në kloftë qi</i>	Ata <i>në</i> janë Xhudhi, edhe u jam <sup>73</sup> . E <i>n</i> anshtë kun kshill, aj si do ban, por do me u gjegjunë <sup>74</sup> . Qi ju <i>n</i> si gëzonj, e tash në kloftë se për pak t ini trazuom mbë shumë mëndyrë për të tentuom, përse të provuomitë e fesë saj të jetë ma e paçmuome se ari <sup>75</sup> . ... <i>në kloftë qi</i> t u jesë kun gjakafshë, jut a digjëni me zjarr <sup>76</sup> .
Rrjedhimore: <i>ashtu qi, aq sa, sa</i>	... pështyj e shaj gjithë të glanëtë e dreni, <i>ashtu qi</i> kurajtë ati mos i nfalesh <sup>77</sup> . E aj nuk ju përgjigj as fjalë, <i>aqë sa</i> gjykatësi çudite fort <sup>78</sup> . E si rjetë patnë shtim, zunë të madh pesh, <i>sa</i> këputishnë rjetë <sup>79</sup> .
Lejore: <i>edhe se, edhe në</i>	As nukë gjegji <i>edhe se</i> gjithë kafshë qi ndë gjë hin, vete ndë mulli pështjerë, e dërgon jashtë për të paditunit <sup>80</sup> .

#### IV.1.1.2 Lidhëzat nënrenditëse shkakore

Në afro 546 ndërtimet me lidhëza shkakore Gjon Buzuku përdor vetëm dy lidhëza: *përse* dhe *se*. Këto lidhëza shërbejnë për të lidhur pjesë të varura shkakore. Lidhëza *përse* përdoret më shumë nga *se*. Janë qëmtuar rreth 387 përdorime të saj, shifër kjo që lë të kuptohet se në kohën e Buzukut ishte mjaft i përhapur përdorimi i saj. Në shumicën dërrmuese të rasteve kjo lidhëz te Buzuku shpreh marrëdhënie shkakore konstatuese. Ja disa shembuj:

Na duomë atë, *përse* aj parë desh neve.<sup>81</sup>

Gëzoni me muo, *përse* u gjeta delenë teme qi e paç bdjerrë.<sup>82</sup>

Po në këtë formë fonetike lidhëza *përse* shfaqet te Buzuku edhe si lidhëz qëllimore. Sigurisht, si lidhëz qëllimore ajo përmbush një tjetër funksion sintaksor dhe nuk ka kuptim shkakor. Kështu, më shume se me polisemi, kemi të bëjmë këtu me dy homonime. Por semantema e një polisemie të mundshme vihet re ende. Le të japim një shembull me *përse* qëllimore:

U të dhae me klenë drita e gjindsë, *përse* ti të jesh të shelbuonitë tem.<sup>83</sup>

Lidhëza *përse* do të jepej në gjuhën e sotme me *që*, kështu do të kishim: *që* ti të jesh...

Kjo lidhëz (*përse*) nuk përdoret sot as me kuptim shkakor, as me kuptim qëllimor.

<sup>72</sup> Meshari i Gjon Buzukut, USHT, Tiranë 1968, I, II, f.353.

<sup>73</sup> Po aty, f. 109

<sup>74</sup> Po aty, f. 67.

<sup>75</sup> Po aty, f. 367.

<sup>76</sup> Po aty, f. 221.

<sup>77</sup> Po aty, f. 79.

<sup>78</sup> Po aty, f. 209.

<sup>79</sup> Po aty, f. 281.

<sup>80</sup> Po aty, f. 213.

<sup>81</sup> Buzuku, f. 275.

<sup>82</sup> Po aty, f. 281.

<sup>83</sup> Po aty, f. 329.

Nga përdorimet e Buzukut del se shkakorja *përse* e asaj kohe mund të realizohet sot me *sepse*:

Gëzoni me mua, *sepse* unë gjeta...

Në një rast e kemi gjetur këtë lidhëz në formën *për se*. Siç duket kemi të bëjmë këtu me një formë më të vjetër prej nga ka dalë forma me përngjitje *përse*:

E këjo fjalë ish e fshehunë n sish, *përse* nukë mundë mernjinë *për se* aj flit<sup>84</sup>.

Lidhëza nënrenditëse shkakore *se* është përdorur nga Buzuku në afro 157 raste. Kjo tregon se edhe kjo lidhëz ka pasur një përhapje të madhe përdorimore në kohën e Buzukut. Funkcioni i kësaj lidhëzeje nuk ka asnjë ndryshim nga ai i sotmi:

E i pari i sinagogësë u mëni *se* kish shëndoshunë atë gruo ditënë e shëtunde<sup>85</sup>.  
E nrashtu ju mos droni, *se* ma të mirë ini ju se shumë trumeca<sup>86</sup>.

Lidhëzat *përse*, *se*, *si*, *që*, njihen deri tani si më të hershmet në sistemin e lidhëzave nënrenditëse.

Edhe në studimin e Emil Lafes „Lidhëzat te libri I shqip“<sup>87</sup>, pranohet që lidhëza *përse* si shkakore ka denduri më të lartë përdorimi ndër lidhëzat nënrenditëse të pranishme në këtë vepër. Pas saj vjen shkakorja *se*. Lidhëza *si* me kuptim shkakor haset vetëm dy herë. E. Lafe vë në dukje se vlera shkakore e saj ka dalë nga ajo kohore dhe kjo ka ndodhur që te Buzuku. Lidhëza (sot që) përdoret rrallë. Madje vlera e saj si shkakore nuk mund të kuptohet pa krahasimin me tekstin latin.

### IV.1.2 Përfundime

Vepra e Buzukut “Meshari”, si vepra e parë e shkruar, e dokumentuar në gjuhën shqipe jep një pasqyrë të qartë të sistemit lidhëzor të gjysmës së parë të shekullit XVI. Pas vjeljes (pothuaj shteruese) të lidhëzave te Buzuku, pas përshtimit të shkurtër të mësipërm të lidhëzave në përgjithësi e të shkakoreve në veçanti, mund të themi:

Sistemi lidhëzor që përdor Buzuku ka shumë afëri me atë që përdorim ne sot. Te “Meshari” pamë lidhëza që përdoren me të njëjtin funksion dhe të njëjtën formë edhe në shqipen e sotme, lidhëza që sapo kanë filluar të përdoren dhe lidhëza që sot shqipja nuk i ka. Lidhëza shkakore *përse* nuk përdoret më sot. Ndërsa lidhëza *qi* ka evoluar në formë, sot del në trajtën *që*.

Sot shqipja është pasuruar me lidhëza të reja që i shprehin në një rrafsh më të gjerë marrëdhëniet e ndryshme sintaksore. Ky zhvillim ka ecur paralelisht me zhvillimin e tërë sistemeve e nënsistemeve gjuhësore. Megjithatë, me gjithë ndryshimet e vërejtura, duke parë dukuritë e përbashkëta të sistemit lidhëzor të përdorur nga Buzuku dhe të atij të sotëm, duke qenë se sistemi lidhëzor është pjesë përbërëse e atij gramatikor, mund të themi se gjuha shqipe ka qenë një gjuhë e zhvilluar qysh në atë kohë. Një vepër e tillë si “Meshari” me një gjuhë të tillë, me një sistem të tillë lidhëzor, duhet të jetë paraprirë nga vepra të tjera që ne nuk i kemi të dokumentuara.

---

<sup>84</sup> *Meshari i Gjon Buzukut*, USHT, Tiranë 1968, I, II, f. 113.

<sup>85</sup> Po aty, f. 305.

<sup>86</sup> Po aty, f. 361.

<sup>87</sup> Lafe, E., “Lidhëzat te libri I shqip”, *Studime Filologjike*, 1971/4.

Prania e lidhëzave të konsoliduara nga funksioni, që i përdor ose nuk i përdor gjuha e sotme, janë një tregues i qartë i vjetërsisë së gjuhës sonë. Sidomos fakti që disa lidhëza i gjejmë te “Meshari”, por sot nuk përdoren, siç është dhe rasti i shkakores *përse*, flet qartë për vjetërsinë e tyre.

Në mendimin e sotëm gjuhësor është përfundimisht i zgjidhur problemi i origjinës së lidhëzave. Sot pranohet se lidhëzat e thjeshta vijnë nga trajta të ngurosurasore të përemrave pyetës dhe lidhorë.<sup>88</sup>

### IV.2 Lidhëzat shkakore në librin e Th. Mitkos “Vepra”

Në gjuhën shqipe ndodh shpesh që e njëjta lidhëz të përdoret për të shprehur marrëdhënie të ndryshme. Kështu dhe lidhëzat *përse*, *se*, *si*, *që*, të cilat deri tani njihen si më të hershmet në sistemin e lidhëzave shkakore, realizojnë disa marrëdhënie. Siç e pamë te “Meshari” i Buzukut lidhëza *përse* si shkakore përdoret mbi 500 herë dhe është kështu lidhëza me denduri më të lartë përdorimi ndër lidhëzat nënrenditëse të pranishme në këtë vepër. Pas saj vjen shkakorja *se*, e përdorur rreth 50 herë. Lidhëza *si* me kuptim shkakor haset vetëm dy herë.

Te „Vepra“ e Th. Mitkos i ndeshim të dyja këto lidhëza (*se*, *përse*), por përdorim më të madh ka shkakorja *se*. Në këtë vepër ka dhe një përmbledhje me proverba, ose sipas autorit „fjalë të moçme“. Ndërtime të tilla të qëndrueshme janë të hershme, shumë të hershme. Prej këtej rrjedh se edhe lidhëzat me të cilat ndërtohen këto konstrukte janë të hershme. Vërehet se tek të gjitha proverbat përdoret vetëm shkakorja *se*. Vetëm në dy raste kemi përdorimin shkakor të kohores *kur*.

Fakte të tilla të bëjnë të mendosh se shkakorja *se* është shumë e hershme. Ajo është karakteristike për gjuhën e gjallë të popullit. Prej këtej ajo ka kaluar në stilin libror. Përdorimi i shkakores *përse* është veçori e stilit libror, prandaj ajo nuk haset rëndom në proverbat e Th. Mitkos.

Ndër dy shkakoret *se* dhe *përse* mendohet që *se* të jetë më e hershme, sepse ajo është e thjeshtë për nga ndërtimi, ekonomike në përdorim dhe se është karakteristike për gjuhën e gjallë të popullit. Lidhëza *përse* është krijuar nga përngjitja parafjalë + lidhëz, është karakteristike për gjuhën e shkruar. Te proverbat e Mitkos shkakorja *përse* është e ndërkëmbyeshme me shkakoren *se*, ato janë sinonime.

Në „Vepra“ të Th. Mitkos lidhëza shkakore *se* përdoret:

- a. Në fjalinë e varur shkakore të drejtpërdrejtë. Me anë të kësaj lidhëze në këtë rast tregohet shkak i afërt, i drejtpërdrejtë i asaj që ka ndodhur në fjalinë kryesore: Mb’ atë kohë as gjendeshin rrush, *se* ishte mot i shkuar për ata.<sup>89</sup>
- b. Në fjalinë shkakore argumentuese të thënies së kushtëzuar. Në këto tipe fjalish lidhëza *se* ka një ngjyrim arsyetimi. Është plotësisht e ndërkëmbyeshme me sepse: Sa për djelmata u menduash më pastaj t’i mbanj këtu, *se* ndë Itali të nuk kanë të nxënë edhe gjuhën arabishte.<sup>90</sup>
- c. Në fjalinë shkakore argumentuese të urdhërit. Te këto tipe fjalish lidhëza *se* përdoret shpesh: Mos iu qas zjarrit, *se* të djeg.<sup>91</sup>
- d. Në fjalinë shkakore argumentuese të konkluzionit. Këtu pjesa e varur shkakore nuk paraqet shkakun e drejtpërdrejtë, shkakun real, të afërt, të vërtetë të asaj

---

<sup>88</sup> Demiraj, Sh., *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1986, f. 629.

<sup>89</sup> Mitko, Th., *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 386.

<sup>90</sup> Po aty, f. 643.

<sup>91</sup> Po aty, f. 445.

që thuhet në pjesën kryesore, por arsyeton rreth asaj që thuhet në pjesën kryesore, lidhëza që shpreh marrëdhëniet shkakore në këtë rast merr ngyrime arsyetimi: U arrinë gorricatë *se* më hahen mua.<sup>92</sup>

- e. Në fjalinë shkakore të shprehjes së ndjenjës. Në këtë rast lidhëza ndodh të shfaqet pas shprehjeve të tipit: më vjen mirë, më vjen keq, më vjen ligisht etj. : Më vjen ligisht *se* të mundova keq.<sup>93</sup> Ky tip fjalie përdoret gjithashtu dhe pas pjesës kryesore që ka si kallëzues folje të tilla: gëzohem, trembem, mburrem, frikësohem: Gëzohem *se* të ra mendja të dërgonjësh birin e dashur në Shqipëri.<sup>94</sup>

Më rrallë përdor Mitkoja fjalinë shkakore argumentuese të pyetjes dhe të dëshirës. Me fjali shkakore të dëshirës do të kuptojmë atë fjali të varur shkakore që paraqet një fakt si shkakun e dëshirës së shfaqur në pjesën drejtuese a kryesore. Pra, te pjesa kryesore shprehet një dëshirë. Kjo pjesë ka në përbërje të saj folje të tilla si dua, dëshiroj, më pëlqen, kam dëshirë, ose folje në mënyrën dëshirore: qoftë, pastë : E motra ... s' donte ta lerë, *se* mos humbej edhe ky.<sup>95</sup>

Nga ky vështrim i shkurtër në veprën e Mitkos vërehet se lidhëza *se* (në këtë periudhë kohore) i ka përvijuar plotësisht tiparet e një lidhëzeje nënrenditëse shkakore.

Por lidhëza *se* te Mitkoja përveç vlerës shkakore mund të përmbajë dhe ngjyrim kundrinore. Madje, hera-herës kjo lidhëz manifeston dhe ngyrime qëllimore. Kjo ndodh rrallë. Lidhëza shkakore *se* me ngjyrim kundrinore ndeshet në këto lloje të fjalisë shkakore:

- f. Në fjalinë shkakore të argumentimit të ndjenjës: Por më vjen keq *se* nuku mund të nxe ...<sup>96</sup>
- g. Në fjalinë shkakore të drejtpërdrejtë: E kuajt i shpuri ay jashtë fshatit...edhe i lëshoi, *se* mos ia gjente njeri ndë dorët.<sup>97</sup>

Shpesh, kur lidhëza *se* ndiqet nga pjesëza mos, manifeston dhe ngjyrim qëllimore: ...s' donte ta lerë, *se* mos humbej dhe ky.<sup>98</sup>

Lidhëza *se* me ndërthurje ngjyrimesh shkakore e kundrinore përdoret rrallë në fjalitë shkakore argumentuese të urdhërit dhe në fjalitë shkakore argumentuese të dëshirës. Në raste të tilla ajo ndiqet nga pjesëza dyshuese *mos*.

Duke trajtuar lidhëzat shkakore të përdorura në „Fjalët e moçme“ të përfshira në përmbledhjen „Vepra“ të Th. Mitkos kemi synuar vështrimin dhe paraqitjen e kësaj klase në një kohë më të vonshme nga ajo e Buzukut.

Edhe në ditët tona shkakorja *se* paraqet po ato tipare semantike e sintaksore që manifeston ajo në gjuhën e Th. Mitkos. Kjo lidhëz është ndër më të përdorshmet, edhe pse herë-herë në stile të ndryshme, në autorë e vepra të veçanta po e konkurren shkakorja *sepse*. Po pse lidhëza *se* është shkakorja më e përdorshme?

Së pari, lidhëza *se* ka një semantikë të konsoliduar (si pasojë e përdorimit të gjatë e të dendur). Duke shprehur hera-herës dhe ngyrime kundrinore a qëllimore ajo mbetet

<sup>92</sup> Mitko, Th., *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 452.

<sup>93</sup> Po aty, f. 706.

<sup>94</sup> Po aty, f. 682.

<sup>95</sup> Po aty, f. 383.

<sup>96</sup> Po aty, f. 647.

<sup>97</sup> Po aty, f. 393.

<sup>98</sup> Po aty, f. 383.

shkakore në kuptimin e saj kryesor e përdoret në realizimin e marrëdhënieve të ndryshme shkakore.

Së dyti, në pikëpamje sintaksore ajo përdoret në të gjitha llojet e fjalive të varura shkakore (9 lloje).<sup>99</sup> Sot përdorimin më të madh e ka në fjalinë shkakore të drejtpërdrejtë dhe në fjalinë argumentuese të urdhërit.<sup>100</sup>

Së treti: Lidhëza shkakore *se* ka një cilësi të veçantë, cilësi që ka të bëjë me theksimin e shkakut, me vënien më në pah të tij. Kjo lidhëz, nga vetë natyra e saj, ka kuptim shkakor.

Një dukuri interesante në „Veprën“ e Th. Mitkos është përdorimi i lidhëzës *përse* si shkakore. Kjo lidhëz me kuptim shkakor përdoret dhe te Buzuku. Edhe në veprën e Th. Mitkos shkakorja *përse* ka një përdorim të dendur. Përdorimet më të shumta i ka në fjalinë e varur shkakore të drejtpërdrejtë:

Istorinë „Dora d’Istria“ do të ta dërgonj cangaca *përse* s’e kam gati.<sup>101</sup>  
Ishnja vajtur nd’ Aleksandri *përse* m’u sëmur fort ime bijë...<sup>102</sup>

Lidhëza *përse* në raste të tilla është e ndërkëmbyeshme me *sepse*. Kjo lidhëz përdoret dhe në fjalinë e varur shkakore argumentuese të urdhërit: Dërgom‘ dhe një fletën e parë, *përse* atë ma muar një mik<sup>103</sup>.

Kjo lidhëz përdoret nga Th. Mitko gjithashtu dhe në fjalinë e varur shkakore të konkluzionit, të supozimit, të ndjenjës. Rrallë e përdor Th. Mitko këtë lidhëz në fjalitë e varura shkakore argumentuese të pyetjes:

E *përse* të më vraç mua?  
*Përse* ti je shkak që më iku ime bijë.<sup>104</sup>

Ka dhe pak raste të përdorimit të shkakores *përse* në fjalinë shkakore shtesore, me një ngyrim të theksuar shtesor sqarues: ... Prandaj erdh që t’i marrë me vete të tria, *përse* të dy të mëdhatë i ka për të martuarë ndë të dy vëllezërit më të mëdhenjtë ...<sup>105</sup>.

Në ndonjë rast lidhëza *përse* ka ngjyrim të theksuara kundrinore: Dërgova te Skiroi një ditare elene tek‘ na shanjënë *përse* duam gjuhën tonë.<sup>106</sup>

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme lidhëza *përse* me kuptim shkakor ka pasur një diapazon të gjerë kuptimesh e përdorimesh. Sot ajo është mënjanuar krejt nga funksioni i dikurshëm lidhëzor shkakor dhe është specializuar si lidhëz për shprehje marrëdhëniesh kundrinore e kryefjalore dhe si ndajfolje qëllimi.

---

<sup>99</sup> Shih, Floqi, S., “Periudha me fjali të varura shkakore II, III”, botuar në, *Studime Filologjike*, 2, 3, Tiranë, 1966.

<sup>100</sup> Shih, Buchholz, O., „Kausalkonjunktionen in der heutigen albanischen literarischen Sprache“, botuar në, *Zeitschrift für Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung*, Band 35/H. 4; Berlin, 1982, f. 383- 391.

<sup>101</sup> Mitko, Th., *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 681.

<sup>102</sup> Po aty, f. 667.

<sup>103</sup> Po aty, f. 662.

<sup>104</sup> Po aty, f. 405.

<sup>105</sup> Mitko, Th., *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 363.

<sup>106</sup> Po aty, f. 693.

### IV.3 Përdorimi i lidhëzave shkakore në veprën “Dhiata e re dhe psalmet”

Korpusi i përshkrimit dhe analizës sonë në këtë rast përfshin 572 faqe. Këtu kemi hetuar përdorimin e lidhëzave në përgjithësi. Jemi përqëndruar në lidhëzat nënrenditëse duke i trajtuar ato si sfond para të cilit kemi vendosur lidhëzat nënrenditëse shkakore. Një korpus i tillë paraqet interes në dy pikëpamje: ka tematikë fetare dhe është tekst i përkthyer. Prandaj e kemi zgjedhur, për të parë se si përdoren e si funksionojnë lidhëzat shkakore në një ligjërim të tillë. Edhe pse përkthimi është bërë në një gjuhë korrekte letrare, tematika fetare dhe fakti që vepra është ridhënie e një teksti të shkruar në një gjuhë tjetër, kanë lënë gjurmët e tyre në sistemin lidhor e në funksionimin e tij në këtë domen.

Në veprën “Dhiata e re dhe psalme” përdoren gjerësisht gati të gjitha lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse të gjuhës së sotme shqipe.

#### IV.3.1 Lidhëzat bashkërenditëse

Këto lidhëza bashkojnë dy gjymtyrë të njëjta, homogjene:

Do të vijë njerëzit nga lindja e perëndimi, nga veriu e jugu, *dhe* do të ulen në tryezën e perëndisë.(f. 104)

Mjeku nuk u duhet të shëndoshëve, *por* të sëmurëve.(f. 105)

Lidhëzat bashkërenditëse mund të lidhin dhe dy a më shumë fjali të së njëjtës gradë, fjali të varura, të pavarura ose fjali kryesore:

Fëmijët do të paraqiten në gjyq *e* do të dëshmojnë kundër prindërve.(f. 106)

Në të vërtetë ju nuk do të flini, *por* shpirti i shenjtë do të flasë nëpërmjet jush.(f.106)

Lidhëza bashkërenditëse *dhe* ka dendurinë më të lartë të përdorimit ndër të gjitha lidhëzat. Ajo përdoret, pothuaj, 4961 herë. Arsyeja e një përdorimi të tillë ndoshta do kërkuar në veçoritë e stilit biblik që shquhet nga një rrëfim narrativ, drejtvizor, ku fjalitë bashkërendohen për të formuar vargje. Lidhëza *dhe* lidh zakonisht pjesë fjalish, më pak-gjymtyrë homogjene:

Tani shkoni në rrugë të madhe e këdo *që* të hasni thirreni në dasmë.<sup>107</sup>

... Isha i sëmurë *dhe* erdhët të më shihni, isha në burg *e* erdhët të më vizitoni.<sup>108</sup>

Midis pjesëve të bashkërenditura me lidhëzat *e*, *dhe* mund të shfaqen dhe marrëdhënie shkak-pasojë:

Mendonin se ishte fantazma *dhe* bërtitën nga frika<sup>109</sup>.

Stuhia nuk pushoi *dhe* kështu humbëm shpresën për të shpëtuar<sup>110</sup>.

---

<sup>107</sup> *Dhjata e re dhe psalmet*, Tiranë, 1991, f.42.

<sup>108</sup> Po aty, f. 50.

<sup>109</sup> Po aty, f. 23.

<sup>110</sup> Po aty, f. 256.

## Panoramë e përdorimit të lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe

Në fakt, kuptimi dhe funksioni i këtyre lidhëzave është thjesht këpujor. Lidhëzat këpujore japin vetëm idenë e lidhjes në mënyrën më të përgjithshme, më të padiferencuar, më abstrakte, prandaj lloji i marrëdhënieve midis pjesëve të bashkërenditura këpujore varet nga përmbajtja reale e tyre dhe jo nga lidhëza.

### IV.3.2 Lidhëzat nënrenditëse

Në periudhat me nënrenditje vihet re përdorimi i shumtë i lidhëzave polisemike:

që – shfaqet si lidhëzë ftilluese, shkakore, qëllimore, rrjedhimore, kohore

se – del si ftilluese, krahasore, shkakore

sikur – e hasim si ftilluese, mënyrore, kushtore

si – kohore, krahasore, mënyrore

sa – kohore, krahasore, rrjedhimore

ndërsa – përqsore, kohore, kundërvënëse

Për të paraqitur dendurinë e përdorimit të lidhëzave në korpusin e zgjedhur po japim një tabelë statistikore:

Lidhëza	Denduria e përdorimit
<i>dhe</i>	4961 herë
<i>e</i>	1356 herë
<i>por</i>	698 herë
<i>edhe</i>	180 herë
<i>ose</i>	172 herë
<i>kurse</i>	102 herë
<i>apo</i>	37 herë
<i>se</i>	1230 herë
<i>që</i>	955 herë
<i>kur</i>	948 herë
<i>sepse</i>	792 herë
<i>në qoftë se</i>	365 herë
<i>siç</i>	117 herë
<i>si</i>	95 herë
<i>meqë</i>	92 herë
<i>derisa</i>	69 herë
<i>ku</i>	50 herë
<i>megjithëse</i>	48 herë
<i>kështu që</i>	42 herë
<i>nëse</i>	39 herë
<i>sikurse</i>	36 herë
<i>gjersa</i>	26 herë
<i>sikur</i>	21 herë

### IV.3.3 Lidhëza nënrenditëse kohore që shprehin raporte shkakore

Në korpusin e hetuar janë vërejtur shumë raste ku lidhëzat kohore shërbejnë për të shprehur marrëdhënie shkakore. Si veçori e përgjithshme e ndërtimeve të tilla është fakti që predikati i pjesës kryesore semantikisht shënon një gjendje shpirtërore, ose

pjesa e varur përmban pjesëzën mohore nuk/s'. Me anë të kësaj pjesëze mohohet veprimi a gjendja e shprehur nga folja. Ja disa shembuj:

Kur nxënësit e dëgjuan këtë, u tmerruan dhe pyetën njëri- tjetri: atëherë kush mund të shpëtojë?<sup>111</sup>

Të gjithë sa ishin në sinagogë u tërbuan, kur e dëgjuan këtë<sup>112</sup>.

Kur dëgjuan se Pali dhe Sila ishin nënshjetas romakë, u trembën.<sup>113</sup>

Kur Jerodi e pa Jezusin, u gëzua shumë.<sup>114</sup>

Moskryerja e veprimit në pjesën e varur është shkak i asaj që ndodh në pjesën kryesore:

Kur nuk gjetën as njërin dhe as tjetrin, tërhoqën zvarrë Jasonin dhe disa besimtarë të tjerë.<sup>115</sup>

Me vlerë shkakore del nganjëherë edhe lidhëza kohore *pasi*. Në pikëpamje kohore kjo lidhëz tregon paskohësi, veprimi i shprehur në pjesën kryesore ndodh pas atij të shprehur në pjesën e varur:

*Pasi* e tha këtë lutje, u nis bashkë me nxënësit e tij.<sup>116</sup>

Ky raport i paskohësisë mundëson lindjen e marrëdhënies shkakore: (Kujto: post hoc ergo propter hoc ,pas kësaj, domethënë për shkak të kësaj)

Ndërkohë nxënësit ishin larg në liqen; barka e tyre përplasej nga valët, *pasi* era po frynte nga e kundërta.<sup>117</sup>

Ju është mbushur mendja se asgjë s'do t'ju ndodhë, *pasi* Abrahami është stërgjyshi më i lashtë i fisit tuaj.<sup>118</sup>

Në shembujt e cituar lidhëza *pasi* mund të zëvendësohet me *se, sepse*. Ka raste që *pasi* të përdoret me vlerën e lidhëzës shkakore *meqë*:

Por *pasi* judenjtë kundërshtuan, nuk më mbeti gjë tjetër veçse të kërkoja për të dalë përpara Cezarit.<sup>119</sup>

U rrëzuan e vdiqën, *pasi* u shfaqe ti.<sup>120</sup>

Kuptim shkakor mund të marrë në kontekst edhe lidhëza kohore *sapo*. Në këtë rast pjesa e varur shërben për të justifikuar përmbajtjen e pjesës kryesore:

*Sapo* u martova, dhe për këtë arsye nuk mund të vij<sup>121</sup>.

---

<sup>111</sup> *Dhjata e re dhe psalmet*, Tiranë, 1991, f. 37.

<sup>112</sup> Po aty, f. 106.

<sup>113</sup> Po aty, f. 236.

<sup>114</sup> Po aty, f. 152.

<sup>115</sup> Po aty, f. 236.

<sup>116</sup> Po aty, f. 194.

<sup>117</sup> Po aty, f. 28.

<sup>118</sup> Po aty, f. 4.

<sup>119</sup> Po aty, f. 258.

<sup>120</sup> Po aty, f. 47.

<sup>121</sup> Po aty, f. 133.



Në raste të tilla është i mundur përdorimi i një korrelati në pjesën kryesore: *prandaj* nuk mund të vij.

### IV.3.4 Shkaku i fshehur në ndërtimet me pjesë të varur rrjedhimore

Pjesa e varur rrjedhimore tregon rrjedhimin e asaj që jepet në përmbajtjen e pjesës drejtuese/kryesore:

Ajo është aq e madhe, *sa* nuk mund të përshkruhet.<sup>122</sup>

Biri rradhitet aq lart mbi engjëjt, *sa* dinjiteti, që perëndia ia dha, është më i lartë se dinjiteti i tyre.<sup>123</sup>

U mblodhën aq shumë njerëz, *saqë* Jezusit iu desh të hipte në barkë.<sup>124</sup>

Në “Fjalorin e Shqipes së sotme”<sup>125</sup> fjala rrjedhojë shpjegohet si “pasojë e diçkaje”. Nëse në pjesën e varur jepet pasoja/rrjedhoja, atëherë në pjesën drejtuese/kryesore duhet të jepet shkaku që prodhon këtë pasojë:

(a) Ajo është aq e madhe, *sa* nuk mund të përshkruhet.

(b) Ajo nuk mund të përshkruhet, se është (aq) e madhe.

Gjatë transformimit të (a) në (b) kemi ndryshime në strukturat sipërfaqësore. Strukturat e thella janë identike. Përmbajtja e (a) rijepet e plotë në (b). Në (b) kemi një strukturë të përbërë nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e varur shkakore. Transformimi i (a) në (b), duke u ruajtur kuptimi, zbulon natyrën shkakore të (a). Gjatë transformimit pjesët e fjalisë kanë ndryshuar rolet: pjesa e varur bëhet kryesore dhe kryesorja bëhet e varur. Pjesa që shpreh rrjedhojën/pasojën është gjithnjë kryesore në një ndërtim shkakor, ndërsa pjesa e varur jep shkakun, motivin etj. Në fjalitë rrjedhimore, në pjesën kryesore, mund të shfaqen ose jo fjalë korrelative. Rastet pa fjalë korrelative janë gjithësesi shumë të rralla:

Ata erdhën dhe i mbushën dy barkat *aq* plot, *saqë* ato gati u fundosën.<sup>126</sup>

Nuk vlen më për asgjë, *kështu që* hidhet jashtë dhe njerëzit e shkelin.<sup>127</sup>

Në ndërtimet me lidhëzën *kështu që*, në pjesën e varur, krahas kuptimit rrjedhimor jepen dhe nuanca qëllimore. Në këtë rast transformimi jep një fjali qëllimore:

Ata i sillnin të sëmuret jashtë në rrugë, *kështu që*, kur Pjetri t’u kalonte pranë, së paku hija e tij t’i binte ndonjërit prej tyre.<sup>128</sup>

Pjesa e varur rrjedhimore vendoset edhe para kryesores:

... *Kështu që* të pabindurit do të hidhen në furrë të ndezur, ku do të ketë të qara dhe kërcitje dhëmbësh.<sup>129</sup>

---

<sup>122</sup> *Dhjata e re dhe psalmet*, Tiranë, 1991, f. 324.

<sup>123</sup> Po aty, f. 382.

<sup>124</sup> Po aty, f. 24.

<sup>125</sup> *Fjalori i Shqipes së Sotme*, Tiranë, 1984, f. 1057.

<sup>126</sup> *Dhjata e re dhe psalmet*, Tiranë, 1991, f. 108.

<sup>127</sup> Po aty, f. 6.

<sup>128</sup> Po aty, f. 210.

<sup>129</sup> *Dhjata e re dhe psalmet*, Tiranë, 1991, f. 26-27.

Me pjesë të varur pas ose para kryesores, me fjalë korrelative ose pa të tilla në pjesën kryesore, me pjesë të lidhura me çfarëdo lidhëzash rrjedhimore, fjalitë rrjedhimore e përmbajnë shkakun brenda tyre dhe mund të transformohen në fjali shkakore. Pjesët e fjalisë shkakore në këtë rast mund të lidhen me lidhëzat: *se, sepse, meqë, ngaqë* etj.

### IV.3.5 Përfundime

Përshkrimi i mësipërm është një paraqitje e sistemit lidhëzor, veçanërisht e lidhëzave shkakore të përdorura në një vepër fetare të përkthyer në gjuhën e sotme letrare shqipe. Në veprën “Dhjata e re dhe psalme” përdoren këto lidhëza shkakore: *se, sepse, meqë, ngaqë, që, për shkak se, për arsye se*. Funkcionet që përmbushin këto lidhëza shkakore janë reale/faktike (më shumë), epistemike dhe ilokutive (më pak). Fjalitë shkakore, në pjesën dërrmuese të rasteve, janë me pjesë të varur konstatuese. Fjalitë me pjesë të varur shkakore arsyetuese janë më të pakta.

Është interesant përdorimi i lidhëzave kohore me kuptim shkakor. Të tilla janë: *kur, pasi, sapo*. Këto lidhëza paraqiten si shkakore kur predikati i pjesës kryesore semantikisht shënon një gjendje shpirtërore, ose pjesa e varur përmban pjesëzën mohore nuk/s’.

Me vlerë shkakore dalin dhe lidhëzat rrjedhimore që përdoren në tekstin e hulumtuar. Fjalitë që përmbajnë një pjesë të varur rrjedhimore mund të transformohen në fjali me pjesë të varur shkakore. Gjatë transformimit kemi ndryshime në strukturat sipërfaqësore. Strukturat e thella mbeten identike.

### IV.4 Mbi një përdorim të veçantë të lidhëzave shkakore

Lidhëzat shkakore përdoren dhe me vlerën e lidhëzës bashkërenditëse (kundërshtore, të barasvlershme me *ndërsa, kurse, por*). Të përdorurit e disa lidhëzave nënrenditëse me vlerën e lidhëzave bashkërenditëse është një dukuri e njohur në gjuhën shqipe. Po pse ndodh kjo, pse pikërisht lidhëza *se* përdoret dhe si lidhëz bashkërenditëse? Në mendimin e sotëm gjuhësor pranohet se gjuha e folur e popullit parapëlqen më shumë ndërtimet me bashkërenditje se sa ato me nënrenditje. Pikërisht tek ata autorë, që mbështeten në gjuhën e folur të popullit, përdoren dhe lidhëzat nënrenditëse me vlerë bashkërenditëse. Kështu, te „Vepra“ e Th. Mitkos kemi disa raste ku shkakorja *se* del me vlerë bashkërenditëse: Me mend gjetën perëndinë, *se* me sy nuk e panë.<sup>130</sup> Në këtë rast *se* mund të këmbehet me *kurse*.

Përdorimi i *se*-së me vlerë bashkërenditëse shpjegohet ndër të tjera dhe me faktin se ajo funksionon edhe si lidhëz krahasuese: Ishte më i shpejtë *se* era. Ajo ka aftësinë të realizojë krahasime midis sendeve, dukurive e cilësive. Kjo aftësi shpjegon përdorimin e saj me vlerë bashkërenditëse kundërshtore. Një shembull tjetër: Tashi e keni radhën ju të më bëni gjyqin, *se (kurse)* djali ma ka bërë qëkur.

Lidhëza *sepse* shërben për të shprehur vetëm marrëdhënie shkakore. Është relativisht e re dhe ka natyrë librare. Prej këtej ka kaluar dhe në gjuhën e folur dhe sot është pronë e të dyjave, gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar. Përdorimin më të madh kjo lidhëz e ka në fjalinë shkakore të drejtpërdrejtë: Rrëmbeu fëmijën dhe krisi e iku, *sepse* i shoqi nuk qe i zoti t’i siguronte qytetin.

---

<sup>130</sup> Mitko, Th., *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 444.

Në ditët tona lidhëza *sepse* po përdoret gjithnjë e më tepër në fjalinë shkakore argumentuese të pyetjes.

Përdoret gjithashtu në fjalinë shkakore argumentuese të supozimit e të konkluzionit: Ndoshta na mbajtën, *sepse* ne jemi klasë muzike.

Në fjalinë shkakore të dëshirës: Ai donte të hante diçka, *sepse* ishte i uritur.

Në fjalinë shkakore argumentuese të urdhërit: Thuamë se nuk do të ndodhë asgjë, *sepse* unë të besoj vetëm ty.

Në fjalinë shkakore argumentuese të thënies së kushtëzuar: Mirëpo ti nuk do që unë të vdes, *sepse* ky do të ishte një dështim për ty. Etj.

Nga një vështrim i kujdesshëm i përdorimeve të lidhëzës *sepse* vërehet se ajo asnjëherë nuk manifeston ndërthurje të ngjyimeve shkakore me ato kundrinore apo me ndonjë lloj tjetër ngjyrimi. Ndërsa vihet re që shkakorja *sepse* ka një ngjyrim të theksuar arsyetimi, një shprehësi të veçantë, ajo i mëshon shkakut. Kjo duket qartë nëse e zëvendësojmë me se: E ngrita problemin në parim..., *sepse* (se) asgjë nuk është vendosur në mënyrë të prerë...

Lidhëza *sepse* përdoret sidomos në stilin teknik, shkencor, politik, shoqëror, por edhe në letërsinë artistike.

Lidhëza *që* del me një gamë kuptimesh, përdorimesh e funksionesh. Një ndër përdorimet e saj është dhe ai shkakor. Tek „Meshari“ i Gj. Buzukut ajo është në embrion të përdorimit të saj si lidhëz, nuk është shkëputur ende nga përemri lidhor<sup>131</sup>. Më vonë që fillon të përdoret më dendur si lidhëz shkakore. Si e tillë ajo ka një denduri përdorimi më të vogël se lidhëzat *se*, *sepse*, *ngaqë*.

Përdorimet e saj si shkakore janë kufizuar vetëm në fjalinë shkakore të ndjenjës, të vlerësimit, të dëshirës, të argumentimit të urdhërit e më rrallë – në fjalinë shkakore të drejtpërdrejtë:

Më vjen keq *që* po jua them (shkakore argumentuese e ndjenjës).

Dhe bëri mirë *që* nuk e zgjati më tej (shakore e vlerësimit).

Edhe ti mësimet e tij ndjek *që* s’do të bëhesh traktorist (shkakore e drejtpërdrejtë).

Vajza të ndezë një qiri në kishë *që* shpëtoi pa u futur në manastir (shkakore argumentuese e urdhërit).

Ajo nuk donte të dilte në atë mot me erë *që* të mos i prisheshin flokët (shkakore argumentuese e dëshirës).

Siç shihet dhe nga shembujt e dhënë lidhëza *që*, zakonisht, paraprin struktura që lidhen me fjali, folja e të cilave shënon një gjendje shpirtërore. Në vend të foljes mund të dalë dhe një emër me kuptim abstrakt, i formuar nga folja (emërzim i foljes). Ja disa folje që mund të dalin në pjesën kryesore të fjalisë shkakore në rastin e lidhjes së pjesëve me shkakoren *që*: zemërohem, gëzohem, hidhërohem, pendothem, më vjen keq, më vjen mirë, jam i lumtur, ndihet i gëruar etj.: Gëzohem *që* erdhe sot. Etj.

Nga kjo paraqitje e përdorimit të lidhëzës *që* vihet re që ajo gjithmonë manifeston një ndërthurje ngjyimesh shkakore e kundrinore. Nuk kemi gjetur asnjë rast të përdorimit të saj si lidhëz e pastër shkakore, pa ngjyime të tjera. Shpesh është vështirë të përcaktohet se cilat janë mbisunduese, ngjyrimet shkakore apo kundrinore.

---

<sup>131</sup> Shih, Lafe, E, „Lidhëzat te libri I shqip”, botuar në, *Studime Filologjike*, 1971/ 4.

Lidhëza *pse* përdoret gjerësisht si lidhëz nënrenditëse kundrinore. Por nuk duhet lënë pa përmendur dhe përdorimi i saj si lidhëz shkakore: Ne s'kemi asnjë arsye *pse* të dyshojmë.

Në këtë rast lidhëza *pse* është shkakore dhe është plotësisht e ndërkëmbyeshme me *që* ose *përse*. Mund të thuhet që një nga kuptimet kryesore të lidhëzës *pse* është ai shkakor. Sot vihet re një lloj mënjanimi i saj nga funksioni shkakor. Kjo shpjegohet me përhapjen në përdorim të shkakores *sepse*, e cila kuptimisht afron shumë me *pse*.<sup>132</sup>

Lidhëza *pse* si shkakore përdoret në fjalinë shkakore të drejtpërdrejtë, në atë të ndjenjës, në fjalinë argumentuese të urdhërit, të pyetjes, të thënies së kushtëzuar, në fjalinë shkakore shtesë. Po japim disa shembuj duke respektuar radhën e mësipërme të përmendjes së tipit të fjalisë së varur shkakore:

Nuk i kujtohej mirë *pse* ishte aq i ndërkryer (e drejtpërdrejtë).

Mos u çudit *pse* nuk deshi të vijë (e ndjenjës).

Dil të të shoh, *pse* je një vajzë e bukur (argumentuese e urdhërit).

Kush do të të pyesë *pse* nuk erdhe të shtunën? (shkakore argumentuese e pyetjes).

Para disa diç të shkrojtja prej Kajrit; *pse* ishnja vajtur atje... (argumentuese e thënies së kushtëzuar).

Lidhëza *pse* del dhe me një ndërthurje të ngjyimeve shkakore me ato kundrinore. Por në këtë ndërthurje asnjëherë nuk është e vështirë të përcaktohet se ngjyrimet shkakore janë mbizotëruese: I ati e qortonte *pse* vinte vonë në mbrëmje.

Kur lidhëza *se* paraqet ndërthurje ngjyimesh, ajo mund të zëvendësohet nga shkakorja *që*: I ati e qortonte *që* vinte vonë në mbrëmje.

Lidhëza *ngaqë*: është relativisht e re. Kjo lidhëz ka qenë përdorur paralelisht me shkakoren *ngase* me të cilën është krejt sinonimike. Në kohën e sotme shkakorja *ngase* po mënjanohet nga përdorimi dhe vendin e saj po e zë *ngaqë*. Në krahasim me shkakoret *se*, *sepse* lidhëza *ngaqë* është më e kufizuar në përdorim, jo vetëm për nga denduria, por edhe nga llojet e fjalive të varura kushtore që lidh. Në shumicën e rasteve shkakorja *ngaqë* lidh fjalinë e varur shkakore të drejtpërdrejtë me atë kryesore: *Ngaqë* binte shi, ndenji tërë ditën në shtëpi.

Lidhëza *ngaqë* përdoret dhe në fjalinë shkakore argumentuese të ndjenjës: Gëzohej nga çdo letër nën derë, *ngaqë* mendonte se ai do t'i shkruante përsëri.

Ka dhe raste të përdorimit të saj në fjalinë shkakore argumentuese të supozimit: Gjumi nuk po e zinte, siç duket, *ngaqë* ishte i shqetësuar.

Siç vë re S. Floqi në punimin „Periudha me fjali të varura shkakore II“<sup>133</sup> kuptimi i pikënisjes, i prejardhjes hapësinore është i qartë edhe sot te kjo lidhëz si dhe te lidhëza *nga se*, ku paraqitet e tejdukshme vlera e përgjithshme e parafjalës *nga*, p.sh.: Sytë i ishin skuqur *nga që* s'e zinte gjumi.

Megjithatë lidhëza *ngaqë* sot është larguar shumë nga kuptimi fillestar i pikënisjes. Sot kjo lidhëz realizon marrëdhënie shkakore si tërë shkakoret e tjera dhe dallohet nga ato për një ngjyrim të theksuar arsyetimi.

---

<sup>132</sup> Bucholz, O., „Kausalkonjunktionen in der heutigen albanischen literarischen Sprache“, botuar në, *Zeitschrift für Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung, Band 35/H. 4*; Berlin 1982, f. 383-391.

<sup>133</sup> Floqi, S., „Periudha me fjali të varura shkakore II“, botuar në, *Studime Filologjike*, 3, Tiranë, 1966, f. 4.

### Kreu V Shprehja gjuhësore e raporteve shkakore në gjuhën gjermane

#### V.1 Kuptimi semantik dhe komunikativ

Po e fillojmë këtë kapitull me një çështje tepër të rëndësishme përsa i përket klasës së lidhëzave ose mjeteve lidhëse shkakore. Është fjala për kuptimin e tyre. Kjo çështje është me rëndësi jo vetëm për mjetet lidhëse shkakore, por edhe për mjetet lidhore në përgjithësi. Në rastin tonë do të merremi vetëm me mjetet lidhëse shkakore, pikërisht me ato mjete që realizohen në mënyrë eksplicite, domethënë janë të shprehura gjuhësisht.

Parafjalë si *wegen* 'për shkak të' ose lidhëza si *weil* 'sepse' etj. duket qartë që nuk kanë atë lloj kuptimi që kanë emrat shtëpi, klasë; foljet ha, pi; mbiemrat i ri, i shtrenjtë etj. Në punimin tonë do të mbështetemi në teorinë mbi kuptimin e lidhëzave të gjuhëtarit Lang.<sup>134</sup>

Lang-e dallon tri lloje kuptimesh: kuptimin nocionor, kuptimin referencial dhe kuptimin operacional. Ai shpjegon me terma të logjikës formale llojet e ndryshme të kuptimeve. Me një shpjegim gjuhësor të kategorive kuptimore të trajtuara dhe të emërtuara nga ai do të kishim: kuptimi nocionor është veçori e emrave, foljeve, mbiemrave, ndajfoljeve. Kuptim referencial manifestojnë përemrat dhe fjalët përemërore. Ndërsa kuptimi operacional është veçori e lidhëzave dhe mjeteve të tjera lidhëse. Lidhëzat nuk referojnë në sende, dukuri, veprime, cilësi të botës reale, por kryejnë një funksion, sinjalizojnë për një lidhje midis elementesh gjuhësore (fjalë, fjali etj.) Për të shpjeguar termin e përdorur prej tij Lang-e përdor fjalën – term *Anweisung* 'udhëzim'. Lidhëzat kryejnë një funksion udhëzues, domethënë ato sinjalizojnë se ç' duhet bërë me elementet që duhet të lidhen në vargun ligjërimor. Lidhëzat janë shenja operative. Në përshkrimin e mëtejshëm të klasës së lidhëzave Lang-e i quan ato metashenja (*Metazeichen*), për shkak se ato nuk janë si shenjat e tjera gjuhësore. Ato veprojnë mbi shenjat e tjera gjuhësore duke sinjalizuar për lidhjen dhe llojin e lidhjes midis tyre. Prandaj dhe shenjat e tjera gjuhësore luajnë rolin e tyre në përcaktimin kuptimor të lidhëzave. Përshkrimi i kuptimit të lidhëzave nuk mund të jepet duke e trajtuar lidhëzën në gjendje të izoluar, por në kuadrin e përdorimit të saj.<sup>135</sup> Një trajtim i ngjashëm i bëhet klasës së lidhëzave (dhe parafjalëve) nga R. Memushaj: Parafjala dhe lidhëza në pikëpamje të funksionit afrojnë shumë midis tyre, sepse, së pari, që të dyja shërbejnë për të lidhur ... Së dyti, si parafjala dhe lidhëza nënrenditëse shërbejnë si koka të sintagmave, të parat si koka leksikore, të dytat si koka joleksikore, ose funksionale.<sup>136</sup>

Përcaktimi i lidhëzave (nënrenditëse) si „koka funksionale“ është pak a shumë i njëjtë me përcaktimin: kuptimi i lidhëzave nënrenditëse është në fakt funksioni i tyre.<sup>137</sup>

Në çështjen e kuptimit të lidhëzave (shkakore) mbetet dhe diçka për t'u sqaruar. Në fakt, karakteri udhëzues i lidhëzave shkakore është i pavarur nga kuptimi konkret i elementeve që lidhen me anë të tyre (le t'i quajmë konjunkte, siç i quan B. Schmidhauser-i<sup>138</sup>). Kështu, fjali të tilla:

---

<sup>134</sup> Shënim: Lang e zhvillon teorinë e tij duke u nisur nga lloje të ndryshme lidhëzash. Rezultatet e studimit të tij janë të vlefshme dhe për grupin e lidhëzave e mjeteve lidhore shkakore, Lang, E., "Studien zur Semantik der koordinativen Verknüpfung, botuar në, *Studia Grammatica*, 14, Berlin, 1977, f. 63.

<sup>135</sup> Po aty, f. 66.

<sup>136</sup> Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, Botimet Toena, 2008, f. 210.

<sup>137</sup> Shih, Lang, E., "Studien zur Semantik der koordinativen Verknüpfung, botuar në, *Studia Grammatica*, 14, Berlin, 1977, f. 65.

<sup>138</sup> Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Niemeyer, 1995, f. 75.

Die Welt ist rund, *weil* ich einen roten Pullover trage. ‚Bota është e rrumbullakët, sepse unë kam veshur një pulovër të kuq.‘ Ose

Die Welt ist *krankheitshalber* rund. ‚Bota është e rrumbullakët për shkak të sëmundjes.‘

janë gramatikusht të sakta. Veç është tepër e rëndësishme që funksioni udhëzues të mos veprojë vetëm në ndërtimin gramatikor të marrëdhënies, por dhe në rrokjen (recipimin) e përmbajtjeve të lidhura nga marrësi, dekoduesi i thënies. Edhe ai duhet të udhëzohet, me anë të mjeteve lidhore të shprehura, që t’i rrokë si shkakore marrëdhëniet e realizuara. Udhëzimi operativ, si funksion i lidhëzave shkakore (në rastin tonë), nuk ka vetëm karakter gramatikor, por dhe komunikativo-pragmatik. Mjetet lidhore shkakore bëjnë pjesë në atë klasë mjetesh gjuhësore që „në sajë të kuptimit të tyre (operacional/ veprues) kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me ndërveprimin komunikativ.“<sup>139</sup>

Dhënësi (ekspedienti) duhet t’i përdorë mjetet lidhëse në mënyrë të tillë që të realizojë marrëdhënie shkakore kuptimplotë midis përmbajtjeve që do të transmetojë; këto raporte shkakore duhet t’i dekodojë dhe marrësi.

Përcaktimi i kuptimit të mjeteve gjuhësore lidhëse shkakore si udhëzues-operativ është i rëndësishëm dhe në procesin mësimor. Nxënësit duhet të mësohen t’i formulojnë saktë fjalitë shkakore, lidhja shkakore të artikulohet në mënyrë të tillë që të shërbejë si udhëzim për zbërthimin, për interpretimin e saj nga marrësi.

Nga ana tjetër marrësi duhet të jetë i kujdesshëm në rrokjen e teksteve ose konteksteve me përmbajtje shkakore. P. sh.: Në tekstet me përmbajtje ushtarake janë shpesh të pranishme marrëdhëniet shkakore. Këto ndërtime duhen rrokur nga recipientët (marrësit) si udhëzim për ta kuptuar drejt natyrën argumentuese dhe bindëse të thënies.<sup>140</sup>

### V.2 Mjetet gjuhësore shprehëse të marrëdhënieve shkakore

Në rastin e shprehjes së raporteve shkakore midis fjalisë kryesore dhe asaj të varur, shpesh ekziston lidhja ontologjike shkak-pasojë. Fjalja e varur shpreh shkakun e asaj që ndodh në fjalinë kryesore (shkakun ose motivin e veprimit a gjendjes). Zakonisht fjalja e varur fillon me lidhëzat *weil* ‚sepse‘, *da* ‚meqë‘, *zumal* ‚për më tepër‘ etj.

Sie kommt nicht, *weil/ da* sie krank ist. ‚Ajo nuk vjen, *sepse/meqë* është sëmurë.‘

Wir sollten ihn nicht mit Fragen belästigen, *zumal* wir ihn kaum kennen. ‚Ne nuk duhej ta lodhnim atë me pyetje, për më tepër ne nuk e njohim mirë atë.‘

Në fjalinë kryesore mund të përdoren dhe fjalë korrelative. Të tilla janë: *darum*, *deshalb*, *deswegen* ‚për këtë, prandaj, për këtë arsye‘. Kjo ndodh në fjalinë kryesore, nga e cila varet një fjali e varur e cila fillon me lidhëzën *weil* ‚sepse‘.

Sie kommt *deshalb* nicht, *weil* sie krank ist. ‚Ajo nuk vjen për arsye se është e sëmurë/ *Prandaj* nuk vjen ajo, *se* është sëmurë.‘

---

<sup>139</sup> Shih, Bierwisch, M., „Wörtliche Bedeutung – eine pragmatische Gretchenfrage“, botuar në, *Sprache und Pragmatik*, Lund, 1983. f. 74.

<sup>140</sup> Shih për këtë, Peyer, A., *Satzverknüpfungen: formale Möglichkeiten und inhaltlichen Kategorien. Ein Klassifizierungsversuch*. Lizentiasarbeit. Zürich, 1989, f. 10.

Dy lidhëzat e sipërpërmendura (*weil* dhe *da*), megjithë ngjashmërinë semantike, nuk janë sinonime të plota. Ato nuk e mbulojnë njëra-tjetrën në çdo përdorim. Shkakorja *weil* (sepse) përdoret në fjalitë e varura që njoftojnë diçka të re ose diçka sqaruese, ndërsa shkakorja *da*, përkundrazi, përdoret në fjalitë e varura që informojnë diçka jo të re, por të njohur për folësin.

Para se të analizojmë më tej lidhëzat shkakore në gjuhën gjermane, le të ndalemi fillimisht te mjetet e tjera gjuhësore që shërbejnë për të realizuar marrëdhënie shkakore. Si të tilla shërbejnë: foljet kauzative, disa parafjalë, disa ndajfolje, lidhëzat shkakore (sigurisht).

### V.2.1 Foljet kauzale

Foljet kauzative shënojnë një veprim që rrjedh në formë ndikimi. Semantikisht ato ngjasojnë me foljen bëj e cila dallohet për semantikën e saj të papërcaktuar. Foljet kauzative janë folje kalimtare që kanë dhe përgjegjëset e tyre jokalimtare: *ertränken* – *ertrinken* ‚*mbys* – *mbytem*‘ etj. Helbig-u/ Buscha japin këtë përcaktim për foljet kauzale: ‚Këto folje tregojnë që një subjekt veprues (ose një veprues në përgjithësi) në mënyrë aktive bën diçka që çon drejt një pasojë‘<sup>141</sup> Folje kauzative janë: *zeigen*, *vorführen*, *demonstrieren*, *präsentieren* ‚*tregoj*, *shfaq*, *demonstroj*, *paraqes*‘ etj.

P. sh.: *Wir treten den Gerüchten entgegen*. ‚Ne u presim rrugën thashethemeve.‘ Kjo fjali do të thotë: Ne përpiqemi, së paku, të ndikojmë që thashethemet të mos përhapen. Në grupin e foljeve kauzative hyjnë dhe disa folje që tregojnë gjendje shpirtërore:

*Es schmerzt mich die Erinnerungen*. ‚Kujtimet më shkaktojnë dhembje.

Përkthimi fjalë për fjalë do të ishte: Kujtimet më dhembin. Në këtë rast kujtimet veprojnë dhe shkaktojnë një gjendje të caktuar shpirtërore, dhembje.

Vepruesi, agjenti mund të jetë dhe një objekt: *Der Brand verwüstete das Dorf*. ‚Zjarri shkretoi fshatin.‘ Zjarri është agjenti që shkaktoi një gjendje të caktuar.

Folje të tjera kauzative janë: *begründen*, *zugrundeliegen*, *verursachen*, *verantwortlich sein*, *implizieren*, *auslösen*, *bewirken*, *führen zu*, *kommen von*, *sich ergeben aus*, *resultieren aus*, *abhängen von*, *beruhen auf* etj. ‚argumentoj, bazohet, shkakton, jam përgjegjës, implikoj, shkaktoj, ndikoj, çoj ..., vjen ..., del ..., rezulton, varet, bazohet etj.‘

Foljet e sapopërmendura janë dhe në gjuhën shqipe folje kauzative. Mund të thuhet që foljet kauzative në shqip, në gjermanisht dhe në gjuhë të tjera kanë të njëjtën semantikë dhe shërbejnë për të shprehur raporte shkakore. Por shprehja e këtyre raporteve në këtë rast bëhet disi ndryshe. Nuk kemi ndërtime (par excellence) ku lidhëza shkakore bashkon atë që thuhet më parë, dhe që është shkak (antecedens) me strukturën që shpreh pasojën (consequens).<sup>142</sup>

Megjithatë fjalitë që përmbajnë folje kauzative janë të mjaftueshme për të shprehur marrëdhënie shkakore. Në çdo ndërtim me folje kauzative rroket marrëdhënia shkak-pasojë. Ajo përmbahet në mënyrë implicite në tërë strukturën:

Sjellja e tij arrogante çoi në prishjen e lidhjes së tyre. (Lidhja e tyre u prish për shkak të sjelljes arrogante të tij = Lidhja e tyre u prish, sepse ai u soll në mënyrë arrogante).

---

<sup>141</sup> Helbig, G./ Buscha, J., *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Langenscheidt, 2001, f. 304.

<sup>142</sup> Termat në gjuhë të huaja antecedens, consequens i kemi marrë te Schmidhauser, B., ‚*Kausalität als linguistische Kategorie*, Niemeyer, Tübingen, 1995.

Shkaku, sjellja arrogante, sjell pasojën: prishjen e lidhjes. Si në çdo fjali shkakore dhe në fjalitë me folje kauzale vihet re një raport i caktuar kohor: shkaku ndodh para pasojës. Ndryshe nuk mund të ndodhë. Por jo çdo veprim a ndodhi që ndodh para një tjetre, mund të jetë shkak i saj; ose dy ndodhi që ndjekin njëra tjetrën në kohë nuk është e thënë që të formojnë një marrëdhënie shkakore. Kështu që thënia lakonike latine: *Post hoc, ergo propter hoc* (pas kësaj dhe për shkak të kësaj) në rastin e raporteve gjuhësore shkakore nuk qëndron gjithmonë.

Përveç foljeve kauzale ka dhe elemente të tjera që realizojnë marrëdhënie shkakore. (Lidhëzat janë elemente të fushës kauzale që janë në gjendje të ndërtojnë një raport shkak pasojë si në planin semantik, ashtu dhe në atë pragmatik.) Nga kjo thënie lind pyetja: Përveç lidhëzave a ka elemente të tjera që kryejnë funksion të ngjashëm, domethënë që mund të realizojnë raporte shkakore. Në librin e tij „Kausalitet als linguistische Kategorie“ Benda Schmidhauser-i e formulon në këtë mënyrë mendimin e tij lidhur me këtë çështje: „Jo vetëm lidhëzat, por të gjitha leksemat, pavarësisht se ç’pjesë ligjërate janë, mund të shërbejnë si pikënisje e një fjalisë të varur shkakore, domethënë në plan semantik mund të realizojnë një raport shkakor, në plan pragmatik mund të sinjalizojnë një argumentim. Ndërtime të tilla ku mungojnë elemente të fushës kauzale B. Schmidhauser-i i quan „ndërtime eliptike“ (elipse).

Si lidhje eliptike do të interpretohen ato fjali ose pjesë fjalisë, ku mund të futet një element i fushës kauzale pa sjellë ndryshime në strukturën sintaksore.<sup>143</sup> Ndërsa Gislimberti shprehet: „Prova e zgjerimit, e futjes së një elementi gjuhësor në vargun linear të fjalëve, mund të shërbejë si provë sintaksore-semantike e ekzistencës së një marrëdhënieje kauzale asindete.“<sup>144</sup> Në këtë rast një rol të rëndësishëm për një interpretim të drejtë „të vargut linear të fjalëve“ (fjalisë) luan konteksti:

Es regnet heftig. Wir bleiben im Hause. ‚Bie shi me rrebesh. Ne qëndrojmë në shtëpi.‘

Të dyja pjesët e izoluar të fjalisë së mësipërme mund të trajtohen si gjymtyrë të një ndërtimi shkakor. Sipas provës së zgjerimit ne mund të ndërtojmë një element të fushës kauzale: Wir bleiben *deshalb* im Hause . ‚Prandaj do të qëndrojmë në shtëpi.‘ Elementi korrelativ *prandaj* bën pjesë në fushën e elementeve kauzale dhe i jep fjalisë së mësipërme natyrë shkakore. Kjo është vetëm një mënyrë interpretimi. Një mënyrë tjetër do të ishte: Es regnet. Wir *aber* bleiben zu Hause. ‚Bie shi. Por ne qëndrojmë në shtëpi. ‚ Elementi i shtuar por është lidhëz kundërshtore dhe i jep tërë kontekstit natyrë kundërshtore.

B. Schmidhauser-i shtron dhe një pyetje tjetër lidhur me shprehjen gjuhësore të raporteve shkakore: A ka mjete të tjera lidhëse përveç atyre të përmendura (lidhëzat, mënyra asindetike)? Duke iu përgjigjur kësaj pyetje ai ndalet në një mjet të vaçantë. Është fjala për një mjet sintaksor. Po japim për ilustrim shembullin e tij:

Zwar musste auch der Schweizerische Bankverein (...) in den letzten Jahren Verluste von immerhin einigen hundert Millionen Franken in Kauf nehmen. Sie fielen aber kaum ins Gewicht, [W]liessen sich *doch* nicht einmal Spuren davon in der Publik gemachten Geschäftszahlen ausfindig machen.<sup>145</sup> ‚Vitet e fundit lidhja e bankave zvicerane njohu një humbje prej disa qindra milionë

---

<sup>143</sup> Shih, Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Niemeyer, 1995, f.81.

<sup>144</sup> Gislimberti, S., *Deutsch-italienisch: Syntaktische und semantische Untersuchungen*, Gottfried Egert Verlag, 1993, f. 95.

<sup>145</sup> Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Tübingen, Niemeyer, 1995, f. 82.



franga. Por kjo nuk ra fare në sy, sepse asnjë gjurmë e saj nuk gjendet në bilancin e botuar‘.

Në gjermanisht në vend të një fjalisë shkakore të pasvendosur qëndron një fjali që përmban pjesëzën *doch* dhe kjo është një fjali argumentuese. Kuptimi i saj argumentues shfaqet në kontekst. Vetë pjesëza *doch* nuk mund të realizojë raporte shkakore, por kjo mundësohet në kontekste të caktuara si në rastin e mësipërm.

Nga sa thamë më sipër del se lidhjet shkakore mund të realizohen në tri mënyra:

- me elemente kauzale (lidhëza, fjale korrelative). Këto mundësojnë në çdo rast ndërtimin e raporteve shkakore.
- me elemente kauzale mbështetëse. Quhen kështu ato elemente (si pjesëza *doch* e sipërpërmendur) që marrin pjesë në ndërtimin e raporteve shkakore në kontekste të caktuara. Pa ndihmën e kontekstit nuk mund të bëhet realizimi i marrëdhënieve shkakore. Ato vetëm mbështesin procesin e realizimit të raporteve shkakore në raste të caktuara.
- mënyra e tretë është ajo asindete. Në këtë rast strukturat shkakore realizohen pa mjete lidhore të shprehura.

### V.2.2 Lidhëza kohore me vlerë shkakore

Para se të vazhdojmë me lidhëzat e mirëfillta shkakore në gjuhën gjermane, le të hedhim një vështrim dhe mbi një grup tjetër lidhëzash që në fakt nuk janë shkakore, por që funksionojnë dhe si të tilla ose përdoren dhe me kuptim shkakor. Është fjala për një grup lidhëzash kohore: *nachdem*, *solange*, *sobald* ,pasi, përderisa/gjersa, sapo,. Kuptimi shkakor në strukturën kuptimore të lidhëzave të përmendura është dytësor. Më saktë, është fjala për një implikacion, për një dimension kuptimor (shkakor) të rrokur nga recipienti, lexuesi apo dëgjuesi i fjalisë/ thënies. Jo në çdo përdorim të tyre lidhëzat në fjale manifestojnë domethënie shkakore krahas asaj kohore. Sipas B. Schmidhauser-it kuptimi shkakor shfaqet në rastet kur fjalia e paraprirë nga lidhëzat e mësipërme kombinohet me një fjali që shpreh hamendje, supozim, pretendim, parashikim, njoftim, kërkesë:<sup>146</sup>

*Nachdem* du so lange nichts mehr von mir gehört hast, hast vermutlich keine grosse Lust mehr, mit mir in Ferien zu fahren. ,*Pasi* nuk ke marrë për një kohë të gjatë asnjë lajm nga unë, ndoshta nuk ke më ndonjë qejf të madh të shkosh për pushime me mua‘.

Fjalia *hast du vermutlich keine grosse Lust* ,ndoshta nuk ke më qejf‘ shpreh një hamendje dhe kjo mundëson shfaqjen e ngjyimeve shkakore në lidhëzën *nachdem* ,pasi‘. Vetë fjalia *nachdem* du so lange nichts mehr von mir gehört hast, pasi për një kohë të gjatë nuk ke marrë asnjë lajm nga unë‘ është një arsye, një argument për atë që thuhet në fjalinë kryesore. Kuptimi kohor është gjithashtu i pranishëm: ngjarjet pasojnë njëra tjetrën në kohë.

Sipas mendimit më të përgjithshëm ngjyrimet shkakore të lidhëzave kohore (të sipërpërmendura) ndodhin kur në fjalinë kryesore folja nuk shpreh ndodhi/ngjarje, por gjendje:

---

<sup>146</sup> Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Tübingen, Niemeyer, 1995, f. 220.

*Nachdem* Maria angerufen hatte, war Hans glücklich. ‚Pasi telefonoi Maria, Hansi u lumturua.‘

Kjo fjali mund të interpretohet: Hansi u lumturua, se Maria e mori në telefon. Folja në pjesën kryesore *war glücklich* ‚u lumturua‘ shënon një ndjenjë, një gjendje. Në një rast tjetër: ‚Pasi telefonoi Maria, Hansi doli në pazar‘ përjashtohet çdo interpretim shkakor i ‚pasi telefonoi Maria‘. Konstrukti në fjalë nuk është më shkakor. Folja në pjesën kryesore shënon një ngjarje, veprim dhe jo gjendje.

Një rast tjetër të përdorimit shkakor të lidhëzës *nachdem* ‚pasi‘ kemi në kombinimin e fjalisë së varur që përmban këtë lidhëz me fjalinë kryesore, ku folja-kallëzues është në kohën e ardhme :

Lieber Toni! Vielleicht wirst du dich wundern, das Du einen Brief von mir bekommst, *nachdem* wir uns so lange Zeit nicht mehr gesehen und gesprochen haben. ‚I dashur Toni! Ti ndoshta do të çuditesh që po merr këtë letër nga unë, *pasi* ne nuk jemi parë dhe as kemi folur për një kohë të gjatë.‘

Në fakt përdorimi shkakor i lidhëzës *nachdem* ‚pasi‘ lidhet me kuptimin e foljes në kohën e ardhme. Në shumicën e rasteve folja në kohën e ardhme shënon supozime, hamendje etj. Siç kemi pohuar më lart, në struktura të tilla (fjali me lidhëzën *nachdem* ‚pasi‘ + fjali kryesore që shpreh supozime, pretendime, parashikime etj.) lidhëza në fjalë manifeston ngrime shkakore.

Vlen të përmendim gjithashtu një mendim të Herweg-ut, i cili propozon një strukturë tjetër të përdorimit shkakor të lidhëzës *nachdem* ‚pasi‘. Është fjala për kombinimin e një fjalisë të varur të paraprirë nga *nachdem* ‚pasi‘ me një fjali kryesore, ku folja nuk shënon gjendje, por mohimin e një ndodhie :

*Nachdem* er diese Nachricht bekommen hat, schrieb er an Anna nicht mehr. ‚Pasi mori këtë lajm, ai nuk i shkroi më Anës.‘

Herweg-u arsyeton: mohimi i një ndodhie nuk është më ndodhi, por gjendje. Në fakt *schrieb nicht* ‚nuk i shkroi‘ nuk është kurrëfarë ndodhie, apo veprimi.<sup>147</sup>

Ngjyrimet kuptimore shkakore janë akoma më të forta kur folja e fjalisë së varur është në formën mohore: *Nachdem* er kein Auto hatte, ging er zu Fuß zur Arbeit. ‚Pasi nuk kishte makinë, shkante në punë më këmbë.‘

Gramatika Duden dhe U. Engel-i këshillojnë dhe rekomandojnë që lidhëza *nachdem* ‚pasi‘ të përdoret vetëm si kohore.<sup>148</sup> Por B. Schmidhauser-i, autori i „Kausalität als linguistische Kategorie“ i quan pa kuptim rekomandime të tilla, përderisa lidhëza në shqyrtim përmban ngjyrim shkakore si implikacion në përmbajtjen e saj.

Kjo që thamë për përdorimin me vlerë shkakore të lidhëzës kohore *nachdem* ‚pasi‘ vlen dhe për dy lidhëzat e tjera *solange*, *sobald*. Në kontekste të tilla ku folja e fjalisë kryesore shënon gjendje, ato shfaqen me ngjyrim shkakore:

*Solange* sie nicht anrief, war er sehr traurig. Ai ishte shumë i mërziur, *përderisa* ajo nuk merrte në telefon.‘

---

<sup>147</sup> Herweg, M., *Die Bedeutung von Tempus, Aspekt und temporalen Konjunktionen*, Wiesbaden, Deutscher Universitäts-Verlag, 1990, f. 219 – 222.

<sup>148</sup> Shih, *Duden Grammatik*, Band 4, botuar nga, G. Drosdowski et al., Mannheim/Wien/Zürich, Bibliografisches Institut, 1984, f. 720.

Lidhëzën *solange* mund ta përkthejmë dhe me ‚sa kohë që‘:

*Solange* Herr Wohlstab für diese Person in Köln arbeiten musste, war er krank.  
‚Zoti Wohlstab ishte sëmurë sa kohë që duhej të punonte për atë person në Köln.‘

Folja në fjalinë e varur që fillon me ‚*sa kohë që*‘ shënon një veprim që zgjatet në kohë (folje durative). Por zgjatja është gjithsesi e kufizuar. Në këtë rast mundësia e ngjyrimit shkakor të foljes është minimale.

Ndërsa në rastin e një veprimi që zgjat pakufi, që është shndërruar, si të thuash në gjendje, ngjyrimet shkakore janë të pranishme në lidhjen e realizuar me lidhëzën kohore: *përderisa* ajo nuk merrte në telefon.

Në ‚Gramatika e gjuhës shqipe‘ 1 lidhëzat *gjersa*, *përderisa* janë përfshirë në grupin e lidhëzave shkakore.<sup>149</sup> Por ngjyrimet e tyre kohore janë krejt të dukshme. Historikisht, përdorimet e tyre kohore janë më të hershme se ato shkakore.<sup>150</sup>

Le të marrim tani një shembull me lidhëzën *sobald* ‚sapo‘:

*Sobald* Maria anrief, war Hans immer glücklich. ‚Sapo telefononte Maria, Hansi ishte përherë i lumtur.‘

Lidhëza *sobald* ‚sapo‘, në raste të tilla, shpreh edhe marrëdhënie shkakore. Fjalja mund të interpretohet: Hansi ishte gjithnjë i lumtur, meqë telefononte Maria.

Krahasuar me lidhëzën *nachdem* ‚pasi‘, lidhëza *sobald* ‚sapo/porsa‘ realizon një lidhje të drejtpërdrejtë e të menjëhershme në pikëpamje kohore të përmbajtjeve të shprehura. Për këtë arsye ajo nuk mund të dalë në vend të lidhëzës *nachdem* ‚pasi‘. Lidhur me përdorimin shkakor të lidhëzës kohore *sobald* B. Schmidhauser-i thotë se kjo lidhëz e përmban ngjyrimin shkakor në vetvete, në mënyrë implicite dhe jo të kushtëzuar nga konteksti, të shfaqur vetëm në kontekst.<sup>151</sup>

Edhe lidhëzat kohore *pasi*, *sapo*, *gjersa* të gjuhës shqipe mund të përdoren me vlerë shkakore. Mendojmë që në përkthimet e mësipërme të shembujve në gjuhën gjermane vihet re një mundësi e tillë. Në përgjithësi, ajo që është thënë për përdorimin shkakor të disa lidhëzave kohore në gjuhën gjermane vlen dhe për gjuhën shqipe.

### V.2.3 Ndajfoljet lidhore

Ndajfoljet lidhore janë një mjet tjetër për realizimin e raporteve shkakore. Emërtimin ‚ndajfolje lidhore‘ po e përdorim në kuptimin që ka ky term te B. Schmidhauser-i. Në këtë grup ai përfshin fjalët: *deswegen*, *deshalb*, *darum*, *daher* ‚prandaj‘, për këtë arsye, për këtë, prandaj/për këtë‘. Në pikëpamje morfologjike këto ndajfolje përbëhen nga elementi përemror *des* dhe *wegen* që shënon në mënyrë të përgjithshme idenë e lidhjes. Ndërsa te *da r um*, *da her*: elementi *da* është përemëror, ndërsa *um* dhe *her* janë elemente ndajfoljore<sup>152</sup>.

---

<sup>149</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f. 408.

<sup>150</sup> Shih, Demiraj, Sh., Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1986, f. 629, § 35.

<sup>151</sup> Schmidhauer, B., Kausalität als linguistische Kategorie, Tübingen, Niemeyer, 1995.

<sup>152</sup> Shih, Leinfellner, E., ‚Kausalität und Referenz: eine linguistische Analyse‘, botuar në, Semiotics unfolding 2, Berlin etc., f. 1175–1182.

Ndajfoljet lidhore janë elemente që referojnë dhe që përcaktojnë llojin e lidhjes, ato referojnë në përmbajtjen e fjalisë para- ose pasardhëse dhe njëkohësisht realizojnë lidhjen midis dy fjalish:

Er sang sehr gespannt. Die Zuschauer lachten deswegen. ‚Ai këndoi shumë i kontraktuar. Prandaj spektatorët qeshën.‘

Ndajfolja lidhore *deswegen* ‚prandaj‘ referon në fjalinë parardhëse, e cila shpreh shkakun e asaj që ndodh në fjalinë e dytë; nga ana tjetër ajo realizon lidhjen midis dy përmbajtjeve, dy fjalive në shqyrtim. Për shkak të këtij funksioni të dyfishtë këto ndajfolje në disa gramatika trajtohen si elemente rrjedhimore, në disa gramatika të tjera si elemente shkakore.<sup>153</sup> Sipas tij ato nuk paraprinë një fjali të varur shkakore, por referojnë në një arsye të përmendur më parë. Në këtë mënyrë ato e karakterizojnë si shkakore fjalinë së cilës i referohen<sup>154</sup>.

Ndajfoljet lidhore *deshalb*, *deswegen* mund të referojnë dhe në fjalinë pasardhëse :

Wir sind *deswegen/ deshalb* nicht an den Strand gegangen, *weil* es regnete. ‚Prandaj ne nuk shkuam në plazh, sepse ra shi.‘

Fjalja që shënon shkakun paraprihet nga lidhëza *weil* ‚sepse‘.

Në të dyja rastet e përdorimit, anaforik ose kataforik (referim në fjalinë para- ose pasardhëse), fjalja me ndajfoljen lidhore nuk duhet të ndodhet shumë larg fjalisë së cilës i referohet, përndryshe vështirësohet të kuptuarit. Vlen, gjithashtu, të vihet në dukje që fjalja me ndajfoljen lidhore nuk duhet të përmbajë dhe elemente të tjera me kuptim shkakor. Ndërtime të tilla nuk janë korrekte:

Unsere Firma feiert dieses Jahr ihr 450-jähriges Bestehens. Aus diesem Grund würden wir uns *deshalb* freuen, wenn sie sich für die Jahresversammlung etwas Besonderes einfallen lassen würden. ‚Firma jonë feston këtë vit 450 vjetorin e themelimit. Për këtë arsye do të gëzoheshim për këtë, nëqoftëse ju do të mendonit diçka të veçantë për mbledhjen vjetore.‘

Përdorimi i dy elementeve shkakore aus diesem Grund dhe *deshalb* (për këtë arsye) dhe (për këtë) e bëjnë thënien e mësipërme jokorrekte. Të dyja këto elemente referojnë te e njëjta fjali argumentuese: ‚Po që se ju do të mendonit diçka të veçantë për mbledhjen vjetore‘.

Funksion lidhës në ndërtimet shkakore mund të kryejë dhe pjesëza ndajfoljore *nämlich* ‚(dhe) pikërisht‘:

Ich konnte letzte Woche in die Vorlesung nicht kommen. Ich war *nämlich* krank. ‚Unë nuk mund të vija në leksion javën e kaluar. Sepse isha sëmurë.‘

Në këtë përdorim pjesëza ndajfoljore *nämlich* ka kuptimin e lidhëzës shkakore *weil* ‚sepse‘<sup>155</sup>.

---

<sup>153</sup> Erben i quan elemente të tilla: *daher, darum, deshalb, deswegen* pjesëza dëftore (*Demonstrativpartikeln*)

<sup>154</sup> Erben, J., *Deutsche Syntax. Eine Einführung*, Bern, 1984, f. 195.

<sup>155</sup> Shënim: ‚Në klasën e ndajfoljeve lidhore përfshihen dhe disa pjesëza që ngjasin pjesërisht ose nuk ngjasin aspak me ndajfoljet. Është fjala për *nämlich, ja, doch* ‚pikërisht, madje, pra‘ ....(Collet, S., “A

Elementi lidhor *nämlich* nuk ka karakter referues.

### V.2.4 Ndajfoljet pyetëse

Çdo ndajfolje pyetëse ka përgjegjësen e saj jopyetëse. Të dyja llojet kryejnë të njëjtin funksion sintaksor. Në pikëpamje fonetike këto ndajfolje dallohen vetëm nga një tingull fonemë: *deshalb* → *weshalb*, *deswegen* → *weswegen*, *prandaj* → *pse*, për këtë → *pse*.

Ndajfoljet pyetëse janë ato ndajfolje që përdoren për të pyetur për shkakun, motivin. Ato janë gjymtyrë të fjalive pyetëse të drejta. Vetë fjalitë pyetëse të drejta dallohen nga fjalitë pyetëse të zhdrejta se këto të fundit funksionojnë si kundrinë e drejtë (fjali kundrinore):

Er möchte wissen, *weshalb du ihn gefeuert hast*. Ai do të di, *pse e pushove nga puna?*<sup>156</sup>

Në pikëpamje pragmatike fjalitë pyetëse të drejta dallojnë nga ato të zhdrejta, se në to kërkohet shprehimisht shkakun, gjë që nuk ndodh në fjalitë pyetëse të zhdrejta:

*Weshalb* haben Sie das nicht gleich gesagt? ,*Pse* nuk e thatë këtë menjëherë?‘  
Ich möchte wissen, *weshalb* Sie das nicht gleich gesagt haben. ,Unë dua të di, *pse* nuk e thatë këtë menjëherë.‘

Përfundim nga ky rregull përbëjnë fjalitë pyetëse të zhdrejta ku personi pyetës është në vetën e parë njëjës ose shumës:

Ich will wissen, *weshalb* du mich gefeuert hast. ,Unë dua të di, **pse** më pushove nga puna.‘

Në raste të tilla kërkohet shprehimisht arsyeja (pse më pushove nga puna).

### V.2.5 Lidhëzat

Lidhëzat janë fjalë, morfologjiksht, të pandryshueshme që realizojnë funksionin sintaksor të lidhjes së elementeve gjuhësore të rrafshëve të ndryshme duke mos qenë gjymtyrë fjalish. Lidhëzat më të rëndësishme shkakore në gjuhën gjermane janë: *weil*, *da*, *denn*, *zumal* etj. ,sepse, meqë, se, për më tepër‘ etj. .

Lidhëzat shkakore *denn*, *weil*, *da*, lidhin dy fjali, nga të cilat njëra shpreh shkakun, arsyen ose motivin, ndërsa tjetra shpreh pasojën.

Ato dallojnë në përdorim sipas raporteve që vendosen midis folësit dhe marrësit të mesazhit të koduar nga folësi.

Në rastin e shprehjes së raporteve shkakore midis fjalisë kryesore dhe asaj të varur, shpesh ekziston lidhja ontologjike shkak-pasojë. Fjalitë e varur shpreh shkakun e asaj që ndodh në fjalinë kryesore (shkakun ose motivin e veprimit a gjendjes). Zakonisht fjalitë e varur fillon me lidhëzat *weil*, ,sepse‘, *da*, ,meqë‘, *zumal*, ,për më tepër‘ etj.

---

propos de quelques conjonctions causales”, botuar në, *Nouveaux cahiers d’allemand (Nancy) 1/3*, f. 155 – 163.

<sup>156</sup> Shih më tej, Eisenberg, P., *Grundriss der deutschen Grammatik*, Stuttgart, 1989, f. 343.

Sie kommt nicht, *weil/ da* sie krank ist. ‚Ajo nuk vjen, sepse/meqë është sëmurë.‘

Wir sollten ihn nicht mit Fragen belästigen, *zumal* wir ihn kaum kennen. ‚Ne nuk duhej ta lodhnim atë me pyetje, për më tepër ne nuk e njohim fare atë.‘

Në fjalinë kryesore mund të përdoren dhe fjalë korrelative. Të tilla janë: *darum, deshalb, deswegen* ‚për këtë, prandaj, për këtë arsye‘. Kjo ndodh në fjalinë kryesore, nga e cila varet një fjali e varur e cila fillon me lidhëzën *weil* ‚sepse‘.

Sie kommt *deshalb* nicht, *weil* sie krank ist. ‚Ajo nuk vjen për arsye se është e sëmurë/ Prandaj nuk vjen ajo, se është sëmurë.‘

Dy lidhëzat e sipërpërmendura (*weil* dhe *da*), megjithë ngjashmërinë semantike, nuk janë sinonime të plota. Ato nuk e mbulojnë njëra-tjetrën në çdo përdorim. Shkakorja *weil* (sepse) përdoret në fjalitë e varura që njoftojnë diçka të re ose diçka sqaruese, ndërsa shkakorja *da*, përkundrazi, përdoret në fjalitë e varura që informojnë diçka të jo të re, por të njohur për folësin.

Lidhëza bashkërenditëse *denn* është në pikëpamje sintaksore shumë e kufizuar, ajo mund të lidhë vetëm fjali kryesore, ose të pavarura. Fjalitë e lidhura me *denn* ‚se‘ kanë një rend të tillë të ngulitur: fjalia që shpreh pasojën qëndron para asaj që shpreh shkakun:

Philip suchte Karoline, *denn* sie hatte sich vor ihm versteckt. ‚Filipi kërkonte Karolinën, se ajo i ishte fshehur.‘

Lidhëza *denn* lidh dy fjali përmbajtja e të cilave, sipas bindjes së folësit, është e re për marrësin:

Gestern war ein langweiliger Tag. Wir konnten nicht an den Strand gehen, *denn* das Wetter war schlecht. ‚Dje ishte një ditë e mërzitshme. Ne nuk mundëm të shkonim në plazh, se koha ishte e keqe.‘

Shembulli i mësipërm me përdorimin e lidhëzës *denn* duhet interpretuar kështu: Folësi, emetuesi i thënies, mendon që marrësi, dekoduesi, nuk di gjë se folësi (dhe grupi i tij) nuk shkuan dot në plazh, madje nuk di gjë që koha kishte qenë e keqe. Por, nëse folësi do të mendonte që një nga informacionet e përmendura do të ishte i njohur për marrësin, atëherë ai do të përdorte lidhëzën *weil* ‚sepse‘ për të realizuar ndërtimin shkakor.

Fjalia që fillon me *denn* ‚meqë‘ mund të tregojë arsyen reale të asaj që ndodh në fjalinë tjetër. Në këtë përdorim ajo është identike me *weil* ‚sepse‘ dhe mund të zëvendësohet nga ajo:

Ich habe Hunger, *denn* ich habe den ganzen Tag nichts gegessen.

Ich habe Hunger, *weil* ich den ganzen Tag nichts gegessen habe. ‚Unë kam uri, sepse nuk kam ngrënë asgjë gjithë ditën.‘

Fjalia që paraprihet nga *denn* mund të shërbejë dhe si argumentuese për fjalinë me të cilën lidhet:

Die Katze hat Hunger, *denn* sie frisst den ganzen Topf leer.<sup>157</sup> ,Macja ka uri, se e për lau të gjithë tenxheren.,

Thënia: Die Katze hat Hunger ,Macja ka uri‘ shpreh një hamendje që bazohet në fjalinë tjetër: *denn* sie frisst den ganzen Topf leer‘ ,sepse e për lau të gjithë tenxheren.‘ Fjalja që fillon me *denn* në shembullin e mësipërm nuk jep ndonjë shpjegim shkakor, por shpreh një simptomë, ka një përdorim simptomatik. Variant simptomatik mund të jetë secila nga fjalitë e lidhura me lidhëzën *denn* ,se‘ :

Die Katze miaut, *denn* sie hat Hunger. ,Macja mjaullin, se ka uri.‘  
Die Katze hat Hunger, *denn* sie miaut. ,Macja ka uri, se miaullin.‘

Përdorimi i ndonjë pjesëze supozimi, si: *vermutlich*, *offensichtlich*, *ndoshta*, siç duket‘ në fjalinë pararendëse, si shenjë e përdorimit simptomatik të fjalisë me lidhëzën *denn* , nuk është i nevojshëm. Mund të ndodhë që fjalja e paraprirë nga *denn* të tregojë shkakun dhe jo simptomën e asaj që shprehet në fjalinë tjetër, e cila përmban një nga pjesëzat e përmendura:

Die Katze hat (offensichtlich) Hunger, *denn* sie hat seit drei Tagen nichts mehr fressen bekommen. ,Macja ( siç duket) ka uri, se që prej tri ditësh nuk i kanë dhënë për të ngrënë.‘

Lidhëza bashkërenditëse *denn* ,se‘ ka, zakonisht, kuptim sqarues. Edhe në rastet, kur ajo mund të zëvendësohet me *weil* , nuk e ka kuptimin e theksuar shkakor të kësaj të fundit :

Man sollte ihnen verzeihen, *denn* sie wissen nicht, was sie tun. , Duhet tua falim, se ata nuk dinë ç’bëjnë.‘

Në shembullin e sapo dhënë shihet qartë se ndërtimet me *denn* , në përgjithësi, nuk shprehin shkaqe të pastra, por shpjegime, sqarime etj.

### V.2.5.1 Lidhëza *weil* ,sepse‘

*Weil* ,sepse‘ është lidhëza shkakore më e përdorshme në gjuhën e sotme gjermane. Ajo ka një spektër të gjerë përdorimi. Kjo lidhëz përdoret edhe si bashkërenditëse.<sup>158</sup> Dukuria e përdorimit të kësaj lidhëze me vlerë bashkërenditëse në gjuhën e folur ka filluar të shtrihet dhe në gjuhën e shkruar. Për të kanë shkruar gjuhëtarë si: Gaumann-i, Pasch-i, Küper-i, Keller-i, Eisenberg-u. Megjithatë, dukuria e kalimit nga lidhja me bashkërenditje në atë me nënrenditje dhe anasjelltas nuk është trajtuar gjërësisht dhe në mënyrë të mjaftueshme në literaturën e sotme gjuhësore. Përdorimi i lidhëzës shkakore *weil* ,sepse‘ me vlerë bashkërenditëse ndodh në ato raste ku normalisht do të përdorej lidhëza shkakore bashkërenditëse *denn* ,se‘. Është rasti të kthehemi dhe njëherë shkurt te përdorimet e lidhëzës *denn*. Kjo lidhëz mund të përdoret dhe në një fjali argumentuese pyetëse, në bashkëvjajtje me një ndajfolje pyetëse:

---

<sup>157</sup> Shembull i cituar nga Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Tübingen, Niemeyer, 1995, f. 142.

<sup>158</sup> Shënim: „Në gjuhën e folur *weil* ,sepse‘ përdoret edhe si lidhëz bashkërenditëse. Në këtë rast pas shqiptimit të saj bëhet një pauzë.“ Shih, Buscha, J., *Lexikon deutscher Konjunktionen*. Leipzig, 1989, f. 126.

... Wo Geld keine Rolle spielte, *denn* wo auf grossem Fusse gelebt wurde, liess sich alles einfach an. ,... Ku paraja nuk luante asnjë rol, *se* ku jetohej duke dhënë pa kursim, gjithçka ishte më e thjeshtë.’

Në vend të *denn* mund të dalë *weil* ,sepse‘. Kemi të bëjmë këtu me dukurinë e re të përhapjes së përdorimit të *weil* si lidhëz bashkërenditëse. Duhet vënë gjithashtu në dukje se në ndërtimet me *weil* me vlerë bashkërenditëse folja e fjalisë nuk e ruan topikën e zakonshme që ka në fjalitë nënrenditëse. Ajo vendoset në këtë rast jo në fund të fjalisë, por në vend të dytë, direkt pas ndajfoljes pyetëse:

..., *denn* was soll das Ganze überhaupt ? ,Pse ç‘ duhet kjo në fund të fundit?‘  
..., *weil* was das ganze überhaupt *soll*? ,Sepse ç‘ duhet kjo në fund të fundit?‘  
(jo korrekte)  
..., *weil-* was *soll* das überhaupt? (korrekte)

Dukuria e re e përdorimit të lidhëzës *weil* ,sepse‘ si bashkërenditëse nuk pranohet nga disa gjuhëtarë ose shihet si një dukuri e ngushtë që shfaqet në disa të folme në dialektet jugore gjermane<sup>159</sup> *Weil* ,sepse‘ është i vetmi element i fushës kauzale që mund të vendoset drejtpërsëdrejti pranë një emri:

Eine *Beförderung*, *weil* du der Chefin gefällst, ist ausgeschlossen. ,Një ngritje në post, *sepse* ti i pëlqen shefes, është i pamundur.’

Në këtë rast lidhëza ka vlerë atributive. Fjalja e mësipërme mund të parafrazohet kështu:

Eine *Beförderung*, die genau erfolgen würde, *weil* du der Chefin gefällst, ist ausgeschlossen.,Një ngritje në post që do të ndodhte, vetëm *sepse* ti i pëlqen shefes, është e pamundur.’

Ndërtime të tilla janë të rralla, ato përmbajnë gjithnjë emra veprimi: *Beförderung* ,ngritje në përgjegjësi‘ etj. Në to përdoret vetëm lidhëza *weil*, e cila nuk mund të ndërkëmbehet me lidhëza e tjera shkakore *denn* ose *da*.

Lidhëza *weil* është e vetmja në llojin e vet që mund të lidhet drejtpërsëdrejti me një mbiemër:

In der Politik muss man mit den Mächtigen schmeicheln ... Diese Schmeichelei ist allenfalls verzeiglich, wenn wir unsere eigene Lüge als Lüge durchschauen; unverzeiglich, *weil tödlich*, ist die Selbstbelügung. ,Në politikë duhet t’u bësh lajka pushtetarëve ... Këto lajka janë gjithsesi të falshme, nëse ne e shohim gënjeshtren tonë si gënjeshtër; të pafalshme, *sepse* vetëgënjimi është *vrassës*.‘<sup>160</sup>

Në pikëpamje semantike lidhëza *weil* ,sepse‘ mund të përdoret në fjali të varura shkakore që shprehin:

---

<sup>159</sup> Shih, Boetscher, W./ Sitta, H., *Deutsche Grammatik III. Zusammengesetzter Satz und äquivalente Strukturen*. Frankfurt a.M., 1972, f. 141.

<sup>160</sup> Shënim, Ky shembull është marrë nga Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Tübingen, Niemeyer, 1995, f. 152.



- Një argumentim, arsyetim në formë supozimi:

Vielleicht weinte er, *weil* er zum erstenmal allein war..., Ndoshta ai qante, *sepse* për të parën herë ishte vetëm ...‘

Në raste të tilla në fjalinë kryesore përdoret pjesëza *vielleicht* ,ndoshta‘ etj.

- Një arsye, një shkak që theksohet, evidentohet në mënyrë të veçantë.

Në rast të tilla lidhëza është shpesh në bashkëvajtje me pjesëzat: *gerade*, *besonders*, *eben* ,pikërisht, veçanërisht, pikërisht‘:

Aber *gerade weil* er den Mann nicht versteht, unterhält er sich gern mit ihm.  
,Por pikërisht sepse ai nuk e kupton burrin, bisedon me qejf me të.‘

Po qe se shkak nuk do të evidentohet në mënyrë speciale, do të përdoret *da* në vend të *weil*.

Përdorimi i pjesëzave përforcuese të përmendura është fakultativ. Lidhëza *weil* (sepse) mund të përdoret në fjalitë që shprehin një shkak të evidentuar edhe pa u mbështetur semantikisht nga elemente të tilla përforcuese. Kjo, për vetë natyrën e lidhëzës, sepse „*der weil-Satz* betont die Ursache mit Nachdruck“<sup>161</sup> ,fjalitë shkakore që fillon me *weil* (sepse) e shpreh shkakun duke e theksuar atë.’

Në pikëpamje pragmatike-komunikative marrëdhëniet shkakore të realizuara me *weil* (sepse) paraqiten si më poshtë: pasoja është e njohur për marrësin, ndërsa shkak – jo. Prandaj në raste të tilla mund të pyesim për shkakun me anë të pyetjes *warum* ,pse‘. Kjo gjë është e pamundur në rastin e përdorimit të lidhëzës *denn* (se).

*Warum* geht ihr nicht an den Strand? – Wir bleiben lieber im Hotel, *weil* das Wetter so schlecht ist.

Ky shembull tregon se për marrësin pasoja është e njohur: folësi me njerëzit e tij nuk shkuan në plazh. Pastaj ai informohet për shkakun që jepet me një fjali të varur shkakore që fillon me lidhëzën *weil* (sepse).

Pjesa shkakore që paraprihet nga lidhëza *weil* (sepse) mund të vendoset para pjesës kryesore, pas saj, ose në mes:

*Weil* du arm bist, musst du früher sterben. ,*Sepse* je i varfër, duhet të vdesësh para kohe.‘

Du musst früher sterben, *weil* du arm bist. ,Ti duhet të vdesësh para kohe, *sepse* je i varfër.‘

Der Schlüssel, *weil* verrostet, versagte seinen Dienst. ,Çelësi, *sepse* ishte i ndryshkur, refuzoi ta kryente detyrën e tij. ,

Në fjalinë kryesore është e mundur të përdoret një korrelat (*deshalb*, *darum* ,prandaj, për këtë‘):

---

<sup>161</sup> Stojanova, N., *Linguistische Untersuchungen zum Ausdruck kausaler Beziehungen in der deutschen Gegenwartssprache unter besonderer Berücksichtigung der Strukturen und der Funktionen der denn-Sätze*.“ Diss. A, Sektion Germanistik/Literaturwissenschaft, Karl-Marx-Universität Leipzig, 1983, f.5.

Du musst *deshalb* früher sterben, *weil* du arm bist. ,‘Prandaj duhet të vdesësh para kohe, sepse je i varfër.’

Lidhëza *weil* ka funksionuar fillimisht si lidhëz kohore dhe ka pasur kuptimin *so lange als* ,përderisa ‘. Ajo lidhet kuptimisht me emrin *die Weile* (një copë herë):

Brüder! Last uns lustig sein, *weil* der Frühling währet ! ,Le të gëzohemi, vëllezër, gjersa kemi .... pranverë!<sup>162</sup>

Në shekullin 19-të përdorimi i saj shkakor, vjen e bëhet mbizotërues. Pastaj më vonë kjo lidhëz përdoret vetëm me kuptim shkakor. Në gjendjen e sotme të gjuhës kjo lidhëz shërben vetëm për shprehje raportesh shkakore.

Edhe lidhëza bashkërenditëse shkakore *denn* (meqë) rrjedh nga ndajfolja kohore dann (pastaj, atëherë).

Shumica e kuptimeve shkakore lidhen jo me kuptime kohore, por vendore. Kështu parafjala shkakore *wegen* (për shkak) rrjedh nga emri *der Weg* (rrugë), *infolge* (si pasojë) rrjedh nga folja *folgen* [ndjek (në hapësirë)] etj.<sup>163</sup>

Në gjuhën shqipe përgjegjësja më e goditur e lidhëzës *weil* është sepse. Të dyja këto lidhëza kanë një kuptim shkakor të spikatur dhe përmbajnë ngjyrimë stilistike librore.

### V.2.5.2 Lidhëza *da*

Lidhëza nënrenditëse *da* sinjalizon një shkak të njohur për adresatin, por ai nuk e di ç’pasojë ka sjellë ose mund të sjellë ky shkak. Prandaj në rastet e përdorimit të *da* nuk mund të pyesim për shkakun me anë të pyetjes *warum* ,pse‘<sup>164</sup>. Në raportet shkakore të realizuara me *da* (meqë), fjalia kryesore nuk përmban asnjëherë ndonjë korrelat:

Er ist deshalb geflohen, *da* er ein Auto gebrochen hatte. (Fjalja nuk është korrekte. Do të ishte korrekte me lidhëzën *weil* në vend të *da*:

Er ist deshalb geflohen, *weil* er ein Auto gebrochen hatte. ,Prandaj iku ai, se theu derën e një makine.’

Në fjalinë:

Es regnete den ganzen Tag. *Da* das Wetter so schlecht war, konnten wir nicht an den Strand gehen. ,Ra gjithë ditën shi. Meqë koha ishte aq e keqe, ne nuk mundëm të shkonim në plazh.’

bëhet fjalë që në fillim për një kohë të keqe. Folësi është i sigurtë se informacioni që jepet në: *Ra gjithë ditën shi. Meqë koha ishte e keqe* është i njohur për marrësin. E panjohur është përmbajtja e fjalisë që vijon: *Ne nuk mundëm të shkonim në plazh*. Kjo është fjalia kryesore. Me anë të saj shprehet pasoja.

Ka raste që lidhëza *da* përdoret me kuptim kohor dhe sinjalizon njëkohësi:

---

<sup>162</sup> Shih, Urmson, J.O., „Motives und Causes“, botuar në, *The Philosophy of Action*, Oxford 1973, f. 153.

<sup>163</sup> Wolfgang, P., *Etymologisches Wörterbuch des Deutschen*, Berlin, 1989, f. 496.

<sup>164</sup> Shih, *Duden Grammatik, Band 4*, botuar nga, G. Drosdowski et al.,Mannheim/Wien/Zürich, Bibliografisches Institut, 1984, f. 790.

...der Tag, *da* Tom Dooley kam... , ...dita *kur* erdhi Tom Dooley...<sup>165</sup>

Në pikëpamje sintaksore *da* (meqë) është e ngjashme me *weil* (sepse). Të dyja janë lidhëza nënrenditëse dhe u nënshtrohen rregullave të përdorimit të lidhëzave nënrenditëse. Në pikëpamje semantike ajo afrohet me *denn* (se).

Rudolf-i thekson aspektin komunikativ të lidhëzës *da* (meqë). Pjesa e varur e fjalisë shkakore që fillon me *da* përmban shpesh dhe elementin *ja* (të kombinuar me *da*). Me anë të këtij kombinimi synohet që folësi dhe dëgjuesi të arrijnë një konsensus lidhur me përmbajtjen e informacionit të njohur nga të dy palët.<sup>166</sup>

Lidhur me përdorimin e lidhëzës *da* (meqë) Engel-i thotë: „Da referon shprehimisht në një arsye të vetkuptueshme, në një arsye që njihet dhe pranohet nga gjithkush. Në qoftë se arsyeja, motivi nuk janë të vetkuptueshëm, nuk duhet të përdoret lidhëza *da*.<sup>167</sup>

Në pikëpamje të teorisë mbi temën dhe remën (tema – informacion i njohur, rema – informacion i ri) pjesa e varur e fjalisë shkakore që paraprihet nga lidhëza *da* përmban informacion të njohur (për folësin dhe dëgjuesin); i takon temës dhe jo remës. Prandaj Hösselbarth-i thotë: „Për fjalitë e varura shkakore që fillojnë me *da* (meqë) mund të thuhet që ato nuk janë asnjëherë remë.”<sup>168</sup>

Ndërsa Redder-i vë në dukje që semantika e lidhëzës *da* kushtëzohet më shumë nga lloji i tekstit, ku ajo gjendet, sesa nga funksioni komunikativ. Ajo (Redder-i) shkon me gjykimin e saj deri atje, sa i mohon elementit *da* statusin e lidhëzës shkakore. Për të *da* është një element me funksion deiktik.<sup>169</sup>

Ka dhe autorë si Thim Mabrey që pohon se funksioni komunikativ i *da*-së duhet të përforcohet nga pjesëza si: *ja, doch, bekanntlich* ,po, si jo, siç dihet‘. Madje janë këto elemente shtesë që e paraqesin informacionin e fjalisë së varur si të njohur:

Peter fährt *ja* mit dem Bus, *da* er kein Auto hat. ‚Petri udhëton me autobus, meqë nuk ka makinë<sup>170</sup>.

B. Schmidhauser-i, që është marrë gjerësisht me trajtimin e kauzalitetit dhe shprehjes gjuhësore të tij, mbron mendimin se lidhëza *da* do të përdoret kur shkak ose argumenti i dhënë në pjesën e varur të fjalisë shkakore është i njohur<sup>171</sup>: Me thënien „shkaku, argumenti është i njohur“ do të kuptojmë: shkaku është i vetkuptueshëm, i njohur nga të gjithë:

Denn sie war der Meinung, dass Knaben nie fähig sein würden, das zu erlernen, *da* sie sich zu langsam und ungeschickt bewegten. ‚Se ajo ishte e mendimit që djemtë nuk do të ishin kurrë të aftë ta mësonin këtë profesion , meqë ata ishin të ngadaltë dhe të ngathët‘.

---

<sup>165</sup> Shih më tej, Engel, U., *Deutsche Grammatik*, München, Judicum, 2004, f. 401.

<sup>166</sup> Rudolf, E., „Zur Problematik der Konnektive des kausalen Bereichs“, botuar në, *Grundelemente der semantischen Struktur von Texten. I. Konnektivausdrücke, Konnektiveinheiten*, Hamburg, 1982/1, f. 183.

<sup>167</sup> Engel, U., *Deutsche Grammatik*, München, Judicum, 2004, f. 286.

<sup>168</sup> Hösselbarth, L., „Äquivalenzbedingte Anforderungen an der Konfrontation kausaler Konnektive“, botuar në, *Zeitschrift für Phonetik, Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung* 43/5. Berlin, 1990, f. 715.

<sup>169</sup> Redder, A., *Grammatiktheorie und sprachliche Handlung: ‚denn‘ und ‚da‘*. Tübingen, 1990, f. 136, f. 264.

<sup>170</sup> Thim-Mabrey, Ch., „Zur Syntax der kausalen Konjunktionen weil, da und denn“, *Sprachwissenschaft* 7, 1982, f. 197-219, këtu, f. 203. f. 155.

Lidhëza *da* përdoret në këtë rast se *ngadalësia dhe ngathtësia* e djemve shihen si veçori të njohura e të pranuar. Vërtetësia e shkakut mund të rrokët nga shqisat:

Doch *da* er keinen Frack anhatte, wollte man ihn hindern, den Sitz einzunehmen. ‚Po *meqë* nuk kishte veshur frak, donin ta pengonin të ulej në atë vend.‘

... da rief sie ‚lass mich in Ruhe‘, aber er verstand sie nicht, *da* sie auf italienisch rief... ‚Dhe thirri ajo ‚më lër rehat‘, por ai nuk e kuptoi, *meqë* ajo foli italisht‘.

Në këto dy shembujt e fundit përdorimi i *da*-së (*meqë*) lidhet me dy shkaqe të shprehura gjuhësisht, përmbajtja e të cilave rrokët me sy: ‘nuk kishte veshur frak’, ose me veshë: ‘foli italisht’.

Përsa i përket vendit të pjesës së varur ndaj asaj kryesore në fjalinë shkakore, ajo mund të qëndrojë para ose pas pjesës kryesore:

Da wir nicht zahlen können, müssen wir die Bedingungen akzeptieren. ‚*Meqë* ne nuk mund të paguajmë, duhet t’i pranojmë kushtet.‘

Edhe rendi i kundërt është i mundshëm:

Wir gingen nicht spazieren, da es regnete. ‚Ne nuk shkuam të shëtisnim, *ngaqë* binte shi.‘

### V.2.5.3 Lidhëza *zumal*

Në pikëpamje semantike *zumal* (aq më tepër/ për më tepër) sinjalizon një shkak krejt special. Buscha shkruan për këtë: ‚Në një kontekst me *zumal* jepet një shkak dytësor, krahas një shkakut parësor të pashprehur gjuhësisht. Shkakut dytësor është vendimtar:

Aus dem Ausflug wird nichts, *zumal* der Bus kaputt ist. ‚Ekskursioni nuk do të bëhet, *për më tepër* autobusi është i prishur‘

Shkakut primar nuk është shprehur, shkakut sekondar – po: prishja e autobusit.

### V.2.5.4 Lista e lidhëzave shkakore në gjermanisht

Lista përmban krahas lidhëzave të pastra, të mirëfillta shkakore edhe ato ku kuptimi i shkakut përzihet me kuptime të tjera, ose kuptimi shkakor manifestohet vetëm në përdorime të caktuara:

- *als* (kur): kohore, shkakore (kur përdoret në bashkëvajtje me korrelatin umso ...në fjalinë kryesore)
- *auf dass* (që, me qëllim që): shkakore, qëllimore: Helft den Anderen, *auf dass* auch euch geholfen werde. Ndhmoni të tjerët *që* edhe juve të ndihmoheni. Kjo shprehje lidhëzore është vjetëruar tashmë.
- *da* (*meqë*): shkakore
- *indem* (ndërsa): shkakore/ instrumentale

- (*in*)*sofern* (*als*), (*in*)*soweit* (*als*) (gjersa, për aq sa): shkakore, kushtore: *Sofern* Sie den Plan für realiesbar halten, können Sie doch unterschreiben. ‚Përderisa e shikoni /mbani planin si të realizueshëm, pra mund të nënshkruani.‘
- *Nachdem* der Termin verschoben ist, sagen wir die Teilname ab. ‚Përderisa është shtyrë afati, ne nuk do të marrim pjesë.‘
- *ob ... ob* (... a ... , ... apo ... ): shkakore, lejore. Si shkakore del në përdorime të tilla:  
Der Vorsitzende, ob krank, *ob* nur enttäuscht, gibt mir zu denken. ‚Kryetari, i sëmurë apo i zhgënjyer, nuk më duket mirë.‘
- *sowenig* (edhe pse): shkakore, lejore:  
Sie ist sehr wichtig für uns, *sowenig* sie auch vom Geschäft versteht. ‚Ajo është shumë e rëndësishme për ne, *edhe pse* kupton pak nga kjo punë.‘
- *trotzdem* (megjithëse): shkakore, lejore:  
*Trotzdem* wir Ihnen nicht völlig zustimmen, verzichten wir auf eine weitere Verhandlung. ‚*Megjithëse* nuk jemi plotësisht dakord me ju, heqim dorë nga bisedime të mëtejshme.‘
- *um ... zu* (për të ...): shkakore, qëllimore:  
Er fuhr nach Karlsruhe, *um* mit Simon *zu* sprechen. ‚Ai shkoi në Karlsruhe për të folur me Simonin.‘
- *ungeachtet* (megjithëse): shkakore, lejore:  
*Ungeachtet* Paul wieder zu spät kam, machte Anton keine Bemerkung. ‚*Megjithëse* Pauli erdhi përsëri me vonesë, Antoni nuk i bëri vërejtje.‘
- *weil* (sepse): shkakore
- *wenn* (nëse): shkakore, kushtore: *Wenn* er jetzt zustimmt, schaffen wir es. ‚*Nëse* ai tani pranon, ne do t’ia dalim mbanë.‘
- *zumal* (për më tepër që): shkakore
- *wo* (se): shkakore : Wir müssen sparen, *wo* die Inspektion doch so teuer war. ‚Ne duhet të kursejmë se kontrolli ishte aq i shtrenjtë.‘

### V.2.6 Parafjalët që përdoren si mjete lidhëse me kuptim shkakor

Ndryshe nga lidhëzat shkakore që paraprinë fjali ose pjesë fjalish, parafjalët formojnë sintagma me elementet që shoqërojnë. Fjalitë shkakore mund të transformohen në grupe parafjalore me kuptim shkakor. Këtë dukuri Pusch-i e quan emërzim të predikatit të fjalisë shkakore.<sup>172</sup> Por jo të gjitha pjesët e varura të fjalisë shkakore mund të kthehen në grupe parafjalore (parafjalë + emër). Ka raste që kjo është e pamundur: Ja disa raste të tilla:

- Në disa ndërtime mohuese: weil niemand weiss, dass ... ,sepse askush nuk e di se...‘ → wegen Nichtwissens (?) ‚për shkak të mosdijes‘ (Në gjermanisht togu wegen Nichtwissens nuk është korrekt.)
- Në disa ndërtime të patransformueshme të tipit: weil er besser nicht anwesend wäre ,sepse ai më mirë të mos ishte i pranishëm‘.
- Në ndërtime krahasuese: weil sie herausfordender wirkt als ihre Kolleginnen ,sepse ajo duket më sfiduese nga koleget e saj.‘

---

<sup>172</sup> Pusch, L., *Substantivierung von Verben mit Satzkomplementen im englischen und im deutschen*, Frankfurt, Athenäum, 1988, f. 151.

### V.2.6.1 Parafjalët *aus* (për/ nga)/ *vor* (prej/nga)

Në gramatikën Duden dhe te Helbig-u/Buscha këto dy fjalë emërtohen si parafjalë paralele shkakore.<sup>173</sup> Në Duden nuk jepet hollësisht dallimi midis tyre. Ndërsa Helbig-u/ Buscha, duke u nisur nga semantika e pjesës kryesore dhe e pjesës së varur të fjalisë shkakore, bëjnë përshkrimin e veçorive dhe dallimeve midis parafjalëve *vor/aus*.

„ Parafjala *aus* me kuptim shkakor qëndron para një emri që shënon një ndjenjë që shërben si motivim për një veprim të ndërgjegjshëm dhe të planifikuar. *Vor* në kuptim shkakor qëndron para një emri, ndikimi objektiv i të cilit shprehet në folje“<sup>174</sup>

Kështu, dy parafjalët *aus/ vor* ndryshojnë shumë njëra nga tjetra. Në pikëpamje sintaksore ato nuk mund të dalin njëra për tjetrën. Në ato rrethina që shfaqet njëra, nuk shfaqet tjetra:

Er heiratete sie aus Mitleid. ‚Ai u martua me të për mëshirë.‘ Er heiratet sie vor Mitleid.(?) Ndërtimi me parafjalën *vor* nuk është i mundshëm.

Ose: Ich könnte dich fressen vor Liebe. ‚Unë do të të kisha përpirë ty nga dashuria.‘ Ich könnte dich fressen aus Liebe. (?) (Formulim jokorrekt gramatikor).

### V.2.6.2 Parafjala *wegen* (për shkak/ nga shkak)

Kjo parafjalë (ose prapafjalë) shënon shkak në mënyrë të përgjithshme, pa e lidhur me një kohë të caktuar:

*Wegen* des schlechten Wetters wurde der Start verschoben. ‚Për shkak të kohës së keqe nisja u shty.‘

Ndryshe nga sintagmat me *aus*, ku jepen shprehimisht (eksplicit) si shkak dhe shkaktari (aus Liebe zum Bruder ‚nga dashuria për vëllanë‘) në sintagmat me *wegen* nuk është e domosdoshme të jepen eksplicit tërë gjymtyrët e një sintagme me kuptim shkakor. Kjo bën që *wegen* të ketë një strukturë semantike të gjerë.

Po të krahasojmë ndërtimet me *weil* me ato që përmbajnë *wegen* do të thonim: në ndërtimet me *weil* (sepse) jepet shkak real konkret, ndërsa në ndërtimet me *wegen* jepet shkak në mënyrë të përgjithshme.

*Wegen* Peter mussten wir eine Stunde warten. ‚Për shkak të Petrit na duhej të prisnim një orë.‘

Kjo thënie mund të ndërtohej dhe ndryshe duke përdorur lidhëzën *weil* :

*Weil* Peter mit Verspätung kam, mussten wir eine Stunde warten. ‚Sepse Petri erdhi me vonesë, na duhej të prisnim një orë.‘

---

<sup>173</sup> Shih, *Duden Grammatik, Band 4*, botuar nga, G. Drosdowski et al., Mannheim/Wien/Zürich, Bibliografisches Institut, 1984, § 631; Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Leipzig, 1984.

<sup>174</sup> Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Leipzig, 1984, f. 419.

Sintagmat me *wegen* kanë përparësinë e mungesës së një lidhjeje të drejtpërdrejtë. Me anë të tyre mund të shmangen justifikimet e padëshiruara:

Der Junge macht seine Hausaufgaben so gut, *wegen* des Vaters. ‚Djali i bën detyrat kaq mirë, për shkak të të atit.‘

Nga kjo thënie nuk del qartë nëse djali i bën detyrat mirë për t’i bërë qejfin babait, apo ka frikë nga babai.

*Wegen* mund të qëndrojë edhe pas fjalës me të cilën formon një sintagmë:

Er wollte sich seiner Eltern *wegen* kirchlich trauen lassen, was sie nicht wollte, ihrer Eltern *wegen*. ‚Për shkak të prindërve ai donte të vinte kurorë në kishë, gjë që ajo nuk e donte po për shkak të prindërve.‘

Në gjuhën gjermane përdorimi i kësaj parafjale është i lidhur me probleme të rasës që ajo drejton (dhanore ose gjinore). Lidhur me përdorimin e parafjalëve që mund të drejtojnë dy rase vlen rregulli:

- Përdoret rase dhanore nëse në fjali gjenden njëri pranë tjetrit dy emra në gjinore, numri njëjës: *Trotz dem Rat des Vaters* ging der Junge raus. ‚Megjithë këshillën e babait, djali doli jashtë.‘
- Në fjalitë, ku forma e gjinore, shumës, nuk dallohet prej emërores dhe kallëzores: *Die Astronauten schützen sich mittels Spezialanzügen* gegen kosmische Strahlen. ‚Astronautët mbrohën nga rrezet kozmike me anë të kostumeve speciale.‘

Edhe pse parafjala *mittels* (me anë) kërkon rasën gjinore emri që e shoqëron, për arsytet e mësipërme, është në rasën dhanore.

Të dyja këto rregulla vlejné edhe për përdorimin e gjinore pas parafjalës *wegen*, ndërsa kur parafjala është e pasvendosur drejton vetëm rasën gjinore.<sup>175</sup>

### V.2.6.3 Parafjala *aufgrund* (në bazë)

Kjo parafjalë përdoret zakonisht në gjuhën e shkencës, të administratës, të biznesit :

*Aufgrund* von Untersuchungen kam man zu neuen Ergebnissen in der Mikroelektronik. ‚Në bazë të studimeve janë arritur rezultate të reja në mikroelektronikë.‘

Në këtë shembull parafjala *aufgrund* nuk përdoret në funksion argumentues, por më tepër në funksion mbështetës të asaj që thuhet në pjesën tjetër të fjalisë. Prandaj ajo nuk mund të zëvendësohet nga *wegen*. Në raste të tilla, ku parafjala *aufgrund* (në bazë) nuk përdoret me funksion argumentues, ajo mund të dalë dhe krahas parafjalës *wegen* (për shkak):

Ein Gericht kann einen Angeklagten selbst *wegen* eines Tötungsverbrechens nur *aufgrund* von Beweisen, aber nicht *aufgrund* von Indizien verurteilen. ‚Një të akuzuar qoftë edhe për shkak vrasjeje procesi gjyqësor mund ta dënojë në

---

<sup>175</sup> Shih, Forstreuter, E /Egerer-Möslein, K., *Die Präpositionen*, 2., unv. Auflage Leipzig, 1980, f. 15.

*bazë të provave konkrete dhe jo në bazë të dëshmive të tërthorta.*<sup>4</sup>

Në shumicën e rasteve kjo parafjalë mund të zëvendësohet me *wegen*, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për *wegen* (për shkak). Parafjala *aufgrund* mund të pasohet nga një emër pa nyjë, veç në këtë rast duhet të përdoret parafjala *von* para emrit (ku nuk shfaqet nyja): *Aufgrund von Untersuchungen ...* (në bazë të studimeve...)

### V.2.6.4 Parafjalët *dank* dhe *mangels* (falë dhe për mungesë)

Parafjala *dank* (falë) mund të qëndrojë para emrave (ose përemrave) që shënojnë persona: *dank dir* (falë teje). Në grupe parafjalore elementi *dank* përdoret në rastet kur folja e fjalisë shënon veprime a gjendje si arsyttime pozitive mbi përmbajtjen e fjalisë në përgjithësi:

*Dank dem schräg einfallenden Licht erhielt das Foto seine besondere Schönheit.* ,Falë dritës që binte shtremër fotografia merrte një bukuri të veçantë.

Parafjala *dank* kërkon, zakonisht, rasën dhanore, por ka dhe raste të përdorimit të saj në bashkëvjajtje me rasën gjinore:

*Dank dem schnellen Eingreifen/ des schnellen Eingreifens der Feuerwehr war der Schaden gering.* ,Falë ndërhyrjes së shpejtë të zjarrfikësit dëmet ishin të vogla.

Para një mbiemri, një paskajoreje të emëruar, parafjala *dank* (falë) mund të dalë dhe si drejtuese e rasës gjinore, si në shembullin e mësipërm. Edhe parafjala *mangels* (në mungesë) mund të drejtojë rasën gjinore ose dhanore:

*Mangels finanzieller Unterstützung konnte die Expedition nicht durchgeführt werden.* ,Për mungesë të mbështetjes financiare dërgimi nuk u realizua<sup>176</sup>.

### V.2.6.5 Parafjalët e pasvendosura

Është fjala për disa fjalë që kryejnë në fakt funksionin lidhës të parafjalëve, por vendosen prapa fjalës që lidhet kështu me elemente të tjera të fjalisë. Fjalët, të cilave u bashkangjiten këto parafjalë, janë emra ose fjalë të tjera të emëruara. Një parafjalë e tillë është *halber* (për hir të /për shkak). Ajo mund të qëndrojë pas fjalësh si: *Form, Ordnung, Deutlichkeit, Bequemlichkeit* etj. ,formë, rregull, qartësi, komoditet etj.:

Besonderer Umstände *halber* musste er seinen Wagen verkaufen. ,Për shkak të rrethanave të veçanta ai duhet ta shiste makinën.

Elementi *halber* mund të shërbejë dhe si prapashtesë ndajfoljore. Duke ia prapavendosur këtë element një teme emërore formohet një ndajfolje:

---

<sup>176</sup> Shih më tej, Engel, U., *Deutsche Grammatik*, München, Judicium, 2004, f. 388.



*ordnungshalber, gesundheitshalber, sicherheitshalber* etj. ( për hir të rregullit, për shkak të shëndetit, për shkak të sigurisë etj.)<sup>177</sup>

Është vështirë të përcaktohet fusha semantike e emrave që lidhen me halber. Por mund të thuhet që fushat tematike që lidhen me sëmundjet dhe me nocionin „vështirësi“ përfaqësohen shpesh në ndërtime të tilla. Fjalë si *umständehalber* (për shkak të rrethanave) kanë një ngjyrim të zbehtë shkakor. Ndërsa formimi *übungshalber* (si ushtrim) nuk ka fare kuptim shkakor ose argumentues.<sup>178</sup>

### V.2.6.5.1 Parafjala *zuliebe* (për hir/ për hatrin)

Shpesh kjo parafjalë është e lidhur me fjalë që shënojnë persona: Ich lade ihn nur dir *zuliebe* ein. ‚Po e ftoj atë vetëm për hatrin tënd.‘

Rrallë herë shfaqet pa u lidhur me fjalë që shënojnë persona: Der Wissenschaft *zuliebe* verzichtete er auf viele Stunden Freizeit. ‚Për hir të shkencës ai hiqte dorë nga shumë orë të lira.‘

### V.2.6.5.2 Parafjala *zufolge* (sipas/ si rrjedhim)

Kjo parafjalë referon indirekt në një shkas, dhe bashkë me fjalën emërore që shoqëron jep pasojën e diçkaje:

Seinem Wunsch *zufolge* wurde die Feier verschoben. ‚Sipas dëshirës së tij festa u shty.‘

Kjo parafjalë (postfjalë) nuk duhet të përdoret në bashkëlidhje me emërtime personash ose sendesh që nuk përbëjnë shkaqe.<sup>179</sup>

Edhe Heuer-i thekson se kjo parafjalë duhet të përdoret vetëm si kausale.<sup>180</sup> Ai citon: ‚Einer Meldung der Associated Press *zufolge*... (Sipas një njoftimi të Ass. Press...) Pastaj thotë se përdorimi i parafjalës *zufolge* në këtë rast është i gabuar, sepse nuk kemi të bëjmë me ndonjë pasojë. I drejtë do të ishte përdorimi i *nach* ose *laut* (sipas). Ndërsa Helbig-u/ Buscha mendojnë që kjo parafjalë krahas përdorimit shkakor ka dhe një përdorim modal. Këtë mendim e ilustron me shembullin:

Eine Pressemeldung *zufolge* ist der ausländische Gast eingetroffen. ‚Sipas një njoftimi të shtypit arriti miku i huaj.‘<sup>181</sup>

### V.2.6.6 Circumpositionen

Emërtohen kështu ato parafjalë që përbëhen nga dy pjesë. Njëra pjesë qëndron para emrit, tjetra pas tij. Një parafjalë e tillë është: *um ... willen* (për hir/ për shkak):

*Um* seiner Gesundheit *willen* hat er das Rauchen aufgegeben. ‚Për shkak të shëndetit ai e la duhanin.‘

---

<sup>177</sup> Shih, Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Leipzig, 1984, f. 428.

<sup>178</sup> Shih: *Das grosse Wörterbuch der deutschen Sprache, Bd. 6*, Mannheim/ Wien/ Zürich, 1976 – 1981.

<sup>179</sup> Shih, *Duden Grammatik, Band 4*, botuar nga, G. Drosdowski et al., Mannheim/Wien/Zürich, Bibliografisches Institut, 1984, § 629.

<sup>180</sup> Heuer, W., *Richtiges Deutsch*, Verlag NZZ, Zürich, 1985, § 1812.

<sup>181</sup> Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Leipzig, 1984, f. 443.

Kjo parafjalë drejton rasën gjinore. Helbig-u/ Buscha e quajnë parafjalë të përbërë.

### V.2.7 Përfundime

Raportet shkakore në gjermanisht mund të realizohen me këto mjete gjuhësore:

- Me folje kauzale

Këto folje e përmbajnë implicit idenë e shkakut: mpreh thikën = bëj që thika të jetë e mprehtë dhe të presë mirë; rris djaln = bëj që djali të marrë gjithçka i duhet trupërisht e shpirtërisht për t'u zhvilluar më tej etj. Folje kauzative në gjuhën gjermane janë: zeigen, ändern, befreien, beleben, präsentieren etj.(tregoj, ndryshoj, çliroj, gjallëroj, paraqes etj.). Klasa e foljeve është pothuaj identike në shqip e në gjermanisht. Në rastet e foljeve kauzative subjekti i fjalisë duhet të jetë njëkohësisht veprues (agjent). Ky subjekt veprues bën diçka në mënyrë aktive, kryen një veprim.<sup>182</sup>

- Me lidhëza shkakore.

Të tilla janë në gjuhën gjermane: *denn, weil, da, zumal* etj. Në rastin e shprehjes së lidhjeve shkakore ndodh shpesh që midis fjalisë së varur dhe asaj drejtuese të ekzistojë një lidhje ontologjike, domethënë shkak i dhënë është real. Në raste të tilla lidhëza më e përshtatshme është *weil*. Kjo është lidhëza më e përdorshme në gjuhën gjermane. Ajo ka një spektër të gjerë përdorimi. Është interesant fakti që kjo lidhëz përdoret dhe si bashkërenditëse. Ky përdorim ka filluar në gjuhën e folur dhe tani ka filluar të shtrihet dhe në gjuhën e shkruar. Lidhëza *weil* përdoret si bashkërenditëse në ato raste ku do të përdorej normalisht lidhëza shkakore bashkërenditëse *denn*. Një veçori tjetër e lidhëzës *weil* është se ajo është i vetmi element i fushës kauzale që mund të vendoset drejtpërsëdrejti pranë një emri. Në këtë rast lidhëza merr një lloj vlere atributive:

Eine Beförderung, *weil* du der Chefin gefällst, ist ausgeschlossen. ,Një ngritje në përgjegjësi, sepse ti i pëlqen shefes, është i pamundur.‘

Ndërtime të tilla janë, gjithsesi, të rralla, ato përmbajnë gjithnjë emra veprimi. Lidhëza *weil* është gjithashtu e vetmja në llojin e vet që mund të lidhet me një mbiemër.<sup>183</sup>

Në pikëpamje semantike lidhëza *weil* (sepse) mund të përdoret në fjali shkakore, në pjesën e varur që shpreh: a) një argumentim, arsyetim në formë supozimi. Në raste të tilla në pjesën kryesore përdoret pjesëza *vielleicht* (ndoshta), b) një arsye, një shkak që evidentohet në mënyrë të veçantë. Në raste të tilla pjesa kryesore përmban fjalë si *gerade, besonders, eben* (tamam, veçanërisht, pikërisht).

Por lidhëza *weil* (sepse) mund të shprehë një shkak në mënyrë të theksuar edhe pa u mbështetur semantikisht nga elemente përforcuese.

Në pikëpamje pragmatike-komunikative marrëdhëniet shkakore të realizuara me lidhëzën *weil* paraqiten të tilla: pasoja është e njohur për marrësin, por shkak – jo. Prandaj në raste të tilla mund të pyesim për shkakun me anë të pyetjes *warum* ,pse‘ . Kjo gjë është e pamundur në ndërtimet me lidhëzën *denn* (se).

---

<sup>182</sup> Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Leipzig, 1984, f. 68, 78.

<sup>183</sup> Shembuj shih në paragrafin përkatës.

Pjesa e varur shkakore që paraprihet nga lidhëza *weil* mund të vendoset para pjesës kryesore, pas saj ose në mes. Në pjesën kryesore mund të vendoset ose jo një korrelat (*deshalb, darum* etj.).

Lidhëza *da* (meqë) këmbëhet shpesh me *weil*. Por kjo lidhëz ndryshon semantikisht nga *weil* (se/ sepse). Pjesa e varur shkakore që paraprihet nga ajo shpreh një shkak të njohur, të pranuar, të përgjithshëm. Në pjesën kryesore nuk mund të vendoset asnjëherë ndonjë korrelat. Në pikëpamje sintaksore *da* (meqë) ngjet me *weil*. Të dyja janë lidhëza nënrenditëse; në pikëpamje semantike ajo ngjet me *denn* (se). Pjesa e varur e fjalisë shkakore që fillon me lidhëzën *da* përmban informacion të njohur, për folësin e lexuesin/ dëgjuesin, i takon temës dhe jo remës. Me informacion të njohur do të kuptojmë: a) shkakun është i vetëkuptueshëm, i pranuar nga të gjithë; b) vërtetësia e shkakut mund të rroket nga shqisat. (Në trajtimin mësipër të kësaj dukurie janë dhënë dhe shembuj për këtë.)

Lidhëza shkakore *denn* është bashkërenditëse, si e tillë ajo mund të lidhë vetëm fjali të pavarura ose kryesore. Për këtë arsye mund të thuhet që në pikëpamje sintaksore kjo lidhëz është tepër e kufizuar. Fjalitë e lidhura me *denn* (se) kanë një rend të ngulitur. Fjalitë që shpreh pasojën qëndron përpara asaj që shpreh shkakun. Fjalitë që paraprihet nga lidhëza *denn* (se) mund të shënojnë një shkak real për përmbajtjen e fjalisë tjetër të bashkërenditur. Në këtë kuptim ajo është identike me *weil*, me të cilën ndërkëmbëhet shpesh. Por fjalitë me *denn* (se) mund të shërbejnë dhe si argumentuese për fjalinë me të cilën lidhet:

Die Katze miaut, *denn* sie hat Hunger. ,Macja mjaullin, se ka uri.‘

Në këtë shembull fjalitë që përmban *denn* (se) nuk jep ndonjë shpjegim shkakor, por shpreh një simptomë, ka një përdorim simptomatik.

Në pikëpamje pragmatike lidhëza *denn* (se) lidh dy fjali përmbajtja e të cilave, sipas mendimit të folësit, është informacion i ri për dëgjuesin. Nëse folësi do të mendonte se njëra nga përmbajtjet e pjesëve të fjalisë shkakore është e njohur për folësin, atëherë ai nuk mund ta shprehë mendimin duke përdorur lidhëzën *denn*, por duhet të zgjedhë midis *weil* (sepse), *da* (meqë).

Lidhëza bashkërenditëse *denn* ka, zakonisht, kuptim sqarues, argumentues. Edhe në rastet, kur ajo mund të zëvendësohet me *weil* (sepse), nuk e ka kuptimin e theksuar shkakor të kësaj të fundit. Ndërtimet me *denn* nuk shprehin shkaqe të pastra, të forta, por më shumë japin shpjegime, argumentime.

- Me lidhëza kohore me ngjyrim/ përdorim shkakor

Është fjala për një grup lidhëzash kohore *nachdem, solange, sobald*, pasi, përderisa/ gjersa, sapo. Jo në çdo përdorim të tyre lidhëzat në fjalë manifestojnë domethënie shkakore. Shpesh kuptimi shkakor shfaqet në rastet kur fjalitë e paraprirë nga lidhëzat e mësipërme kombinohet me një fjali që shpreh hamendje, supozim, pretendim, parashikim, njoftim, kërkesë. Kuptimi shkakor mund të shfaqet dhe në rastin kur në pjesën kryesore folja nuk shpreh ndodhi/ veprim, por gjendje:

*Nachdem* Maria angerufen hatte, war Hans glücklich. ,Pasi telefonoi Maria, Hansi u lumturua.‘

Folja e pjesës kryesore u lumturua shënon një gjendje, një ndjenjë. Në një rast tjetër „Pasi telefonoi Maria, Hansi doli në pazar“ përjashtohet çdo mundësi interpretimi shkakor i ndërtimit „Pasi telefonoi Maria“.

Lidhëza kohore *nachdem* fiton vlerë shkakore dhe në fjalitë ku pjesa e varur, e paraprirë nga *nachdem* kombinohet me pjesën kryesore, folja e së cilës shënon mohimin e një veprimi :

*Nachdem* er diese Nachricht bekommen hat, schrieb er an Anna nicht mehr.  
,Pasi mori këtë lajm, ai nuk i shkroi më Anës.‘

Mohimi i një veprimi nuk është më veprim, por gjendje. Çka thamë për përdorimin e lidhëzës kohore *nachdem* (pasi) me vlerë shkakore vlen dhe për dy lidhëzat e tjera *solange, sobald* ( gjersa, sapo).

Lidhëza kohore *sobald* (sapo) e përmban ngjyrimin shkakor në kuptimin e saj, në mënyrë implicite dhe jo të kushtëzuar nga konteksti.

### - Me ndajfolje lidhore

Ato kryejnë funksionin e lidhëzave dhe kanë vlerën e ndajfoljeve. Lidhin pjesë fjalish (ose fjalinë e varur me atë drejtuese) shkakore dhe , njëkohësisht, janë gjymtyrë fjalie. Të tilla janë *deswegen, darum, deshalb, daher* (prandaj, për këtë arsye, për këtë, prandaj/për këtë). Si mjet lidhor ndajfoljet realizojnë lidhje bashkërenditëse, janë mjete semantike-referuese. Ato referojnë në drejtim paravajtës ose pasvajtës. Referimi më i zakonshëm është ai anaforik, pasvajtës. Kjo do të thotë që ndajfoljet lidhore referojnë zakonisht në përmbajtjen e fjalisë paraardhëse:

Meine Mutter schlägt mich! *Deswegen/ deshalb* habe ich oft Kopfschmerzen.  
,Nëna më rreh! *Prandaj* unë kam shpesh dhembje koke.‘

Ndajfolja *deswegen* (prandaj) referon ose rimerr përmbajtjen e fjalisë *meine Mutter schlägt mich* (nëna më rreh).

Si në përdorimin anaforik dhe në atë kataforik, fjalia me ndajfoljen lidhore nuk duhet të vendoset shumë larg fjalisë së cilës i referohet, se vështirësohet të kuptuarit. Në një fjali që përmban një ndajfolje lidhore-shkakore nuk mund të përdorim elemente të tjera me kuptim ose vlerë shkakore.

### - Me ndajfolje pyetëse

Ndajfoljet pyetëse shkakore përdoren për të pyetur për shkakun a motivin. Ato vendosen detyrimisht në fillim të fjalisë. Çdo ndajfolje pyetëse ka përgjegjësen e saj jopyetëse: *deshalb – weshalb, deswegen – weswegen* (prandaj – pse, për këtë – pse).

Në pikëpamje pragmatike fjalitë pyetëse të drejta dallohen nga ato pyetëse të zhdrejta se në to pyetet direkt dhe qëllimshëm për të mësuar shkakun. Kjo nuk ndodh në fjalitë pyetëse të zhdrejta.

### - Me parafjalë

Grupi i parafjalëve që përdoren si mjete lidhëse me kuptim shkakor është realativisht i madh. Ato janë:

*aus/ vor* (për/nga – prej/nga): edhe pse në shumë vepra kodifikuese të gjuhës standarde gjermane nuk bëhet dallimi kuptimor midis këtyre dy parafjalëve (si parafjalë me kuptim shkakor), ato janë të dallueshme në kuptim e në përdorim. Në pikëpamje sintaksore ato nuk mund të dalin për njëra- tjetrën. Parafjala *aus* qëndron para një emri që shënon një ndjenjë që shërben si motivim: *aus Mitleid* (për mëshirë) etj. *Vor* me kuptim shkakor qëndron para një emri, ndikimi i të cilit shprehet në foljen e fjalisë: *Ich könnte dich fressen vor Liebe.* ,Do të të kisha ngrënë nga dashuria.

*wegen* (për shkak/ nga shkak) shënon shkak në mënyrë të përgjithshme. Ndërsa në ndërtimet me *weil* jepet shkak real, konkret, në ndërtimet me *wegen* jepet shkak në mënyrë të përgjithshme:

*Wegen* Peter mussten wir eine Stunde warten. ,Për shkak të Petrit duhej të prisnim një orë‘

*Weil* Peter mit Verspätung kam, mussten wir eine Stunde warten. ,Meqë Petri erdhi me vonesë, duhej të prisnim një orë.‘

Zakonisht parafjala qëndron para fjalës me të cilën formon një sintagmë, por mund të qëndrojë dhe pas: Eltern *wegen* (për shkak të prindërve).

Kjo parafjalë drejton zakonisht rasën gjinore, por del në rasën dhanore kur në fjali gjenden njëri pas tjetrit dy emra në gjinore, numri njëjës.

*aufgrund* ( në bazë) përdoret zakonisht në stilin shkencor, administrativ, në gjuhën e biznesit. Në shumicën e përdorimeve ajo mund të zëvendësohet nga *wegen*. Por kur përdoret në shprehje argumentuese nuk mund të zëvendësohet nga *wegen*: *aufgrund* von Untersuchungen dhe jo *wegen* Untersuchungen. Në funksion shkakor, jo argumentues ajo mund të dalë dhe krahas parafjalës *wegen* (shembuj – në paragrafin përkatës).

*dank dhe mangels* (falë dhe për mungesë). Parafjala *dank* qëndron zakonisht para emrave ose përemrave që shënojnë persona: *dank dir* (falë teje). Ajo drejton zakonisht rasën dhanore, por ka dhe raste të përdorimit të saj me rasën gjinore: *dank dem schnellen Eingreifen* (falë ndërhyrjes së shpejtë).

Edhe parafjala *mangels* (për mungesë) mund të drejtojë rasën gjinore ose dhanore.

Gjuha gjermane zotëron dhe disa fjalë që kryejnë funksionin e parafjalëve, por vendosen prapa fjalës me të cilën formojnë një sintagmë. Këto mund të quheshin dhe pasfjalë. Të tilla janë:

*halber* (për hir të/ për shkak). Ajo vendoset pas fjalëve si: Form, Ordnung, Deutlichkeit etj.( formë, rregull, qartësi etj.).<sup>184</sup>

*zuliebe*: (për hir/ për hatrin). Shpesh kjo parafjalë është e lidhur me fjalë që shënojnë persona: *dir zuliebe* ,për hatrin tënd‘.

*zufolge* (sipas/ si rrjedhim). Kjo parafjalë përdoret zakonisht si kauzale. Por Helbig-u/ Buscha flasin dhe për një përdorim modal të saj.

Parafjalët dygjymtyrëshe përbëhen nga dy pjesë; njëra pjesë qëndron para emrit, tjetra pas tij: *um seiner Gesundheit willen* (për shkak të shëndetit). Drejton rasën gjinore.

---

<sup>184</sup> Shembuj shih më lart.

**Kreu VI Një ballafaqim i mjeteve kryesore lidhore shkakore në shqip e në gjermanisht**

Ky ballafaqim do të bëhet me anë tabelash dhe me anë shënimesh të shkurtra. Do të ballafaqojmë këto mjete lidhëse shkakore: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat. Listat tona do të paraqesin mjetet më të rëndësishme nga klasat e përmendura. Një ballafaqim i tillë ka rëndësi teorike, por më tepër praktike. Çdo tabelë përmban tri kolona. Në kolonën majtas jepet mjete lidhës në gjuhën shqipe. Në kolonën e mesit jepet mjete përgjegjës në gjermanisht, në kolonën djathtas jepen shënime të shkurtra rreth ndonjë veçorie të spikatur ose të pa përmendur më parë. Jemi përpjekur të qëmtojmë dhe të paraqesim mjetet përgjegjëse të përshtatshme në gjuhën gjermane. Raporti midis elementit në gjuhën shqipe e atij në gjuhën gjermane nuk është gjithnjë 1:1. Ndosht shpesh që një elementi në gjuhën shqipe i përgjigjen disa në gjuhën gjermane, si në rastin e ndajfoljeve lidhore. Ndosht dhe e kundërta: shqipja zotëron një numër më të madh lidhëzash nënrenditëse shkakore se gjermanishtja. Edhe sinonimia brenda klasave është e ndryshme; kjo vihet re p.sh. në klasën e lidhëzave kohore me vlerë shkakore. Për të dhënë të njëjtën lidhëz të shqipes në gjermanisht përdoren disa variante: përderisa → insoweit, insofern, weil, da; derisa → bis, weil, da

*Lidhëzat shkakore*

Shqip	Gjermanisht	Shënime
se →	denn, weil	Lidhëza <i>se</i> në shqip mund të përdoret dhe si lidhëzë bashkërenditëse. Lidhëza <i>denn</i> në gjermanisht është lidhëz bashkërenditëse.
sepse → që →	da, weil dass, weil	Lidhëza <i>që</i> e shqipes përmban të gërshtuara ngjyrimet kundrinore dhe shkakore. Ka raste që ngjyrimet shkakore mbizotërojnë.
pse → ngaqë → meqë → aq më tepër (që) →	weil, da weil, da da, weil zumal	Fjala përgjegjëse në gjuhën shqipe e lidhëzës <i>zumal</i> është një lokucion lidhor aq më tepër (që)

*Vërejtje*

Është me rëndësi të vihet në dukje edhe shenjimi (markimi) specifik shkakor i lidhëzave nënrenditëse shkakore. Lidhëza të tilla janë në gjermanisht *zumal/ zumal da*. Këto lidhëza përmbajnë në semantikën e tyre një lloj shtese kuptimore. Ato referojnë jo te një shkak çfarëdo, por te shkakun kryesor midis disa shkaqeve të pranishme.

## Një ballafaqim i mjeteve kryesore lidhore shkakore në shqip dhe në gjermanisht

### *Lidhëzat nënrenditëse kohore me vlerë shkakore*

Shqip	Gjermanisht	Shënime
derisa →	solange bis, weil, da	
kur →	als, wenn, wann, indem	
pasi →	wenn, nachdem, da, weil	Lidhëza nachdem me kuptim shkakor përdoret sot shumë rrallë në gjermanisht. Në këto lidhëza kuptimi kohor është gjithashtu i pranishëm, ngjarjet pasojnë njëra – tjetrën në kohë: Si shkuan vjetët, erdhën mendtë. ‚Nachdem die Jahre vergingen, kam der Verstand.‘ <sup>185</sup>
përderisa →	insoweit, insofern, weil, da	
posa →	sobald, kaum dass	
posaqë →	sobald	
sa →	sobald, als, wenn	
sapo →	sobald, kaum dass	
tek →	gerade als	
kurse →	während	

Lidhëzat kohore përdoren me vlerë shkakore kur folja në pjesën kryesore shënon ndjenjë, supozim, hamendje, është në kohën e ardhme, shënon mohimin e një veprimi etj.

Nuk duhet ta kishte marrë letrën time, përderisa nuk më shkroi.

### *Shprehje lidhëzore me kuptim shkakor (grup parafjalor + lidhëz)*

Shqip	Gjermanisht	Shënime
nga puna se/që → nga shkakun se për shkak se për arsye se	aus dem Grunde, dass	Në përkthimin e shprehjeve lidhëzore të gjuhës shqipe mund të përdoret në vend të aus dem Grund, dass → aus dem Grund, weil

### *Vërejtje*

Siç duket dhe nga tabelat e mësipërme, numri i lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe është shumë i madh: se, pse, sepse, meqenëse, meqenëqë, poqë, meqë, ngaqë, po sa që. (Disa prej këtyre lidhëzave nuk figurojnë në tabelat e mësipërme.)

<sup>185</sup> Buchholz, O/Fiedler, W. i quan përdorime të tilla forma kalimtare. Shih, Buchholz, O/ Fiedler, W., *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, f. 519.

## Një ballafaqim i mjeteve kryesore lidhore shkakore në shqip dhe në gjermanisht

Grupit të lidhëzave shkakore të mirëfillta u shtohen dhe ato me origjinë kohore ose vendore: si, pasi, mbasi, sa, posa, sapo (që), kur, tek, kurse, derisa, përderisa, qysh se. Në gjuhën shqipe në pjesën kryesore të fjalisë shkakore që ndërtohet me anë të lidhëzave të sipërpërmendura nuk është i domosdoshëm përdorimi i fjalëve korrelative:

(*Prandaj*) nuk e mbaroi dot, *se* nuk kishte kohë.

Një grup të posaçëm në klasën e lidhëzave nënrenditëse shkakore të shqipes përbëjnë shprehjet lidhëzore të përbëra nga një grup parafjalor + një lidhëzë shkakore (që/se): për shkak se, për arsye se etj.

Numri i madh i lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe kanë si përgjegjëse në gjuhën gjermane një numër të kufizuar lidhëzash, kryesisht: *weil, da* (sepse) . Për të ilustruar këtë mendim po japim disa shembuj:

I donte, *se* ishin trima. ,Er mochte sie, *weil* sie mutig waren.‘

Ndiejmë një farë kënaqësie, *pse* do të mundim të çlodhemi pak. ,Wir spüren eine Art Zufriedenheit, *weil* wir uns ein wenig werden ausruhen können.

*Meqë* kishte punë, nuk erdhi.,*Weil* er zu tun hatte, kam er nicht.‘

Nuk u nis, *ngaqë* ishte i sëmurë. ,Er ging nicht weg, *weil* er krank war.

*Meqenëse* kërkohet, do ta bëjmë. ,*Da* es gefordert wird, werden wir es tun.‘

*Parafjalët që përdoren për shprehjen e marrëdhënieve shkakore*

Shqip	Gjermanisht	Shënime
falë (+ rrjedhore) →	dank/aufgrund (+ gjinore)	Në gjuhën shqipe pjesa më e madhe e parafjalëve me kuptim e funksion shkakor janë shprehje parafjalore.  Si në shqip dhe në gjermanisht këto parafjalë drejtojnë, në shumicën e rasteve, rasën gjinore
në sajë (+ gjinore) →	dank/aufgrund (+ gjinore)	
nga (+ emëror) →	durch/wegen (+kall./gjinore)	
nga shkak ( + gjinore) →	infolge/ wegen (+ gjinore)	
për (+ kallëzore) →	durch (+ kallëzore)	
për arsye (+ gjinore) →	wegen/ aufgrund (+ gjinore)	
për hir (+ gjinore) →	um ... willen (+ gjinore)	
për punë (+ gjinore) →	wegen (+ gjinore)	
për shkak (+ gjinore) →	wegen/ infolge (+ gjinore)	
prej (+ rrjedhore) →	aus/vor/ durch/ vom/an (+dhan./dhan./kall./dhan./kall.)	

Pjesa më e madhe e parafjalëve ka një kuptim të rrokshëm, të shpjegueshëm (edhe jashtë kontekstit). Të tilla janë, zakonisht, parafjalët e prejardhura. Në listat e mësipërme pjesa më e madhe e mjeteve parafjalore që përdoren në ndërtimet shkakore në gjuhën shqipe janë grupe parafjalore të formuara nga një parafjalë e parme dhe një emër. Emrat, edhe pse dalin në formë të ngurosur, e ruajnë semantikën e tyre. Prandaj lokucionet parafjalore, që kanë në përbërjen e tyre një emër, janë semantikisht më të qarta se parafjalët e thjeshta, ose dhe se ato të përngjitura a të përbëra.



## Një ballafaqim i mjeteve kryesore lidhore shkakore në shqip dhe në gjermanisht

Në gjuhën gjermane parafjalët me kuptim shkakor, për nga formimi, janë më shumë fjalë të përbëra *augrund, zufolge, zuliebe ...* ose të parme *aus, vor, wegen*. Parafjalët e përbëra kanë një kuptim më të qartë se ato të parme.

Parafjalët me kuptim shkakor në gjuhën gjermane, siç duket dhe nga tabela, janë të shumta në numër. Por shumica e tyre kanë kuptime dytësore dhe nuk kanë denduri të madhe përdorimi. Parafjalët më të përdorshme, që nuk kanë kuptime dytësore, janë vetëm dy *wegen, aufgrund/ auf Grund*. Edhe parafjalët *aus* dhe *vor* përdoren shpesh. Por kuptimi i tyre shkakor është vetëm një nga kuptimet e tyre.

Gjuha gjermane ka dhe parafjalë me kuptim shkakor dygjymtyrëshe: *um ... willen*. Emri që lidhet me këtë parafjalë vendoset midis dy gjymtyrëve: *um der Wahrheit willen ...* (për hir të së vërtetës)

*Ndajfoljet si mjete gjuhësore për shprehjen e marrëdhënive shkakore*

Shqip	Gjermanisht	Shënime
prandaj →	deshalb darum daher deswegen	Si në gjermanisht dhe në shqip ndajfoljet shkakore lidhore qëndrojnë në krye të pjesës që ato bashkërendisin.
rrjedhimisht →	folglich demzufolge	Në gjermanisht pas ndajfoljes vjen me njëherë folja e fjalisë, në shqip nuk ndodh patjetër kështu:
përndryshe →	sonst ansonsten	Eno will hier arbeiten, <i>deshalb</i> lernt er Deutsch.
për këtë shkak →	aus diesem Grund dadurch	,Eno do të punojë këtu, <i>prandaj</i> ai mëson gjermanisht.’
pse →	warum weshalb wieso wozu	

*Vërejtje:*

Ndajfoljet shkakore lidhore shërbejnë për të lidhur dy pjesë homogjene të një fjalisë shkakore, në këtë mënyrë ato funksionojnë si lidhëza bashkërenditëse. Kjo thënie vlen si për ndajfoljet lidhore në gjuhën gjermane, ashtu dhe për ato në gjuhën shqipe.

Në pikëpamje sintaksore dhe komunikative këto ndajfolje dalin vetëm me funksion përfaqësues. Ato referojnë ose përfaqësojnë një përmbajtje të përmendur në fjalinë tjetër ose diçka të dhënë në situatë. Prandaj ato nuk mund të përdoren vetëm:

Javën e shkuar isha sëmurë, *prandaj* nuk erdha në leksion. ‚Letzte Woche war ich krank, *deshalb* kam ich nicht in die Vorlesung.‘

Për shkak të statusit special (janë të pranishme në fjalinë që shpreh pasojën dhe referojnë në fjalinë që shpreh shkakun) këto ndajfolje në disa gramatika të gjuhës gjermane trajtohen si lidhëza rrjedhimore, në disa të tjera si lidhëza shkakore.<sup>186</sup>

<sup>186</sup> Erben, J., *Deutsche Grammatik. Ein Abriss*. München, 1972, f.195.

## Një ballafaqim i mjeteve kryesore lidhore shkakore në shqip dhe në gjermanisht

Për të shprehur marrëdhënie shkakore përdoren dhe ndajfoljet pyetëse. Ndajfoljet pyetëse përdoren në fjali pyetëse të drejta ose të zhdrejta. Ato janë treguese të natyrës pyetëse të fjalisë. Të dy nocionet: fjali pyetëse e drejtë dhe fjali pyetëse e zhdrejtë janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin, në çdo fjali pyetëse të zhdrejtë gjendet fjalia pyetëse e drejtë.

Në fjalitë pyetëse të zhdrejta në gjuhën shqipe ndajfoljet pyetëse shoqërohen shpesh me lidhëzën *se*, e cila vendoset përpara ndajfoljes:

Nuk e mora vesh *se* pse nuk erdhi. ‚Ich erfuhr nicht, warum er nicht kam.‘

Foljet e pjesës drejtuese në fjalinë pyetëse të zhdrejtë kanë një kuptim të caktuar leksikor. Të tilla folje mund të jenë: pyes, them, rrëfej, tregoj, kuptoj, kujtoj, sjell ndër mend, mësoj marr vesh, di, hetoj, zbuloj, mendoj, besoj, druhem, kam frikë.

Në „Gramatika e Gjuhës Shqipe 2“ thuhet se ndajfoljet pyetëse janë „edhe mjete të lidhjes, (funksionojnë si lidhëza) , edhe gjymtyrë të fjalisë së varur.“<sup>187</sup>

Pjesëza *nämlich* në gjermanisht ndodh të përfshihet në klasën e ndajfoljeve lidhore, ndonëse ajo vetëm pjesërisht ngjet me to. Ndryshe nga ndajfoljet lidhore elementi *nämlich* nuk ka karakter referues. Collet-i thotë lidhur me këtë: „ Në klasën e ndajfoljeve lidhore mund të përfshihen edhe disa pjesëza që kanë ngjashmëri të pjesshme ose s’kanë fare ngjashmëri me klasën në fjalë. Është fjala për *nämlich*, *ja*, *doch* (pikërisht, po, pra).“<sup>188</sup>

<sup>187</sup> Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë, 2002, f. 520.

<sup>188</sup> Shih, Collet, S., “A propos de quelques conjonctions causales”, botuar në, *Nouveaux cahiers d’allemand*(Nancy), 1/3, 1983, f.158.

**Kreu VII Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“**

Përdorimit të lidhëzave shkakore në një tekst letrar siç është romani „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ po i kushtojmë një kapitull më vete. Marrëdhëniet shkakore zënë një vend të madh e të rëndësishëm në tekstet letrare. Tekstet letrare hartohen, zakonisht, në një stil të ngritur (stilus gravis). Ky stil synon të trazojë ndjenjat dhe emocionet e lexuesve, t'i nxisë ata në plotësimin e mëtejshëm të përmbajtjes së tekstit. Racionaliteti dhe emocionaliteti janë dy dimensione të domosdoshme të tekstit letrar. Hartuesi dhe lexuesi i teksteve të tilla synojnë të reagojnë ndaj dy botëve të ndryshme. Teksti vetë është një reaksion ndaj botës reale, ndërsa leximi/ interpretimi i këtij teksti është një reaksion ndaj tekstit, botës së paraqitur me anë të tekstit. Meqë bëhet fjalë për botë, atëherë paraqitja e saj duhet të bëhet me veçoritë e domosdoshme që ka ajo dhe sipas ligjit të koherencës tekstore.

Në këtë kapitull do të trajtohen:

- Lidhëzat shkakore dhe përdorimi i tyre në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ të I. Kadaresë.
- Lidhëzat shkakore në përkthimin gjermanisht të këtij romani nga Oda Buchholz-i dhe Wilfried Fiedler-i. (Romani në gjermanisht titullohet „Der General der toten Armee“.)
- Ballafaqimi i lidhëzave që përdor I. Kadareja me përgjegjëset e tyre në gjuhën gjermane të përdorura nga përkthyesit e përmendur.

Për realizimin e qëllimit tonë do të përdorim metodën përshkruese-krahasuese.

**VII.1 Lidhëzat shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“**

Nga një qëmtim i kujdesshëm i lidhëzave shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ del se ai ka përdorur këto lidhëza shkakore: *se, sepse, ngaqë, që, pse*.

Paraqitja e marrëdhënieve shkakore në një tekst, dhënia e shkaqeve pse ndodhin ngjarjet dhe gjendjet e përshkruara, i japin tekstit një lloj thellësie kuptimore-informative. Zbërthimi, dekodimi i raporteve kausale nuk është gjithnjë i thjeshtë, kërkon, gjithsesi, një lloj kompetence interpretuese nga lexuesi. Për më tepër, në një tekst letrar një pjesë e mirë e informacionit nuk jepet eksplicit. Lexuesi duhet ta plotësojë vetë tekstin, t'i ndërtojë vetë në shumë raste raportet shkak-pasojë. Shkrimtari paraqet vetëm ato lidhje kausale që i sheh si të rëndësishme. Dhe ia lë në dorë lexuesit interpretues t'i ndërtojë lidhjet e tjera, të shohë shkakun e pashprehur përtej paraqitjeve të dhëna në mënyrë eksplicite. Kështu shpjegohet fakti që i njëjti tekst kuptohet ndryshe nga lexues të ndryshëm.

Edhe rrëfimi në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ nuk mbështetet në principin e paraqitjes së të gjitha shkaqeve të veprimeve, gjendjeve dhe ngjarjeve. I. Kadareja i le fushë të lirë parafytyrimit të lexuesit. Pse-ja e shumë gjërave shpjegohet intuitivisht nga lexuesi. Prandaj dhe sasia e raporteve kausale të realizuara gjuhësisht në romanin në fjalë nuk është kurrsesi aq e madhe sa p.sh. raportet hapësinore ose kohore. Rrokja e raporteve kohore dhe hapësinore është më e lehtë se sa të kuptuarit e lidhjeve shkak-pasojë. Kuptimi dhe interpretimi i raporteve shkakore

është shkalla e fundit e kuptimit të një teksti. Siç kemi theksuar dhe më lart, kur flasim për kauzalitetin në gjuhësi, kemi parasysh jo vetëm realizimin gjuhësor të shkakësisë reale, ku shkakun prodhon në rrjedhën kohore një pasojë, por një marrëdhënie të caktuar, që shprehet me anë të fjalisë shkakore, ku shkakun nuk është gjithnjë shkak logjik, pasoja, gjithashtu, nuk është pasojë logjike. Shpesh herë shkakun është një shpjegim, sqarim, argumentim, arsyetim i përmbajtjes së shprehur në pjesën kryesore. Edhe në romanin e I. Kadesës „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ pjesa më e madhe e marrëdhënieve shkakore janë marrëdhënie argumentuese.

Një ndër mjetet më të rëndësishme që përdor I. Kadare për të shprehur marrëdhëniet shkakore janë lidhëzat shkakore.

Le të paraqesim funksionin e lidhëzave të sipërpërmendura që përdor I. Kadareja. Po fillojmë me lidhëzën *sepse*. Është lidhëza më e përdorshme. Ajo përdoret në roman 87 herë, ndërsa *se*-ja – 20 herë.

a. Lidhëza *sepse* përdoret në roman:

- Në fjalitë shkakore të drejtpërdrejta:

Fitoi *sepse* ai udhëhiqte mirë dhe nuk i linte në baltë ushtarët e tij.<sup>189</sup>

- Në fjali shkakore argumentuese të pyetjes:

*Përse* mendon kështu ajo? Ndoshta, *sepse* ne e kërkuam kolonelin në mbrëmje<sup>190</sup>.  
*Përse* duhet të harroj ato që shikoj ditë? – tha prifti. *Sepse* ne kemi një atdhe me këta të mjerë.<sup>191</sup>

- Në pyetje retorike:

Mos vallë u njolloso emri i ushtrisë sonë, *sepse* e shau atë një plakë shqiptare?<sup>192</sup>

- Në fjalinë shkakore argumentuese të supozimit:

Tani me sa duket po jepnin lajmet, *sepse* spikerja përsëriste fjalë të njohura.<sup>193</sup>  
Gropat, siç duket, ishin hapur një ose dy javë përpara, *sepse* ishin mbushur përgjysmë me ujë nga shirat e fundit.<sup>194</sup>

- Në fjalinë shkakore argumentuese të konkluzionit:

Ai nuk do të ishte gjeneral, *sepse* s’mund të dërgonin një gjeneral tjetër vetëm për 200 veta.<sup>195</sup>

Nuk do t’u binin më në qafë vajzave tona, *sepse* do të kishin të tyret.<sup>196</sup>

---

<sup>189</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 122.

<sup>190</sup> Po aty, f. 193.

<sup>191</sup> Po aty, f. 25.

<sup>192</sup> Po aty, f. 195.

<sup>193</sup> Po aty, f. 26.

<sup>194</sup> Po aty, f. 195.

<sup>195</sup> Po aty, f. 176.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

- Në fjalinë argumentuese shkakore të dëshirës:

Doja të bëja një gropë të thellë, *sepse* kështu kishte qenë dëshira e tij.<sup>197</sup>  
Ai donte t’i thonte diçka priftit, *sepse* heshtja e kishte mërziur.<sup>198</sup>

- Në fjalinë shkakore argumentuese të urdhërit:

Të ikësh sa më parë, *sepse* dhe ti je i mallkuar si ai.<sup>199</sup>

- Në fjalinë shkakore të ndjenjës:

Në atë kohë, ne nuk çuditeshim lehtë, *sepse* ishte kohë lufte.<sup>200</sup>

- Në fjalinë argumentuese shkakore të vlerësimit:

Bën mirë të mbledhësh ushtarët e vranë, *sepse* çdo rob i perëndisë duhet të prehet në vatanin e tij.<sup>201</sup>

- Në fjalinë shkakore shtesore:

Ky ishte një alarm i vjetër, një frikë e lashtë nga ujrat e kaltra dhe në përgjithësi nga vendet e ulëta, *sepse* e keqja depërtonte gjithmonë nga vendet e ulëta.<sup>202</sup>

Nga një vështrim i vëmendshëm i përdorimeve të lidhëzës *sepse* vihet re që kjo lidhëzë nuk manifeston asnjëherë ndërthurje ngjyrimesh shkakore me kundrinore ose me lloje të tjera ngjyrimesh. Lidhëza *sepse* ka një ngjyrim të theksuar shkakor. Ky ngjyrim duket qartë po ta zëvendësojmë këtë lidhëzë me lidhëzën *se* (në një tekst të caktuar):

Kjo ndodhi, *sepse* shiptarët prej natyre janë të prirë për luftë, - tha prifti<sup>203</sup>.  
Kjo ndodhi, *se* shqiptarët prej natyre janë të prirë për luftë.

Në këtë zëvendësim vihet re që fjalisë së dytë i mungon diçka në forcën argumentuese.

- b. Lidhëza shkakore *që* (në korpusin në fjalë) përdoret:

- Në fjalinë shkakore argumentuese të ndjenjës:

Me siguri gëzohen *që* po heqim ushtarët, - tha gjenerallejtanti.<sup>204</sup>

---

<sup>196</sup> Po aty, f. 62.

<sup>197</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f.16.

<sup>198</sup> Po aty, f. 10.

<sup>199</sup> Po aty, f. 190.

<sup>200</sup> Po aty, f. 59.

<sup>201</sup> Po aty, f.188.

<sup>202</sup> Po aty, f. 147.

<sup>203</sup> Po aty, f. 124.

<sup>204</sup> Po aty, f. 215.

- Në fjalinë shkakore argumentuese të dëshirës:

Ai qe penduar shumë *që* kishte ardhur këtu<sup>205</sup>.

Edhe te I. Kadareja lidhëza që paraqet një ndërthurje ngjyrimesh shkakore dhe kundrinore. Nuk ka asnjë rast të përdorimit të saj si shkakore e pastër.

c. Lidhëza *pse*:

Në „Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe“<sup>206</sup> kjo lidhëz trajtohet vetëm si kryefjalore dhe kundrinore, nuk i njihet funksioni shkakor. Duke mbivlerësuar përdorimin e madh të lidhëzës *pse* si kundrinore, nuk duhet ta shpërfillim përdorimin shkakor të saj. Edhe te Kadareja e gjejmë lidhëzën *pse* me kuptim shkakor:

Në fillim nuk e kuptova *pse* lëvizën njerëzit nga tavolina dhe u afruan te xhamat e mëdhenj për të vështruar përjashta në sheshin e Bashkisë.<sup>207</sup>

Ndonëse rrallë, lidhëza *pse* përdoret si shkakore dhe në ditët tona. (Në romanin që po analizojmë I. Kadare e përdor këtë lidhëz me kuptim shkakor 7 herë.)

Si e tillë ajo del te I. Kadareja në fjalinë e varur shkakore argumentuese të pyetjes:

Pse s’do të na kërkojnë llogari *pse* ikëm nga lufta?<sup>208</sup>  
Kush do të na kërkojë llogari *pse* ikëm nga lufta ?<sup>209</sup>

Në të dyja këto raste lidhëza *pse* shfaq ndërthurje të ngjyimeve shkakore me ato kundrinore. Por në këtë ndërthurje nuk është vështirë të përcaktohet se ngjyrimet shkakore janë mbizotëruese. Në raste të tilla lidhëza *pse* mund të zëvendësohet nga shkakorja që: Kush do të na kërkojë llogari *që* ikëm nga lufta?

d. Lidhëza *ngaqë*

Në ndërtimet që shprehin raporte shkakore te I. Kadareja haset dhe lidhëza *ngaqë*. Në shumicën e rasteve shkakorja *ngaqë* qëndron në krye të fjalisë së varur shkakore të drejtpërdrejtë:

Gjenerali, si zuri vend mirë në sedile, *ngaqë* s’kishte ç’të bënte, hapi fletoren...<sup>210</sup>  
*Ngaqë* vendi ishte i zhveshur, kantieri dukej vigan në sfondin e mjegullës.<sup>211</sup>

Këtë mjet lidhëz e gjejmë dhe në fjalinë shkakore argumentuese të ndjenjës:

---

<sup>205</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 193.

<sup>206</sup> Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1980, f. 1563.

<sup>207</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 63.

<sup>208</sup> Po aty, f. 94.

<sup>209</sup> Po aty, f.94.

<sup>210</sup> Po aty, f. 91.

<sup>211</sup> Po aty, f. 39.

Kur mbarova, e sheshova si munda tokën dhe sipër nuk i vura asnjë shenjë, asnjë gur, sepse ai trembej nga çdo shenjë, *ngaqë* i dukej se do ta gjenin e do ta nxirrnin prapë nga dheu.<sup>212</sup>

Ka dhe raste të përdorimit të saj në fjalinë e varur shkakore të supozimit:

S’kam asgjë, - tha gjenerali, duke e ndier se fërneti po i binte më shpejt se çdo herë në kokë, siç duket, *ngaqë* ishte tepër i lodhur.<sup>213</sup>

## VII.2 Lidhëzat shkakore në përkthimin gjermanisht “General der toten Armee”

Duhet të them që në fillim, se ky roman është përkthyer nga mjeshtra të tillë të albanologjisë siç është Fiedler-i dhe Buchholz-i. Nuk është hera e parë që ata bashkëpunojnë. Fryt i një bashkëpunimi të tyre është dhe vepra „Albanische Grammatik“ (Gramatika e Gjuhës Shqipe), një ndër gramatikat më të mira të shkruara për gjuhën shqipe. Mendimi i parë që të shkon nëpër kokë, kur mëson se një vepër artistike është përkthyer nga gjuhëtarë të zotë, është: përkthimi duhet të jetë krejt i saktë gjuhësisht, por ana artistike nuk mund të jetë në nivelin e korrektësisë gjuhësore. Në rastin në fjalë kjo do të ishte një hamendje e gabuar. Albanologët-përkthyes i kanë qëndruar besnik jo vetëm fjalorit, strukturave gjuhësore, rrafshit të mendimit, por edhe stilit rrëfyes të Kadaresë. Tërë ajo atmosferë artistike që vesh dhe shoqëron ngjarjet, bëmat dhe personazhet te Kadareja është bartur dhe në përkthimin gjermanisht. Vetëm një kuptim i thellë, i saktë, logjik dhe artistik mund të çonte në një përkthim të tillë. Me siguri, që përkthyesve u është dashur shpesh të gërmojnë në leksikon aktiv a pasiv të gjuhës gjermane ose kanë krijuar vetë fjalë për të dhënë përgjegjëset e atyre fjalëve shqipe që shënojnë dukuri tipike, të papërsëritshme të kulturës shqiptare. Në romanin „Der General der toten Armee“ është arritur që personazhet e I. Kadaresë ta shpalosin botën e tyre, jo në shqip, por në gjermanisht. Tërë koloriti kohor, hapësinor shqiptar gjëllin autentik në një gjuhë të ndryshme nga shqipja.

Në kuadrin e përkthimit ne jemi ndalur vetëm në lidhëzat shkakore. Si në variantin origjinal shqip, edhe në përkthimin gjermanisht lidhëzat shkakore bëjnë pjesë në ndërtimet shkakore, ku jepet shkak real i veprimit a gjendjes, ose shpjegimi, motivimi i tyre. Rastet e shprehjes së shkaqeve reale, të mirëfillta ose logjike me anë të fjalive shkakore janë më të rralla. Edhe në dhënien e lidhjeve shkakore që paraqiten në roman përkthyesit shquhen për një besnikëri të nivelit të lartë. Nuk është fjala këtu thjesht për një përkthim fjalë për fjalë. Dihet që përkthimi fjalë për fjalë nganjëherë është i pamundur, nganjëherë është i pasaktë. Por ka dhe shumë raste që është i saktë. Në klasën e lidhëzave shkakore nuk ka simetri të plotë midis gjermanishtes dhe shqipes, shqipja ka në dispozicion një numër më të madh lidhëzash shkakore se gjermanishtja. Nga ana tjetër lidhëzat kryesore shkakore në gjermanisht: *weil, da, denn* dallojnë semantikisht dhe në pikëpamje sintaksore njëra nga tjetra. Përkthyesve u është dashur të gjejnë mjetin e përshtatshëm lidhës në gjuhën gjermane për strukturat semantike të fjalive shkakore të romanit. Në romanin e Kadaresë përdoren këto lidhëza për të shprehur raporte shkakore: *sepse, se, ngaqë, që, pse*. Dendurinë më të madhe në përdorim e ka shkakorja *sepse*. Kjo lidhëz, ashtu si lidhëza *weil* (*sepse*) në gjermanisht është e aftë të shprehë raporte shkakore, ku shkak, argumentimi,

---

<sup>212</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 16.

<sup>213</sup> Po aty, f. 121.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

arsyetimi theksohen më fort se gjatë përdorimit të shkakoreve të tjera. Përveç kësaj, kjo lidhëz në gjuhën shqipe ka ngjyrim libror. Përdorimi i dendur i kësaj lidhëze (katër herë më shumë se shkakorja *se*) krahas mjeteve të tjera gjuhësore, që janë tipike për ligjërimin libror, bëjnë që ligjërimi i I. Kadaresë të manifestojë nuanca të dukshme librore.

Përkthyesit e romanit për të dhënë raportet shkakore përdorin, kryesisht, lidhëzat *weil, da, denn*. Në disa raste përdorin mjete të tjera lidhëse, si: pjesëza, lidhëza kohore me vlerë shkakore, ndonjë formulim paralel ku mungon lidhëza etj.

Le t'i shohim tani më në hollësi ndërtimet shkakore me lidhëzat e sipërpërmendura të I. Kadare dhe përgjegjëset e tyre në përkthimin gjermanisht.

### VII.2.1 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës *sepse*

- Lidhëza *sepse* përkthehet me *weil* (*sepse*):

Nuk ju besohet *sepse* nuk keni qenë ndonjëherë në Shqipëri në kohën e luftës.<sup>214</sup>  
,Sie können es sich nicht vorstellen, *weil* Sie während des Krieges nicht ein einziges Mal in Albanien gewesen sind'.<sup>215</sup>

Nuk i vura asnjë shenjë, asnjë gur, *sepse* ai trembej nga çdo shenjë.<sup>216</sup>  
,Aber ich brachte keinerlei Kennzeichen an, nicht einmal einen Stein legte ich darauf, *weil* er vor jeder Kennzeichnung Angst hatte'.<sup>217</sup>

Lidhëza *sepse* dhe përgjegjësja në gjuhën gjermane *weil* paraprijnë fjali shkakore, përmbajtja e të cilave ka peshë të veçantë në kuadrin e mbarë fjalisë. Në to shkakujepet i theksuar. Thënia *sepse nuk keni qenë ndonjëherë në Shqipëri në kohën e luftës* krahas përmendjes së një shkakuj krijon dhe hapësira boshe të cilat lexuesi i plotëson me fantazi: lufta duhet të ketë qenë shumë e ashpër. Asnjë lidhëz tjetër shkakore nuk do t'ia jepte thënies këtë dimension. Në përkthimin gjermanisht pesha e shkakut është gjithashtu e pranishme. Në fakt është lidhëza, krahas përmbajtjes së fjalisë që evidenton, që shpreh një atmosferë të tërë brenda semantikës së një fjalisë shkakore. Për shembullin e dytë *sepse ai trembej nga çdo shenjë* do të ishte i tepërt çdo koment. Shkakuj i frikës nga identifikimi dhe pas vdekjes ka përmasa patologjike. Lidhëza *sepse* (*weil*) këtu është e pazëvendësueshme, asnjë lidhëz tjetër *se, meqë, ngaqë* etj. nuk do t'ia jepnin thënies atë shprehësi që i jep lidhëza *sepse*.

Shembuj të tjerë:

Në hartë ndodhet i shënuar vendi i varrimit, por unë ngula këmbë që të pyesim fshatarët, *sepse* thëniet e tyre na lehtësojnë shumë punën.<sup>218</sup> ,Auf der Karte ist die Stelle, wo sie begraben sind, genau eingezeichnet. Ich hatte nur darauf bestanden, die Bauern zu fragen, *weil* ihre Angaben unsere Arbeiten im allgemeinen sehr erleichtern können'.<sup>219</sup>

---

<sup>214</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 16.

<sup>215</sup> General der toten Armee, f. 14.

<sup>216</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 17.

<sup>217</sup> General der toten Armee, f. 15.

<sup>218</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 44.

<sup>219</sup> General der toten Armee, f. 41.



## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

Lidhëza *sepse* luan rol në theksimin e rëndësisë së faktit të dhënë me fjalinë shkakore. Të njëjtin rol luan kjo lidhëz dhe në shembujt e mëposhtëm:

Dy veta u arrestuan, *sepse* kishin thënë se kjo gjë bëhej për të futur mënyrën e jetesës së huaj.<sup>220</sup> ‚Zwei Personen wurden verhaftet, *weil* sie gesagt haben, dass dies alles ja nur gemacht werde, um Albanien die fremde Lebensweise ... aufzuzwingen.‘<sup>221</sup>

Nuk do t’u binin më në qafë vajzave tona, *sepse* do të kishin të tyret.<sup>222</sup> Nicht mehr an unseren Mädchen nachstellen würden, *weil* sie dann ihre eigenen hätten‘.

- Lidhëza *sepse* përkthehet me *denn* (meqë):

Kishte ndoshta shumë nga ata që nuk e dinin se cili shtet po sulmonte dhe me cilin armik po vriteshin, *sepse* për ta kjo nuk kishte ndonjë rëndësi.<sup>223</sup> ‚Und unter diesen waren sicherlich viele, die noch gar nicht wußten, welcher Staat sie angegriffen hatte und gegen welchen Feind sie zu Felde zogen, *denn* für sie war das ohne Belang.‘<sup>224</sup>

... Njerëzit e klasave të ulëta kanë nevojë të bëjnë krime, *sepse* krimet u japin atyre disa ndjesira të forta, të cilat, ne të tjerëve, na i jep arti.<sup>225</sup> ... Die Angehörigen der niederen Klassen haben das Bedürfnis, Verbrechen zu begehen, *denn* das Verbrechen bewirkt bei ihnen ähnlich starke Gefühlserlebnisse wie bei uns anderen die Kunst.‘<sup>226</sup>

Lidhëza *sepse* në gjuhën shqipe mund të përdoret edhe për të motivuar ose argumentuar një përfundim, një hamendje.<sup>227</sup>

Edhe lidhëza *denn* e gjuhës gjermane mund të përdoret në fjali shkakore që argumentojnë përmbajtjen e fjalisë me të cilën lidhen në kontekst.<sup>228</sup>

Në dy rastet e cituara më sipër fjalitë e lidhura me *sepse* vlejné si argumentime të asaj që thuhet në fjalinë kryesore, e cila ka përmbajtjen e një përfundimi logjik. Që ky përfundim të jetë sa më i besueshëm për dëgjuesin argumentohet, sqarohet më tej.

Të njëjtin funksion kryen në këto kontekste dhe lidhëza *denn*. Ajo vendoset në krye të fjalisë shkakore argumentuese. Në gjuhën gjermane kjo lidhëz është bashkërenditëse, por kjo nuk ndryshon asgjë në funksionin argumentues të fjalisë që paraprihet nga ajo. Në raste të tilla përdorimi i *denn* dhe jo i *weil* është i saktë.

Funksion sqarues, motivues kanë dhe fjalitë shkakore në shembujt e mëposhtëm:

---

<sup>220</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 61.

<sup>221</sup> General der toten Armee, f. 58.

<sup>222</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 61.

<sup>223</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 144.

<sup>224</sup> General der toten Armee, f. 139.

<sup>225</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 124.

<sup>226</sup> General der toten Armee, f. 119.

<sup>227</sup> Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Tiranë, 2002, f. 564.

<sup>228</sup> Shih, Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Tübingen, Niemeyer, 1995, f. 142.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

Kur më tha këto fjalë, më erdhi të zë kokën me duar, *sepse* m' u duk sikur më ngushëlloi.<sup>229</sup> „Als sie das zu mir sagte, hätte ich am liebsten die Hände vors Gesicht gehalten, *denn* mir war, als wollte sie mich trösten.“<sup>230</sup>

Të ikësh sa më parë, *sepse* edhe ti je i mallkuar si ai<sup>231</sup>. „Verschwinde so schnell wie möglich, *denn* auch du bist verflucht genauso wie er.“<sup>232</sup>

Në këtë rastin e fundit motivohet një urdhër në formë dëshire.

Por nuk e bëj, *sepse* nuk dua t' u kujtoj të zezat e luftës këtyre dasmorëve.<sup>233</sup>  
Aber ich tue es nicht, *denn* ich will die Hochzeitsgäste nicht an die Schrecken des Krieges erinnern<sup>234</sup>.

Unë nuk e di i cilës ushtrie je ti, *sepse* asnjëherë nuk i kam njohur rrobat e ushtrive...<sup>235</sup> „Ich weiß nicht, von welcher Armee du bist, *denn* ich habe mich nie in Uniformen ausgekannt...“<sup>236</sup>,

Fjalitë e varura të paraprirra nga *sepse* nuk japin shkaqe reale, por shpjegime, arsytetime rreth asaj që thuhet në fjalitë me të cilat lidhen kuptimisht. Përkthimi ndjek të njëjtën logjikë shprehjeje. Fjalitë e ndërtuara me *denn* nuk shprehin shkakun e asaj që thuhet në fjalinë tjetër, por e sqarojnë më tej përmbajtjen e saj.

Por edhe lidhëza *denn* mund të shënojë shkak real; në raste të tilla ajo është pothuaj identike me *weil*:<sup>237</sup>

Thoshin se ai shkoi përsëri natën te shtëpia e Nicës, *sepse* nuk e dinte që vajza kishte vdekur.<sup>238</sup> „Am Abend sei er wieder zu Nicas Haus gegangen, *denn* er wußte nicht, das das Mädchen bereits tot war“<sup>239</sup>

Sa më shumë që i shtrëngonte qepallat, aq më tepër errësira bëhej e pafuqishme, *sepse* aty – këtu errësirën e shponin njolla dhe rripa drite ...<sup>240</sup> „Je mehr er die Lieder zukniff, desto kraftloser wurde die Dunkelheit, *denn* sie wurde von Lichtflecken durchbohrt ...“<sup>241</sup>

Në të dy shembujt e cituar, jepet shkak i asaj që thuhet në fjalinë parardhëse. Si një shpjegim të mëtejshëm të përdorimit të *denn* në fjalitë që shprehin shkaqe reale po sjellim një thënie të B. Schmidhauser-it: „*Denn* mund të shënojë dhe një shkak real,

---

<sup>229</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 63.

<sup>230</sup> *General der toten Armee*, f. 59.

<sup>231</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 184.

<sup>232</sup> *General der toten Armee*, f. 174.

<sup>233</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 182.

<sup>234</sup> *General der toten Armee*, f. 171.

<sup>235</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 179.

<sup>236</sup> *General der toten Armee*, f. 169.

<sup>237</sup> Shih, Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Tübingen, Niemeyer, 1995, f. 141.

<sup>238</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 188.

<sup>239</sup> *General der toten Armee*, f. 178.

<sup>240</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 194.

<sup>241</sup> *General der toten Armee*, f. 184.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

edhe pse marrëdhënia shkakore e shprehur në këtë rast nuk është aq strikte sa në ndërtimet me *weil*.<sup>242</sup>

- Lidhëza *sepse* përkthehet me *nämlich*:

Pastaj, kur u ktheva, mezi e hapa portën. *Sepse* ishte hera e parë që e hapja portën me një dorë.<sup>243</sup> ,Und als ich dann wieder zurückkam, konnte ich kaum noch die Tür öffnen. Es war *nämlich* das erset Mal, dass ich sie mit einer Hand öffnen musste.<sup>244</sup>

Në fjalinë në gjuhën shqipe pjesa e varur del e shkëputur nga pjesa drejtuese. Kjo bëhet për qëllime stilistike, në rastin tonë për të vënë në dukje përmbajtjen e pjesës së varur, për të theksuar shkakun dhe argumentin që sjell ajo. Përmbajtja e pjesës shkakore ka brenda saj tërë dramën e njeriut që kthehet invalid nga lufta. Në variantin gjermanisht përkthyesit e japin lidhëzën *sepse* të pjesës shkakore me pjesëzën *nämlich*. Në këtë përdorim kjo pjesëz ka kuptimin e lidhëzës shkakore *weil*. Përdorimi i këtij mjete lidhës në këtë rast është mjaft i goditur. Në këtë mënyrë edhe thënia përgjegjëse në gjuhën gjermane e jep shkakun të theksuar. Në fakt, edhe në gjermanisht pjesa shkakore jepet e shkëputur nga pjesa drejtuese.

- Lidhëza *sepse* alternohet me 0

Në këtë rast në vend të përkthimit të ndërtimit me *sepse* jepet një ndërtim tjetër paralel që nuk e përmban fare lidhëzën e shkakut:

E vërteta është se, në atë kohë, ne nuk çuditëshim, *sepse* ishte kohë lufte ...<sup>245</sup>  
,Um die Wahrheit zu sagen, im jener Zeit waren wir nicht so leicht aus der Ruhe zu bringen, es war schliesslich Krieg.<sup>246</sup>

Edhe pse përmbajtja e përkthimit në gjermanisht, në përgjithësi, i përgjigjet përmbajtjes së fjalisë gjegjëse në shqip, prapë ajo bën një lloj devijimi nga kuptimi i thënies në shqip. Në shqip bëhet fjalë për çuditje, ndërsa në gjermanisht për humbje qetësie (aus der Ruhe bringen). Segmenti shkakor *sepse ishte luftë* jepet me *es war schliesslich Krieg* (në fund të fundit ishte luftë). Në variantin gjermanisht mungon lidhëza shkakore, por rolin e saj e luan fjala *schliesslich*. Edhe pse kuptimisht fjala shqip *sepse* dhe fjala gjermanisht *schliesslich* dallojnë nga njëra-tjetra, stilistikisht ato mund të merren për sinonime.

- *sepse* përkthehet me *da*

Kjo ndodh shumë rrallë:

Ai donte t'i thonte diçka priftit, *sepse* heshtja e kishte mërziur.<sup>247</sup> ,Da ihn das Schweigen allmählich zu bedrücken begann, hätte er gern den Priester angesprochen.<sup>248</sup>

---

<sup>242</sup> Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Tübingen, Niemeyer, 1995, f. 143.

<sup>243</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 227.

<sup>244</sup> *General der toten Armee*, f. 214.

<sup>245</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 58.

<sup>246</sup> *General der toten Armee*, f. 55.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadesës „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

Ndërtimi me *da* (meqë) në gjermanisht lë të kuptohet se fakti i paraqitur në këtë fjali është një shkak i vetëkuptueshëm, i njohur dhe i pranuar; dihet që heshtja e gjatë është, përgjithësisht, e papëlqyeshme. Ky shkak i njohur e bën gjeneralin të mendojë se do të ishte mirë të hapte ndonjë bisedë me priftin. Këtij ndërtimi në gjermanisht do t'i përgjigjej saktë ndërtimi në shqip: *Meqë* heshtja e kishte mërzhitur, ai donte t'i thonte diçka priftit. Por I. Kadareja na paraqet diçka tjetër sepse heshtja e kishte mërzhitur. Me anë të ndërtimit me *sepse* ai e thekson shkakun. Nga krahasimi i dy thënieve *meqë heshtja e kishte mërzhitur* dhe *sepse heshtja e kishte mërzhitur* vihet re ndryshimi, thënia e parë tingëllon si një farë justifikimi, thënia e dytë si pohim i një shkakut rëndues që do të çonte në një veprim. Në variantin gjermanisht me *da* (meqë)përmbajtja e fjalisë së varur shkakore është po aq e shenjuar emocionalisht sa thënia në origjinal. Në këtë markim luan një rol të veçantë folja e fjalisë *bedrücken* (mundoj, mërzhis, trishtoj). Përdorimi i kësaj foljeje bën stilistikisht atë që s'e bën dot përdorimi i mjetit lidhës. Dihet që të gjitha mjetet gjuhësore luajnë rol në kuptimin, ngjyrimin, në peshën racionale-emocionale të thënieve.

Me përdorimin e pjesëzës *ndoshta* në bashkëvjajtje me lidhëzën *sepse* theksohet karakteri i pasigurtë i një fakti që shërben si shkak:

*Ndoshta sepse* ata porsa kishin dalë nga përleshja dhe ishin të plagosur ....<sup>249</sup>  
,*Vielleicht deshalb, weil* sie gerade eine Schlacht überstanden hatten und verwundet worden waren.<sup>250</sup>

Grupit shqip *ndoshta sepse* i përgjigjet në gjermanisht grupi *vielleicht deshalb, weil*. Në këtë grup bën pjesë dhe ndajfolja përemërore *deshalb* (prandaj). Përdorimi i saj është i domosdoshëm për të realizuar përmbajtjen e dhënë në gjuhën shqipe.

Ka raste kur theksohet pranimi i një fakti si shkak i vetëm për atë që thuhet në pjesën kryesore. Atëherë para lidhëzës shkakore *sepse* vendoset pjesëza vetëm:

Mos vallë u njollos emri i ushtrisë sonë, *vetëm sepse* e shau atë një plakë shqiptarë?<sup>251</sup> ,Ist die Ehre unserer Armee befleckt worden, *bloß weil* ein altes albanisches Weib sie beschimpft hat.<sup>252</sup>

Përmbajtjet e dhëna në shqip dhe në gjermanisht janë identike.

- Ndërtimi me lidhëzën *sepse* jepet me një ndërtim ku lidhja shkakore shprehet me një parafjalë:

Ai nuk do të ishte gjeneral, *sepse* s'mund të dërgonin një gjeneral vetëm për 200 veta.<sup>253</sup> ,Ein General würde es sicherlich nicht sein, *nur wegen* zweihundert Mann entsendet man keinen General.<sup>254</sup>

---

<sup>247</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 13.

<sup>248</sup> General der toten Armee, f. 9.

<sup>249</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 112.

<sup>250</sup> General der toten Armee, f. 108-109.

<sup>251</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 195.

<sup>252</sup> General der toten Armee, f. 179.

<sup>253</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 176.

<sup>254</sup> General der toten Armee, f. 161.

Formës foljore (*nuk*) do të ishte, si shprehje e një gjendjeje jo reale, i përgjigjet në gjermanisht forma *würde (nicht) sein*, që ka kuptim të njëjtë. Në fjalinë që shpreh aryetimin, sqarimin, në gjuhën shqipe përdoret folja në vetën e dytë shumë me kuptim të përgjithësuar (s') mund të dërgonin. Në gjermanisht operohet me një një mundësi paralele, përdoret folja pavetore *entsendet man*. Mjeti lidhor është i ndryshëm: në shqip del *sepse*, në gjermanisht *wegen*. Në përkthimin gjermanisht kuptimi i shkakut është vendosur në segmentin *wegen zweihundert Mann (për shkak të 200 vetave)*; ndërsa në origjinal autori e shtrin kuptimin e shkakut në një fjali të tërë *sepse s'mund të dërgonin një gjeneral vetëm për 200 veta*. Fjalja shkakore e përdorur nga I. Kadare dhe fjalja me segmentin shkakor në gjermanisht janë sinonime: *sepse s'mund të dërgonin një gjeneral vetëm për 200 veta = ,nur wegen zweihundert Mann entsendet man keinen General' (vetëm për 200 veta nuk dërgohet një gjeneral)*. Janë sinonime, edhe pse në fjalinë në gjuhën shqipe *segmenti s'mund të dërgonin një gjeneral* është tema; *vetëm për 200 veta është* rema, informacioni i ri. Në përkthimin gjermanisht ndodh e kundërta: *nur wegen zweihundert Mann* është tema, dhe pjesa tjetër është rema. Gjithësesi, besnikëria e kuptimit mbetet e pacënuar.

- Lidhëza *weil* (*sepse*) del në përkthim dhe nuk gjendet në tekstin origjinal:

Telegrafojnë ata, - tha gjenerali. – Ata janë tepër të shqetësuar sonte.<sup>255</sup> „Sie telegrafieren eben“, sagte der General; „weil sie in dieser Nacht besonders unruhig sind.“<sup>256</sup>

Varianti origjinal shqip e ka realizuar marrëdhënien shkakore midis dy thënieve të gjeneralit me anë të pranëvendosjes, në mënyrë asindet, pa kurrëfarë mjeti lidhës. Përkthyesit i kanë lidhur thëniet me lidhëzën *sepse*. Edhe pse kjo lidhëz ka aftësinë ta theksojë e ta evidentojë shkakun, formulimi asindetik është më shprehës. Thënia *ata janë tepër të shqetësuar sonte* e vetme, ka një lloj pavarësie kuptimore që e bën atë më domethënëse dhe më shprehëse se përkthimi me lidhëzën *weil* që tingëllon si një koment, si një sqarim i pjesës kryesore.

#### VII.2.2 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës *se*

Lidhëza *se* është nga lidhëzat më të përdorshme shkakore. Në krahasim me *sepse*, *se* përdoret më shumë në gjuhën e folur, *sepse* më shumë në gjuhën e shkruar; këto dy lidhëza dallojnë dhe për nga forca shprehëse. *Sepse* ka forcë shprehëse më të spikatur. Siç kemi thënë I. Kadare përdor më shumë lidhëzën *sepse*. Edhe *se-* ja, si *sepse-* ja, mund të përdoret në fjalitë që shprehin një shkak të drejtpërdrejtë, ose në fjalitë motivuese-argumentuese. Në fjali të tilla mund të motivohet një përfundim a një hamendje, një pyetje, një nxitje etj.

Le ta shohim konkretisht këtë lidhëz dhe përkthimet e saj.

- *se* jepet me *weil* (*sepse*):

Me siguri njerëzit, që ishin prapa kanateve dhe portave të rënda të shtëpive, dridheshin *se* kujtonin mos fillonte ndonjë masakër e re.<sup>257</sup> „Sicherlich standen die

---

<sup>255</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 228.

<sup>256</sup> *General der toten Armee*, f. 214.

<sup>257</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 100.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

Menschen zitternd hinter den Fenstläden oder hinter den schweren Haustüren, weil sie ein neues Massaker befürchteten.<sup>258</sup>

Në këtë rast *se* paraprin pjesën e varur që shpreh shkakun e asaj që thuhet në pjesën drejtuese-kryesore. Kjo lidhëz tregon në mënyrë të përgjithshme shkakun e drejtpërdrejtë ose motivon një përfundim, një hamendje, një pyetje, një nxitje. Në shembullin e mësipërm bëhet fjalë për një shkak që ka ngjyrimë motivimi. Gjendja e alarmit që përjetonin njerëzit është diçka e marrë me mend, realiteti i saj nuk është krejt i padyshimtë. Kjo gjendje është pasojë e frikës nga një masakër e mundshme. Në të dyja pjesët e fjalisë shkakore bëhet fjalë për gjendje të rënda, të cilat më shumë merren me mend, sesa kanë ekzistencë reale. Prandaj përmbajtja e pjesës së varur është më shumë argumentim sesa shkak për atë që pohohet në fjalinë kryesore. Lidhëza *se* është e specializuar të marrë pjesë në ndërtimin e raporteve të tilla. Edhe përgjegjësjë *weil* e përkthimit është e aftë të japë argumentime të hamendjeve. Edhe në shembullin që vijon shkakorja *se* paraprin një pjesë argumentuese:

Siç duket, ishte penduar, *se* nuk kishte asgjë të veçantë për të shkruar, ose i qe mërzhitur kjo gjë.<sup>259</sup> „Anscheinend hatte er bereut, ... weil er nichts Besonderes zu notieren gab oder weil er vielleicht am Ende des Schreiben überdrüssig geworden war.“<sup>260</sup>

Në origjinal përdoret vetëm njëherë lidhëza *se*, edhe pse bëhet fjalë për dy shpjegime të ndryshme. Dy fjalitë shkakore shpjeguese lidhen me elementin bashkërenditës ose. Përdorimi dy herë i *se-së* nuk është i nevojshëm. Ndërsa në përkthimin gjermanisht lidhëza *weil* (sepse) është vendosur para çdo fjalisë argumentuese. Në këtë mënyrë evidentohen të dyja arsyet e mundshme të hamendjes *anscheinend hatte er bereut* (siç duket ishte penduar). Në përkthimin gjermanisht ka një evidentim më të fortë të shpjegimeve shkakore të hamendjes së dhënë me fjalinë drejtuese. Në origjinal përdorimi i shkakores *se* i jep rrefimit një ton të rrafshtë, pa ngritje e zbritje.

- *se* përkthehet me *denn*

Kuptuam se të gjitha ato tregimet për kuplaratë e Tokios apo të Honolulusë ishin diçka krejt tjetër nga kjo që kishim përpara, *se* kjo ishte një gjë krejt e ndryshme, shumë më e trishtueshme dhe më fatzezë se ato.<sup>261</sup> „Uns war klargeworden, daß sich alles, was über die Freudenhäuser von Tokio oder Honolulu erzählt wurde, grundsätzlich von dem unterschied, was wir vor uns sahen, denn das hier war wirklich etwas völlig anderes, viel trauriger und kläglicher als das, was wir gehört haben.“<sup>262</sup>

Në përkthimin gjermanisht përdoret shkakorja *denn*. Në „Deutsche Grammatik“ Engel-i thotë për këtë lidhëz „kausal, erklärend; verbindet Sätze“ (shkakore, sqaruese, lidh fjali).<sup>263</sup>

---

<sup>258</sup> *General der toten Armee*, f. 97.

<sup>259</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 107.

<sup>260</sup> *General der toten Armee*, f. 104.

<sup>261</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f.62

<sup>262</sup> *General der toten Armee*, f. 59.

<sup>263</sup> Engel, U., *Deutsche Grammatik*, München, Judicum, 2004, f. 428.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadesës „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

Në shembullin e mësipërm, në të dyja formulimet, shqip dhe gjermanisht, pjesa e paraprirë nga *se* bën një arsyetim të mëtejshëm, shpjegon më tej përmbajtjen e fjalisë tjetër. Nuk duhet harruar që *denn* (se/ meqë) është lidhëz bashkërenditëse. Ja dhe një shembull tjetër me *se*, ku lidhëza realizon marrëdhënie të pastra shkakore.

Nuk ishte e mundur të hapje gropë , *se* gropa mbushej përgjysmë me ujë.<sup>264</sup>  
,Man konnte keine Grube graben, *denn* sie hätte sich sofort mit Wasser gefüllt...<sup>265</sup>,

Në përkthim mungon fjala përgjegjëse përgjysmë. Pjesa e varurur shkakore *se* *gropa mbushej përgjysmë me ujë* shpreh një shkak real. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për *denn sie hätte sich sofort mit Wasser gefüllt*. Autori paraqet një shkak real për përmbajtjen e pjesës kryesore *nuk ishte e mundur të hapje gropë*. Shkaku konceptohet i tillë dhe nga përkthyesit që përdorin në këtë rast lidhëzën *denn* . Një ndër përdorimet e *denn* është të tregojë dhe shkak real.<sup>266</sup>

- *se* përkthehet me *bloß weil* (vetëm se)

Në fjalinë e mëposhtme kemi një rast interesant të përdorimit të *se*-së:

Kujton *se* je njeri me shkollë dhe mund të lozësh teatër me të tjerët<sup>267</sup>? ,Du denkst wohl, dass du vor unser einem eine Schau abziehen kannst, *bloß weil* du ein Studierter bist!<sup>268</sup>,

Në origjinal lidhëza *se* është në fakt kundrinore me nuanca shkakore. Natyra shkakore del më në pah gjatë receptimit ose gjatë interpretimit të saj: Kujton se, *meqë* je me shkollë, mund të lozësh me të tjerët ?

Edhe përkthyesit e kanë receiptuar, e kanë interpretuar fjalinë si shkakore, prandaj kanë përdorur në përkthim lidhëzën *bloß weil* (vetëm sepse). Madje, në fjalinë e përkthyer, në pjesën shkakore, shkaku paraqitet si i vetëm dhe kjo mundësohet nga përdorimi i pjesëzës *bloß* (vetëm). Kështu, në pikëpamje komunikative, lidhëza *se* e thënies së cituar është shkakore, megjithë ngjyrimet e dukshme kundrinore (ftilluese). Kjo dukuri emërtohet nga Lang-e „Erkenntnisgrund“ (shkak i receiptuar).<sup>269</sup>

- *se* jepet me *sonst* (përndryshe)

Është fjala në këtë rast për përkthimin e një kënge të njohur popullore. Kënga origjinale popullore thotë : Hanko, mos shko nëpër varre, *se* të vdekurit i ngjalle...

Në tekstin e Kadesës, në f. 222, gjendet një variant i ndryshuar i kësaj kënge:

Ti, moj Hanko, që je kaq simpatike, mos shëtit nëpër varre, *se* me bukurinë tënde i ngjalle të vrrarët. Nuk do të ndalemi këtu në humorin e hollë që emeton një paraqitje e tillë e një kënge të njohur. Janë shumë elemente stilistike që vihen në veprim për të realizuar informacionin dytësor dhe shprehësinë e rallë të tekstit të rikrijuar nga Kadareja. Por do të merremi me lidhëzën shkakore *se*, me funksionin e saj dhe me

<sup>264</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 182.

<sup>265</sup> General der toten Armee, f. 171.

<sup>266</sup> Shih, Lang, E., „Erklärungstexte“, botuar në, *Probleme der Textgrammatik*, Berlin, 1976, f. 171.

<sup>267</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 134.

<sup>268</sup> General der toten Armee, f.129.

<sup>269</sup> Shih, Lang, E., „Erklärungstexte“, botuar në, *Probleme der Textgrammatik*, Berlin, 1976, f. 172.

natyrën e raportit shkakor që realizohet me anë të saj. Fjalja drejtuese *Hanko, mos shko nëpër varre* shpreh një lloj lutjeje me nuanca urdhëri e dëshire. Shprehje të tilla ilokutive ndodh shumë shpesh të argumentohen *se të vdekurit i ngjalle*. Me një parafrazim të mundshëm do të kishim: Hanko, unë të lutem shumë të mos shkosh nëpër varre! Arsyeja për këtë është se të vdekurit i ngjalle, të gjallët i vdiqe fare.

Ja dhe përkthimi gjermanisht: „Du, mein liebes Muslimweibchen, bist so anmutig. Spaziere nicht über die Gräber hinweg, sonst weckst du mit deiner Schönheit noch die Toten.“<sup>270</sup>

Në fakt, përkthimi devijon goxha nga origjinali. Vetë varianti i poezisë popullore që sjell I. Kadareja në roman është një devijim nga origjinali popullor. Por është një devijim stilistik, i qëllimshëm, për të treguar se finesën dhe artin e poezisë popullore nuk ka përkthim që ta japë. Nuk do të merremi me devijimin që shfaqet në përkthimin gjermanisht, por vetëm me mjetin lidhës *sonst*. Është një ndajfolje lidhore shkakore. Zakonisht raportet shkakore janë përkthyer me elemente paralele, domethënë lidhëzat me lidhëza etj., por këtu lidhëza është përkthyer me ndajfolje, veç ndajfolja është lidhore dhe shkakore, prandaj raporti shkakor është dhënë me saktësinë e origjinalit. *Sonst* do të përkthehej këtu me *se përndryshe*.

### VII.2.3 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës *ngaqë*

Fjalitë shkakore me lidhëzën *ngaqë* e tregojnë shkakun si pikënisje a si veprues; stilistikisht janë asnjane.<sup>271</sup> Ja një shembull nga I. Kadareja:

*Ngaqë vendi ishte i zhveshur, kantieri dukej vigan në sfondin e mjegullës.*<sup>272</sup>

Pjesa e varur shkakore jep një shkak real të paraqitjes së bërë në pjesën kryesore. Veç lidhja midis dy pjesëve të bashkuara me shkakoren *ngaqë* nuk është aq e ngushtë, shkakun nuk është i brendshëm, as i theksuar. Pjesa e varur qëndron shpesh para kryesores. Në përkthimin gjermanisht kemi:

„In der kahlen Gegend wirkte die Baustelle vor dem nebligen Hintergrund riesenhaft.“<sup>273</sup>

Kuptim shkakor është dhënë me foljen kauzale *wirken* (duket/ bën përshtypje). Ideja e peizazhit të zhveshur është dhënë me anë të një raporti hapësinor *in der kahlen Gegend* (në mjedisin e zhveshur). Edhe pse raportet janë realizuar me mjete të ndryshme gjuhësore, përmbajtja e fjalive është e njëjtë. Përkthimi gjermanisht ka dhënë si domethënien logjike, ashtu dhe atmosferën afektive që prodhon një pamje e tillë te subjekti vëzhgues.

---

<sup>270</sup> *General der toten Armee*, f. 209.

<sup>271</sup> Shih, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Tiranë 2002, f. 440.

<sup>272</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 39.

<sup>273</sup> *General der toten Armee*, f. 36.



- Në shumicën e rasteve *ngaqë* përkthehet me *da* (meqë):

*Ngaqë* e kishte treguar shumë herë këtë histori, ai kishte përpunuar një farë stili të vet në të treguar.<sup>274</sup> *Da* er diese Begebenheit schon viele Male erzählt hatte, hatte er mittlerweile seinen eigenen Stil entwickelt.<sup>275</sup>

Edhe pse lidhëza *ngaqë* referon në shkaqe reale, në shembullin e mësipërm nuk kemi të bëjmë me shkak real: *ngaqë* e kishte treguar shumë herë këtë histori. Lidhëza *ngaqë* del me përdorimin dhe me funksionin e lidhëzës *meqë*. Këtë e mbështet dhe përkthimi: *Da* er diese Begebenheit schon viele Male erzählt hatte...‘ Lidhëza *da* është përgjegjëse e lidhëzës *meqë*.

Si *meqë*, edhe *da*, referojnë në një shkak të vetëkuptueshëm, të pranuar si të tillë. Po të tregosh shumë herë të njëjtën histori, sigurisht do të përpunosh një mënyrë shprehëse tregimi. Përmbajtja e pjesës së varur mund të interpretohet ose si shkak në përgjithësi, ose si shkak veprues. Në shembullin që vijon pjesa e varur shkakore me lidhëzën *ngaqë* e shpreh shkakun si veprues: Gjenerali, si zuri mirë vend në sedilie, *ngaqë* s’kishte ç’të bënte, hapi fletoren.<sup>276</sup>

Përkthimi e jep *ngaqë* me *da*:... *Da* er nichts Besseres zu tun hatte...<sup>277</sup>.

- Ka raste që *ngaqë* përkthehet me *weil*:

Unë e pashë tek vinte në xhade me pushkën në krahë *dhe*, *ngaqë* e njihja, i dola përpara...<sup>278</sup> *Ich* sah ihn mit dem Gewähr über der Schulter die Straße entlangkommen, *und weil* ich ihn kannte, ging ich auf ihn zu.<sup>279</sup>

Në gjermanisht përdoret përpara lidhëzës *weil* lidhëza bashkërenditëse *und*. Në origjinal kjo lidhëz përdoret para lidhëzës *ngaqë*. Në strukturën shqipe të paraprirë nga *ngaqë* kuptimi i shkakut është një nxitje për veprim. Përkthimi i kësaj fjalie shkakore në gjuhën gjermane është bërë fjalë për fjalë. Edhe pse në përkthim përdoret lidhëza *weil* që zakonisht del në fjalitë që shprehin shkaqe reale, kuptimi i pjesës së varur nuk ka të bëjë me një shkak real, por më shumë me një argumentim të veprimit që pason në fjalitë kryesore, ose siç e kam thënë më lart me një nxitje për veprim. (Dihet që lidhëza *weil* del dhe në fjalitë shkakore argumentuese).

- Ndonjëherë lidhëza *ngaqë* përkthehet me një grup me kuptim shkakor të përbërë nga një parafjalë + një emër:

... Fërneti po i binte më shpejt se çdo herë në kokë, siç duket, *ngaqë* ishte i lodhur.<sup>280</sup> ... *Dass* der Fernet ihn diesmal rascher berauschte als sonst, wahrscheinlich *wegen der Erschöpfung*.<sup>281</sup>

---

<sup>274</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 58.

<sup>275</sup> General der toten Armee, f. 54.

<sup>276</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 90.

<sup>277</sup> General der toten Armee, f. 86.

<sup>278</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 141.

<sup>279</sup> General der toten Armee, f. 136.

<sup>280</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 119.

<sup>281</sup> General der toten Armee, f. 114.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadesës „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

Segmenti me kuptim shkakor në shqip *ngaqë ishte i lodhur* jepet në gjermanisht me grupin *wegen der Erschöpfung* (për shkak të lodhjes). Kemi folur më lart për dukurinë e transformimit të ndërtimeve me parafjalë shkakore në fjali shkakore (ose anasjelltas): për shkak të etjes → sepse kishte etje etj. Ndërtime të tilla janë barasvlera semantike.

Në rastin në fjalë shkakor është arsytim i një hamendjeje. Përmbajtjet e dy pjesëve të fjalisë shkakore lidhen në këtë rast me anë të një operacioni mendor: merret me mend që veprimi i alkoolit është më i shpejtë se zakonisht, për shkak të lodhjes. Kjo lloj shkakësie quhet në literaturën gjuhësore epistemike. Lidhja shkak-pasojë është e tillë që nuk shfaqet rregullisht. Te I. Kadare nuk është krejt e sigurtë, nëse vetëm për shkak të lodhjes alkooli veprimi shpejt. Në kontekst është i pranishëm grupi *siç duket* që e paraqet shkakun jo si real, por të marrë me mend. Edhe përkthimi në gjuhën gjermane ndjek relievin operacional të dhënies së raportit shkakor në gjuhën shqipe. Fjala *wahrscheinlich* (ndoshta) e paraqet shkakun si të mundshëm (jo real). Për ta dhënë shkakun si të mundshëm përdoren elemente semantike të posaçme *siç duket* dhe *wahrscheinlich*. Nuk është lidhëza vetë që referon në përmbajtje shkakore jo reale, por më shumë, përdorimi i elementeve që kanë semantikë të tillë (shprehin mundësi) dhe ngjyrosin tërë strukturën, duke e bërë të pamundur që lidhëza *ngaqë* ose *weil* të shprehin raporte të një shkakësie reale. Në fakt, ndërtimet me *ngaqë* paraqesin, zakonisht, shkaqe reale.

### VII.2.4 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës *që*

Pjesa e varur shakore me lidhëzën *që* është e lidhur shumë ngushtë me pjesën kryesore. Te I. Kadareja ajo përdoret:

- Në ndërtime që argumentojnë një gjendje të brendshme:

Me siguri gëzohen *që* ne po heqim ushtarët.<sup>282</sup> „Sicherlich sind sie auch froh darüber, dass wir die Soldaten herausholen.“<sup>283</sup>

Në përkthimin gjermanisht përdoret në këtë rast lidhëza *dass* që është përgjegjësjë e zakonshme e *që* -së, sidomos në kuptimin kundrinor të kësaj të fundit. Pjesa shkakore në këtë rast varet semantikisht nga folja e pjesës kryesore që tregon ndjenjë.

- Në ndërtime që argumentojnë një vlerësim:

Bën mirë *që* mbledh ushtarët e vrarë...<sup>284</sup> „... Du tust recht daran, dass du die toten Soldaten suchst...“<sup>285</sup>

Si në rastin e parë, ashtu dhe në dytin, ashtu në përkthimin gjermanisht, në fjalinë drejtuese përdoren si korrelate dy ndajfoljet përemërore *darüber* dhe *daran*. Përdorimi i tyre është i lidhur me përdorimin shkakor të lidhëzës *dass*.

Në shumë raste përdorimi shkakor i *që*-së nuk është shumë i qartë. Në kësi rastesh gërshetohen ngyrime shkakore me kundrinore, me përcaktore. Interesant është që në

<sup>282</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 208.

<sup>283</sup> *General der toten Armee*, f. 196.

<sup>284</sup> *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 183.

<sup>285</sup> *General der toten Armee*, f. 173.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadesës „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

përkthimet gjermanisht këto raste të ndërmjetme jepen me përdorimin e lidhëzës *da* (meqë), domethënë receptohen si shkakore:

Po tani *që* ti ke ikur, ... kush vete me dhentë e me dhitë?<sup>286</sup> ,Jetzt aber, *da* du nicht zu Hause bist... wer hütet da deine Schafe und Ziegen.<sup>287</sup>

### VII.2.5 Përdorimet dhe përkthimi i lidhëzës *pse*

Pse- ja si lidhëz shkakore përdoret shumë rrallë:

Po a s' do të na kërkojë llogari *pse* ikëm nga lufta.<sup>288</sup> ,Wird man uns nicht zur Rechenschaft ziehen, *weil* wir uns verdrückt haben?<sup>289</sup>

Ndërtimi me lidhëzën *pse* kryen funksion argumentues ndaj pyetjes në pjesën kryesore. Në gjermanisht *pse*-ja jepet me *weil* (sepse).

### VII.2.6 Lidhëza kohore me kuptim shkakor

Të tilla janë: *përderisa*, *pasi* :

Me siguri, e ke pasur mik, *përderisa* e kërkon kaq shumë.<sup>290</sup> ,Sicher er war dein Freund, *da* du ihn so eifrig suchst?<sup>291</sup>

Si në origjinal, ashtu dhe në përkthim lidhëza *përderisa* nuk ka kuptimisht asgjë kohore, përveç origjinës. Përsa i përket raportit që shprehet me anë të kësaj lidhëze, mund të thuhet që ai është argumentues. Kemi një shpjegim epistemik, domethënë në pjesën kryesore mendohet, besohet diçka që shpjegohet më tej në pjesën e varur. Kjo vlen edhe për ndërtimin me lidhëzën *da* (meqë) në gjermanisht.

### VII.2.7 Përfundime

Në kapitullin „ Lidhëzat shkakore në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ të shkrimtarit I. Kadare, ndër mjetet lidhëse të shprehjes së raporteve shkakore, trajtohen vetëm lidhëzat. Ky kapitull ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë paraqiten dhe analizohen lidhëzat nënrenditëse shkakore në variantin origjinal. Në pjesën e dytë bëhet një krahasim i lidhëzave të përdorura nga I. Kadareja dhe elementeve lidhore përgjegjëse që dalin në përkthimin e romanit në gjermanisht.

Për pjesën e parë si sfond teorik kemi përdorur literaturë shqiptare. Jemi mbështetur kryesisht në trajtimin e lidhëzave dhe fjalive shkakore në „Gramatika e Gjuhës Shqipe I, II“ dhe në artikujt e S. Floqit. Krahas këtyre kemi bërë dhe vetë vërejtje teorike ose kemi mbajtur qëndrime vetiake. Në literaturën shqiptare lidhëzat shkakore grupohen në:

- lidhëza konstatuese të shkakut se, pse, sepse, ngaqë, nga shkak se etj.
- lidhëza motivuese, arsyetuese meqë, meqënëse, duke qenë se etj.

---

<sup>286</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 95.

<sup>287</sup> General der toten Armee, f. 92.

<sup>288</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 93.

<sup>289</sup> General der toten Armee, f. 90.

<sup>290</sup> Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 184.

<sup>291</sup> General der toten Armee, f. 174.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

- lidhëza kohore kur, si, pasi, sapo, posa etj.

Ndërsa periudha me fjali të varur shkakore ngërthen dy nëntipa kryesorë<sup>292</sup>:

- periudhën me fjali shkakore konstatuese
- periudhën me fjali shkakore arsyetuese

Dallimi i nëntipave të fjalive shkakore nuk varet vetëm nga lidhëzat e përdorura, por dhe nga faktorë të tjerë kuptimorë, modalë, situacionalë etj. Kjo e bën të vështirë hetimin dhe klasifikimin e fjalive shkakore të përdorura në tekste të ndryshme. Vërtet lidhëzat shkakore të shqipes e kanë një lloj specializimi kuptimor, por shpesh ato përdoren njëra për tjetrën dhe dallimet fshihen. Në përcaktimin e llojit të fjalisë së varur shkakore luan një rol të rëndësishëm dhe fjalia drejtuese me përmbajtjen e saj. Sado që kauzaliteti në gjuhësi ka fytyrën e vet të veçantë (dallohët nga kauzaliteti logjik, filozofik dhe fizik), ai në vetvete e ka një dimension logjik. Në interpretimin e dukurive kauzale gjuhësore shpesh ndërhyjnë dhe intuita. Të gjitha këto bëjnë që përcaktimi i raporteve dhe i fjalive shkakore të jetë i vështirë. Këtë vështirësi ne e ndjejmë edhe gjatë trajtimit të lidhëzave shkakore në romanin e Kadaresë. Jo gjithnjë faktet gjuhësore shkakore u përshtateshin kallëpeve teorike. Shpesh na u desh të bëjmë vërejtje teorike për të shpjeguar dukuri të caktuara, p.sh.: lidhëza *ngaqë* (konstatuese) del edhe me kuptim motivues-shpjegues etj.

Si në çdo tekst letrar, edhe në tekstin e I. Kadaresë, raportet shkakore janë në sasi më të pakta se ato kohore apo hapësinore. Edhe rrëfimi në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ nuk mbështetet në principin e paraqitjes së të gjitha shkaqeve të veprimeve, gjendjeve dhe ngjarjeve. I. Kadareja i le fushë të lirë parafytyrimit të lexuesit. Pse-ja e shumë gjërave shpjegohet intuitivisht nga lexuesi. Rrokja e raporteve kohore dhe hapësinore është më e lehtë se sa të kuptuarit e lidhjeve shkak-pasojë. Kuptimi dhe interpretimi i raporteve shkakore është shkalla e fundit e kuptimit të një teksti.

Kur flasim për kauzalitet në gjuhësi, kemi parasysh jo vetëm realizimin gjuhësor të shkakësisë reale, ku shkak prodhon në rrjedhën kohore një pasojë, por një marrëdhënie të caktuar, që shprehet me anë të fjalisë shkakore, ku shkak nuk është gjithnjë shkak logjik, pasoja, gjithashtu, nuk është pasojë logjike. Shpesh herë shkak është një shpjegim, sqarim, argumentim, arsyetim i përmbajtjes së shprehur në pjesën kryesore. Ose, thjeshtë, një mënyrë të lexuari e një ndërtimi me lidhëz shkakore. Edhe në romanin e I. Kadaresë „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ pjesa më e madhe e marrëdhënieve shkakore janë marrëdhënie argumentuese.

Në romanin e I. Kadaresë përdoren këto lidhëza shkakore: *se, sepse, ngaqë, që, pse*. Në paragrafin përkatës ne kemi analizuar e përshkruar hollësisht përdorimin e këtyre lidhëzave në roman. Lidhëza më e përdorshme është *sepse*. Ajo është një ndër mjetet e tjera stilistike që i japin romanit ngjyrim libror. Në veprën në fjalë kjo lidhëz përdoret si për të sinjalizuar shkak real, ashtu dhe motiv, arsye ose argument.

Në pjesën e dytë të këtij kapitulli bëhet një krahasim midis ndërtimeve shkakore të realizuara me lidhëza në origjinal dhe në përkthimin gjermanisht. Përkthyesit O. Buchholz-i dhe W. Fiedler-i, albanologë të njohur, kanë dhënë me saktësi gjuhësore dhe stilistike strukturat shkakore të romanit të Kadaresë. Pas ndërtimeve shkakore të përkthimit gjëllin po ajo shkakësi e gjërave si te vetë Kadareja. Kompetenca e lartë gjuhësore, njohja perfekte e shqipes ka bërë që dy përkthyesit të kenë në dorë një mjet

---

<sup>292</sup> Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Tiranë, 2002, f. 563 – 571.

të sigurtë, siç është gjuha, për të zbuluar botën shqiptare të romanit, në rastin tonë pse në reale ose jo reale të gjërave.

Për të paraqitur krahasimin me gjithë detajet që rrjedhin nga përdorimi i mjeteve paralele të gjuhëve të ndryshme jemi mbështetur në teori të ndryshme (ose në qëndrime subjektive), por sidomos në teorinë e Sweetser-it.<sup>293</sup> Na u desh të vepronim me këtë teori se një përkthim është, njëkohësisht, dhe interpretim. Dhe teoria e Sweetser-it mbi kuptimin e raporteve shkakore ka të bëjë shumë me rrokjen e këtyre ose siç e quan autori „lexim i marrëdhënieve shkakore“. Në rastin tonë ishte interesante mënyra e leximit të këtyre raporteve nga përkthyesit.

Sipas Sweetser-it marrëdhëniet shkakore mund të lexohen në disa mënyra. Një fjali si:

Vera do të qëndrojë në shtëpi, sepse bie shi.

mund të parafrazohet së paku në tri mënyra:

Vera do të qëndrojë në shtëpi dhe shkak për këtë është fakti që po bie shi.

Unë jam i bindur që Vera do të qëndrojë në shtëpi dhe shkak për bindjen time është fakti që po bie shi.

Unë këshilloj që Vera të qëndrojë në shtëpi dhe shkak për këtë urdhër është vlerësimi nga unë i faktit që po bie shi.

Këto mënyra të leximit, interpretimit të ndërtimeve shkakore quhen: dispozicionale, epistemike, deontike. Në ndërtimin dispozicional kemi raporte përmbajtjesh objektive. Njëra fjali (përmbajtje) paraqet shkakun, tjetra-pasojën. Këto raporte quhen ndryshe dhe shkakësi reale.<sup>294</sup>

Në rastin e dytë, raporte epistemike, kemi lidhjen e një përfundimi të folësit me një dukje, e cila çon në atë përfundim. Shiu që bie e çon folësin në përfundimin që Vera do të qëndrojë në shtëpi.

Në rastin e tretë kemi një marrëdhënie shkakore në rrafshin e aktit të të folurit. Midis përmbajtjeve të lidhura njëra shpreh këshillë, urdhër, tjetra – motiv. Ky motiv justifikon urdhërin. Lidhëza shkakore në të tre rastet është e njëjtë, *se*. E njëjta lidhëz, domethënë ndërtimi që realizohet me anë të saj, mund të lexohet, interpretohet në mënyra të ndryshme. Interpretimi dispozicional është asnjëherë, jo modal. Interpretimi epistemik dhe deontik janë modale. (modaliteti, në këtë rast, është kategori semantike që shpreh qëndrimin e folësit ndaj përmbajtjes së një thënieje). Në këtë kuptim modaliteti nuk është vetëm kategori gramatikore, por lidhet dhe me llojet e fjalive: pohore, pyetëse, urdhërore etj. Në pikëpamje logjike modaliteti mund të jetë epistemik, deontik; kështu mund të flitet për një logjikë epistemike e për një logjikë deontike.<sup>295</sup>

Si në origjinal, ashtu dhe në përkthim mbizotërojnë raportet shkakore modale. Ndër lidhëzat e shqipes që mund të shërbejnë për ndërtime shkakore modale janë *se/sepse*, *ngaqë, që, pasi*. Këto i përdor dhe I. Kadareja në rrëfimin e tij për të shprehur lidhje të ndryshme shkak –pasojë me elemente subjektive. Përmbajtjen shkakore të ndërtimeve të I. Kadaresë përkthyesit e japin të thyer në prizmin e gjuhës së tyre. Lidhëza kryesore e gjuhës gjermane, që është e aftë të marrë pjesë në ndërtimet shkakore të të

---

<sup>293</sup> Sweetser, E., *From etymology to pragmatics*, Cambridge, University Press, 1990, f. 76.

<sup>294</sup> Zifonun, 1997, f. 2296.

<sup>295</sup> Bybee, J. L./ Fleischmann, S., *Modality in grammar and discourse*, Amsterdam, 1995, f. 79.

## Lidhëzat nënrenditëse shkakore në romanin e I. Kadesës „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

---

tri rrafshëve është *weil* (sepse). Në përkthim kjo lidhëz përdoret shpesh për të dhënë ato raporte shkakore që në origjinal jepen me *sepse*. Lidhëza *sepse* e origjinalit ndodh të jepet dhe me *denn* (meqë) ose me *da* (ngaqë). Të tria lidhëzat e gjuhës gjermane *weil, da, denn* mund të shfaqen në ndërtimet shkakore modale.

Më se njëherë ndodh që në përkthim raportet shkakore të origjinalit të kenë një tingëllim tjetër. Kjo nuk ka të bëjë me të kuptuarit e segmentit shkakor, por me interpretimin e tij. Kështu fragmenti: *Telegrafojnë ata, - tha gjenerali. – Ata janë të shqetësuar sonte.*, ideja e shkakut është dhënë këtu në mënyrë asindete. Ndërsa në përkthim shfaqet lidhëza *weil* (sepse):

‘Sie telegrafieren eben, sagte der General; *weil* sie in dieser Nacht besonders unruhig sind.’

Sipas analizës së bërë në kapitullin e mësipërm, formulimi në gjuhën shqipe është më shprehës. Kjo realizohet me anë të dukurisë së dezintegritimit sintaksor. Lidhja e dy fjalive asindete është më e çlirët, integrimi sintaksor më i dobët se lidhja e realizuar me lidhëzën *weil*.

Në kapitullin përkatës ne i kemi paraqitur dhe analizuar të gjitha rastet e asimetrisë në paraqitjen e raporteve shkakore në origjinal dhe në përkthim.

**Kreu VIII Një përdorim i veçantë i lidhëzës „weil“ (se/ sepse) në gjermanishten e folur**

Si lidhëz nënrenditëse *weil* (sepse) përdoret në pjesën e varur të fjalisë shkakore, ku folja vendoset në fund. Sot në gjuhën e folur, gjithnjë e më shumë, vihet re përdorimi i kësaj lidhëze në pjesën e varur të fjalisë shkakore, ku folja nuk vendoset në fund, por në vendin e dytë, pas kryefjalës. Në paragrafët në vijim do të merremi me këtë dukuri. Gjatë shtjellimit të kësaj çështjeje ne do të përqipemi t'i përgjigjemi pyetjes: A është i gabuar përdorimi i *weil* (se/sepse) në pjesët e varura të fjalisë shkakore me folje në vend të dytë? Apo kemi të bëjmë me një zgjerim të funksioneve të këtij elementi lidhës?

VIII.1 Veçori sintaksore të fjalive hipotetike ku përdoret lidhëza “*weil*” (sepse)

VIII.1.1 “*Weil*” (sepse) në fjali me folje në fund të pjesës së varur

Si lidhëz nënrenditëse *weil* (sepse) paraqet këto veçori:

- Është e palakueshme.
- Nuk drejton rasa.
- Shpreh lidhje shkakore midis dy konstrukteve.
- Këto dy konstrukte janë fjali ose thënie.
- Lidh direkt dy fjali, pjesë të një fraze shkakore.
- Paraprin pjesën e varur.

Siç tregojnë veçoritë e sipërnumëruara, lidhëza në shqyrtim lidh jo vetëm konstrukte të gjuhës së shkruar, por edhe të gjuhës së folur. Analiza thëniesh të mbledhura në komunikime autentike tregojnë se kjo lidhëz mund të funksionojë edhe si konektor (mjet lidhës) midis një thënieje dhe një thënieje tjetër të mbirenditur, brenda një sekuence bisedore. Në raste të tilla *weil* (sepse) është, në radhë të parë, një element strukturues i bisedës (diskursmarker). Kuptimi i saj shkakor kalon në plan të dytë. Kjo është një dukuri e përhapur në gjuhën e folur, por ne nuk do ta shtjellojmë me hollësi këtë çështje. Vetëm do të përmendim shkurtimisht një klasifikim të Gohl-it/Günthner-it.<sup>296</sup>

Dy autoret e materialit të përmendur dallojnë katër funksione të elementeve të tilla:

- Këto elemente prijnë thënie që sjellin informacion plotësues në bisedë.
- Bashkërendojnë sekuenca narrative.
- Paraprijnë thënie me të cilat realizohet këmbimi i temës së bisedës.
- Mund të shërbejnë si sinjal i vazhdimit të bisedës.

Le të kthehemi përsëri në pikën ku u nisëm: *weil* (sepse) në fjali me folje në fund të pjesës së varur:

- (a) Die Strasse ist nass, *weil* es geregnet hat. ‘Rruga është e lagur, sepse ka rënë shi.’

---

<sup>296</sup> Shih, Gohl, Ch./ Günthner, S., „Grammatikalisierung von weil als Diskursmarker in der gesprochenen Sprache“, botuar në, *Zeitschrift der Sprachwissenschaft, Band 18, Heft 1*, Berlin, de Gruyter 1999, f. 45.

## Një përdorim i veçantë i lidhëzës „weil“ (se/ sepse) në gjermanishten e folur

---

Pjesa e varur me lidhëzën *weil* mund të qëndrojë pas pjesës kryesore, por edhe para saj:

- (b) *Weil es geregnet hat*, ist die Strasse nass. ‚Sepse ka rënë shi, rruga është e lagur.‘

Pjesa shkakore mund të vendoset dhe në mes të pjesës kryesore:

- (c) Die Strasse ist, *weil es geregnet hat*, nass. ‚Rruga është, për shkak se ka rënë shi, e lagur.‘

Pjesa e varur me *weil* (sepse) mund të transformohet në një rrethanor:

- (d) *Wegen des Regens* ist die Strasse nass. ‚Rruga është e lagur për shkak të shiut.‘

Nga ana sintaksore fjalitë (a)-(c) mund të realizohen dhe me lidhëzën *da* (ngaqë) në vend të lidhëzës *weil* (sepse). Të dyja këto lidhëza manifestojnë veçori të ngjashme sintaksore. Veç lidhëza *da* (meqë) nuk pranon korrelate, si *darum*, *deshalb*, *deswegen* (për këtë, prandaj, për këtë arsye) në pjesën kryesore. Ndërtimet me *da* (meqë) nuk u përgjigjen, në formë eliptike, as pyetjeve me *warum* (pse). Kjo ndodh se ato nuk mund të qëndrojnë pa pjesën kryesore:

- (e) Die Strasse ist deswegen nass, weil es geregnet hat.  
(f) Strasse ist deswegen nass, da es geregnet hat. (?)  
(g) Warum ist die Strasse nass? – Weil es geregnet hat.  
Warum ist die Strasse nass? – Da es geregnet hat.(?)

Në pjesët e varura të prira nga *weil* (sepse) shkakun mund të shprehet ose mund të supozohet, në ndërtimet me *da* (meqë) shkakun vetëm merret me mend, presupozohet. Prandaj fjalia (g) është e pamundur.

### VIII.1.2 Fjalitë e varura shkakore me folje në vendin e dytë

Në gramatikat e së kaluarës të gjuhës gjermane ky rast, kjo dukuri, ose nuk përmendej fare, ose përmendej shkurt me shënimin “përdorim i gabuar”. Në gramatikat e kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë bëhet fjalë për këtë përdorim të lidhëzës *weil* (sepse).<sup>297</sup> Eisenberg-u<sup>298</sup> duke iu referuar Keller-it (Keller, 1993) flet për përdorimin e *weil* (sepse) në fjali të varura shkakore me folje në vendin e dytë në ligjërimin replikativ. Heringer-i tërheq vëmendjen mbi përdorimin e ndërtimeve të tilla në gjuhën e folur, pa u marrë me kontekstin e përdorimit. Një informacion i shkurtër mbi kontekstin e përdorimit jepet në Online-Grammatik Grammis, ku thuhet: “Ndërtime shkakore me foljen në vendin e dytë vihen re në rrafshin komunikativ epistemik.”<sup>299</sup>

Në botimin e katërt të gramatikës Duden, 1984, as që bëhet fjalë për këtë fenomen. Vetëm në botimin e gjashtë, 1998, shkruhet për përdorimin e këtij ndërtimi në gjuhën

---

<sup>297</sup> Shih, Eisenberg, P., *Grundriss der deutschen Grammatik*. 3. überarbeitete Auflage, Stuttgart, Metzler, 1994, f.355; Engel, U., *Deutsche Grammatik*. 3. korrigierte Auflage. Heidelberg, Groos, 1996, f. 730.

<sup>298</sup> Eisenberg, P., *Grundriss der deutschen Grammatik*. 3. überarbeitete Auflage, Stuttgart, Metzler, 1994, f. 358.

<sup>299</sup> <http://hypermedia.ids-manheim.de/pls/grammis>, 09. 07. 04.



e folur. Njëkohësisht theksohet se kjo dukuri nuk mund të hyjë në standard. Në gramatikën e tyre, ribotim i vitit 2004, Helbig-u/Buscha i kushtojnë këtij fenomeni një paragraf të gjithë, ku përshkruajnë dhe dallimet e dy përdorimeve: me folje në vend të dytë dhe me folje në fund të pjesës së varur shkakore.<sup>300</sup>

Në përdorime të tilla *weil* (sepse) është e krahasueshme me *denn* (se/ngaqë). Fjalja me *weil*, ku folja është në vendin e dytë, nuk mund të zëvendësohet me një rrethoror shkak dhe nuk mund të referojë në një fjalë korrelative në pjesën kryesore:

Die Strasse ist nass, *denn* es hat geregnet. 'Rruga është e lagur, *meqë* ka rënë shi.'

Die Strasse ist nass, *weil* es hat geregnet. 'Rruga është e lagur, *sepse* ka rënë shi.'

Es hat geregnet, *weil* die Strasse nass ist. 'Ka rënë shi, *sepse* rruga është e lagur.'

*Denn* es hat geregnet, die Strasse ist nass. (?) 'Ngaqë ka rënë shi, është rruga e lagur.'

*Weil* es hat geregnet, die Strasse ist nass. (?) 'Sepse ka rënë shi, rruga është e lagur.'

Die Strasse ist *deshalb* nass, *denn* es hat geregnet. (?) 'Rruga është prandaj e lagur, sepse ka rënë shi.'

Die Strasse ist *deshalb* nass, *weil* es hat geregnet. (?) 'Prandaj rruga është e lagur, sepse ka rënë shi.'

Për korrektësinë ose pakorrektesinë e ndërtimeve të tilla do të japim shpjegime në një paragraf tjetër.

Por këtu mund të themi: edhe nëqoftëse *weil* (sepse) në gjuhën e folur manifeston veçori të njëjta sintaksore me *denn* (se/ ngaqë), kjo nuk do të thotë që ajo po e zhvendos lidhëzën bashkërenditëse *denn*. Edhe pse në përdorim ajo merr përsipër funksionet e *denn* (se/ngaqë), nuk mund të flitet për zhvendosje. Më tepër mund të flitet për zgjerim të funksioneve të *weil* (sepse).

### VIII.2 Një vështrim semantiko-pragmatik i fjalive me *weil* (sepse)

Si lidhëz shkakore *weil* lidh dy konekte, pjesë fjalish apo thëniesh, që kanë midis tyre marrëdhënie shkakore. Në gjuhën e shkruar, në pikëpamje sintaksore, është fjala për dy pjesë fjalish. Në gjuhën e folur, në pikëpamje funksionale, është fjala për dy propozicione. Propozicioni që drejtohet nga lidhëza *weil* (sepse) shpreh shkakun, arsyen për atë që jepet gjuhësisht në pjesën kryesore. Në raste të tilla folja e pjesës së drejtuar me *weil* (sepse) është në pozicion fundor. Siç e kemi përmendur dhe më lart, në gjuhën e folur po përdoren gjithnjë e më shumë fjali me *weil*, ku folja nuk është në fund të fjalisë së varur, por në vendin e dytë, pas kryefjalës. Kjo tendencë në rritje nuk mund të trajtohet thjesht si gabim, si përdorim jo korrekt. Për më tepër dukuria në fjalë nuk shfaqet vetëm në grupe të caktuara sociale ose regionale. Nuk duhet shpërfillur gjithashtu që gjuha nuk është një sistem statik. Ajo është një dukuri përherë në lëvizje dhe në ndryshim.

<sup>300</sup> Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, 8., neubearb. Auflage, Leipzig, 2004., f.413.

## Një përdorim i veçantë i lidhëzës „weil“ (se/ sepse) në gjermanishten e folur

Le të shohim e të shpjegojmë tani funksionet e lidhëzës *weil*:

- Funksioni faktik

*Weil* (sepse) e shfaq këtë funksion kur lidh dy pjesë, ku pjesa kryesore shënon pasojën dhe pjesa e varur – shkakun. Një marrëdhënie të tillë mund ta paraqesim kështu:

Die Strasse ist nass,	weil	es geregnet hat
b	←	a
pasojë	←	shkak/ arsye

Për një relacion të tillë shkakor drejtohet pyetja: Pse është kështu?

- Funksioni epistemik

Në këtë funksion ndërtimet me *weil* nuk shprehin raporte shkakore logjiko-faktike/reale, por qëndrimin e folësit ndaj një dukurie. Ky qëndrim ka vlerën e një arsytimi ndaj një fenomeni. Raporti shkakor në këtë rast është marrëdhënia midis një hamendjeje dhe një arsyeje:

Es hat geregnet	weil	die Strasse ist nass
b	→	a
Hamendje/pretehim	→	Shkak i vonuar

Si shkak për rrugën e lagur hamendësohet shiu që do të ketë rënë para momentit soditës të rrugës së lagur. Për të pyetur mbi këtë situatë përdoret pyetja: Pse mendon/beson kështu? (që rruga është lagur nga shiu).

Në përdorime të tilla epistemike përdoren ndërtimet me lidhëzën *weil* (sepse) në vendin e dytë në pjesën e varur. Konstrukte të tilla janë zakonisht replika. Është diçka e diskutueshme, nëse me funksion epistemik mund të dalë dhe *weil* në pozicion fundor.

- Funksioni ilokutiv

Ndërtimet me *weil*, që përmbushin funksion ilokutiv, shërbejnë si argument i aktit ligjërimor:

- Gib mir bitte die Butter. *Weil* da komm ich grad nicht dran. ‚Më jep, të lutem, pak gjalp. Se nuk po e arrij dot.‘
- Gibt es etwas anderes außer „Alexander“? *Weil* den habe ich schon gesehen. ‚Ka ndonjë gjë tjetër (film) përveç „Aleksandër“? Se atë e kam parë.‘

Një raport i tillë shkakor i përgjigjet pyetjes: Pse po pyet për këtë? Ilokucionet e fjalive nuk është e thënë që të jenë vetëm pyetje ose kërkesa. Ato mund të jenë çfarëdo thëniesh apo fjalish me vlerë ilokutive. Keller-i<sup>301</sup> përmend dhe ndërtime të tjera ilokutive që shprehin: paralajmërime, premtime, kërcënime etj.:

<sup>301</sup> Keller, R., „Das epistemische weil. Bedeutungswandel einer Konjunktion“, botuar në, *Sprachgeschichte und Sprachkritik*. Festschrift für Peter von Polenz. Berlin/New York: de Gruyter, 1993, f. 241.

- (c) Beiß da lieber nicht hinein! Weil das ist unheimlich scharf.“ ‚Më mirë mos e kafsho! Se është shumë djegës!
- (d) Bis spätestens übermorgen haben Sie Ihr Geld. Weil ich will endlich wieder in Ruhe schlafen können. ‚E shumta deri pasnesër do t’i merrni paratë. Se unë dua më në fund të fle i qetë.’
- (e) Sieh bloß zu, dass das beim nächsten Mal klappt. Weil ich kann nicht mehr mit ansehen. ‚Shih se mos e mbaron herën tjetër. Se unë nuk mund të duroj më.‘<sup>302</sup>

Keller-i pohon gjithashtu se, nëse fjalia ilokutive shpreh një hamendje, atëherë fjalia me lidhëzën *weil* shpreh një argument epistemik. Në raste të tilla fshihet, në princip, dallimi midis funksionit epistemik dhe ilokutiv. Ai mbetet një dallim i karakterit asertiv (ilokutiv) - jo asertiv (epistemik). Për Keller-in rëndësi të dorës së parë ka vetëm dallimi midis funksionit faktik/real dhe atij epistemik. Funksionin epistemik e përmbushin ndërtimet me lidhëzën *weil* ku folja është në vend të dytë.<sup>303</sup>

### VIII.3 Fjalitë e varura shkakore me lidhëzën *weil* dhe foljen në vend të dytë

Në letërsinë gjuhësore gjenden shpjegime të ndryshme për përdorimin e *weil* (sepse) në fjali me folje në vendin e dytë. Ka gjuhëtarë që flasin për një shndërrim leksikor të *weil*, shndërrim i cili ka ndodhur si në planin sintaksor (nga *weil* në fjali me folje në fund në *weil*, në fjali me folje në vendin e dytë), ashtu dhe në planin semantik (nga *weil* faktik në *weil* epistemik). Keller-i shkon akoma më tej kur pohon që një shndërrim i tillë nuk përjashtohet dhe në rastin e gjuhës së shkruar. „Megjithëse, thotë ai, kjo dukuri kufizohet vetëm në gjuhën e folur.“<sup>304</sup> Në përmbledhjen e vet ai shkon edhe një hap tjetër më tej, kur e përdor lidhëzën *weil* në fjali me folje në vendin e dytë:

...Aber das wird sich ändern, *weil schlechtere Alternativen*, die nur deshalb in Gebrauch sind, weil es immer schon so war, *halten sich nicht lange*.<sup>305</sup> , ... Por kjo do të ndryshojë, *sepse alternativat më të këqia*, që janë në përdorim vetëm se kështu ka qenë gjithnjë, *nuk do të rezistojnë gjatë*.’

Wegener-i i referohet Küper-it<sup>306</sup> dhe nuk pranon që ka ndodhur një shndërrim kuptimor i *weil* por: „Është i njëjti relacion semantik ku argumentimi njëherë mbetet në rrafshin propozicional real/faktik, njëherë kalon nga nga ky rrafsh në atë ilokutiv.“<sup>307</sup>

Është e vërtetë që relacionet e konekteve zhvendosen nga rrafshi propozicional (lidhje shkakore faktike/reale) në rrafshin ilokutiv (epistemik). Por nga kjo zhvendosje fitohet një semantikë e re e thënies.

<sup>302</sup> Keller, R., „Das epistemische weil. Bedeutungswandel einer Konjunktion“, botuar në, *Sprachgeschichte und Sprachkritik*. Festschrift für Peter von Polenz. Berlin/New York: de Gruyter, 1993, f. 241.

<sup>303</sup> Po aty, 1993, f. 241.

<sup>304</sup> Po aty, f. 222.

<sup>305</sup> Po aty, f. 245.

<sup>306</sup> Wegener, H., „Syntaxwandel und Degrammatikalisierung im heutigen Deutsch? Noch einmal zu weil-Verbzweit“, botuar në, *Deutsche Sprache* 27, 1999, f. 3-26.

<sup>307</sup> Wegener, H., „Weil – das hat schon seinen Grund.“ Zur Verbstellung in Kausalsätzen mit weil im gegenwärtigen Deutsch“, botuar në, *Deutsche Sprache* 21, 1993, f. 289-305, këtu f. 299.

Wegener-i e mohon ekzistencën e ndërtimeve të tilla në gjuhën e shkruar. Wegener-i, ashtu si dhe Keller-i, dallon dy funksione të *weil* (sepse) që realizohen në ndërtime të ndryshme sintaksore. Ajo flet për „argumentim objektiv“, në fjalitë me *weil*, ku folja është në fund, dhe „justifikim subjektiv“ në fjalitë e varura shkakore me foljen në vend të dytë.<sup>308</sup>

Në gjuhën e shkruar këto funksione realizohen me leksema të ndryshme dhe me vendosjen e foljes së pjesës së varur shkakore në vende të ndryshme: *denn* (se, ngaqë) me folje në vendin e dytë dhe *da* (meqë) me folje në vendin e fundit. Në gjuhën e folur të dyja këto funksione i merr përsipër vetëm një leksemë, *weil* (sepse).

Një veçori e rëndësishme e ndërtimeve me *weil*, ku folja është në vendin e dytë, ka të bëjë me intonacionin dhe pauzat e shqiptimit të njëjësive të tilla. Zakonisht konstruktet me *weil* epistemik-ilokutiv shqiptohen me një intonacion dykulmor dhe me pauzë midis pjesëve të fjalisë shkakore. Ndërsa ndërtimet shkakore me *weil* faktik shqiptohen me intonacion njëkulmor dhe pa pauzë midis pjesëve.

Susanne Uhmman-i bën fjalë për dy variante të lidhëzës *weil* dhe për ndryshime semantike midis tyre. Të dyja variantet nuk janë ekuivalente, as nga ana gramatikore, as nga ajo pragmatike: „Në to manifestohet ekzistenca e dy lidhëzave të ndryshme shkakore, domethënë kemi një polisemi të *weil*.“<sup>309</sup>

Keller-i dhe Wegener-i i atribuojnë funksione të ndryshme *weil* në fjali me folje në fund dhe me folje në vendin e dytë. *Weil* në fjali me folje në fund përmbush funksion faktik/real, ndërsa në fjali me folje në vendin e dytë kryen funksion epistemik-ilokutiv. Uhmman-i i njeh lidhëzës *weil* në fjali me folje në vend të dytë edhe funksion real/ faktik.<sup>310</sup>

Kështu mund të thuhet që në gjuhën e folur lidhëza *weil*, si në pikëpamje sintaksore, ashtu dhe në pikëpamje semantike, po merr gjithnjë e më shumë veçoritë e lidhëzës *denn* (se/ngaqë) dhe po e zhvendos këtë të fundit nga terreni përdorimor.

### VIII.3 Përfundime

Gjuha është një sistem në zhvillim që i nënshtrohet gjithfarëlloj ndryshimesh. Një ndryshim i tillë është dhe përdorimi i *weil* (sepse) në fjali të varura shkakore me folje në vendin e dytë. Pasch-i e përfundon argumentimin e saj për këtë çështje me pyetjen retorike: „Pse duhet të jetë *weil* (sepse) më keq se *denn* (ngaqë) dhe pse duhet të jetë për foljen vendi pas kryefjalës më i keq se vendi në fund të fjalisë?“<sup>311</sup>

Nga analiza e mësipërme dhe nga shumë analiza, gjykime, prova dhe testime të tjera rezulton se përdorimi i lidhëzës *weil* (sepse) në fjali me folje jo në fund të fjalisë, por në vendin e dytë nuk është jo korrekt, i gabuar. Në këtë rast bëhet fjalë për zgjerim të funksioneve të kësaj lidhëzeje. Krahas përdorimit të zakonshëm të saj në fjali që shprehin shkaqe reale, kemi dhe përdorime të tjera që mund të interpretohen si epistemike dhe si ilokutive. Një veçori e rëndësishme dalluese e këtyre përdorimeve

<sup>308</sup> Wegener, H., „Weil – das hat schon seinen Grund.“ Zur Verbstellung in Kausalsätzen mit weil im gegenwärtigen Deutsch“, botuar në, *Deutsche Sprache* 21, 1993, f. 289-305, f. 303.

<sup>309</sup> Uhmman, S., „Nur ein Sturm in Lexikonglas. Zur aktuellen Verbstellungsvariation in weil-Sätzen“, botuar në, *Wuppertaler Arbeitspapiere zur Sprachwissenschaft* 13, 1996, f. 1-26, këtu f. 3.

<sup>310</sup> Uhmman, S., „Nur ein Sturm in Lexikonglas. Zur aktuellen Verbstellungsvariation in weil-Sätzen“, botuar në, *Wuppertaler Arbeitspapiere zur Sprachwissenschaft* 13, 1996, f. 1-26, këtu f. 21.

<sup>311</sup> Pasch, R., „Weil mit Hauptsatz – Kuckucksei im denn-Nest“, botuar në, *Deutsche Sprache*, 25/3, 1997, f. 296.

ka të bëjë me intonacionin, i cili pasqyron në strukturat sipërfaqësore aspekte të ndryshme pragmatike.

Nga përshkrimi ynë del gjithashtu qartë se gjuhëtarët që janë marrë me këtë çështje nuk janë gjithnjë të të njëjtit mendim. Por ata pranojnë unanimisht se përdorimi në fjalë i lidhëzës weil (sepse) nuk mund të quhet i gabuar. Këtu kemi të bëjmë, siç kemi thënë më lart, me një zgjerim të funksioneve të kësaj lidhëzeje. Ulrike Gaumann-i<sup>312</sup> e quan këtë dukuri „Bestandteil der kommunikativen Kompetenz“ (Pjesë përbërëse e kompetencës komunikative).

Po e mbyllim shtjellimin tonë më fjalët e Eisenberg-ut.<sup>313</sup>

„Në rastin e weil në fjali me folje në vendin e dytë nuk kemi të bëjmë vetëm me një formë gjuhësore, por me një formë me një funksion të caktuar dhe me një qëllim komunikativ. Dhe a ekzistojnë vallë mendje njerëzore që t’u diktojnë përdoruesve të gjuhës si të flasin dhe madje çfarë të thonë?“

---

<sup>312</sup> Gaumann, U., „Weil die machen jetzt bald zu“. *Angabe- und Junktivsatz in der deutschen Gegenwartssprache*, Göppingen, Kümmerle, 1983, f. 4.

<sup>313</sup> Eisenberg, P., „Der Kausalsatz ist nicht zu retten“, botuar në, *Praxis Deutsch* 20/118, 1993, f.11.

### **Kreu IX Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)**

Shkakësia implicite është veçoria më e qenësishme e foljeve ndërvetore. Këto folje shënojnë veprime, që ndodhin midis njerëzish, gjendje shpirtërore ose procese mendore. Konceptimi i shkakësisë drejtohet nga semantika e foljes, e cila jep informacion implicit mbi shkakun e ngjarjes ose të ndodhisë së paraqitur nga folja. Foljet ndërvetore zënë një vend të gjerë e të rëndësishëm në fjalorët foljorë. Studime të ndryshme bëjnë të ditur se rreth 30% e foljeve janë interpersonale. Është fjala për studime gjuhësh të ndryshme.<sup>314</sup>

Ekzistenca e foljeve ndërvetore në një sasi të tillë të konsiderueshme lidhet me faktin e thjeshtë se njeriu gjatë jetës së tij vendos kontakte me botën përreth, me natyrën dhe me njerëzit e tjerë. Veprimet që shprehin raporte të njeriut me natyrën, me objektet etj. jepen me folje veprorë ose ergative, numri i të cilave është shumë më i madh se ai i foljeve që shprehin veprime e gjendje tipike për jetën e për marrëdhëniet midis njerëzve.

Vetë foljet ndërvetore mund të klasifikohen në grupe e nëngrupe. Së pari dallojmë dy grupe:

- Folje ndërvetore që shënojnë veprime ose sjellje ndëraktive: godas, numëroj, vras, kritikoj etj.
- Folje ndërvetore që tregojnë gjendje: mërzis, frikësoj, zhgënjej, frymëzoj etj.

Foljet ndërvetore aktive klasifikohen më tej:

- Folje që përmbajnë në strukturën e tyre argumentore një veprues dhe një pësues: zbuloj, zgjedh, gjej, braktis etj.
- Folje që kërkojnë një plotës-veprues dhe një plotës që reagon ndaj veprimit të shprehur nga folja: kritikoj, lëvdoj, korrigjoj, këshilloj etj.

Foljet ndërvetore që tregojnë gjendje dhe procese psikike-mendore ndahen më tej në:

- Folje që kërkojnë dy argumente, të cilët luajnë njëkohësisht dhe rolin semantik të stimulit dhe të përjetuesit: kërcënoj, mrekulloj, dëfrej, qetësoj etj.
- Folje me strukturë dyargumentore, ku argumenti subjekt është përjetësues dhe argumenti objekt është stimul, shkak i gjendjes së shprehur nga folja: dashuroj, përbuz, admiroj, besoj etj.

Hulumtimet dhe eksperimentet psiko-linguistike kanë treguar se recipientët i konceptojnë veprime a gjendje të tilla të lidhura me një shkak, i cili mund të jetë subjekti ose objekti që kërkon folja ndërveprorë.

Meqenëse kjo dukuri ka të bëjë vetëm me folje dhe me shprehje foljore e pamë me vend ta fillojmë këtë kapitull me një paragraf kushtuar foljes. Duke qenë se, nga ana tjetër, se nuk mund ta përshkruash këtë klasë foljesh e këtë dukuri (shkakësinë) pa e integruar në strukturat e teorisë së valencës, e pamë të udhës të japim fillimisht një trajtim të shkurtër informues të këtij drejtimi gjuhësor.

---

<sup>314</sup> Shih, Rudolph, U./ von Hecker, U.: "Die Erklärung interpersonaler Ereignisse", *Zeitschrift für experimentelle Psychologie*, Band XLIV, Heft 2, 1997, f. 246- 265.

### IX.1 Gramatika e foljes

Gramatika e foljes është bërthama e çdo gramatike. Qëndrimi sintaksor i foljes përcakton në mënyrë vendimtare strukturën e fjalisë. Një paraqitje e konstrukteve të mundshme të përcaktuara nga folja lidhet ngushtë me konceptin valencë.

#### IX.1.1 Mbi konceptin valencë

Teoria e valencës duhet parë si pjesë integrale e gramatikës së varësisë. Megjithatë koncepti i valencës dhe konceptet e tjera që lidhen me të kanë përmbajtje të ndryshme ndër gjuhëtarë të ndryshëm. Këto koncepte kanë njohur dhe emërtime të ndryshme në kohë dhe autorë të ndryshëm.<sup>315</sup>

Si në shumë e shumë raste termi *valencë* rrjedh nga latinishtja [lat. *valentia* ‘aftësi’, ‘forcë’; *valere* ‘jam i vlefshëm’]. Gjuhësia e ka huazuar termin nga kimia. Edhe pse thuhet që Tesniere e ka futur i pari konceptin dhe termin ‘valencë’ në gjuhësi, para tij ka pasur dhe të tjerë gjuhëtarë që e njihnin dhe operonin me konceptin ‘valencë’, por nën emërtime të tjera. Si pararendës të teorisë së valencave mund të përmendim Behangel-in<sup>316</sup> dhe Heyse-in,<sup>317</sup> që dalluan foljet absolute nga ato relative. Te foljet absolute nuk ishte e domosdoshme prania e plotësive, te ato relative- po.

Koncepti dhe termi valencë, pothuaj me vlerën që ka sot, është sjellë në gjuhësi nga Tesniere.<sup>318</sup>

Në analizën e tij strukturore të fjalisë ai nisët nga folja. Aftësinë e foljes për të marrë një sasi të caktuar „aktantësh“ ai e quan valencë. Krahas aktantëve dallon dhe „cirkonstans“. Ndryshe nga aktantët që i kërkon valenca foljore dhe janë për nga sasia të kufizuar, cirkonstantët, megjithë varësinë e tyre nga folja, janë jo vetëm fakultativë, por dhe në sasi të pakufizuar. Koncepti i valencës te Tesniere kufizohet te subjekti, kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë. Jashtë lidhjeve valencore mbeten predikativët, plotësat ndajfoljorë. Për këtë Tesniere thotë: „Është e mundur që disa valenca mbeten të lira ose të papërdorura.“<sup>319</sup>

Në letërsinë gjuhësore gjermane teoria e Tesniere gjeti një truall të favorshëm. Të parët që shfrytëzuan teorinë e valencave të Tesniere në gramatikat e tyre ishin Brinkmann-i dhe Erben-i. Brinkmann-i e përkufizon valencën si aftësi të foljes për të hapur vende bosh në fjali. Këto vende bosh që mund ose duhen plotësuar me plotësuesit përgjegjës i quan “Mitspieler” (bashkëveprues).<sup>320</sup>

Te Erben-i koncepti i valencës shfaqet me emërtimin “Wertigkeit” (vlerë).<sup>321</sup> Nga kjo vlerë e foljes varet numri dhe lloji i „Ergänzungsbestimmungen“ (plotësive).

Ndryshe nga Tesniere dhe Brinkmann-i, Erben-i trajton si plotësa jo vetëm subjektin dhe objektet, por edhe predikativët, dhe plotësat ndajfoljorë të domosdoshëm strukturalisht. Është fjala këtu vetëm për plotësat e vendit dhe të drejtimit. Mbi bazën

---

<sup>315</sup> Shih, Helbig, G., „Der Begriff der Valenz als Mittel der Sprachbeschreibung und des Fremdsprachunterrichts“, botuar në, *Deutsch als Fremdsprache*, 1965, 1, f. 10.

<sup>316</sup> Behangel, O., *Deutsche Syntax*, II, Heidelberg, 1924, f. 113.

<sup>317</sup> Heyse, J.C.A., *Deutsche Grammatik*, Hannover, 1908, f. 296.

<sup>318</sup> Tesniere, L., *Esquisse d'une Syntaxe structurale*, Paris 1953, f. 69.

<sup>319</sup> Tesniere, L., *Elements de syntaxe structurale*, Paris 1959, f. 238.

<sup>320</sup> Brinkmann, H., *Die deutsche Sprache*, Düsseldorf, 1962, f. 223.

<sup>321</sup> Erben, J., *Abriss der deutschen Grammatik*, Berlin, 1964, f. 230.

e vlerës foljore që përcakton kuadrin e plotësive ai zhvillon teorinë e tij të modeleve të fjalive.<sup>322</sup>

Tek Admoni koncepti valencë del me emërtimin “Fügungspotenz” (aftësi lidhëse) dhe u atribuohet jo vetëm foljeve, por të gjitha pjesëve të ligjëratës. ‘Këto aftësi dremisin në çdo pjesë ligjërata dhe zgjohen menjëherë gjatë procesit të ligjëritimit.’<sup>323</sup> Ai dallon lidhje të detyrueshme dhe fakultative. Lidhja e elementit të varur ndaj atij dominues është gjithnjë e detyrueshme. Ndërsa lidhja e gjymtyrës dominuese ndaj asaj të varur mund të jetë e detyrueshme ose fakultative.<sup>324</sup>

Gjuhëtari rus, Meltschuk e koncepton valencën si aftësi të një rrënje për të drejtur një formë. Në qendër të përshkrimit të tij është analiza e përbërësve imediatë.<sup>325</sup>

Abramov dallon aftësinë centrifugale nga ajo centripetale. Aftësia lidhëse që del nga folja është centrifugale, ajo që kthehet në folje – centripetal.<sup>326</sup>

Në gjuhësinë ruse nganjëherë nuk flitet vetëm për valenca semantike e sintaksore, por edhe për valenca fonologjike e morfologjike. Koncepti valencë përdoret nga Stepanova edhe për fjalëformimin.<sup>327</sup>

Duke u nisur nga konceptimi i dukurisë së valencës, sot mund të flitet për tre grupe gjuhëtarësh:

- Linguistë që valencën e trajtojnë si veçori vetëm të foljes (Tesniere, Brinkmann-i, Erben-i etj.)
- Ka linguistë që valencën e lidhin me të gjitha pjesët e ligjëratës (Admon-i, Lomtew-i, Meltschuk-u etj.)
- Një grup i tretë e lidh valencën jo vetëm me foljen, jo vetëm me çdo pjesë ligjërata, por me çdo element gjuhësor të çdo rrafshi (Stepanova, Sassorina etj.)

Me paraqitjet e mësipërme nuk mund të shpallet i mbyllur rrethi i gjuhëtarëve që kanë si objekt të punës së tyre konceptin ose termin “valencë”. Për më tepër punimet në këtë fushë i kanë kapërcyer shpesh kufijtë e gramatikës së varësisë.

Një nga çështjet qendrore të diskutimeve në teorinë e valencave ka qenë dhe është pyetja: çfarë natyre ka valenca, është dukuri e planit të shprehjes apo e planit të përmbajtjes, është dukuri semantike apo e rrafshit strukturor, ka të bëjë me strukturat e thella apo sipërfaqësore ?

### IX.1.2 Çështje konceptuale dhe terminologjike

Në kuptimin tonë valenca është dukuri që lidhet me tri rrafshet: me rrafshin sintaksor, semantik dhe pragmatik. Me valencë sintaksore kuptohet veçoria ose aftësia e fjalëve për t’u kombinuar me fjalë të tjera e për t’u shfaqur në fjali me forma të caktuara. Valenca sintaksore përcakton në ç’formë morfosintaksore do të realizohen plotësat dhe ç’ gjymtyrë të strukturave sipërfaqësore do të shprehin ata (subjekt, objekt, plotës ndajfoljor etj.)

---

<sup>322</sup> Erben, J., *Abriss der deutschen Grammatik*, Berlin, 1964, f. 231.

<sup>323</sup> Admoni, W., *Der deutsche Sprachbau*, Moskau 1966, f. 80.

<sup>324</sup> Admoni, W., *Der deutsche Sprachbau*, Moskau 1966, f. 84.

<sup>325</sup> Meltschuk, I. A., *Avtomaticheskij sintaksičeskij analiz*, Novosibirsk 1964, f. 274.

<sup>326</sup> Abramov, B. A., *Sintaksičeskije potencii gllagolla b sopostavlenii s potencijami drugih častej rječi*, Moskva 1966, f. 35.

<sup>327</sup> Stepanova, M.D., „*Die Zusammensetzung und die innere Valenz des Wortes*“, botuar në, *Deutsch als Fremdsprache*, 1967/6, f. 335.



Në planin semantik kuptimet e fjalëve luajnë një rol të veçantë dhe përcaktojnë ndërtimin e strukturës sintaksore. Përshkrimi kompleks i gjuhës kërkon që aspekti semantik të plotësohet me atë logjiko-mental. Në aspektin logjik valenca shënon veçorinë e një kuptimi (sememë) për të hapur vende bosh në sajë të përmbajtjes konceptore të tij. Këto vende bosh mbushen ose mund të mbushen me plotësa.<sup>328</sup>

Në rrafshin pragmatik valenca shikohet në lidhje me komunikimin, me situatën komunikuese, me informacionin sociokulturor. Në situata të caktuara komunikuese ndodh që plotësat, edhe kur janë fakultative, nuk mund të mungojnë në strukturat sintaksore sipërfaqësore.

Përshkrimi i gjuhës mbi bazën e teorisë së valencave mbështetet në koncepte specifike. Këtu fjalia krahasohet me një skenë, ku luhet një pjesë (përmbajtja e fjalisë). Folja ndërmerr punën e regjisorit dhe përcakton sasinë dhe llojin e gjymtyrëve të tjera.

Duke shpallur vetëm një gjymtyrë kryesore rrëzohen skemat klasifikuese me dy gjymtyrë kryesore dhe tri gjymtyrë të dyta.

Sipas teorisë së valencave gjymtyrët e fjalisë janë satelitë të foljes qendrore. Ato mund të jenë plotësa ose rrethorë.

Lidhur me emërtimin dhe kuptimin e termave plotës dhe rrethor jemi mbështetur në teorinë e valencave, në modelin engelian. Nocioni që shënon termi plotës tek ne është pothuaj i njëjtë me nocionin që paraqet termi *Ergänzung* në gramatikat e në fjalorët e U. Engel-it.<sup>329</sup> Termi plotës ka diçka nga termi i përdorur nga gjuhëtari ynë, M. Domi.<sup>330</sup> Por në rastin tonë termi tradicional është rivlerësuar. Që nga Tesniere e deri më sot për nocionin në fjalë përdoren terma si: Aktant, *Ergänzung*, Komplement, Mitspieler, Partizipiant, Satellit e ndonjë tjetër. Termi Komplement (*X-bar-Theorie*) në fjalorin e termave gjuhësore, gjermanisht, përkthehet me *Ergänzung*.<sup>331</sup> Duke përdorur termin plotës kam dhënë një ekuivalent dhe të termit komplement. Dukuria në fjalë, për nga kuptimi nocionor kategorial, mund të shënohet me një term të tillë.

Termi tjetër, rrethor, nuk është ekuivalent, por përgjegjës i termit *Angabe* (gjermanisht). Ndërsa me termin e L. Tesniere cirkonstant vendos marrëdhënie ekuivalence. Termin rrethor e kemi marrë nga Gramatika e Akademisë.<sup>332</sup> Vëllimi dhe përmbajtja e këtij koncepti në rastin tonë ndryshon nga ai i Gramatikës së Akademisë.

Në klasën e plotësive, sipas konceptimit të ri, përfshihen gjymtyrë të tilla të gramatikës tradicionale, si: kryefjala, kundrina e drejtë, kundrina e zhdrejtë, dhanoret e lira, disa rrethorë, përcaktori kallëzuesor.

Rrethorët përcaktohen si gjymtyrë jo të domosdoshme të fjalisë, ekzistenca e të cilave nuk kushtëzohet nga valenca e foljes, që modifikojnë ose specifikojnë kuptimin e foljes.

Kështu, fjalia përbëhet nga një folje (predikat) që shoqërohet nga gjymtyrët e varura prej saj: plotësat dhe rrethorët.

---

<sup>328</sup> Shih, Bondzio, W., *Die Stellung der Valenz im Rahmen der Satzstruktur*, Berlin, 1969, f. 234 – 235.

<sup>329</sup> Shih, Engel, U., *Syntax der deutschen Gegenwartssprache*, Berlin 2009, f. 134.

<sup>330</sup> Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë 1955, f. 55.

<sup>331</sup> Bußmann, H., *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart, Kröner Verlag, 2002, f. 357.

<sup>332</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*; Tiranë 2002, Kreu 13, Rrethorë f. 269 -281.

### IX.1.3 Plotësat në gjuhën shqipe

Në shqipen e sotme letrare, sipas teorisë së valencave, ka dhjetë lloje plotësash. Në përcaktimin e numrit dhe llojit të plotësave ka mënyra dhe teste të ndryshme. Ulrich Engel-i, që është marrë gjerësisht me këtë problem, përdor metodën e anaforizimit, të zëvendësimit të mundshëm të elementit , që shpreh plotësin, me një anaforë.<sup>333</sup> Edhe për gjuhën shqipe mund të përdoret kjo mënyrë. Sipas kësaj metode plotësat mund të rriepen ose të rimerren me anë të fjalëve deiktike ose me anë të shprehjeve anaforike. Si të tilla në gjuhën shqipe shërbejnë kryesisht përemrat dhe ndajfoljet. Kuptimi i plotësave mund të anaforizohet, të rriepet me fjalët e shprehjet e dhëna në kolonën djathtas në tabelën e mëposhtme.

Termat plotës dhe rrethanorë janë, në rastin tonë, përshtatje të termave të Tesniere, aktantë dhe cirkonstantë.

Tabela e plotësave të gjuhës shqipe:

Shkurtimi	Emërtimi	Anafora
sub	subjekti	Përemër dëftor në emërore: ai, ajo etj.
kall	plotësi në kallëzore	Përemër dëftor në kallëzore: atë, këtë etj.
dhan	plotësi në dhanore	Përemër dëftor në dhanore: atij, këtij, asaj kësaj etj
par	plotës me parafjalë	Parafjalë + përemër dëftor: me të, mbi të, pa të etj
fol	plotës foljor	të bëjë këtë/të ndodhë kështu/ kjo/këtë
sit	plotës situativ	Ndajfolje: atje, këtu etj.
dir	plotës direktiv	Ndajfolje/ frazë parafjalore: atje, deri atje, nga këtu
eksp	plotës ekspansiv	gjatë, aq, kaq, shumë
prd	plotës predikativ	kështu, ashtu, i tillë
mën	plotës mënyre	kështu, në këtë mënyrë

#### IX.1.3.1 Rolet semantike

Plotësave u imponohen ose u atribuohen në fjali role të caktuara, role që ata nuk i kanë në natyrën e tyre. Rolet semantike<sup>334</sup> vështrohen në pikëpamje gjuhësore, nuk kanë të bëjnë me referentët e realitetit objektiv. Kjo dukuri, kjo madhësi semantike njihet me emërtime të ndryshme ndër autorë e teori të ndryshme.<sup>335</sup>

<sup>333</sup> Engel, U., *Syntax der deutschen Gegenwartssprache*, Berlin, 2009, f. 26.

<sup>334</sup> Shih, Büntig, K. D., *Einführung in die Linguistik*, Frankfurt 1971, f. 22.

<sup>335</sup> Emërtime të tjera: relatorë semantikë, role semantike, role tematike, Theta Rolle, rasë e thellë etj.

- Relatorët semantikë

Me termin relator semantik emërtohet kuptimi që zhvillohet (te plotësi) gjatë kombinimit të përmbajtjes foljore me përmbajtjen e plotësive. Në krahasimin e gjuhëve relatorët semantikë luajnë një rol të rëndësishëm, sepse ndodh që strukturave të thella identike u përgjigjen në gjuhë të ndryshme struktura krejt të ndryshme sipërfaqësore.<sup>336</sup>

Letërsia gjuhësore gjermane dhe veçanërisht Engel-i njih katër relatorë:<sup>337</sup> Agentiv (lat. Agens ,veprues') (AGT), Affektiv (lat. affectio ,gjendje') (AFF), Lokativ (lat.: locus ,vend,) (LOC) dhe Klasifikativ (lat. classis ,klasë') (KLS).

Shihet që termat janë me prejardhje latine. Në gjuhësi dhe në shkencat e tjera është e njohur prirja për të marrë emërtime nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja. (Edhe vetë termi gramatikë rrjedh nga greqishtja e vjetër.) Kjo prirje ka një funksion mnemoteknik; terma të tillë, duke qenë se hyjnë në sistem me termat e shumta ekzistuese të kësaj natyre, mësohen dhe mbahen mend lehtë. Ecuria tradicionale për krijimin e termave të tillë është: merret koncepti ekzistues i një lloji të afërt (genus proximum) dhe përpunohet për të dhënë veçorinë specifike të dukurisë që do të emërtohet (differentia specifica). Nga forma agens ,veprues' me prapashitesën – iv është krijuar termi agentiv që përmban në strukturën e vet kuptimore si komponente të rëndësishme kuptimin e formës agens ,që vepron' dhe fjalës agere ,veproj, bëj' prej nga rrjedh. Sufiksi i njëjtë fjalë-termformues i bashkon emërtimet-terma në një klasë. Kështu është vepruar dhe me termat e tjerë (Affektiv etj.). Nga ana tjetër përdorimi i termave vetëm në gjuhën amtare i vështirëson studimet krahasuese. Jacob Wackernagel-i thotë lidhur me këtë: „Dy përparësi kanë termat me origjinë nga gjuhët klasike: së pari nuk përmbajnë kuptime të jetës së përditshme, janë thjesht shenja, simbole; së dyti çajnë me lehtësi rrugë dhe në gjuhë të tjera.“<sup>338</sup>

Ndërsa në informacionin që kemi dhënë mbi rolet tematike në kuadrin gjenerativist ne kemi përdorur, kryesisht, letërsi në gjuhën shqipe ku termat janë, përgjithësisht (por jo gjithnjë), përkthime në gjuhën shqipe.

### IX.1.3.2 Rolet tematike/semantike në kuadrin e gramatikës gjenerative

Teoria e roleve tematike në kuadrin e gjenerativizmit njihet dhe si teoria “theta“. Edhe këtu kuptimi terminologjik i kësaj dukurie ka të bëjë me funksionet logjiko-semantike të gjymtyrëve të fjalisë, funksione të tipit: kush vepron, kush mbart veprimin, kush e pëson veprimin, kush përfiton etj. Këto funksione janë të rëndësishme për logjikën dhe kuptimin e fjalisë. Rolet tematike burojnë nga raportet që krijon folja me argumentet (plotësat) e saj. Le të shqyrtojmë shembujt e mëposhtëm:

- (a) Ana fle.
- (b) Ana lexon një libër.

---

<sup>336</sup> Kjo duket qartë po të krahasojmë fjali gjuhësh të ndryshme. P.sh.: Ushtarët nuk kishin më granata. Ky është përkthimi i fjalisë në gjuhën latine: Militibus tela desunt. Sipas Fillmore të dy plotësat ushtarët dhe militibus do të kishin një semantikë relacionale të njëjtë, edhe pse me struktura sipërfaqësore të ndryshme. Ndërsa për Tesnieren ushtarët (emërore) do të ishte aktant i parë, ndërsa militibus (dhanore), aktant i dytë.

<sup>337</sup> Engel, U., *Semantische Relatoren* (separat), Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1996, f. 17.

<sup>338</sup> Wackernagel, J., *Vorlesungen über Syntax der deutschen Sprache, Band 2*, Basel 1968, f. 24.

(c) Ana i dhuron nënës lule.

Në fjalinë e parë folja *fle* i cakton argumentit të saj Ana rolin tematik të përjetuesit. Në fjalinë e dytë folja *lexoj* i cakton argumentit Ana rolin tematik të vepruesit, ndërsa argumentit tjetër një libër i cakton rolin tematik të temës (objektit). Në fjalinë e tretë folja *dhuron* kërkon tre plotësia (argumente). Plotësi Ana (subjekt) kryen rolin e vepruesit, plotësi nënës luan rolin e përfituesit, plotësi lule mban rolin e temës (objektit të veprimit).

Teoria “theta” përveç numrit të argumenteve që duhet të marrë një folje përshkruan dhe rolet apo veçoritë që duhet të ketë një argument. Argumentet (plotësia) pajisen me role tematike nga folja. Këto role tematike janë të lidhura ngushtë me informacionin leksikor që mbart folja. Parimi themelor i kësaj teorie është: “Çdo argument bart një dhe vetëm një rol tematik dhe çdo rol tematik i caktohet një dhe vetëm një argumenti.”<sup>339</sup>

Por siç do të shohim më poshtë foljet “psikologjike” bëjnë përjashtim nga ky rregull.

Teoria theta njeh, përgjithësisht, këto role tematike:

- Agjenti
- Aktori
- Pësuesi
- Tema
- Përjetuesi
- Përfituesi
- Lokativi
- Pikësynimi
- Burimi

Agjenti është bërësi i ndërgjegjshëm i një veprimi.

Aktori është bërësi jofrymor i një veprimi. Çdo agjent është një aktor, por jo e kundërta.

Pësuesi – objekti i drejtpërdrejtë i veprimit, gjendja e të cilit ndryshon pas veprimit.

Tema: objekt i veprimit të foljes, njësia që lëviz, ndryshon pozicion ose gjendje nga veprimi.

Përjetuesi: pjesëmarrësi që përjeton një ndjenjë apo emocion.

Përfituesi: qenia a madhësia që përfiton nga një veprim.

Lokativi: hapësira a pika në të cilën ndodh një veprim.

Pikësynimi: është objekti apo pika drejt së cilës orientohet a shkon lëvizja.

Burimi: objekti a pika nga e cila rrjedh veprimi.

Rolet tematike janë të kushtëzuara nga informacioni semantik i foljes.

Gjatë trajtimeve tona jemi mbështetur dhe do të mbështetemi në teori të ndryshme mbi rolet semantike, jo vetëm në atë gjenerativiste, por edhe në atë gjermane apo engeliene. Do të mbështetemi sidomos në teoritë më të reja që kanë lindur për të shpjeguar dukurinë e variabilitetit rasor të stimulit dhe të përjetuesit të foljes që tregojnë gjendje shpirtërore ose procese mendore që janë, kryesisht, kauzale.

---

<sup>339</sup> Memushaj, R. *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, Botimet Toena, 2008, f. 169.

### IX.1.4 Kombinimi i roleve semantike me funksionet sintaksore

Edhe pse çështja e dallimeve midis plotësive dhe rrethorëve ende nuk është sqaruar plotësisht, një tematikë e re, që lidhet me këtë çështje, ka hyrë në fokusin e studimeve gjuhësore në fushën e gramatikës së foljes. Është fjala për principet e kombinimit të roleve semantike me funksionet sintaksore. Kjo çështje ka të bëjë me strukturën argumentore të foljes. Nga hetimet dhe studimi i kësaj dukurie në gjuhë të ndryshme rezultojnë disa principe të përgjithshme mbi bazën e të cilave bëhet ky kombinim. Problemi i kombinimit të roleve semantike me funksionet sintaksore është i lidhur ngushtë me rasat dhe me kuptimet e tyre, sepse funksionet sintaksore realizohen me elemente rasash të ndryshme. Prandaj po ndalemi shkurt në një paraqitje të përdorimit të rasave me folje valencash të ndryshme. Foljet njëvalente kërkojnë zakonisht një plotës (argument) dhe ky është kryesisht në rasën emërore. Folje që nuk kërkojnë subjekt, ka, por jo shumë. Në këtë model ndërtimi përfshihen, zakonisht, folje që shënojnë dukuri të natyrës. Ja disa shembuj në shqip e në gjermanisht:

Po gdhin. ‚Es tagt gerade‘...

Vetëtin ‚es blitzt‘; bubullon ‚es donnert‘; fryn ‚es zieht‘; zbardhëllon ‚es tagt‘.

Foljet mund të jenë dhe refleksive: ngriset ‚es dämmert‘, erret ‚es dunkelt‘. Në gjermanisht elementi es është subjekt formal. Për të nuk ka përgjegjëse në gjuhën shqipe.

Folje të tjera që dalin pa subjekt janë: bën ftohtë ‚es ist kalt‘; bën ngrohtë ‚es ist warm‘; është erë ‚es ist windig‘ etj.

Në gjermanisht e në shqip ka shumë folje njëvalente që kërkojnë vetëm subjekt:

Dikush këndonte. ‚Jemand sang.‘

Babai vdiq. ‚Der Vater starb.‘

Po çlodhem [pak]. ‚Ich ruhe mich [kurz] aus.‘

Ja dhe disa folje të tjera:

ndryshon ‚sich ändert‘

punon ‚arbeiten‘

marr frymë ‚atmen‘.

ngrihem ‚aufstehen

qetësohem ‚sich beruhigen‘

dehem ‚sich betrinken‘

Moti ndryshon. ‚Das Wetter ändert sich.‘

Nëna punon. ‚Die Mutter arbeitet.‘

Ai [nuk po] merr [më] frymë. ‚Er atmet [nicht mehr]

‘Era ngrihet [në orën pesë]. ‚Era steht [um fünf Uhr] auf.‘

Qetësohuni [pra]! ‚Beruhigen Sie sich [doch]!

Folje njëvalente vetëm me një plotës në kallëzore ka shumë pak:

Ka vetëm një zgjidhje.

‚Es gibt nur eine Lösung.‘

Akoma më të pakta janë foljet që kërkojnë vetëm një argument në dhanore:

Më merren mendtë.

‚Mir schwindelt.‘

Te foljet dyvalente ndërtimet me një plotës në emërore dhe një në kallëzore janë të shpeshta, më të shpeshta se ndërtimet e tjera të mundshme. Beatrice Primus-i<sup>340</sup> studimin e vet mbi principet e reksionit e shoqëron me një statistikë ku jepet denduria e përdorimit të rasave të ndryshme në bashkëvajtje me folje valencash të ndryshme. Në rastin e foljeve dyvalente, që kërkojnë një plotës në emërore dhe një në kallëzore, në korpusin që ka hetuar, ajo ka gjetur 4560 folje të tilla. Ndërsa folje me strukturën argumentore: emërore + dhanore janë 360, folje me një plotës në emërore dhe një në gjinore – vetëm 14. Realiteti i gjuhës gjermane, statistika e Primus-it që e vërteton këtë realitet, tregon që rasia gjinore si argument i foljes po përdoret gjithnjë e më pak, mund të themi, shumë pak. Gjnjorja kryen zakonisht funksione atributive që nuk kanë të bëjnë me foljet.

Edhe në foljet trevalente mbizotëron kombinimi: emërore + kallëzore + dhanore. Edhe kombinimi: emërore + kallëzore + frazë parafjalore shfaqet dendur.

Duke u nisur nga statistikat e dendurisë së përdorimit rasat dhe kombinimet e tyre mund t'i paraqesim në një hierarki si më poshtë:

- emërore
- emërore + kallëzore
- emërore + kallëzore + dhanore
- emërore + kallëzore + rasë me parafjalë

Primus-i interpreton më tej: Kësaj hierarkie rasore i përgjigjet një hierarki e funksioneve sintaksore. Kështu kemi:

subjekt > plotës në kallëzore (k. e dr.) > plotës në dhanore (k. e zhdr.) > plotës me parafjalë  
emërore > kallëzore > dhanore > rasë me parafjalë

Subjekti i prin hierarkisë së funksioneve. Rasia emërore, rasia e subjektit, është edhe në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën gjermane (edhe në gjuhë të tjera) shpesh e pa shenjuar me tregues gramatikorë. Në trajtën e pashquar është identike me formën përfaqësuese. Një pozicion qendror në fjali ka dhe rasia kallëzore. Ky argument shndërrohet në subjekt në transformimet pasive. Kjo dukuri është shumë e kufizuar te dhanorja. Format e rasës kallëzore, njëlloj si format e emërores, janë relativisht pak të shenjua. Në gjuhën shqipe vetëm trajta e shquar e kallëzores, njëjës ka një formë të shenjuar me anë të mbaresës -n.

Tani le të merremi me pyetjen: Cilat janë principet e kombinimit të roleve semantike me funksionet sintaksore?

Teoria më bindëse duket të jetë ajo e Wunderlich.<sup>341</sup> Ai formulon si rregull: Zakonisht, roli tematik i rangut më të lartë (më i përdorshmi) projektohet te funksioni sintaksor i rangut më të lartë. Ky formulim mund të paraqitet me simbolet e mëposhtme:

---

<sup>340</sup> Shih, Primus, B., „Rektionsprinzipien“, botuar në, *Deutsch- kontrastiv*, Tübingen, 1999, f. 135-170.

<sup>341</sup> Wunderlich, D., „Über die Argumente des Verbs“, botuar në: *Linguistische Berichte* 97, Tübingen, 1985, F. 183- 227.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

vepruesi (agjenti)	pësuesi (pacienti)	marrësi/ pritësi (recipienti)
↓	↓	↓
subjekt	plotës në kallëzore	plotës në dhanore

Vepruesi është i lidhur me subjektin, çdo veprues është praktikisht subjekt, por jo çdo subjekt është veprues. Ka disa folje njëvalente ku subjekti shfaqet si pësues. Të tilla janë: arrij, vij, vdes etj. Këto quhen folje ergative dhe karakterizohen nga disa veçori:

- Nuk kanë formë pasive.
- Nuk shërbejnë si tema fjalëformuese emrash me sufiksin –ës: prishës por jo vdekës.
- Nga forma pjesore e tyre mund të formohen mbiemra dhe nga mbiemrat prejpjesorë formohen emra: i ardhur – i ardhuri.
- Në gjuhën gjermane kohët foljore të përbëra të këtyre foljeve formohen me ndihmën e foljes jam ‘sein’: Ich bin gekommen. ‘Unë kam ardhur.’

Le të vëzhgojmë dhe njëherë caktimin e roleve të foljet dyvalente. Nëse krahas rolit të vepruesit (agent) shfaqet roli i pësuesit, atëherë ky rol do të realizohet si kundrinë e drejtë (plotës në kallëzore). Plotësi në dhanore që shfaqet në foljet trevalente shënon rregullisht marrësin (recipientin), pritësin e veprimit të shprehur nga folja. Zakonisht plotësi në dhanore është frymor. Nëse plotësi në dhanore del me një folje dyvalente, atëherë ai përmban veçori agjenteve.

Në foljet që shënojnë gjendje psikologjike kemi një kombinim interesant të dy argumenteve që kërkon folja me rolet semantike që u cakton ajo atyre. Duke u nisur nga veçoritë e tyre semantike rolet tematike që u atribuohen funksioneve sintaksore në rastin e foljeve psikologjike quhen stimul dhe përjetues (stimulus – experiencer). Ndërsa në foljet që tregojnë veprime, vepruesi (agjenti) leksikalizohet te subjekti, përjetuesi – te objekti (plotësi në kallëzore), në ndërtimet me folje psikologjike ndodh krejt ndryshe. Ka folje të cilat stimuli shfaqet si subjekt (frikësoj, tmerroj, lodh, shqetësoj etj.), ka dhe folje ku pësuesi kombinohet me subjektin (dashuroj, urrej, admiroj, përbuz etj.) Ka dhe disa folje ku stimuli del si subjekt, ndërsa përjetuesi si plotës në dhanore: më pëlqen, më shijon, më bie në sy etj.

Siç do të shohim dhe më poshtë një teori interesante për shpjegimin e kësaj dukurie të foljet psikologjike është ajo e Dowty-t, teoria e protoroleve, protoagjentëve dhe protopacientëve.

IX.1.4.1 Disa veçori të foljeve ndërpersonale-psikologjike<sup>342</sup> njëvalente, pa subjekt, në gjuhën gjermane

Në gjuhën gjermane ka disa folje një valente që kërkojnë kundrinë të drejtë. Këtij argumenti i caktohet nga folja roli semantik i pësuesit, jo i vepruesit, siç do të ndodhte po qe se argumenti do të realizohej me një element në emërore. Në fakt ndërtime me folje të tilla e me plotës (argument) në kallëzore janë alternativa të ndërtimeve me folje njëvalente dhe me një plotës në emërore: Le të bëjmë një krahasim:

(a) mich friert (es)                      ich friere                      ,mërdhah'

<sup>342</sup> “Folje psikologjike” janë folje që shënojnë një gjendje psikologjike. Këtu përfshihen folje që shprehin emocione, folje që shënojnë gjendje psikologjike.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

---

(b) mich fröstelt (es)	ich fröstle	‘rrëqethem’
(c) mich hungert (es)	ich hungere	‘kam uri’
(d) mich dürstet (es)	ich dürste	‘kam etje’

Tendenca e zhvillimit gjuhësor është e tillë që ndërtimet me plotës në kallëzore me rolin semantik të përjetuesit po zëvendësohen gjithnjë e më shumë me ndërtimet alternative, ku rolin e përjetuesit e merr subjekti. Përdorimi i *es* si subjekt formal, semantikisht bosh, përbën një fazë kalimtare që manifeston shfaqjen e subjektit në rrafshin morfosintaksor të valencës foljore.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndërtimet me folje njëvalente dhe mbiemrat që kërkojnë një kundrinë të zhdrejtë (plotës në dhanore). Edhe ato priren të zëvendësohen me ndërtime ku rolin tematik të përjetuesit e merr subjekti, jo më objekti i zhdrejtë. P.sh.:

(a) mir ahnt x	ich ahne x	‘ma merr mendja’
(b) mir träumt x/von x	ich träume x/von x	‘më del në ëndërr/ëndërroj’
(c) mir ist schwiendlig	ich bin schwindlig	‘më merren mendtë’

Foljet pa plotës-subjekt janë zakonisht folje psikologjike që përmbajnë vetëm një plotës-argument në kallëzore ose në dhanore. Në gjuhën e sotme gjermane ato përbëjnë një mbetje nga e kaluara që po zhbëhet gradualisht. Parashikohet që zhbërja, mënjanimi i tyre nga përdorimi, të bëhet me një shpejtësi gjithnjë në rritje. Shkak për dezintegrimin e këtyre shprehjeve pa subjekt mendohet të jetë ekzistenca e tyre në forma të ngurosura dhe paaftësia për të dalë në forma të tjera sintaksore-morfologjike.<sup>343</sup>

P.sh.: Shprehje të tilla nuk mund të dalin me kuptim dhe formë urdhërore:

Friere nicht! (?) ‘Mos mërdhij!’(?)

Ato nuk dalin as në konstrukte infinitive të llojit:

Anna glaubt, vor Heinrich zu grauen.(?) ‘Ana mendon që tmerrohet nga Hajnrih.’(?)

Po të bëjmë një krahasim me gjuhën shqipe, vëmë re që vetëm foljet pa subjekt dhe me plotës në dhanore kanë veçori të përbashkëta me ato përgjegjëse gjermane. Ndërtimet me plotës në kallëzore të gjermanishtes, ndërtime që po zëvendësohen nga ato me plotës – subjekt, kanë si përgjegjëse në gjuhën shqipe strukturën subjekt + folje (unë mërdhij). Dihet që kryefjala mund të mungojë në strukturat sipërfaqësore të shqipes: mërdhij etj.

Në ndërtime të tilla vihet re konkurrenca midis roleve stimul dhe përjetues për të zënë “postin” e subjektit.

---

<sup>343</sup> Shih, Wegener, H, „Zum Bedeutungs- und Konstruktionswandel bei psychischen Verben“, botuar në, *Deutsch kontrastiv. Studien zur deutschen Grammatik* 28. Tübingen, Stauffenburg 1999, 171-210.



### IX.1.5 Përfundime

Në këtë paragraf trajtuam kombinimin e roleve semantike me funksionet sintaksore të foljet veprorë dhe të foljet kauzale që tregojnë gjendje psikologjike dhe procese mendore. Më poshtë do ta trajtojmë më hollësisht teorinë e Dowty-t që përshkruan principet e kombinimit të dy dukurive në fjalë. Ai paraqet një model-“konkurrimi”. Midis gjymtyrëve ka një lloj konkurrimi në synimin për të realizuar funksionet qendrore sintaksore: subjekt dhe kundrinë. Gjymtyra që ka më shumë veçori agentive bëhet subjekt, ajo që ka më shumë veçori pësuese bëhet kundrinë (e drejtë ose e zhdrejtë). Në fragmentin kushtuar teorisë së Dowty-t do të jepet informacion mbi veçoritë agentive dhe ato pësuese të argumenteve.

Kjo rregullsi vlen vetëm për foljet në trajtë veprorë. Në foljet pësore kombinimi paraqitet ndryshe.

### IX.2 Principi kauzal

Që në fillim mund të themi që kauzaliteti i foljeve që tregojnë gjendje shpirtërore ose procese mendore, ashtu siç është trajtuar nga mendimtarë dhe linguistë të ndryshëm bashkëkohorë, mbështet ndjeshëm dhe dukshëm teori rrymash filozofike të vjetra dhe të reja, rrymash që kanë bërë objekt vëzhgimi edhe lidhjet e marrëdhëniet shkakore në botën që na rrethon. Në trajtimin që vijon do të prezantojmë konceptet shkakore që kanë shërbyer si ideatore të mendimeve linguistike për shpjegimin e çështjes sonë: foljet “psikologjike” dhe realizimi i strukturës argumentore (plotësive, sipas terminologjisë që kemi propozuar më lart) të tyre.

Principi kauzal ka një rëndësi të veçantë për perceptimin dhe konceptimin e botës nga njeriu. Ky princip bazohet në pranimin e një shkakut për çdo ngjarje. Nuk ndodh asgjë pa një arsye, pa një shkak. Platoni e formulon kështu këtë ide: „Çdo ndodhi ka në origjinë domosdoshmërisht një shkak.”<sup>344</sup> Ndërsa Kanti shprehet: „Të gjitha ndryshimet ndodhin sipas ligjit të lidhjes së shkakut me pasojën.”<sup>345</sup>

Filozofi David Hume<sup>346</sup> e vështron principin kauzal si një relacion ontologjik që ekziston në vetë sendet. Idetë dhe formulimet e Hume-s përshkruajnë edhe sot diskutimet mbi kauzalitetin. Hume e lidh gjithashtu ekzistencën e relacioneve shkakore me eksperiencën e njerëzve. Një relacion, një lidhje shkakore e objekteve dhe e ngjarjeve rroket vetëm nga mendja e subjektit soditës të botës që është i pajisur me eksperiencën e vet në njohjen e botës. Për herë të parë, Hume vendos kështu një lidhje midis mendimit filozofik mbi metafizikën e kauzalitetit dhe psikologjisë njerëzore që merr pjesë në kuptimin dhe shpjegimin e lidhjeve shkakore.

Identifikimi dhe kufizimi i raporteve shkakore vështirësohet nganjëherë për shkak të ngatërrimit të këtyre raporteve me relacionet midis dukurive/ndodhjeve që ngjasin njëra pas tjetrës. Dukuria që ndodh, në kohë, para tjetrës cilësohet si shkak, dukuria që pason (në kohë) merret si pasojë. Raporte të tilla nuk janë gjithnjë shkakore. Për të trajtuar e shmangur këtë problem janë zhvilluar teori të ndryshme, në themelin e të cilave qëndron formulimi i principit kauzal si një lidhje logjike midis një shkakut të

---

<sup>344</sup> Platon. *Sämtliche Werke, Bd. 1*, Übersetzer Friedrich Schleiermacher, Taschenbuch, 2004, f. 237.

<sup>345</sup> Kant, I., *Kritik der reinen Vernunft, Werkausgabe in 6 Bänden, Band 2*, Darmstadt, 1781/1983, f. 89.

<sup>346</sup> Shih, Hume, D., *Eine Untersuchung über den menschlichen Verstand*, Reclam, Philipp, jun. GmbH Verlag, 1968.

domosdoshëm për të sjellë një pasojë të caktuar. Lewis-i<sup>347</sup> e përshkruan raportin kauzal si një varësi shkakore të dy ndodhive, dy propozicioneve (që jepen me fjali pohore). Të dyja këto Lewis-i i vendos në një rrafsh të përbashkët. Marrëdhënia shkakore krijohet atëherë, kur midis këtyre madhësive ekziston një varësi e dyanshme. Lewis-i arsyeton:

“ *e* është në varësi kauzale nga *c*, ... nëse varësia është e dyanshme. Kjo do të thotë: nëse *e* ndodh ose nuk ndodh, kjo varet nga *c*; anasjelltas: nëse *c* ndodh ose nuk ndodh, kjo varet nga *e*... Nëse *e* nuk ekziston, edhe *c* nuk do të ekzistojë.<sup>348</sup> ”

Formulimi i Lewis-it vlen vetëm për rastet kur dukuritë/ndodhitë ekzistojnë në botën reale.

Përkufizimi i Lewis-it mbi varësinë kauzale të dukurive reale ka gjetur jehonë dhe ka ndikuar mendimin teorik gjuhësor. Teoria e tij është në bazën e konceptit lingvistik “Cause - Operators” që ka të bëjë me procesin e dekompozimit të kuptimeve foljore në përbërës semantikë.<sup>349</sup>

Në studimet e sotme në fushën e fizikës moderne mbivlerësohet principi kauzal ontologjik sipas të cilit shkak gjendet në vetë sendet. Ndërsa në shkencat filozofike e lingvistike mendimi se raportet kauzale lidhen me principe psikologjike, që shprehin lidhjen e njeriut me botën, mbetet gjerësisht i pranueshëm, i padyshimtë. Për njeriun është e natyrshme dhe e zakonshme të vendosë raporte midis ngjarjeve dhe dukurive, t'i shohë ato si shkaqe ose si pasoja. Kjo ndodh pavarësisht nga kultura. Ky konceptim i botës, duke zbuluar në të raporte dhe lidhje shkakore, është një princip themelor njohës. Principi kauzal është “i montuar” në aparatën njohës të njeriut. Teza e lidhjes së raporteve kauzale me perceptimin dhe konceptimin njerëzor, domethënë principi psikologjik i njohjes së botës dhe marrëdhënieve kauzale është bërë sot një fushë e preferuar studimi në psikologji, lingvistikë, filozofi, antropologji etj.

Një tjetër problem i rëndësishëm në fushën e kauzalitetit ka të bëjë me identifikimin dhe përcaktimin e shkakut në një raport kauzal. Pyetja këtu është: në ç'kushte dy ngjarje do të trajtohen si elemente të një raporti kauzal dhe cili element përbën shkakun, cili pasojën. Ky problem është quajtur “Konnektionsproblem”(problemi i lidhjes).

Problemi i lidhjes është një çështje bazë dhe ka të bëjë me premisat themelore sipas të cilave funksionon njohja njerëzore. Le të kthehemi dhe njëherë te Hume.<sup>350</sup>

Për të ilustruar principin kauzal ai përdor dukurinë e përplasjes së dy bilave në një tryezë bilardoje. Bila lëvizëse prek bilën në qetësi e cila fillon dhe ajo të lëvizë. Zhvendosja hapësinore e bilës së dytë ndodh për shkak të bilës së parë lëvizëse. Është e qartë: pa “transferimin” e forcës nga objekti i parë tek i dyti, ky i fundit do të qëndronte në vend. Kështu, bila e parë është shkak për zhvendosjen e së dytës. Përmbledhtazi mund të themi: dy objekte ose dukuri janë në lidhje shkak-pasojë kur përmbushen këto kushte:

- lëvizja fillestare e objektit të parë

---

<sup>347</sup> Shih, Lewis, D., *Counterfactuals*, Harvard, University Press 1973.

<sup>348</sup> Shih, Lewis, D., *Counterfactuals*, Harvard, University Press 1973.

<sup>349</sup> Shih, Dowty 1979, Pesetski 1995, dhe Primus, 2002, 2004, 2006.

<sup>350</sup> Shih, Hume, D., *Eine Untersuchung über den menschlichen Verstand*, Reclam, Philipp, jun. GmbH Verlag, 1968.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

---

- kontakti midis objekteve
- pas kontaktit, fillim i lëvizjes ose i ndryshimit të objektit të dytë si pasojë e transferimit të energjisë.

Në këto kushte qartësohet identifikimi i një objekti ose i një ngjarjeje si shkak i diçkaje.

Problemi i seleksionit është një çështje tjetër filozofike që lidhet me konceptimin e kauzalitetit. Një pasojë rrjedh rëndom jo nga një, por nga disa shkaqe. Mill-i<sup>351</sup> është një nga filozofët e parë që janë marrë me këtë çështje. Në librin e tij ai thekson që shpjegimi i një raporti shkakor, zakonisht, mbështetet vetëm në kushtet, në arsyet e njohura dhe të kapshme nga njeriu. Një sërë shkaqesh të tjera mbeten në hije, të pazbardhura. Për ta ilustruar këtë mendim ai sjell shembullin e një burri që bie nga shkalla dhe vdes. Si shkak i vdekjes merret rënia nga shkalla. Por mbeten të papërfillura shkaqe të tjera si: pesha e burrit, forca e gravitetit etj. Janë një grup arsyesh që sollën vdekjen e personit, por në shpjegimin e saj një pjesë e tyre nuk përmenden, edhe kur nënkuptohen.

Në studimin e komunikimit midis njerëzve duhet dalluar kjo dysi: nga njëra anë shpjegimi i plotë i shkaqeve në raportet shkakore, nga ana tjetër, në gjuhën e përditshme, përmendja vetëm e një pjese të shkaqeve të këtyre dukurive. Talmy<sup>352</sup> në punimet e tij mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënieve shkakore dhe mbi semantikën e koncepteve kauzale merret posaçërisht me këtë dukuri. Ai ballafaqon dy fusha përdorimi të konstrukteve shkakore: shkencat e natyrës dhe gjuhën e përditshme. Në shkencat e natyrës raportet shkakore vrojtohen me imtësi për të zbuluar të gjitha shkaqet dhe pasojat e mundshme, të gjitha lidhjet reciproke. Në ligjërimin bisedor ndodh që lidhja shkakore të paraqitet autonome, domethënë nuk jepet asnjë shkak. Talmy<sup>353</sup> jep dhe një shembull tjetër ilustrues, një cisternë që rrjedh. Ndërsa një vëzhgim shkencor sheh në këtë rast një konglomerat arsyesh, në një bisedë të përditshme kjo dukuri ndodh të jepet thjesht me thënien/fjalinë “Cisterna rrjedh.” ose “ Nga cisterna rrjedh ujë.”

Vlen të përmendim dhe vërejtjen e Carnap-it (1969) lidhur me këtë dukuri. Ai shprehet që në shtjellimin e një lidhjeje kauzale shpallen shkaqe të ndryshme nga persona të ndryshëm. Kjo kushtëzohet nga interesat e ndryshëm të personave. Edhe Carnap-i vëren që në ligjërimin e zakonshëm, të përditshëm sasia e shkaqeve që prodhojnë një pasojë reduktohet.

Kjo veçori e ligjërimin të përditshëm analizohet dhe shpjegohet në drejtimin filozofik të quajtur: Modeli ligjërimor pragmatik i seleksionit të shkaqeve.

Një ndër përfaqësuesit kryesorë të këtij drejtimi është Hilton (1988, 1995). Ai propozon që shpjegimet e lidhjeve shkakore në ligjërimin bisedor të trajtohen në kuadrin e pragmatikës ligjërimore. Në ndërtimin e ligjërimin të përditshëm luajnë rol faktorë të tillë, si situata konkrete, folësi, dëgjuesi, informacioni sociokulturor i tyre, komunikimi.

---

<sup>351</sup> Mill, S., *Buch III, Kapitel V*, Leipzig, 1874, §3.

<sup>352</sup> Talmy, L., *Cognitive Semantics*, Berlin, de Gruyter, 2007, f. 121.

<sup>353</sup> Talmy, L., *Cognitive Semantics*, Berlin, de Gruyter, 2007, f. 125.

### IX.2.1 Përfundime

Të kuptuarit e botës nga njeriu drejtohet nga zbatimi i principit të shkakësisë. Ky është i montuar në aftësinë njohëse të njeriut. Shpallja e një objekti ose ndodhie si shkak në gjuhën bisedore nuk lidhet me qëllimin e zbulimit të morisë shkakore, por orientohet nga situata dhe nga interesat e biseduesve.

Principi kauzal ka gjetur në linguistikë një truall të përshtatshëm zbatimi. Teoritë dhe përshkrimet e ndryshme që merren me foljet “psikologjike” (Psychverben) mbështeten të gjitha në principin filozofik kauzal. Disa e shprehin hapur mbështetjen (explicit) si Croft-i në “Kognitive Kausalkettentheori.”<sup>354</sup> Të tjerë ndjekin implicit linjat, idetë dhe konceptet filozofike kauzative që trajtuam më lart. Këtu mund të përmendim modelet e ndryshme semantike të Dowty-t<sup>355</sup>, Pesetsky-t (1995), Van Valin-it/LaPolla-s<sup>356</sup> etj.

### IX.3 Shkakësia implicite

Kauzaliteti implicit është veçori e foljeve ndërvetore-psikologjike, të cilat evidentojnë (tregojnë) si shkaktar të përmbajtjes së shprehur në folje ose subjektin, ose plotësin në kallëzore, rrallë në dhanore:

- (a) Eva e admiron Dorinën.
- (b) Eraldi na befasoi të gjithë.

Në shembullin (a) gjendja e shprehur nga folja admiroj shkaktohet nga Dorina (kall) dhe përjetohet nga Eva (sub).

Në fjalinë (b) Eraldi (sub) është shkaktar i gjendjes së shprehur nga folja dhe të përjetuar nga të gjithë (kall).

Grupi i foljeve në fjalë është quajtur shpesh “folje psikologjike” në kuptimin folje që shënojnë një gjendje psikologjike. Këtu përfshihen folje që shprehin emocione: dua, urrej; folje që shënojnë qëndrime psikologjike: vlerësoj, di; folje që shënojnë perceptime: shikoj, dëgjoj; folje që tregojnë ndërveprim: ndihmoj, lavdëroj etj.<sup>357</sup>

Ne jemi përpjekur të hartojmë një listë foljesh të tilla në gjuhën shqipe, punë kjo mjaft e vështirë, sepse disa herë kufij të këtyre leksemave nuk janë të prerë dhe të qartë.

Duke u nisur nga semantika foljet ndërvetore mund të grupohen në:

- folje që tregojnë veprim (përshtëndes, përgjigjem, ndihmoj),
- folje që tregojnë gjendje psikologjike: (dashuroj, urrej, çuditim, admiroj).

---

<sup>354</sup> Shih, Croft, W., “Case marking and the semantics of mental verbs”, botuar në, *Semantics and the Lexicon*, botuar në, Dordrecht, 1991, f. 55 – 72.

<sup>355</sup> Dowty, D., “Thematic proto-roles and argument selection”, botuar në, *Language* 67/3, 1991, f. 547-619 1991.

<sup>356</sup> Van Valin/LaPolla, *Syntax. Structure, meaning and function*. Cambridge, 1997, f. 98.

<sup>357</sup> Shih, Primus, B., *Kasusvariation bei psychischen Verben*. Tübingen, Gunter Narr Verlag, 2004, f. 378 – 401.

Foljet që tregojnë veprim përshkruajnë aktivitete, veprime të vëzhguara. Foljet që tregojnë gjendje shënojnë situata emocionale, mendore, të cilat nuk mund të vëzhgohen direkt.<sup>358</sup>

Në pikëpamje të roleve semantike foljet psikologjike karakterizohen nga një veçori e përgjithshme:

Ato nuk marrin agjent (veprues) ose pacient (pësues) në kuptimin e ngushtë të termit, siç ndodh me foljet veprorë *vras*, *shkruaj*. Ato plotësohen me gjymtyrë (plotësia/argumente) të cilat, veç funksionit sintaksor luajnë dhe rolin semantik të stimuluesit (stimulus) ose të përjetësuesit (experiencer)<sup>359</sup>.

Më poshtë do t'i trajtojmë më gjerësisht rolet semantike në bashkëvjajtje me foljet që tregojnë gjendje psikologjike. E filluam këtë trajtesë me rolet semantike për arsyen e thjeshtë se struktura e roleve semantike të këto folje paraqitet krejt ndryshe nga ajo e foljeve të tjera që tregojnë veprim ose e foljeve ergative.

### IX.3.1 Foljet „psikologjike“ përmbajnë gjithnjë dhe kauzalitet implicit

Foljet e grupit në fjalë e përmbajnë gjithnjë shkakësinë implicite në semantikën e tyre. Edhe paraqitje krejt minimale tregojnë që veprimet ndërvetore, sidomos gjendjet psikologjike, referojnë te një shkak dhe te një përjetim, ose te një shkaktar dhe te një përjetues:

- (c) Andin e *irriton* Besa...
- (d) Inës i *pëlqen* Arturi...

Në shembullin (c) marrëdhënia shkakore konceptohet si lidhje e gjendjes së shkaktuar të Andi nga Besa. Ndërsa në shembullin (d) stimul, shkaktar është Arturi, ndërsa Ina është përjetues.

Në literaturën gjuhësore të kohëve të fundit, për të provuar shkakësinë, që përmban semantika foljore, janë përdorur teste të ndryshme. Grimschaw dhe Van Valin-i/La Polla praktikojnë si test perifrazën. Sipas këtyre autorëve me anë të perifrazimit tregohet që folje, si: *tremb*, *magjeps* etj. u japin ndërtimeve ku bëjnë pjesë kuptime shkakore. Ndërtime të tilla, që përmbajnë folje ndërvetore, mund të shtjellohen në ndërtime të perifrazuara paralele, ku shkakësia shfaqet eksplizit:

- (e) *Stuhia na trembi* = *Stuhia bëri që ne të trembeshim*.

Perifrazimi mund të bëhet jo vetëm me ndërtime me folje kauzative (bën etj), por edhe me një konstrukt të varur shkakor:

- (f) *Vera e ka frikë* Gencin.

---

<sup>358</sup> Një klasifikim i tillë bëhet nga shumë studiues. Ne jemi mbështetur te: Rudolph, U./ von Hecker, U., "Die Erklärung interpersonalen Ereignisse", botuar në, *Zeitschrift für experimentelle Psychologie, Band XLIV, Heft 2, 1997, f. 246- 265*.

<sup>359</sup> Lidhur me termat: ne jemi përpjekur t'i shqipërojmë, siç kemi thënë dhe më sipër, në paragrafin ku është trajtuar teoria e valencave, teoria e plotësive dhe e roleve semantike. Gjithsesi shqipërimi ka qenë dhe mbetet problem, për shkak se disa aspekte të këtyre teorive nuk janë trajtuar gjerësisht në gjuhësinë tonë, ose nuk janë trajtuar fare. Kështu përkthimet, shqipërimet e termave që gjëllin në këto fusha, janë të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Unë jam përpjekur të jap ndihmesën time, i sigurtë që ka vend për korrigjime dhe përmirësime.

(g) Vera e ka frikë Gencin, sepse ai është brutal.

Thënia (f) është perifrazuar në konstruktin (g). Të dyja ndërtimet janë barasvlera semantike, veç, në shembullin (f) jepet implicit ajo që në shembullin (g) shprehet eksplicit. Është fjala për shkakësinë. Në (g) shkak shprehet gjuhësisht, në (f) sugjerohet nga folja dhe merret me mend, gjithnjë presupozohet një shkak (veç në raste anomaliteti – jo, p.sh.: nëse Vera është e sëmurë psiqike).

Në rastin e perifrazimit të dyja konstruktet duhet të kenë një sasi të njëjtë argumentesh (plotësash). Një strukturë shkakore duhet të ketë, së paku, dy argumente (stimul – përjetues). Kështu, foljet njëvalente nuk përbëjnë strukturë shkakore. Ndërtimet e perifrazuara duhet të përmbajnë folje, të paktën, dyvalente.

Van Valin-i/LaPolla dhe Grimshaw përdorin versione të ndryshme testimi, gjithsesi të ngjashme, por eksperimentojnë me të njëjtën folje psikologjike (Psychverb) “tremb/frikësoj” (ängstigen).

Te Van Valin-i/LaPolla (e) testimi i shkakësisë në foljet që tregojnë gjendje shpirtërore bëhet me anë të parafrazimit, i cili ka një ndërtim të tillë: X (=Stimuli) i shkakton Y(=Përjetuesit) një gjendje emocionale. Semantika e foljes në këtë rast mund të jepet me një mbiemër: X e bën Y të trembur.

Në rastin e versionit të Grimshaw-t (g) krahas foljes që testohet duhet të ekzistojë një emër me të njëjtën semantikë, si folja, që të mund të bëhet perifrazimi:

X i shkakton Y frikë. Emri frikë ekziston krahas foljes frikësoj. Në këtë mënyrë testi është i mundur.

Një mënyrë tjetër testimi për të vërtetuar kauzalitetin implicit është dhe i ashtuquajtur i dekompozim i predikatit. Në këtë rast provohet nëse predikati është i zërthyeshëm në dy komponente. Komponentja e parë duhet të shënojë veprim, komponentja e dytë – gjendje.<sup>360</sup>

Teste të tjera, paraqitje eksplicite, për të provuar kauzalitetin e foljeve që tregojnë gjendje shpirtërore nuk kemi gjetur në literaturën e shqyrtuar.

Në përshkrimin dhe në analizën tonë nuk mund të lemë pa përmendur dhe mendimin që pranon grupimin e foljeve psikologjike në kauzale dhe jokauzale.<sup>361</sup> Ky mendim ka ngjallur diskutime.

Edhe studimet, dhe eksperimentet psikologjike dhe psikolinguistike<sup>362</sup> mbështesin konkluzionin e arritur me anë të testimit për natyrën kauzale të foljeve që tregojnë gjendje shpirtërore. Shprehje të tilla gjendjesh shpirtërore, pavarësisht nga struktura e tyre argumentore (plotësore), shënojnë raporte kauzale. Eksperimentet janë zhvilluar në laboratore ose në auditore. Objekt i kërkimit kanë qenë shprehje që përmbanin folje që shënonin gjendje shpirtërore. Dëgjuesit duhej të bënin interpretimin e

---

<sup>360</sup> Shih, Grimshaw, J.: *The Structure of Argument Structure*, Cambridge/Mass, 1990, f. 24.

<sup>361</sup> Primus, B., *Kasusvariation bei psychischen Verben*, Tübingen, Gunter Narr Verlag, 2004, f. 378 – 401.

<sup>362</sup> Brown, R./Fish, D., “The psychological causality implicit in language”, botuar në, *Cognition*, 14; Rudolph, U./Fösterling, E., „Zur impliziten Kausalität in Sprache: Kriterien zur Selektion von Stimulusmaterial in Studien zur Verbkausalität“, botuar në, *Zeitschrift für experimentelle Psychologie*, 44, 1997/2, f. 293-304; Härtl, H., “Mapping conceptual onto grammatical structures: The case of psych verbs”, botuar në, *Structural Aspects of Semantically Complex Verbs*, Frankfurt/New York: Lang, 2001, 191-217.

thëniet duke u nisur nga semantika e foljeve. Interpretimi kishte të bënte me formimin e një pjese të varur që ishte rrjedhë logjike e thëniet të cituara:

- (h) Maria e *çudit* Enon ... (Interpretimi): meqë është tepër inteligjente ...
- (i) Maria e *do* Enon...

Në pjesën më të madhe të interpretimeve thëniet e artikuluar ishin pjesë të varura shkakore, gjë që flet për natyrën implicite të kauzalitetit në foljet që po shqyrtojmë. Foljet psikologjike e kanë shkakun me vete, brenda tyre. Çdo folje psikologjike paraqet një ndodhi, është një skenar që pas dukjes, shfaqjes fsheh shkakun. Ndodh që shkakun të jetë dhe evident, i dukshëm:

- (j) Ai ishte mrekulluar *nga fjalët e saj*.

Është një skenë, një ndodhi e tërë që shpaloset me foljen mrekullohem.

Të gjitha foljet dhe shprehjet foljore që shënojnë emocione dhe gjendje shpirtërore përmbajnë në semantikën e tyre shkakësi implicite. Në ndërtimet, ku ato marrin pjesë, ekziston një marrëdhënie shkakore midis stimulit dhe përjetuesit. Ndjenja që provon përjetuesi konceptohet si pasoja e një shkakun që rrjedh nga stimuli:

- (k) Andeta më tërheq. Interpretimi: Andeta (stimuli) prodhon tek unë atë gjendje (pasoje) që quhet tërheqje.

Po t'u kthehem dhe njëherë shembujve (h) dhe (i):

- Maria e çudit Enon ...*
- Maria e do Enon...*

Vemë re që në rastin (h) stimuli Maria është në rasën emërore, përjetuesi Enon – në rasën kallëzore, në shembullin (i) Stimuli Enon është në rasën kallëzore, përjetuesi Maria është në rasën emërore. Këtë dukuri të variacionit rasi të roleve semantike stimul dhe përjetues do ta trajtojmë në segmentin që vijon.

### IX.3.2 Variacioni kombinues i roleve semantike me funksionet sintaksore të foljet psikologjike

Për disa kohë foljet “psikologjike” me veçoritë e tyre e kanë shqetësuar e turbulluar mendimin gjuhësor. Është, pothuaj, një rregull i përgjithshëm që roli semantik (tematik) i agjentit projektohet te subjekti. Ndërsa roli i pacientit (pësuesit) projektohet zakonisht te plotësi në kallëzore. Si në shqip, ashtu dhe në gjermanisht nuk takohet shfaqja e anasjelltë: kombinimi i agjentit (vepruesit) me plotësin në kallëzore (kundrinorin e drejtë) dhe i pacientit (pësuesit) me subjektin. Krejt ndryshe paraqitet puna me rolin semantik “eksperiencer” (përjetues).<sup>363</sup>

Edhe në shqip, edhe në gjermanisht, si dhe në shumë gjuhë të tjera, ai mund të dalë herë si subjekt, herë si plotës në kallëzore (kundrinor i drejtë). Folje që kërkojnë përdorimin e rolit tematik të përjetuesit të shoqëruar me një subjekt janë: *dashuroj, urrej, admiroj, përbuz* etj. (*lieben, hassen, bewundern, verachten*).

---

<sup>363</sup> “Eksperiencer” (përjetësues) shënon bartësin e një procesi mendor-ndjenjësor.

Folje që kërkojnë kombinimin përjetues-plotës në kallëzore janë: *frikësoj, tremb, lodh, shqetësoj, mërzis* etj. (*erschrecken, ängstigen, ermüden, aufregen, langweilen*).

Folja shqipe (më) intereson, ndryshe nga folja përgjegjëse në gjermanisht kërkon një plotës në dhanore, në gjermanisht – plotës në kallëzore.

Çështja që e ka shqetësuar dhe e shqetëson mendimin gjuhësor është:

Pse kombinimi i roleve tematike agjent/ pacient (veprues/pësues) me gjymtyrët e fjalisë është i përcaktuar dhe i pakthyeshëm (agjenti është subjekt, pacienti është objekt), ndërsa kombinimi i roleve stimulus<sup>364</sup>/ eksperiencer (stimul/ përjetues) me funksionet sintaksore është i lëvizshëm, i ndryshueshëm, reversibel?

Le të shikojmë disa teori dhe mendime që përpiqen dhe synojnë të shpjegojnë dukurinë e variacionit rasor të roleve semantike stimul dhe përjetues.

### IX.3.2.1 Teoria Belleti/ Rizzi (1988)

Teoria e zhvilluar nga Adriana Belleti dhe Luigi Rizzi<sup>365</sup> ka për objekt foljet psikologjike. Në këtë kuadër trajtohen ndërtimi i tyre sintaksor, strukturat e tyre të thella dhe strukturat sipërfaqësore që rrjedhin prej tyre. Foljet psikologjike kanë strukturë të njëjtë argumentore, domethënë aktivizojnë të njëjtat role tematike, stimul dhe përjetuesin. Këto role tematike mund të projektohen herë në subjektin, herë në objektin që kërkon folja. Në varësi të kësaj foljet psikologjike mund të kategorizohen si më poshtë:

- (l) Era e ka frikë këtë.
- (m) Kjo e shqetëson Erën.
- (n) Erës i pëlqen kjo.

Në të tria rastet përjetuesi shfaqet në funksione të ndryshme sintaksore, si pasojë dhe në rasta të ndryshme. Në fjalinë (l) përjetuesit *Era* i atribuohet subjekti që kërkon folja, në rastin (m) përjetuesi *Erën* kombinohet me funksionin sintaksor të plotësit në kallëzore (kunderinorin e drejtë). Ndërsa folja në fjalinë (n) kërkon dy argumente (*Erës, kjo*). Roli semantik i përjetuesit i projektohet plotësit në dhanore (kunderinorit të zhdrejtë).

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për gjuhën gjermane:

- (l<sub>1</sub>) Era fürchtet das.
- (m<sub>1</sub>) Das beschäftigt Era.
- (n<sub>1</sub>) Era gefällt das.

Shembujt ilustrues në teorinë në fjalë janë madje italisht:

- (l<sub>2</sub>) Gianni temme questo.
- (m<sub>2</sub>) Questo preoccupa Gianni.
- (n<sub>2</sub>) A Gianni piace questo.

---

<sup>364</sup> Ky rol shënohet shpesh me termin “temë”. Meqë ky term nuk ka kufinj të qartë, në vëllimin e tij ai përmbledh role nga më të ndryshmit semantikisht, ne preferuam termin “stimul” që shënon në rastin tonë shkaktarin e proceseve mendore – ndjenjësore të përjetuesit (eksperiencer).

<sup>365</sup> Belleti, A/ Rizzi, L., “Psychverbs and Theta – Theory”, botuar në, *Natural Language and Linguistic Theory* 6, f. 293-352.



Në të tria gjuhët e cituara dukuria e shfaqjes së roleve stimul dhe përjetues paraqet të njëjtën problematikë: Pse përjetuesi në folje të tilla që tregojnë gjendje shpirtërore-emosionale projektohet në gjymtyrë me funksione të ndryshme sintaksore?

Sipas shpjegimit të autorëve të sipërpërmendur ka një sasi foljesh të llojit *shqetësor* që paraqesin disa veçori të caktuara sintaksore. Në ndërtimet, ku marrin pjesë këto folje, subjektet e strukturave sipërfaqësore janë objekte në strukturat e thella. Nga ana tjetër dhe objektet e ndërtimeve të tilla nuk janë objekte të mirëfilltë, pësues të veprimit foljor.

Nga shembujt e paraqitur lind edhe një pyetje tjetër:

Pse eksperienca (përjetuesi) Era në (m) dhe (n) nuk mund të vendosen në pozicionin e subjektit? Në këtë pozicion shfaqet elementi *kjo*.

Autorët i përgjigjen kësaj pyetjeje: Përjetuesit e fjalive (m) dhe (n) pengohen të lëvizin në pozicionin e subjektit, se atyre u është atribuar një rasë leksikore dhanore ose kallëzore. Dhe, meqë rasa leksikore varet nga folje të caktuara, fenomeni në fjalë rezulton si një veçori leksikore rastësore e disa foljeve.

Teoria e sapo paraqitur është kritikuar, sepse merr përsipër, por nuk shpjegon tërësisht pse pikërisht foljet psikologjike paraqesin veçori të tilla. Dukuria evidentohet qartë, gjatë shpjegimit jepen të dhëna interesante për raportin e strukturave të thella me ato sipërfaqësore në rastin e ndërtimeve me folje të tilla. Por zinxhiri i argumenteve ndërpritet kur fillon motivimi jo i mjaftueshëm që i hap shtigjet rastësisë.

### IX.3.2.2 Teoria e Grimshaw-t<sup>366</sup>

Grimshaw e mbështet teorinë e saj në semantikën e foljeve në fjalë. Autorja ndërton fillimisht një renditje hierarkike të roleve tematike:

Agjenti-Përjetuesi- Burimi/Lokativi/Pikësynimi-Objekti

Struktura argumentore, sipas autores, nuk përmban asnjë informacion mbi rolet tematike, por veç mbi rendin e tyre në hierarki. Pyetjes: pse eksperienca (përjetuesi) në disa raste është subjekt (Era e admiron Gentin.), në disa raste është objekt ( Kllouni i tremb fëmijët.) Grimshaw i përgjigjet me teorinë e “dimensionit aspektor” të foljeve. Në sistemin e llojeve të aspekteve dallon katër të tillë: gjendje, gjendje me ndryshim të saj, aktivitet, aktivitete me rezultate.<sup>367</sup>

Këto lloj foljesh (psikologjike) shprehin aspekte të ndryshme. Aspekti foljor është i lidhur me kauzalitetin. Grimshaw ndërton dhe një hierarki kauzale<sup>368</sup> të lidhur gjithnjë me aspektin foljor. Ajo dallon argumentin shkak nga argumentet e tjera që nuk e kanë këtë veçori. Hierarkia kauzale dhe ajo tematike gërshetohen njëra me tjetrën me anë të strukturës leksiko-semantike të foljes. Kështu çdo argument ka rendin e tij në hierarkinë tematike dhe në atë kauzale.

Për Grimshaw agjenti leksikalizohet gjithnjë te subjekti, sepse ai qëndron krejt lart në hierarkinë tematike dhe kauzale.

---

<sup>366</sup> Grimshaw, J., *The Structure of Argument Structure*, Cambridge/Mass, 1990, f.12.

<sup>367</sup> Grimshaw, J., *The Structure of Argument Structure*, Cambridge/Mass, 1990, f. 23.

<sup>368</sup> Po aty, f. 24.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

(o) Një vajzë thyen xhamin. 'Ein Mädchen zerbricht das Fenster.'

Një vajzë = Agjent  
thyen = Folje  
xhamin = Pacient

Ein Mädchen = Agent  
zerbricht = Verb  
das Fenster = Patient

Po ta krahasojmë këtë ndërtim me ndërtimin:

(p) Portreti e tmerroi Anën. 'Das Bild erschreckte Anna.'

vëmë re që subjektet ndryshojnë për nga rendi në hierarkitë e ndryshme. Në shembullin (p) subjekti qëndron lart në hierarkinë kauzale, ndërsa në shembullin (o) në hierarkinë tematike, është agjent.

Dimensioni aspektiv është i lidhur ngushtë me strukturën semantike të foljes si shprehje e një ndodhie. Kjo strukturë ndahet më tej në njësi përbërëse. P.sh.: një ndodhi e tillë „x ndërton një y“ përbëhet nga dy pjesë, një aktivitet dhe një gjendje rezultuese:

(q) ndodhi  
/ \  
aktivitet gjendje

Argumenti-shkak është gjithnjë i përfshirë në pjesën e parë përbërëse (aktivitet). Pjesa e parë qëndron në marrëdhënie shkakore me pjesën e dytë përbërëse të ndodhisë së shënuar nga folja. Në foljet njëvalente, si *punoj* struktura e ngjarjes së shënuar nga folja nuk copëtohet në pjesë përbërëse, përbëhet thjeshtë nga një kuptim që tregon aktivitet.

(r) punoj  
|  
aktivitet

Grimshaw përgjithëson dhe shpall: gjymtyra „prominente“ në pikëpamje aspektive del si subjekt. Me fjalë të tjera përfundimi i Grimshaw-t mund të formulohet kështu: Stimuli në të gjitha foljet psikologjike me kuptim kauzal del si subjekt, sepse ai në këto përdorime ka veçori të agjentit dhe duhet të leksikalizohet si subjekt.

### IX.3.2.3 Teoria e Dowty-t

Në këtë teori operohet me konceptet Agjent dhe Pacient (veprues dhe pësues) që zënë një vend qendror. Dowty<sup>369</sup> argumenton që këto koncepte nuk janë kategori monolite, por kategori të zbërthyeshme. Ato mund të zbërthehen në komponente përbërëse. Gjatë përdorimit ndodh që konceptet e përmendura të përmbajnë më shumë ose më pak komponente përbërëse. Mbi këtë bazë Dowty zhvillon teorinë e „Proto- Roleve“ ku përfshihen „Proto-Agens“ dhe „Proto-Patiens“.

Për proto-agjentin Dowty numëron këto veçori:

<sup>369</sup> Dowty, D., “Thematic Proto-Roles and Argument Selektion”, botuar në, *Language* 1991, 67/3, f. 547-619.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

- është pjesëmarrës i vullnetshëm në një ndodhi ose në një gjendje (të shprehur nga folja).
- është i rrokshëm mendërisht, me anë të shqisave dhe me anë të ndjenjave.
- kushtëzon një ndodhi ose një ndryshim të një gjymtyre tjetër.
- është i lëvizshëm (drejt pozicionit të gjymtyrës tjetër)

Për proto-pacientin Dowty jep këto tipare:

- përjeton një ndryshim
- në gjendjen e tij mund të „lexohet“ zhvillimi i veprimit ose i gjendjes (së shprehur nga folja)
- ekzistenca e tij kushtëzohet nga një gjymtyrë tjetër
- në raport me gjymtyrën që kushtëzon ekzistencën e tij ka një pozicion statik

Argumentet (plotësat) manifestojnë herë më shumë, herë më pak nga veçoritë e përmendura, ndërsa të quajturat „proto-role“, „proto-agens“, „proto-paciens“ i përmbajnë, secila gjymtyrë, të gjitha këto veçori. Dowty formulon principin e mëposhtëm lidhur me kombinimin e roleve semantike me funksionet sintaksore:

“Në ndërtimet me folje që kërkojnë një subjekt dhe një objekt do të leksikalizohet si subjekt gjymtyra (argumenti) që përmban më shumë veçori të „protoagentit“; ndërsa gjymtyra që manifeston më shumë veçori të „protopacientit“ do të leksikalizohet si objekt (kundrinë).<sup>370</sup>

Nëse dy argumentet e një relacioni paraqesin të njëjtën sasi të veçorive të protoroleve, atëherë secili prej tyre konkurren për vendin e subjektit.

Në rastin e foljeve psikologjike me një stimul dhe një përjetues krijohet një situatë ekuivoke. Në disa ndërtime përjetuesi ka më shumë veti të vepruesit (agjentit), në disa të tjera stimuli manifeston më shumë veçori agentive. Nga kjo del se të dyja madhësitë, stimuli dhe përjetuesi kanë një tendencë të njëjtë të fortë, në fakt të dobët, për t'u bërë subjekt. Po cili do të bëhet subjekt. Këtu Dowty thërret në ndihmë semantikën e foljeve. Në klasën e foljeve psikologjike dallohen grupe të ndryshme. Në një grup përmbledh foljet me subjekt përjetuesin. Ato janë zakonisht statike. Ndërsa foljet me subjekt stimulin mund të jenë statike ose të sinjalizojnë ndryshim. Kjo do të thotë që sinjalizohet ndryshimi i gjendjes së përjetuesit, i cili kalon në një gjendje të re mendore-emocionale. Sipas këtij interpretimi përjetuesi (eksperiencer) ka veçori të pësuesit dhe kjo bën që ai të funksionojë si objekt (kundrinë). Dhe stimuli automatikisht mbetet subjekt.

### IX.3.2.4 Përfundime

Secila nga teoritë e përshkruara më sipër jep kontributin e vet në shpjegimin e dukurisë së variacionit rator të roleve semantike stimul dhe përjetues gjatë kombinimit të tyre me funksionet sintaksore. Këto teori synojnë të shpjegojnë pse ndodh që në strukturat që përmbajnë folje kauzative psikologjike stimuli (shkaku) herë del si subjekt, herë si objekt fjalie. E njëjta gjë ndodh dhe me përjetuesin (experiencer). Teoritë e shtrojnë drejt problemin, bëjnë përshkrime dhe analiza të sakta. Japin informacion interesant për analizën e rasteve të tilla, për identifikimin e

<sup>370</sup> Dowty, D., “Thematic Proto-Roles and Argument Selektion”, botuar në: *Language* 1991, 67/3, f. 119.

madhësive shkak -pasojë (stimul-përjetues) në këto konstrukte. Por në të tria teoritë ka shumë hapësirë intuitive, i lihet shumë fushë intuitës, gjë që dëmton argumentin shkakor. Ka dukuri që merren të mirëqena pa dhënë shpjegime (rasa leksikore në teorinë e parë, ndërtimi i hierarkive). Ndër të tria teoritë, sipas mendimit tonë, më bindëse dhe më e përdorshme paraqitet teoria e tretë e autorit Dowty. Teoria e Protoroleve e Dowty-t është përdorur gjerësisht në shpjegimin e dukurisë në fjalë, në raste gjuhësh të ndryshme. Duke u njohur me këtë teori, menjëherë, me asociacion, të kujtohet principi logjik i transferimit të energjisë në teorinë e lidhjes kauzale që është trajtuar e ilustruar bindshëm nga Hume. Kështu, problemi i raportit shkak-pasojë në ndërtimet me folje ndërvetore (interpersonale) nuk mund të shtjellohet e të zgjidhet kënaqshëm pa u lidhur me filozofinë.

### IX.3.3 Stimuli si shkak

Po e fillojmë këtë paraqitje me formulimin që tashmë është pranuar nga shumica e lingvistëve: “Stimuli në ndërtimet me folje psikologjike është shkak i emocionit të përjetuar nga gjymtyra tjetër që kërkon folja, përjetuesi.”<sup>371</sup> Le ta ilustrojmë këtë formulë me shembuj:

- (a) Talenti i poetit e mahniti publikun.
- (b) Gënjeshtat e tij e zhgënjyen.

Në fjalinë e parë elementi *talenti* shënon një tipar i cili shkakton një gjendje emocionale te gjymtyra tjetër publikun. Gjymtyra *talenti* kryen funksionin e subjektit, gjymtyra tjetër *publikun* kryen funksionin e plotësit në kallëzore (objektit). Folja i cakton gjymtyrës së parë rolin semantik të stimulit, gjymtyrës tjetër rolin semantik të pësuesit. Stimuli është dhe shkak i përjetimit, i emocionit të përjetuesit, emocioni i tij është pasoja.

Në fjalinë e dytë te subjekti *gënjeshtat e tij* projektohet roli semantik i stimulit që shkakton gjendjen emocionale të objektit *e (atë e)* i cili luan dhe rolin e përjetuesit. Kauzaliteti i foljeve të tilla provohet me mjete e mënyra të ndryshme. Ne kemi përmendur më lart mënyrën e perifrazimit me fjali shkakore. Një mënyrë tjetër evidentimi i shkakësisë që përmban folja do të ishte transformimi i fjalisë me anë të shoqërimit të foljes së dhënë me foljen *bëj* : Talenti i poetit bëri që të mahnitej publiku. Folja e përdorur në këtë transformë është folje kauzative. Fjalitë janë barsvlera semantike.

Krahas testimeve për të provuar dhe argumentuar kauzalitetin e foljeve psikologjike, janë bërë dhe testime për të diferencuar shkakun dhe pasojën në ndërtimet me folje psikologjike.<sup>372</sup> Nga testimet ka rezultuar: gjymtyra që luan rolin e stimulit është gjithnjë shkak, pavarësisht nëse ajo është subjekt ose objekt. Testimet dhe eksperimentet janë zhvilluar me material e folës gjuhësh të ndryshme, anglisht, gjermanisht, holandisht, italisht, kinezisht etj. Në asnjë rast nuk është interpretuar përjetuesi si shkak i përmbajtjes së foljes. Studimet dhe eksperimentet në gjuhë të ndryshme kanë theksuar tezën se stimuli në ndërtimet me folje emocionale është

---

<sup>371</sup> Shih, Kutscher, S., *Kausalität und Argumentrealisierung. Rollensemantik der Psychverben*, Tübingen, 2009, f. 89.

<sup>372</sup> Shih, Härtl, H., *Cause and Change. Thematische Relationen und Ereignisstrukturen in Konzeptualisierung und Grammatikalisierung*. Berlin, 2001; Wegener, H., „Zum Bedeutungs- und Konstruktionswandel bei psychischen Verben“, botuar në, *Deutsch kontrastiv. Studien zur deutschen Grammatik* 28. Tübingen, Stauffenburg 1999, 171-210.

gjithnjë shkak. Kjo tezë vlen dhe për shqipen. Stimuli konceptohet si shkak, stimuli është shkak në të gjitha proceset dhe gjendjet mendore, në të gjitha realizimet gjuhësore (me folje psikologjike) të këtyre dukurive. Kjo thënie vlen si në pikëpamje ontologjike, ashtu dhe në rrafshin gjuhësor të shprehjes së fenomeneve të tilla. Stimuli shkakton emocionin.

Një çështje tjetër që lidhet me stimulimin është dhe ajo e llojit të stimujve. Çështja mund të formulohet si pyetje: A ka tipa të ndryshëm stimujsh?

Autorë si Pesetsky (1995), Kailuweit-i (2005)<sup>373</sup> pranojnë që stimuli shfaqet në dy lloje. Për ta argumentuar këtë ide në gjuhën tonë do të sillnim si ilustrim shembuj të tillë:

(c) Fëmija e mërzi nënën me sjelljen e tij.

Gjymtyrët *fëmija* dhe *me sjelljen e tij* trajtohen nga Pesetsky si dy stimuj. Stimuli i parë është i projektuar te subjekti, stimuli i dytë – te plotësi instrumental.

Ndërsa Kailuweit-i e emëron gjymtyrën e parë korrelat, të dytën – shkak.

Për mendimin tonë gjymtyra *fëmija* mund të shihet si stimul direkt ose i brendshëm, gjymtyra tjetër *me sjelljen e tij*, stimul i jashtëm, jo direkt. Tek e fundit gjymtyra *me sjelljen e tij* është gjymtyrë fakultative, nuk bën pjesë në planin ndërtimor fillestar të fjalisë. Edhe pa të fjalia është e rregullt nga ana gramatikore: *Fëmija e mërzi nënën*. Si e tillë kjo gjymtyrë nuk ka pse të trajtohet si pjesë e strukturës argumentore të foljes *mërzi*.

### IX.3.4 Përjetuesi si komponent i domosdoshëm i raporteve shkakore implicite

Gjendja psikologjike dhe emocija nuk janë ekzistentë, po qe se nuk perceptohen, nuk përjetohen nga dikush. Perceptuesi është një gjymtyrë e domosdoshme e foljeve psikologjike. Sepse nuk mund të kemi:

Andi më tërheq, por unë nuk përjetoj gjë. (?)

Nëse folësi dhe përjetuesi nuk janë identikë, ekzistenca e përjetuesit është e domosdoshme për të perceptuar shkakun dhe për ta përjetuar atë.

Ndryshe ndodh me foljet që tregojnë veprime konkrete fizike, si *godas*. Perceptimi nuk është i së njëjtës mënyrë si tek foljet psikologjike. Një veprim i tillë nuk lidhet domosdoshërisht me perceptimin e pësuesit. Veprimi nuk varet nga pësuesi, nga receptimi i tij. Prandaj proceset e manifestuara fizikisht përbëjnë konstrukte shkakore asimetrike. Njëra gjymtyrë e ndërtimit (vepruesi/agjenti) është njëkohësisht kushti i domosdoshëm i procesit. B. Primus-i e përcakton proto-pacientin/pësuesin në raportet shkakore implicite si të varur nga proto-agjenti/vepruesi.<sup>374</sup>

Por kuptimi i një foljeje psikologjike përcaktohet nga gjendja mendore-shpirtërore e përjetuesit dhe jo nga veprimi i kryer nga stimuli. Kështu përmbajtja e foljes *mahnis* ka të bëjë me perceptimin e referentit-përjetues, që e vlerëson si mahnitës një veprim

---

<sup>373</sup> Kailuweit, R., „Protorollen und Makrorollen“, botuar në, *Semantische Rollen*, Tübingen, 2005, f. 83 – 102.

<sup>374</sup> Shih, Primus, B., „Proto-roles and case selection in Optimality Theory“, botuar në: *Theorie des Lexikons, Arbeiten des Sonderforschungsbereichs 282, Nr. 122*, 2002.

ose një veti të referentit-stimul. Ky vlerësim/përjetim i përjetuesit nuk i nënshtrohet kontrollit të referentit-stimul. Kjo do të thotë që referenti-stimul përpriqet ta mahnisë referentin përjetues. Ia arrin ose jo qëllimit, kjo nuk është nën kontrollin e tij.

Perceptimi i vetëdijshëm dhe vlerësimi i stimulit nga përjetuesi është i një rëndësie të veçantë. Nga ana tjetër përjetuesi si argument i një foljeje psikologjike është një gjymtyrë tejet rëndësore. Siç del dhe nga shumë studime<sup>375</sup> valenca e një foljeje psikologjike kërkon gjithnjë një argument-përjetues. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për stimulit. Kështu mund të pohojmë: në gjuhën shqipe dhe në shumë gjuhë të tjera ka folje psikologjike njëvalente. Argumenti i vetëm i domosdoshëm në këtë rast është përjetuesi:

*Atij as i hahej, as i pihej.*

*Po më luan mendja.*

Një argument tjetër në të mirë të kësaj teze janë dhe hulumtimet në fushën e emocioneve.<sup>376</sup> Punimet në këtë sferë tregojnë se emocionet e përjetuara mund të kontrollohen me vetëdije. Ndërsa stimuli nuk ka ndikim kontrollues ndaj emocioneve, përjetuesi mund të përpunojë strategji të ndryshme për t'i vënë ato nën kontroll. Roli i përjetuesit për nga vlera dhe rëndësia në strukturën argumentore të foljeve psikologjike mund të krahasohet me atë të vepruesit. Ata ngjasin dhe në pikëpamje morfosintaksore.<sup>377</sup>

B. Primus-i<sup>378</sup> e quan përjetuesin një kusht të domosdoshëm në një situatë mendore-psikologjike. Përjetuesi përcakton veçoritë që duhet të përmbajë një objekt për të qenë stimul. Primus-i e ilustron këtë mendim me një shembull domethënës:

Lulja ka disa veçori, aromën, ngjyrën, formën. Por përjetuesi vendos se cila veçori vendoset në fokus gjatë një situatë perceptiv-mendore. Mund të jetë ngjyra, kur është fjala për pamjen, mund të jetë aroma në lidhje me nuhatjen etj. Primus-i e shpall përjetuesin si konstitutiv për interpretimin e stimulit, vetëm në sajë të përjetuesit bëhet i mundur interpretimi i ndikimit, i pasojës që rrjedh nga veprimi i stimulit. Kështu përjetuesi, në raportet shkakore të proceseve mendore është gjymtyrë e pavarur. Ndërsa stimuli, në pikëpamje të varësisë shkakore, është gjymtyrë e varur nga përjetuesi.<sup>379</sup>

Primus-i ndërton dhe një hierarki të argumenteve të foljeve psikologjike (njëvalente) ku përjetuesi ka rangun më të lartë: *Experiencer* > *Stimulus*. Kjo vërtetohet dhe nga fakti që përjetuesi realizohet gjuhësisht si një argument/plotës i detyrueshëm, stimuli – jo. Gjithnjë sipas Primus-it kjo hierarki me mbivendosje të përjetuesit vlen vetëm për foljet psikologjike jokauzative që shënojnë ndijime të thjeshta (më intereson, më shijon, më pëlqen).<sup>380</sup>

---

<sup>375</sup> Shih, Kutscher, S., *Kausalität und Argumentrealisierung. Rollensmantik der Psychverben*, Tübingen, 2009, f. 82.

<sup>376</sup> Shih, Mauss, E. /Bunge, S. A. /Gross, J. J., "Automatic emotion regulation", botuar në, *Psychologie Social and Personality, Compas 1*, 2008, f. 146 – 167.

<sup>377</sup> Shih, Dowty, D., "Thematic proto-roles and argument selection", botuar në, *Language 67/3*, 1991, f. 547- 619.

<sup>378</sup> Primus, B., *Semantische Rollen. Kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag Winter, 2012, f. 56.

<sup>379</sup> Shih, Primus, B., *Semantische Rollen. Kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag Winter, 2012, f. 60.

<sup>380</sup> Shih dhe trajtimin tonë të paraqitur në: Disa veçori të foljeve interpersonale-psikologjike, pa subjekt, njëvalente në gjuhën gjermane.

Ndërsa në foljet kauzative, që shënojnë procese emocionale të shkaktuara me vetëdije nga një stimul, procese që prekin ndjenjën e një përjetuesi, stimuli si shkak vlerësohet më lart nga përjetuesi (Stimulus > Experiençer).<sup>381</sup>

Sipas mendimit tonë numri i foljeve njëvalente që mund të dalin pa stimul është shumë i vogël. Në princip foljet psikologjike janë dyvalente. Ato kërkojnë një stimul dhe një përjetues. Edhe shembulli me lulen, i paraqitur nga Primus-i, mund të interpretohet dhe kështu: një lule shkakton një ndjesi, një gjendje, në sajë të veçorive të saj ekzistente dhe jo, p.sh., për shkaqe akustike. Kështu stimuli, shkaktari me veçoritë e tij jep kornizën, terrenin, ku ndodh përjetimi. Duhet të ekzistojë një objekt a një ndodhi që të mund të përjetohet, të perceptohet. Kjo të kujton mendimin filozofik të Lewis-it: “Nëse nuk ka stimul, nuk ka as përjetues të një gjendjeje, anasjelltas, po të mos ekzistojë përjetuesi, nuk mund të ketë as stimul”.<sup>382</sup>

Të dyja argumentet ku projektohen stimuli dhe përjetuesi janë kusht për ekzistencën e një gjendjeje mendore-psikologjike të shprehur nga një folje. Si stimuli, ashtu dhe përjetuesi gjenden në të njëjtin rrafsh në hierarkinë e roleve semantike.

### IX.3.5 Përfundime

Si përfundim mund të theksojmë se foljet që shprehin gjendje a procese mendore-psikologjike janë, zakonisht, dyvalente. Rastet, ku ato paraqiten njëvalente, janë tepër të rralla, si në shqip (*më merren mendtë*), edhe në gjermanisht (*mir ist schwindlig*). Në gjuhën gjermane vihet re prirja e transformimit të njësive të tilla në ndërtime ku roli i përjetuesit projektohet te subjekti (*ich bin schwindlig*).

Siç u përpoqëm të provojmë dhe më lart stimuli dhe përjetuesi janë dy elemente të domosdoshme në ndërtimet me folje psikologjike. Këto folje hapin vend për dy argumente të detyrueshme; njëri luan rolin e stimullit, tjetri të përjetuesit. Stimuli, si shkaktar i gjendjes që provon përjetuesi, mund të jetë frymor, ide ose objekt. Përjetuesi është gjithnjë qenie njerëzore. Si stimuli, ashtu dhe përjetuesi gjenden në të njëjtin nivel në hierarkinë e roleve semantike .

### IX.4 Paragraf - eksperiment

#### IX.4.1 Eksperimenti

Për të hulumtuar më tej zbatimin dhe vërtetimin e teorive të përmendura mbi kauzalitetin implicit në foljet ndërvetore-psikologjike në gjuhën tonë, ne ndërmorëm dhe një kërkim me ndihmën e një grupi studentësh të degës gjermanisht. Ilustrimet sistematike me shembuj në gjuhën shqipe në kapitujt e mësipërm tregojnë që tezat e parashtruara, teoritë e ndryshme linguistike mbi kauzalitetin implicit gjejnë terren zbatimi e vërtetimi dhe në gjuhën tonë. Kjo është lehtësisht e shpjgueshme: kauzaliteti implicit me dimensionin e tij ontologjik gjen shprehje në rrafshin linguistik të çdo bashkësie gjuhësore. Megjithatë kjo dukuri mund të paraqesë ndryshime nga gjuha në gjuhë. Sepse bota reale nuk strukturohet gjithnjë njëllë në gjuhë të ndryshme; strukturat e njëjta të thella nuk jepen gjithnjë me të njëjtat struktura sipërfaqësore.

---

<sup>381</sup> Shih, Primus, B., *Semantische Rollen. Kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag Winter, 2012, f. 79.

<sup>382</sup> Shih, Lewis, D., *Counterfactuals*, Harvard, University Press 1973, f. 63.

Korpus analize këtë herë nuk ishte ndonjë tekst, por një listë foljesh. Janë folje që shënojnë veprime ose gjendje, folje të fondit themelor leksikor, të vjela nga “Fjalori i Gjuhës Shqipe”, Tiranë, 1984. Numri i foljeve të cilat ishin pjesë e këtij fondi ishte rreth 700. Krahas foljes në gjuhën shqipe është dhënë dhe forma përgjegjëse e gjuhës gjermane. Kjo mënyrë hartimi e korpusit gjuhësor ka pasur si qëllim pasqyrimin e dallimeve në planin morfosintaksor. Sepse foljeve të njëjta ose të ngjashme në planin logjikosemantik, nuk u përgjigjen gjithnjë forma të njëjta morfosintaksore. Ka folje që në gjuhën shqipe dalin në formë veprorë, ndërsa përgjegjësja në gjuhën gjermane është reflexive, ose e kundërta (dëshpërohem-‘verzweifeln’; ‘kollitem- husten’; kundërshtoj – ‘sich weigern’; ndryshoj – ‘sich verändern’ etj.). Edhe reksioni i foljeve të njëjta ndodh të jetë i ndryshëm nga gjuha në gjuhë (më kushton – ‘mich kostet’ etj.). Nga ana tjetër elementet përgjegjëse hedhin dritë mbi njëri-tjetrin dhe krijohet një terren më i favorshëm për hulumtim, semantika e foljeve fiton më shumë vëllim e kontur. Qëllimi kryesor, që lidhet dhe me objektin e mbarë punimit tonë, ka qenë krahasimi. Atje, ku ka pasur dallime dhe vend për krahasim, jemi ndalur veçanërisht e janë hetuar dhe foljet e gjuhës gjermane.

Detyra e studentëve ishte që në këtë listë foljesh të dallonin foljet ndërvetore dhe në grupin e foljeve ndërvetore të përzgjedhura të veçonin foljet psikologjike.

Në një fazë të dytë të eksperimentit studentët duhej të ndërtonin strukturën argumentore të foljeve ndërvetore duke paraqitur dhe projektimin e roleve semantike.

### IX.4.2 Rezultatet e eksperimentit

Të dhënat përfundimtare të studentëve ishin disi të ndryshme për nga numri i foljeve ndërvetore-psikologjike të qëmtuara; disi të ndryshme për nga skemat semantike, ku jepej kombinimi i roleve semantike me funksionet sintaksore të ndërtimeve me folje të tilla.

Por ndryshimet nuk ishin të tilla sa të mos gjendej një e mesme e përgjithshme. Më poshtë do t’i japim rezultatet në tabela, ku jepen foljet dhe skemat kombinuese të roleve semantike me gjymtyrët sintaksore. Në pjesën më të madhe të rasteve studentët, si përdorues dhe studiues të gjuhës, arritën në përfundimin se foljet e skemave veprues – pësues (Agent – Patient AP) dhe stimul – përjetues (Stimulus – Experience SE) rolin e stimulit ia caktojnë subjektit, ndërsa foljet e skemave veprues – evokues (përgjegjës i termit në gjuhën angleze evocator) (Agent – Evocator AE) dhe përjetues – stimul (Experiencer – Stimulus ES) rolin e stimulit ia ngarkojnë objektit të fjalisë, plotësisht në kallëzore, rrallë në dhanore. Ky rezultat ka të bëjë me konceptimin subjektiv të këtyre raporteve nga studentët si përdorues të gjuhës dhe i përgjigjet tezës së përgjithshme që roli i stimulit, i shkakut, në ndërtimet me folje psikologjike i atribuohet së njëjtës gjymtyrë (subjektit ose objektit), nga gjuha në gjuhë.

#### IX.4.2.1 Veprues – Pësues (Agent – Patient)

arrij	erreichen
braktis	verlassen
dëgjoj	zuhören
dorëzoj	aufgeben
gjej	finden
ndërpres	unterbrechen



## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

---

ngre	aufheben
numëroj	zahlen
ndihmoj	helfen
përdor	benutzen
pezulloj	aussetzen/suspendieren
pyes	fragen nach
shërbej	dienen
shikoj	sehen
shmang	vermeiden
shoh	schauen
synoj	beabsichtigen
them	sagen
thërras	rufen
tregoj	zeigen
vendos	legen/stellen
vizitoj	besuchen
vras	töten
zbuloj	entdecken
zgjedh	wählen

### Shpjegime

Foljet e renditura në kolonat e mësipërme janë folje dyvalente. Në strukturën e tyre argumentore duhet të realizohen dy argumente, dy gjymtyrë të domosdoshme:

Andeta e braktisi shkollën.                      ‚Andeta verlass die Schule.‘

Gjymtyrë e detyrueshme janë *Andeta* dhe *shkollën* (gjerm.: *Andeta, die Schule*). Gjymtyra *Andeta* është subjekt, *shkollën* është objekt, në rastin tonë – plotës në kallëzore.

Të njëjtën strukturë argumentore kanë dhe foljet: *arrij, dëgjoj, dorëztoj, gjej, ndërpres, ngre, numëroj, përdor, pezulloj, pyes, shikoj, shmang, shoh, synoj, them, thërras, tregoj, vendos, vizitoj, vras, zbuloj, zgjedh*.

Në ndërtime të tilla, argumenteve (plotësive sipas terminologjisë të përdorur nga ne) u atribuohen role të ndryshme semantike. Subjekti luan rolin e vepruesit, ndërsa objekti shfaqet me rolin e pësuesit.

Në disa raste pësuesi është thjesht objekt i veprimit të kryer nga subjekti. Gjithsesi ai pëson diçka, qoftë dhe zhvendosje ose ndryshim të gjendjes. Në këtë kuptim ndodh që gjymtyra ku leksikalizohet pësuesi të jetë dhe në rasën dhanore:

I shërbej Agimit. (Argumenti Agimi shfaqet si objekt i veprimit të subjektit)  
,Agim (wem) dienen.’ (në gjermanisht është e domosdoshme edhe shfaqja e subjektit i cili vepron mbi argumentin Agim)

Ndërsa folja *ndihmoj* në gjermanisht kërkon një plotës në dhanore, në gjuhën shqipe plotësi mund të jetë në dhanore ose në kallëzore:

Ich helfe der Mutter.                      ‚Unë i ndihmoj nënës./ Unë ndihmoj nënën‘.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

Ajo që është më e rëndësishme në ndërtimet me folje të këtij lloji është se subjekti luan rolin e vepruesit, ndërsa objektit i ngarkohet nga folja roli i pësuesit.

### IX.4.2.2 Veprues – Evokues (Agent – Evocator)

analizoj/shqyrtoj	untersuchen
bind	überzeugen
dënoj	bestrafen
flas	sprechen
i shpëtoj	entkommen
jap	geben
këshilloj	raten
kujtoj	erinnern
korrigjoj	korrigieren
kritikoj	kritisieren
kthej (përgjigje)	erwidern
marr në mbrojtje	beschützen
mbroj	verteidigen
ndal	stoppen
ndërpres	unterbrechen
ndjek	verfolgen
pengoj	behindern
përshëndes	grüßen
pranoj	akzeptieren
pres	erwarten
reagoj	reagieren
shqiptoj	ausdrücken
siguroj	sichern

Shpjegime:

Në modelet me folje të llojit të mësipërm objekti është njëkohësisht veprues, subjekti është pësues, disi i veçantë. Ne e kemi quajtur reagues, që është një përshtatje e termit Evocator. Në disa raste unë kam përdorur termin evokues për Evokator. Edhe pse subjekti është veprues, shkaku i veprimit të tij është objekti/ evokuesi. Ndërsa në grupin veprues-pësues veprimi i subjektit bie mbi objektin dhe ky e pranon atë në mënyrë pasive, në ndërtimet me folje që plotësohen me argumente që luajnë rolet veprues dhe reagues, veprimi i subjektit vjen si rezultat, si ngacmim apo evokim i argumentit, që në fjali luan rolin e objektit, i cili reagon p.sh.: *lavdëroj, kritikoj, korrigjoj* etj.

Edhe në këtë rast kemi dallime midis shqipes dhe gjermanishtes në realizimin rasor të gjymtyrës objekt që luan rolin semantik të reaguesit (Evocator). Folja *raten*, përveç subjektit, kërkon një objekt në dhanore, ndërsa në gjuhën shqipe kjo gjymtyrë është në rasën kallëzore:

Ich rate *dir.* ,Unë të këshilloj *ty.*'

Vlen gjithashtu të theksojmë që objekti, i cili luan dhe rolin e reaguesit, në të dyja gjuhët mund të jetë, siç e pamë, dhe në dhanore: i shpëtoj /entkommen.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

Duhet të themi që këto lista janë të reduktuara, tejet të reduktuara. Megjithatë mund të jepet një ide e qartë për foljet interpersonale në gjuhën shqipe, për realizimin e argumenteve të tyre dhe për rolet semantike të këtyre argumenteve. Në të dyja modelet AP, AE vërtetohet teza e përgjithshme se subjekti është dhe veprues në aksionin e shënuar nga folja.

### IX.4.2.3 Stimul – Përjetues (Stimulus – Experienter)

befasoj	überraschen
ç'këshillon	abraten
çudis	erstauen
dëfrej	unterhalten
frikësoj	ängstigen
frymëzoj	inspirieren
ftoj	einladen
gjallëroj	animieren
nxis	aufmuntern
hutoj	verwirren
jap mësim	lehren
kënaq	befriedigen
kërcënoj	bedrohen
kujtoj	erinnern
lëviz	bewegen
mërzis	langweilen
mrekulloj	faszinieren
ndikoj	beeinflussen
ndryshoj	ändern
përgatis	vorbereiten
qetësoj	beruhigen
zhgënjej	frustrieren, enttäuschen

### Shpjegime

Modeli i fjalive që përmbajnë një folje psikologjike dhe dy plotësa të tillë është i përhapur në gjuhë. Megjithatë vlen të theksohet se numri i foljeve që tregojnë procese dhe gjendje psikologjike nuk është i madh, as në gjuhën shqipe, as në gjuhët e tjera. P.sh.: Në një studim të bërë në gjuhën gjermane u hetuan 10176 folje, të mbledhura nga gjashtë burime. Nga këto 3761 u klasifikuan si folje ndërvetore. Në klasën e foljeve ndërvetore u dalluan 3479 folje ndërvetore me kuptim vepror dhe 282 folje psikologjike (që shënojnë gjendje ose procese mentale-psikologjike).<sup>383</sup> Studime dhe hulumtime të tilla vlen të bëhen dhe në gjuhën shqipe. Në punimin tim është hedhur vetëm një hap modest në këtë fushë me përmasat e një „bote“ të tërë dukurish dhe interpretimesh.

Në ndërtime të tilla stimuli, shkaku/shkaktari i atribuohet subjektit, ndërsa objekti luan rolin e përjetuesit. Lidhur me realizimin morfologjik edhe këtu kemi ndryshime midis shqipes e gjermanishtes. Ndërsa objekti i foljes çkëshilloj në gjuhën shqipe

<sup>383</sup> Shih, Spörrle, M. /Barth, K. /Gerber-Braun, B./Försterling, F, „Eine lexikalische und korpusbasierte Analyse“, 46. *Tagung experimentell arbeitender Psychologen*, München, April, 2004.

## Shkakësia implicite dhe foljet ndërvetore (interpersonale)

realizohet me një element në rasën kallëzore, në gjermanisht folja kërkon rasën dhanore. Edhe te folja *kujtoj* ‚*erinnern*‘ ka dallime në realizimin morfologjiko-sintaksor të plotësit të dytë.

### IX.4.2.4 Përjetues – Stimul (Experiencer – Stimulus)

admiroj	bewundern
besoj	vertrauen
bezdís	belästigen
dashuroj	verlieben, sich
dua	lieben
ëndërroj	träumen
fal	vergeben
falenderoj	danken
harroj	vergessen
imagjinoj	sich vorstellen
konsideroj	betrachten
kuptoj	verstehen
lakmoj	beneiden
lejoj	erlauben
merakos	sorgen
njoh	erkennen
përbuz	erachten
preferoj	bevorzugen
qëndroj	stehen
respektoj	respektieren
rezistoj/kundërshtoj	widerstehen
vendos	entscheiden
vlerësoj	bewerten

### Shpjegime

Në modelet me folje dhe argumente të tilla subjekti është përjetues i ndodhisë së shprehur nga folja, ndërsa objekti është shkaktari:

Agimi e admiron guximin e Mimosës. ,Agim bewundert den Mut von Mimosza.‘

Nga shembuj të tillë shihet që stimuli, shkak mund të jetë jo vetëm një person, por edhe një objekt ose diçka abstrakte. Përjetuesi është gjithmonë person. Këto folje përfshihen në grupin e foljeve ndërvetore, edhe pse këtu nuk kemi gjithnjë ndëveprim njerëzish (shembull: Ata *lakmojnë* pasurinë e tij). Proceset dhe ndodhitë mentale-psikologjike që shënojnë këto folje janë dukuri thjesht njerëzore, kryekëput njerëzore. Në grupin e foljeve ES takohen gjithashtu ndryshime në realizimin morfologjik të rolit përjetues në shqip e në gjermanisht. Folja *besoj* në shqip ka dy reksione: *besoj Agimin/ i besoj Agimit*. Në gjermanisht përdoret për këtë realizim vetëm rasi dhanore. *Falenderoj* kërkon rasën kallëzore, ndërsa *danken* – rasën dhanore.

Mund të përmendja dhe dallime të tjera midis gjuhëve në realizimin morfosintaksor të gjymtyrëve që luajnë role të ndryshme semantike në bashkëvjatje me folje

ndërvetore, por kjo dukuri nuk është objekt special i këtij kapitulli, as i këtij paragrafi.<sup>384</sup>

### IX.4.2.5 Përfundime

Si përfundim mund të shpallim që në shumicën dërrmuese të rasteve në konstruktet e skemave AP/VP (veprues – pësues), SE/VP (veprues/ përjetues) roli i vepruesit (Agent) i caktohet nga folja subjektivit.

Në ndërtimet me folje që kanë strukturën argumentore AE/VR (veprues – reagues) , ES/ PS (përjetues/ stimul) rolin e vepruesit/shkakut e luan objekti (plotësi në kallëzore, rrallë në dhanore).

---

<sup>384</sup> Siç kam thënë dhe më sipër, tabelat përmbajnë një numër jo të madh foljesh ndërvetore. Në listën, në korpusin foljor që u dhashë studentëve për hulumtim, gjenden shumë më tepër folje ndërvetore. Unë kam paraqitur vetëm foljet e qëmtuara nga grupi i punës. Kam vënë dorë vetëm në disa raste për ndonjë korrigjim. Lista, korpusi foljor, që përgatita unë paraprakisht, mund të përdoret për hulumtime dhe eksperimente të tjera.

### Kreu X Kauzaliteti dhe foljet që shprehin veprim

#### X.1 Foljet ndërvetore që shprehin veprim. Një vështrim teoriko- empirik

##### X.1.1 Ç'është veprimi?

Përgjigjja e pyetjes së mësipërme ka të bëjë jo vetëm me domethënien e një dukurie të tillë, por dhe me përcaktimin e kufijve të saj, me dallimin e ndryshimin e saj nga veprimtari e forma të tjera sjelljeje. Përkufizimi do të bëhet duke dhënë veçoritë karakteristike të dukurisë. Së pari, dukuria *veprim* ka të bëjë me njerëzit. Fjalët, në rastin tonë foljet, që shprehin veprim, përfshihen në grupin e gjerë të foljeve ndërpersonale. Si të tilla ato shënojnë e shprehin veprimtari njerëzore. Kur flasim për veprimet tona ose të tjerëve, ne bëjmë fjalë për bëmat, për atë ç'ka është bërë, bëhet ose do të bëhet. Në raste të tilla pyetet: ç'bën/ ç'bëre/ ç'do të bësh.

Emërtimet *veprim*, *veproj* përdoren shpesh si terma në filozofi, psikologji dhe drejtësi. Teoria e veprimit sot është një disiplinë në kuadrin e filozofisë praktike. Fillimet e saj duhen kërkuar në antikitetin grek. Etika aristoteliane është baza e filozofisë së sotme praktike-analitike.<sup>385</sup>

Natyrën filozofike të termave të tillë e thekson dhe Austin-i në trajtimet e tij filozofike mbi përdorimin e gjuhës: „Një fillim i arsyeshëm, për të mos thënë një fillim i mençur, do të ishte shpjegimi se termi *veprim* ka po atë kuptim si në filozofi, një kuptim tepër abstrakt; ai përfshin tërë foljet me një subjekt njerëzor...“<sup>386</sup>

Përkufizime të tilla, ku theksohet se foljet, që tregojnë veprim, kanë një subjekt njerëzor, luajnë një rol të rëndësishëm në mendimin filozofik-analitik. Por hulumtimet e detajuara nuk janë mjaftuar vetëm në këtë veçori. Është e vërtetë që fjalitë me folje të tilla kërkojnë një person si subjekt, por jo çdo folje me një subjekt-person është folje veprimi. Rayfield-i e analizon çështjen me anë të një blloku shembujsh. Si test ai përdor jo vetëm subjektin-person, por dhe pyetjen ç'bën. Fjalitë e dhëna si shembuj prej tij kanë për subjekt një person dhe u përgjigjen pyetjes ç'bën:

- (a) Ai rruhet.
- (b) Unë vizatoj gruan time.
- (c) Po pres tezen time, Evën, që do të vijë me autobus.
- (d) Ai po fle.
- (e) Tërë familja e tij u asgjësua nga sëmundja, vetëm ai mbeti.
- (f) Shokët e tij u ngjitën në mal, ndërsa ai mbeti në kamp për t'u kujdesur për aparatet.
- (g) Ai hapi dritaren.
- (h) Ai gogësi.
- (i) Ai gogësi, pa e vënë dorën para gojës dhe pa kërkuar të falur, kështu e zemëroi teze Emën, një grua tepër korrekte.
- (j) Unë përpiqem të ngrihem.
- (k) Unë teshtij.

Autori analizon se jo në të gjitha rastet e mësipërme kemi të bëjmë me veprime, edhe pse subjekti është person dhe folja i përgjigjet pyetjes ç'bën. Në analizën dhe në

---

<sup>385</sup> Shih, Aristoteles, *Nikomachische Ethik*, Rowohlts Enzyklopädie, Hamburg, 2006, f. 18.

<sup>386</sup> Austin, J. L., *Zur Theorie der Sprechakte*, Stuttgart, 1972, f. 12.

përfundimet e tij autori mbështetet edhe në një mënyrë të kuptuari intuitive të lexuesit.

“Këtu ka diçka që nuk shkon, thotë ai. A mund të pretendojmë se fle, gogësisj, teshtij janë veprime? Bëj diçka nuk mund të barazohet gjithnjë me vepro, edhe pse vepro do të thotë gjithnjë bëj diçka.” Më tej autori shton se *fle, gogësisj* etj. nuk janë folje veprimi. Argumentimi i mëtejshëm ka, siç thamë, edhe ngjyra intuitive. Në folje të tilla, në përmbajtjen e tyre, nuk përmbahet implicit ideja e ndonjë veprimi të kryer. Folja nuk emërton veprim.<sup>387</sup>

Një karakteristikë tjetër e foljeve që shprehin veprim do të ishte dhe fakti që veprimi i shprehur prej tyre shoqërohet me lëvizje trupore, më saktë ato kërkojnë lëvizje trupore. Kjo veçori duket qartë në shembujt e mësipërm ilustrues. Në numrin më të madh të shembujve lëvizja është e pranishme në semantikën e foljeve si një komponent i domosdoshëm. Edhe foljet *teshtij* dhe *gogësisj* e përmbajnë idenë e një lloj lëvizjeje në përmbajtjen e tyre, por nuk janë folje veprimi. Në jetën e përditshme kuptimi i foljeve të tilla nxirret duke konsultuar fjalorët. Fjalorët japin gjithsesi informacion mbi përmbajtjen e foljeve dhe mbi përdorimin e tyre, por nuk japin asnjë lloj kriteri për dallimin e foljeve të veprimit nga masa e foljeve të tjera. Rayfield-i arsyeton “Siç duket leksikografët nisen nga premisa që përdoruesit e fjalorëve janë në gjendje ta bëjnë vetë këtë dallim.”<sup>388</sup>

Thënia e mësipërme fut në lojë dhe faktorë jashtëgjuhësorë. Një veprim nuk mund të përcaktohet vetëm me kategori gjuhësore. Prandaj për të përkufizuar veprimet Rayfield-i bën një hap më tutje: ai nuk merret më me foljet e njësisive të analizuara, me foljet e mundshme të veprimit, me veprimin e mundshëm, por hidhet te vepruesi, subjekti i këtyre fjalive. Ai pyet: “A është bërja e diçkaje një vendim që bërësi, vepruesi mund të merrte në një situatë të caktuar?”<sup>389</sup>

Duke iu përgjigjur, duke iu referuar kësaj pyetjeje dallohen foljet *gogësisj, teshtij, fle* nga *vizatoj, pres, ngjitem*.

Por edhe ky test rezulton i pamjaftueshëm, sepse nuk është gjithnjë i suksesshëm. Gisela Harras-i<sup>390</sup> sjell dy shembuj për krahasim: *teshtij* dhe *jap paratë* në një situatë të caktuar. Është fjala në një situatë kërcënimi me armë. I kërcënuari i jep paratë hajdutit. Këtu nuk kemi të bëjmë me një aktivitet të pastër fizik si në rastin e *teshtij, gogësisj*. “Unë i dhashë paratë vjedhësit, sepse ai më detyroi. Kështu do të përgjigjesha, po të më pyesnin: pse e bërë këtë. Për pyetjen tjetër pse teshtive, do të përgjigjesha: sepse më ka zënë rrufa.”<sup>391</sup>

Dhe tani të bëjmë dallimin midis *teshtij* dhe *i jap paratë* hajdutit. *Teshtij* ndodh në mënyrë të pandërgjegjshme, të paqëllimshme. Përkundrazi i *jap paratë* hajdutit është një bërje e ndërgjegjshme, e qëllimshme, edhe pse bëhet në kushte detyrimi.

Kështu kemi gjetur një kriter të ri për dallimin midis dukurive të tipit *teshtij* dhe *i jap paratë* hajdutit, kriteri quhet qëllimshmëria. Një person mund të bëjë diçka në mënyrë të qëllimshme ose jo. Ky kriter është në harmoni me eksperiencën tonë të

---

<sup>387</sup> Rayfield, D., *Handlung. Analytische Handlungstheorie*, Band 1, Frankfurt/M, Suhrkamp, 1977, f.

70.

<sup>388</sup> Po aty, f. 75.

<sup>389</sup> Po aty, f. 77.

<sup>390</sup> Shih, Harras, G, *Handlungssprache und Sprechhandlungen*, Berlin, de Gruyter, 1983, f. 16.

<sup>391</sup> Po aty, f. 16.

## Kauzaliteti dhe foljet që shprehin veprim

---

përditshme, është gjithashtu një kriter vendimtar i studimeve në fushën e teorisë analitike të veprimit për të karakterizuar bërjen si veprim. Në vend të termit qëllim përdoret shpesh intension, intensionalitet.

Sipas analizave të deritanishme mund të konkludohet se një veprim përbëhet nga dy komponente:

$$\text{Veprim} = \text{Bërje} + \text{Qëllim}$$

Në këtë ekuacion komponenti bërje përcaktohet si përfshirje në përmbajtje të lëvizjes trupore.<sup>392</sup>

Në anën e djathtë të ekuacionit janë dy gjymtyrë që lidhen me dy përmbajtje të ndryshme, njëra tregon qëllimin e veprimit dhe tjetra lëvizje trupore.

Autorja, Gisela Harras, e shtjellon më tej këtë situatë. Le të marrim një fjali ku paraqitet një veprim i cili përshkruhet me anë të një foljeje që tregon lëvizje trupore dhe të një fjale që jep idenë e qëllimit:

(l) Ai ngriti krahun me qëllim.

Në dukje nuk mungojnë elementët e ekuacionit të veprimit. Por për çdo folës kjo fjali ka diçka që nuk shkon. Ajo informon thjesht se dikush ngriti krahun. Shtesa me qëllim nuk sjell asnjë information të ri.<sup>393</sup>

Gilbert Ryle në librin e tij „Concept of Mind“ shpjegon dhe mbron idenë se bërja me qëllim është një episod i vetëm dhe nuk përbëhet nga dy komponente.

„Er runzelte absichtlich die Stirn“ berichtet nicht den Vorfall von zwei Episoden. Es berichtet den Vorfall einer einzigen Episode...“(„Ai rrudhi ballin me qëllim“ nuk shpreh një ndodhi me dy episode. Fjalia shpreh ndodhinë e një episodi të vetëm...)”<sup>394</sup>

Përcaktimi i Ryle është bërë udhërrëfyes për tërë teorinë analitike të veprimit. Qëllimi i një vepruesi nuk do kuptuar si një proces mendor që krahas bërjes paraqet dhe një aktivitet trupor si komponente të dytë. Qëllimi ose intension përmbahet në veprim, në bërje.

Përkufizimi i mësipërm “qëllimi gjendet brenda veprimit” është precizuar më tej nga von Wright, i cili thotë: “Një veprim ose një sjellje merr karakterin e saj qëllimor, nëse vështrohet nga vepruesi ose nga një tjetër vëzhgues në një këndvështrim më të gjerë, nëse vendoset në një kontekst qëllimesh dhe eksperiencash...”<sup>395</sup>

Kështu, qëllimi ose intension konceptohet jo si veçori e një bërjeje, por si aspekt, gjykim ose interpretim i një sjelljeje. Veprimi është një aktivitet i interpretuar si veprim. I njëjti aktivitet mund të interpretohet në mënyra të ndryshme, të konceptohet si veprime/përshkrime të ndryshme. P.sh.:

(m) Er öffnete das Fenster. ‚Ai hapi dritaren.‘

(n) Er betätigte den Fenstergriff. ‚Ai lëvizi dorezën e dritares.‘

---

<sup>392</sup> Shih edhe, Harras G., *Handlungssprache und Sprechahndlungen*, Berlin, de Gruyter, 1983, f. 18.

<sup>393</sup> Po aty, f. 19.

<sup>394</sup> Ryle, G., *Concept of Mind*, Reclam, 1969, f. 95.

<sup>395</sup> Wright, G. H. von, *Erklären und verstehen*, Fischer Verlag, 1974, f. 108.



(o) Er lüftete das Zimmer. ‚Ai ajrosi dhomën.‘

Tri fjalitë e mësipërme mund të vështrohen si tre përskrime të të njëjtit aktivitet. Keller-i thekson se aktiviteti si i tillë është rezultat i një procesi interpretimi.<sup>396</sup>

Si përfundim themi që:

- Veprimi është aktiviteti i interpretuar si veprim.
- Me anë të interpretimit referojmë dhe në qëllimin e vepruesit.
- Për interpretime të tilla ka shumë mundësi paraqitjeje, përskrimi.

### X.1.2 Kauzaliteti i foljeve që shprehin veprim

Një veprim i shprehur mund të sqarohet duke dhënë një arsye ose një justifikim. Si arsye, si shkaqe të veprimeve, ndodh të jenë qëllimet, qëndrimet, preferencat etj. Çështja e raportit midis veprimeve dhe shkaqeve të tyre trajtohet në mënyra të ndryshme, disa herë të kundërta, në kuadrin e teorisë analitike të veprimit. Kjo çështje shtrihet kështu: a janë foljet e veprimit folje kauzale apo jo. A e përmbajnë foljet e veprimit në semantikën e tyre kuptimin e shkakësisë? Për të argumentuar këtë çështje filozofët dhe gjuhëtarët, që janë marrë me të, i referohen përsëri filozofit anglez, David Hume:

X dhe Y janë dy fakte të ndryshme

X = një meteor dy tonësh e godet zotin A, në kokë

Y = zoti A vdes

X dhe Y janë dy fakte që logjikisht nuk varen nga njëri tjetri, rënia e meteorit dhe vdekja e zotit A nuk kanë midis tyre kurrëfarë varësie logjike.

Lidhja shkakore, që ne vendosim midis personit dhe meteorit (X dhe Y) mbështetet thjesht në eksperiencën tonë, ka natyrë empirike. Sa herë që dikujt i bie në kokë një meteor dy tonësh, ai do të vdesë.

Mbartja e këtij argumenti filozofik (mbi shkakësinë) në teorinë e veprimit, për të përcaktuar kauzalitetin si element të përmbajtjes të foljeve që tregojnë veprime, ka hasur në kundërshtime të tilla:

- Arsyet e shprehura me një fjali shkakore, që jepen si shkaqe për një veprim, nuk lidhen me fakte konkrete, nuk janë ndodhi reale.
- Arsyet e një veprimi nuk janë të lidhura logjikisht me të.
- Nuk ka ligje të përgjithshme që të justifikojnë veprimet e veçanta.

Këto tre kundërargumente kundërshtojnë tezën sipas së cilës shkaqe të një veprimi janë qëllimet tona, pozicionimet sipas eksperiencës, preferencat etj. Në kampin e kundërshtarëve vlen të përmendim qëndrimin e Ryle. Ai shprehet që arsyet e një veprimi nuk janë fakte konkrete, por gjendje, dispozita. Dhe shpjegimet me anë të dispozitave nuk janë shpjegime shkakore. Qëllimet, pozicionimet e një vepruesi nuk

---

<sup>396</sup> Keller, R., „Kollokutionäre Akte“, botuar në, *Germanistische Linguistik*, 1-2, 1977, f. 9.

japin asnjë information mbi shkaqet e veprimeve të tij. Këto janë shprehje e prirjeve të vepruesit në rrethana të caktuara.<sup>397</sup>

G. Harras-i e kundërshton Ryle-n kur thotë se shkaqet nuk mund të jenë vetëm fakte reale. Ajo merr në shqyrtim dhe rastin që paraqitet në shembullin më poshtë:

Antoni e goditi gruan, se ishte xheloz.

Në këtë rast arsyeja e goditjes është vërtet xhelozia, një dispozitë, një veçori e Antonit. Por kjo e vetme nuk është shkak i plotë. Përtej kësaj ne ndërtojmë shkaqe të tjera, shkaqe që sollën në shfaqjen e kësaj veçorie të Antonit, p.sh.: Antoni e pa gruan e tij me një burrë tjetër. Këto të dyja, xhelozia si dispozitë e vepruesit dhe shkak i ndërtuar, që solli shfaqjen e dispozitës, e bëjnë thënien e mësipërme një shprehje të vërtetë veprimi. Pas çdo dispozite, prirjeje, që shfaqet si arsye e veprimeve, qëndron një fakt real, i cili është shkak i manifestimit të dispozitës.<sup>398</sup>

Për ta shpjeguar më mirë idenë e kauzalitetit implicit në foljet e veprimit vlen të sqarohet dhe kuptimi i koncepteve *arsye* (Grund) dhe *shkak* (Ursache). Në fjalorin e gjuhës shqipe jepet ky shpjegim për artikullin *arsye*:

- “Shkalla më e lartë e veprimtarisë njohëse të njeriut; aftësia mendore për të njohur dhe për të shpjeguar botën...
- Shkak ose fakt që shpjegon a përligj një veprim; argument...”<sup>399</sup>

Për fjalën *shkak* jepet ky shpjegim:

- „Rrethanë, dukuri, ngjarje etj. që sjell si rrjedhim të lindë, të ndryshojë ose të zhduket diçka tjetër...
- Arsyeja pse ndodh një gjë, pse bëhet një punë etj.”<sup>400</sup>

Në rastin e shkakësisë implicite në foljet e veprimit ne do të përdorim termin *arsye* në kuptimin 2, kuptim, që e shpjegon më së miri përmbajtjen kauzale të foljeve që shprehin veprim.

### X.1.2.1 Mbi dallimin kuptimor midis termave arsye dhe shkak

Dallimi themelor kuptimor midis termave *arsye* dhe *shkak* ka të bëjë me llojet e ndryshme të faktorëve ndikues. Arsyeja (Grund) është e lidhur me një subjekt që shpjegon, argumenton veprimin e tij për ta bërë atë të kuptueshëm, të pranueshëm. T’i rrokësh arsye të tilla do të thotë të interpretosh. Pra, arsyeja është dukuri e botës njerëzore.

Ndërsa termi *shkak* ka të bëjë me faktorët ndikues në botën fizike. Këtu shkakësia organizohet sipas ligjesh të përgjithshme. Duke u nisur nga përkufizime të tilla mund të themi se dukuria *arsye* është objekt i hermeneutikës, teorisë së interpretimit, ndërsa dukuria *shkak* është objekt i shkencave të natyrës. Ky dallim mund të shikohet ndryshe si ndryshim midis kuptimit dhe shpjegimit. Ndryshimin në fjalë e ka

---

<sup>397</sup> Ryle, G., *Concept of Mind*, Reclam, 1969, f. 120.

<sup>398</sup> Harras, G., *Handlungssprache und Sprechhandlung*, Berlin, de Gruyter, 1983, f. 77.

<sup>399</sup> *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1984, f. 34.

<sup>400</sup> Po aty, f. 1149.

paraqitur në mënyrë proverbiale W. Dilthey, madje në shekullin XIX. Ja formulimi i tij: Natyrën ta shpjegojmë, shpirtin ta kuptojmë.<sup>401</sup>

Arritëm kështu në një pikë, ku mund të shpallim se faktorët ndikues janë dy llojesh; shpjegimi kauzal i një faktori veprues mund të bëhet në rrafsh fizik ose/dhe në rrafsh mental. Një shpjegim mental do të thotë argumentim logjik i veprimit me anë të arsyeve që e sollën atë. Në rrjedhën e zhvillimit të teorisë së veprimit kanë ekzistuar prirje të ndryshme që herë mbivlerësojnë njërin aspekt dhe herë tjetrin. P.sh.: Ryle, siç thamë pak më lart, jo vetëm e redukton aspektin mental në favor të atij fizik, por e sakrifikon atë krejt, kur thotë se prirjet, dispozitat e subjektit veprues nuk mund të jenë shkaqe. Ose: arsyet e veprimeve nuk mund të jenë shkaqe të tyre. Për mua është më i arsyeshëm dhe krejt i pranueshëm mendimi i Davidson-it. Ai flet për një simetri midis aspektit fizik dhe mental të një veprimi. Mendimin e tij e ilustron me një paraqitje domethënëse:

Bruti e vrau Cezarin me thikë. Kështu Bruti është autor i vrasjes së Cezarit. Ky e realizoi vrasjen duke e përdorur mjetin në kohën, në vendin dhe në mënyrën e duhur. Lëvizja trupore, gjestet, thika, manovrimi me thikë, ngulja e thikës janë faktorë fizikë që sollën vdekjen e Cezarit. Të gjitha këto bëjnë pjesë në shkakësinë fizike. Po të mos ishte vepruesi, thika dhe vërsulja mbi Cezarin, ky nuk do të ishte vrasës. Por ky shpjegim, në rrafshin e kauzalitetit fizik, është i pamjaftueshëm për të dhënë tërë shkakësinë e vrasjes së Cezarit. Krahas faktorëve mekanikë-fizikë duhen vënë në dukje dhe faktorët mentalë, siç janë qëllimi, bindja, dëshira. Bruti e kishte si qëllim e bindje vrasjen e Cezarit. Po të mos donte, nuk do ta kishte vrasës, mund të ishte vërtitur me thikë në dorë, por nuk do të kishte qëlluar.<sup>402</sup>

### X.1.3 Përfundim

Mendimi i Davidson-it në fushën e teorisë së veprimit, që është më i përhapuri, më ndikuesi dhe më i pranueshmi, mbështetet në tezën: arsyet, që japim për të shpjeguar veprimet tona, duhen marrë, konceptuar si shkaqe të tyre.

Thënia proverbiale e W. Dilthey-t e formulon më së miri dallimin midis shkakut në natyrë dhe karakterit racional të arsyes njerëzore-shoqërore: Natyrën ta shpjegojmë, shpirtin ta kuptojmë.

---

<sup>401</sup> Jung, M., *Dilthey zur Einführung*, Junius Verlag, Hamburg, 1996, f. 38.

<sup>402</sup> Shih, Davidson, D., *Können Gründe Ursachen sein*, München, 2004, f. 3.

### Kreu XI Kauzaliteti implicit në foljet e komunikimit

Foljet psikologjike, foljet e veprimit dhe foljet e komunikimit bëjnë pjesë në klasën e foljeve ndërvetore. Siç e kemi përmendur dhe në kapitullin mbi foljet psikologjike, foljet ndërvetore shënojnë e shprehin veprime, gjendje, ndodhi që janë karakteristike për njerëzit dhe për marrëdhëniet midis tyre. Për foljet psikologjike thamë që ato e përmbajnë idenë e shkakësisë në kuptimin e tyre. Dhe këtë u përpoqëm ta provojmë.

Në hetim e sipër të shkakësisë implicite, pasi përshkruam shfaqjet e saj në foljet psikologjike, u hodhëm në një terren të ri gjuhësor, ku gjithashtu gjëllin shkakësia. Është fjala për foljet e veprimit, të cilat i përshkruam, karakterizuar, përcaktuam në kapitullin e mësipërm. Në klasën e foljeve ndërvetore grupi i foljeve të veprimit është më i madh se ai i foljeve psikologjike.

Ndërsa foljet e komunikimit po hyjnë në punën tonë si një nocion i ri.

#### XI.1 Foljet e komunikimit

Nën këtë emërtim, në këtë koncept, përmbliidhen foljet e tipit *them, flas, tregoj* (verba dicendi), foljet e mendimit, gjykimit *gjykoj, arsyetoj, konceptoj, mendoj* (verba cogitandi), si dhe folje të tjera performative. Ndërsa foljet konstative përshkruajnë ose, thjesht, konstatojnë diçka, foljet performative shprehin dhe qëndrimin e folësit mbi domethënien konstatuese të foljes.<sup>403</sup>

Në gjuhësinë e sotme analiza e tyre bëhet në zonën e përbashkët, ku takohet gjuhësia tradicionale me pragmatikën. Që në fillimet e shekullit të kaluar pati gjuhëtarë që u morën me analizën e foljeve të tilla në pikëpamje pragmatike. Kështu gjuhëtarët francezë Breal (1901) dhe Meillet (1916) analizuan kuptimet përdorimore të foljeve në gjuhën frënge *dire* (them) dhe *parler* (flas) në ligjërimin gjyqësor. Analiza e foljeve të tilla mori një impuls dhe zhvillim të ri me fillimin e epokës së aktit ligjërimor. Teoria në fjalë u themelua në vitet 60- 70 të shekullit të kaluar nga John Austin-i dhe John R. Searle. Sipas tyre ligjërimi është një akt, një veprim komunikues me natyrë shoqërore. Një akt ligjërimor është një kombinim i tre akteve të pjesshme që realizohen njëkohësisht:

- akti i të shprehurit ka të bëjë me realizimin fonetik të fjalëve, fjalive;
- akti propozicional: shprehja e realizuar ka një kuptim, i referohet shfaqjeve të realitetit objektiv;
- Ilokucioni, akti ilokucionar: me thënien, me kuptimin e aktit propozicional është lidhur një qëllim i caktuar, premtim, paralajmërim, indinjatë etj.

Këtyre akteve u shtohet dhe perlokucioni. Me perlokucion nënkuptohet ndikimi i synuar. P.sh.: Me paralajmërim mund të synohet alarmim, frikësim, kujdes etj.

Në tabelën që vijon do të paraqesim përshkrimin e aktit ligjërimor nga John R. Searle, nxënës i Austin-it:

---

<sup>403</sup> Shih, Bußmann, H., *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart, Kröner Verlag, 2002, f. 503.

## Kauzaliteti implicit në foljet e komunikimit

Akti i pjesshëm:	Akti i të shprehurit	Akti propozicional	Akti ilokutiv	Akti perlokutiv
Lloji i aktit të pjesshëm:	Shprehje	propozicion	ilokucion	perlokucion
Shpjegime:	Tinguj, fjalë, fjali	Thënie mbi realitetin	Qëllim i veprimit	Efekti i synuar të marrësi
Kritere vlerësimi	Gramatikisht i saktë/ ose jo	E vërtetë/ jo e vërtetë	I arritur/ i paarritur	I suksesshëm/ jo i suksesshëm
Shembull	Qeni kafshon	Ky qen kafshon	Njoftim/ Konstatim/Paralajmërim/ Kërcënim/Këshillim	Marrësi reagon duke iu shmangur qenit/Blen qenin etj.

Aktet e ligjërimit janë konvencionale. Kjo do të thotë që partnerët e një komunikimi janë të pajisur me rregullat, njohuritë e sistemet përkatëse, sipas të cilave ndërtohen aktet e komunikimit. Komunikuesit e dinë p.sh. se ç'është një premtim, një kërcënim, një ngushëllim etj.

Një akt ligjërimi është një akt dhe si i tillë karakterizohet nga folja, folja është bërthama e aktit, ose akti mund të reduktohet në folje, e cila mban peshën kryesore semantike/pragmatike-gramatikore. Është fjala për folje, ku thënia është njëkohësisht dhe bërje. Përdorimi i këtyre foljeve është i lidhur me një situatë, një kohë, me persona dhe konvencione të caktuara.<sup>404</sup>

Akti i të shprehurit (lokucioni) ka natyrë gjuhësore. Ai realizohet me mjete gjuhësore. Akti ilokutiv është një lidhje midis elementesh gjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Ndërsa efekti perlokutiv ka natyrë jashtëgjuhësore.

Akti ilokutiv qëndron në qendër të interesit pragmatik. Madje ky i vetëm shpesh konceptohet dhe emërtohet akt ligjërimi. Akti ilokutiv realizohet me anë të “forcës” që i atashohet aktit propozicional.

Mjetet gjuhësore, që realizojnë ilokucionin quhen indikatorë ilokutivë. Të tillë mund të jenë: intonacioni, shenjat e pikësimit, përemrat dhe ndajfoljet pyetëse, format mënyrore, foljet modale, rendi i fjalëve dhe fjalive, pjesëzat, afikset, shprehjet eksplicite performative etj. Me anën e akteve ilokutive (ose shprehjeve performative) kryhen veprime, që ndryshojnë nga shprehjet konstative me anën e të cilave vetëm bëhen përshkrime ose konstatime, të cilat janë të vërteta ose të rreme. Shprehjet performative mund të kenë natyrë implicite ose eksplicite. Natyrë implicite kanë shprehje të tipit: *ti gabohesh*. Me një shprehje të tillë mund ta japim idenë që marrësi gabon po aq mirë sa me shprehjen eksplicite: them që ti gabohesh. Në këtë shprehje është dhënë eksplicit folja them. Folje të tilla do të jenë objekt i këtij paragrafi. Siç thamë pak më lart, këto folje mund të shprehen eksplicit ose implicit në fjali:

<sup>404</sup> Shih, Austin, J., *Zur theorie der Sprechakte*, Reclam, Stuttgart, 1972.

Qeni kafshon. (implicit)

Po të paralajmëroj, qeni kafshon. (eksplicit)

Ndërsa në pragmatikë këto quhen folje performative, në gramatikën tradicionale dhe në teorinë e komunikimit emërtohen „folje komunikimi“. Ato kanë rëndësi të veçantë në interpretimin e thënieve. Nga shumë gjuhëtarë ato përfshihen gjithnjë në strukturën e thellë të thënieve. Një fjali me strukturë sipërfaqësore: Shko në shtëpi mund të dalë kështu në strukturat e thella:

Të urdhëroj të shkosh në shtëpi.

Të këshilloj të shkosh në shtëpi.

Të lutem të shkosh në shtëpi.

Të gjitha fjalitë mund të kthehen në transformime eksplicite performative:

Muri është i bardhë → Unë thashë se muri është i bardhë.

Përdorimi i njërës ose tjetrës transformë kushtëzohet nga situata, nga pozicionimi social i biseduesve etj. Fjali me strukturë të njëjtë sipërfaqësore në përdorimin e tyre situacional-shoqëror kanë funksione krejt të ndryshme.

Kjo që thamë për fjalitë vlen, sigurisht, dhe për foljet, sepse ato mund të përdoren dhe të vetme me vlerë fjali dhe mbajnë peshën kryesore semantike-ilokutive të shprehjeve performative.

Objekt i hulumtimit tonë janë dhe shprehjet ilokutive eksplicite (...kërkoj të më lësh të qetë) dhe shprehjet ilokutive implicite (...më lër të qetë). Në shprehjen *më lër të qetë* shenjues ilokutiv është mënyra urdhërore.<sup>405</sup>

### XI.1.1 Intensionimi dhe kauzaliteti (qëllimshmëria dhe shkakësia) në foljet e komunikimit

Edhe foljet performative, si dhe foljet e tjera ndërvetore (psikologjike, të veprimit) fshehin brenda tyre kauzalitet, domethënë nënkuptojnë shkakësi: Po ku e mbështesim ne këtë konsideratë?

Së pari, në faktin që janë folje ndërvetore, që kanë të bëjnë me sjelljen e njeriut. Dhe njeriu është qenie e arsyeshme.

Kauzaliteti edhe këtu, si në foljet e veprimit, nuk ka natyrën e kauzalitetit në natyrë ku veprojnë ligje të verbra, ku një shkak, sa herë që shfaqet, sjell të njëjtën pasojë. Kauzaliteti në foljet e komunikimit ka të bëjë me racionalitetin njerëzor dhe më konkretisht, me qëllimet racionale. Se çdo qëllim njerëzor është racional. Me anën e foljeve performative folësi synon, ka për qëllim, që të arrijë diçka të marrësi, të ndikojë tek ai. Mbi intencionalitetin (qëllimshmërinë) e foljeve të tilla dhe të thënieve, ku ato marrin pjesë, Gizela Harras-i ka shkruar një studim të plotë prej 40 faqesh.<sup>406</sup>

Le t'i referohemi përsëri Davidson-it: „Racionaliteti është veçori themelore e njeriut...Irracionaliteti kuptohet si i tillë vetëm në kuadrin e racionalitetit.“<sup>407</sup>

---

<sup>405</sup> Shih, Bußmann, H., *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart, Kröner Verlag, 2002, f. 292; Zarnikov, A., *Einführung in die Linguistik*, Frankfurt am Main, Verlag Diesterweg, 1987, f. 78, 79, 80.

<sup>406</sup> Shih, Harras, G., *Handlungssprache und Sprechhandlung*, Berlin, de Gruyter, 1983, f. 131- 172.

<sup>407</sup> Shih, Davidson, D., *Probleme der Rationalität*, Frankfurt am Main, Suhrkamp 2006, f. 312.

Vetë karakteri ilokutiv i foljeve të tilla është gjithashtu një argument për kauzalitetin e tyre implicit se ilokucioni s'është veç intension (qëllim) që i shtohet përmbajtjes së thënies implicit ose me anë të foljeve, si: paralajmëroj, premtoj etj. Akti ilokucionor mund të realizohet dhe me anë të interpretimit të thënieve, ai shfaqet kështu si forcë ilokucionore. Kjo forcë s'është veç përfaqësimi i folësit në gjuhë. Atje, ku shfaqet folësi, shfaqet dhe racionaliteti, arsyeja, qëllimi, shkakësia (gjithnjë jo në kuptimin që ka kauzaliteti në shkencat e natyrës).<sup>408</sup>

Motsch-i e përcakton aktin ilokutiv si një tërësi katër komponentësh. HI (ilokutive Handlung/akt ilokutiv) = ä, int, kond, kons (ä Äußerung/shprehje, int Intention/qëllim, kond Kondition/kusht, kons Konsequenz/pasojë). Kjo do të thotë që një akt ligjërimit përbëhet nga një shprehje me anën e së cilës folësi synon të arrijë diçka, në disa kushte që duhet të përmbushen në një situatë të dhënë. Kryerja e aktit ilokutiv shoqërohet me një sasi pasojash që lidhen me të.<sup>409</sup>

Përcaktimi i Motsch-it mund të ilustruhet kështu:

Thënia lokucionore *Qeni kafshon* përmban në situata të caktuara dhe një aspekt ilokutiv paralajmërim si dhe një aspekt perlokutiv arritja e një efekti, e një pasoje. Meqë qeni kafshon, nuk do ta shkel truallin ku është ai.

Me këtë shpjegim evidentohet qartë shkakësia implicite e foljeve të tilla. Kështu shkakësia lidhet me aktin ilokutiv dhe me atë perlokutiv, ku jepet rrjedhoja, pasoja, efekti.

G. Harras-i shkruan kështu për aktin ligjërimit: „Wir können von einer kommunikativen Handlung sagen, dass sie gelungen ist, wenn der Adressat die primäre Intention rekonstruiert, d.h. verstanden hat, und dass sie erfolgreich ist, wenn der Adressat die primäre Intention erfüllt, d.h. die intendierte Reaktion zeigt.“<sup>410</sup> (Ne mund të themi që një akt ligjërimit është realizuar, nëqoftëse adresati e ka kuptuar atë, ose e ka ristrukturuar qëllimin primar të folësit; akti ligjërimit është i suksesshëm, nëse adresati e përmbush qëllimin primar, d.m.th. tregon reagimin e synuar.)

Në faqen 161 të veprës së cituar të G. Harras-it ajo flet për qëllimet e synuara në aktet ligjërimitore si „Mittel zum Zweck“ (mjet për të arritur qëllimin). Kombinime të tilla: qëllim + mjet „çojnë ujë në mullirin e shkakësisë“. Le të kujtojmë dhe të citojmë thënien e famshme të Heidegger-it:

„Ku ndiqen qëllime, ku përdoren mjete, ku instrumentalizohet, atje vepron e sundon shkakësia, kauzaliteti...“<sup>411</sup>

Foljet performative të komunikimit kanë në përmbajtjen e tyre qëllimin e folësit për të ndikuar te dëgjuesi ose te vetë thënia. Dhënia eksplicite ose implicite është mjeti, instrumentalizimi mbështetet në qëllimin dhe mjetin. Ajo që arrihet është pasoja, ndikimi i arritur. Pajoja rrodhi nga shkak, më saktë nga arsyeja që solli pasojën përmes instrumentalizimit.

---

<sup>408</sup> Shih, Janish, N., *Werbessprache*, Tübingen, Narr Studienbücher, 2003, f. 74; Toska, T., Disertacion, Tiranë, 2013.

<sup>409</sup> Motsch, W., „Sprache als Handlungsinstrument“, botuar në, *Neue Aspekte der Grammatikforschung, Band 19. Linguistische Studien des ZISW*, Berlin, Akademie Verlag, 1987, f. 45.

<sup>410</sup> Harras, G., *Handlungssprache und Sprechhandlung*, Berlin, de Gruyter, 1983, f. 167.

<sup>411</sup> Heidegger, M., *Die Frage nach der Technik, Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000, f. 9.

Kauzaliteti dhe intensioni (shkakësia dhe qëllimshmëria) janë në fakt dy koncepte të ndryshme, por në kontekstet, ku shprehen veprime, mund të shfaqen si njëri ashtu dhe tjetri; ose njëri, ose tjetri.<sup>412</sup>

Në raste të tilla një qëllim mund të shërbejë si arsye për realizimin e një veprimi, madje si shkak në lidhjen kauzale midis qëllimit dhe përmbushjes fizike të veprimit. Sapo shfaqen kontradikta midis interpretimit shkakor dhe qëllimor të veprimeve, rrugët e tyre ndahen.

Le ta ilustrojmë përshkrimin dhe shpjegimin tonë me një shembull, me dy vargje të marra nga një poezi e botuar shumë vite më parë:

O kjo natë e qetë sa e bukur qenka,  
ti duhet të vije...

Në vargun e parë kemi një shprehje konstative, ndërsa në vargun e dytë kemi një shprehje ilokutive. Shprehja ilokutive ka përmbajtjen propozicionale (ardhja e mundshme e dikujt) dhe forcën ilokutive, një dëshirë e një qëllim i pashprehur. Si indikator ilokutiv vlen këtu folja modale *duhet*. Gjatë interpretimit mund të parafrazojmë me një fjali qëllimore ose shkakore:

*ti duhet të vije që të shijonim të dy atë bukuri mbrëmjesore (qëllim); ti duhet të vije sepse doja ta kaloja atë mbrëmje me ty (shkak) etj.*

Shembull tjetër:

Nënë, mos rri pas babait në poste...  
Babai të trazon me mjekrën e bardhë...<sup>413</sup>

Vargu i parë është një akt ilokutiv. Forca ilokutive jepet me anë të mënyrës urdhërore. Folësi-poeti kërkon me insistim diçka nga nëna. Qëllimi për këtë jepet në vargun e dytë: Babai të trazon me mjekrën e bardhë. Ky qëllim është dhe arsyeja që nëna nuk duhet të rrijë pranë babait të Teqesë.

Ndërsa në vargun e mëposhtëm, ku përdoret prapë imperativi për të dhënë forcën ilokutive, qëllimi/shkaku nuk jepen eksPLICIT:

Mjekër, dorën e nënës, lëre!...<sup>414</sup>

Lexuesi gjatë receptimit mund të lexojë ndër rreshta dhe të plotësojë: se do të gjesh belanë me mua (shkak); që të mos shkojë puna më larg (qëllim).

Foljet e komunikimit luajnë një rol të rëndësishëm në ridhënien e ligjëratave e të teksteve.

Në klasën e foljeve të komunikimit foljet e tipit *them* (verba dicendi) përbëjnë grupin më të madh në sasi e me shpeshësi të veçantë përdorimore. Prandaj ne do të merremi më gjerësisht me këtë grup. Në vitin 2004 është botuar një fjalor „Handwörterbuch

---

<sup>412</sup> Shih, Gabriel, G. /Janisch, P., „Kausalität“, botuar në, *Enzyklopädie, Philosophie und Wissenschaftstheorie, I-IV*, Stuttgart, Weimar 1995-1996, II, f. 372-376.

<sup>413</sup> Agolli, D., *Poezi*, Tiranë 1979, f. 319.

<sup>414</sup> Po aty, f. 321.



der Kommunikationsverba“ që përmban të listuara 750 folje komunikimi. Ky manual i hap folësit një fushë të tërë mundësish për të zgjedhur foljen e duhur si shoqëruese të ligjëratave.<sup>415</sup>

### XI.1.2 Veçori të përgjithshme të foljeve të tipit them (verba dicendi)

Verba dicendi presupozojnë që ekziston një folës, i cili një produkt gjuhësor ia adreson një marrësi. Ky konstelacion përbën dhe bazën e strukturës semantike të tyre. Kjo strukturë bazë është vlerësuar dhe si konstante kuptimore e tërë klasës së foljeve në fjalë.<sup>416</sup>

Foljet në fjalë janë trevalente, domethënë kërkojnë tre argumente: një folës, një marrës dhe një referim në tekst. Argumentet mund të jenë fakultative ose të domosdoshme. P.sh.:

*Ai tha se do të vijë nesër.*

Folja *them* kërkon detyrimisht një objekt në kallëzore, në rastin tonë një fjali kundrinore dhe një kryefjalë. Pa to ajo nuk mund të qëndrojë gramatikisht, nuk është fjali gramatikore, e saktë gramatikisht.

Ndërsa foljet *bisedoj*, *përgjigjem*, *diskutoj* etj. kërkojnë një plotës parafjalor, të detyrueshëm: *bisedoj me ty, përgjigjem për këtë, diskutoj mbi/për këtë* etj. Folje të tilla nuk mund të përdoren në lidhje me citime në ligjëratë të drejtë:

Ne *diskutojmë*(?): “Filmi ishte shumë i bukur.” ( E pamundur)

Foljet *them*, *njoftoj*, *pyes* etj. mund të lidhen me shprehje në ligjëratë të drejtë, ose jo:

*Ai e tha këtë.* Por edhe: *Ai tha:* “Nesër do të bjerë shi.”

#### XI.1.2.1 Klasifikimi i foljeve të tipit them (verba dicendi) dhe veçori specifike të paradigmatave

Në strukturën semantike të verba dicendi reflektohen veçoritë më të qenësishme të aktit komunikativ-gjuhësor propozicional me të cilin ato lidhen.<sup>417</sup>

Wilske i quan ato: „Benennungs- und Charakterisierungseinheiten für Sprechhandlungen“ (njësi emërtuese dhe karakterizuese të akteve ligjërimore).<sup>418</sup>

Në klasifikimin e këtyre foljeve krahas komponenteve të një akti ligjërimitor folës F, marrës M, përmbajtje propozicionale P, luan rol dhe komponenti qëndrim/vlerësim i folësit Q.

---

<sup>415</sup> Harras, G., *Handwörterbuch der Kommunikationsverben*, Teil I, Teil II, Berlin/New York, de Gruyter, 2004.

<sup>416</sup> Shih, Winkler, E., „Syntaktische und semantische Eigenschaften von verba dicendi und ihre Bedeutung“, botuar në, *Studien zum Satzmodus I*, Akademie des Wissenschaften der DDR Zentralinstitut für Sprachwissenschaft, 1988, f. 216-253.

<sup>417</sup> Shih, Wilske, L., „Sprachkommunikative Verben“, botuar në, *Wissenschaftliche Zeitschrift der Pädagogischen Hochschule*, K. Liebkecht, Potsdam, 1986, H. 5, f. 741 – 748, këtu f. 743.

<sup>418</sup> Po aty, f. 744.

## Kauzaliteti implicit në foljet e komunikimit

Shumica e foljeve komunikative e rijapin ose e rimarrin përmbajtjen propozicionale, përmbajtjen reale të thënieve duke formuluar eksplicit dhe tipin e aktit ligjërimor. Ky tip nuk është dhënë në thënien origjinale. Kur folësi e rijep thënien, e rindërton dhe e vendos atë në një situatë të re ligjërimore, duke e paraqitur ashtu siç e ka kuptuar ai. Folësi që rijep fjalët, thëniet e një tjetri, ndodh t'i transformojë ato sipas qëllimeve të veta. Kështu folësi, që rijep një thënie të dikujt tjetër, mund ta identifikojë atë si akt ilokutiv, si kërkesë, konstatim, pyetje, falenderim, këshillim, premtim etj. Tiparet themelore të akteve ligjërimore me të cilat lidhet folja janë njëkohësisht dhe tipare themelore semantike të foljes. Teoria e aktit ligjërimor ndihmon dhe mbështet përcaktimin e semantikës të verba dicendi. Por nuk duhet menduar që çdo foljeje i përgjigjet një akt i caktuar ligjërimor.

Në përcaktimin e saktë të semantikës të verba dicendi luajnë rol disa shtresa kuptimore. Dy nga komponentet më të rëndësishme semantike janë:

- përmbajtja propozicionale (reale) P. Kjo dukuri, ky komponent përmbledh shtresa të tilla, si lloji i ndodhisë (gjendje, veprim etj.), referenca kohore, roli i dhënësit dhe marrësit.
- qëllimi i folësit, i cili mund të jetë llojesh të ndryshme.

Le ta ilustruim këtë me një thënie nga romani „Ansichten eines Clowns“:

„Ich glaube, ich weinte fast, als ich ihn bat, den Scheck zu nehmen.“<sup>419</sup> „Besoj që isha gati për të qarë, kur iu luta atij të merrte çekun.“

Me anë të elementit *glaube* (besoj) folësi (rrëfyesi) përmbush një akt ilokucionor, përmbajtja e thënies *ich weinte fast, als ich ihn bat, den Scheck zu nehmen* merr ngjyra subjektive të një lloj pasigurie për marrësin, folësi nuk e thotë hapur *unë qava*. Kjo duket më qartë po të krahasohen dy ndërtimet: ndërtimi me foljen *besoj* dhe *ai pa të*. Përdorimi i foljes *besoj* realizon ndërhyrjen e folësit në thënien e tij. Dhe kjo bëhet me qëllimin që të arrijë një efekt te lexuesi, t'i transmetojë vetëm atë që beson ai, dhe jo të vërtetën mbi ngjarjen.<sup>420</sup>

Në tabelën e mëposhtme po japim të ndara në grupe paradigmat (modelet) më të rëndësishme të foljeve të komunikimit.<sup>421</sup>

Verba dicendi me kuptim të përgjithshëm	Folje, që lidhen me një situatë, ku folësi ka shprehur diçka
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim i diçkaje
Tipi i ndodhisë	I papërcaktuar
Referimi kohor	I papërcaktuar
Rolet e aktantëve	Të papërcaktuar
Qëllimi i folësit	I papërcaktuar
Shembuj	<i>them, flas, shprehem</i>

<sup>419</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 196.

<sup>420</sup> Shih, Searle, J., *Sprechakte*, Frankfurt, 1971.

<sup>421</sup> Vetë Searle dallon pesë lloje aktesh ligjërimore. Klasifikimi ynë mbështetet si në klasifikimin e Searle, ashtu dhe në klasifikime të tjera, që marrin në konsideratë si klasifikimin e Searle ashtu dhe të Austin. Shih, Searle, J.R., „Taxonomie illokutionärer Akte“, botuar në, *Searle*, Frankfurt, 1982, f. 12.

## Kauzaliteti implicit në foljet e komunikimit

Reprezentative (paraqitëse)	Folje, që lidhen me një situatë, ku folësi i njofton diçka marrësit, një qëndrim të tij
a)	
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim i diçkaje
Tipi i ndodhisë	I papërcaktuar
Referimi kohor	I papërcaktuar
Rolet e aktantëve	Të papërcaktuar
Qëllimi i folësit	Folësi do që Marrësi të mësojë diçka
Shembuj	<i>pohoj, përforcoj, përgënjeshtroj, dyshoj, diskutoj, mohoj, dëshmoj, kundërshtoj, miratoj</i>
b)	Folje, që lidhen me një situatë, ku folësi i bën të ditur diçka marrësit
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim i diçkaje
Tipi i ndodhisë	I papërcaktuar
Referimi kohor	I papërcaktuar
Rolet e aktantëve	Të papërcaktuar
Qëllimi i folësit	Folësi do që Marrësi të njohë, të pranojë atë që thuhet në aktin lokucionor
Shembuj	<i>konstatoj, kujtoj, lajmëroj, njoftoj, quaj</i>

Direktive (drejtuese)	Folje, që lidhen me një situatë, në të cilën folësi shprehet e thotë që marrësi duhet të bëjë (ose jo) diçka.
a)	
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim i diçkaje
Tipi i ndodhisë	Veprim
Referimi kohor	I ardhshëm
Rolet e aktantëve	Folësi i drejtohet marrësit
Qëllimi i folësit	Folësi do që Marrësi të bëjë/ose jo atë që jepet në aktin lokutiv
Shembuj	<i>kërkoj, paralajmëroj, udhëzoj, lutem, dëshiroj, apeloj, urdhëroj, ndaloj, refuzoj, hedh poshtë, sfidoj</i>
b)	Folje, që lidhen me një situatë, ku folësi drejton një pyetje
Përmbajtja propozicionale/reale	Pyetje për diçka
Tipi i ndodhisë	I papërcaktuar
Referimi kohor	I papërcaktuar
Rolet e aktantëve	Të papërcaktuar
Qëllimi i folësit	Folësi do që Marrësi të plotësojë përmbajtjen e asaj që thuhet në aktin lokucionor
Shembuj	<i>pyes, informohem, marr në pyetje, zhbiroj</i>

Kommissive (premtuese)	Folje, që lidhen me një situatë, ku folësi shprehet se
------------------------	--

## Kauzaliteti implicit në foljet e komunikimit

	ai do të bëjë diçka
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim i diçkaje
Tipi i ndodhisë	veprim
Referimi kohor	I ardhshëm
Rolet e aktantëve	Folësi është në fokus të aktit
Qëllimi i folësit	Folësi do që marrësi ta mësojë se ai do të kryejë ose jo atë që thuhet në aktin lokutiv
Shembuj	<i>premtoj solemnisht, premtoj, siguroj, ofroj, betohem, kërcënoj/kanosem, refuzoj, heq dorë, pranoj, lejoj</i>
Deklarative	Folje, që lidhen me akte institucionale
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim i diçkaje
Tipi i ndodhisë	I pacaktuar
Referimi kohor	I pacaktuar
Rolet e aktantëve	I pacaktuar
Qëllimi i folësit	Folësi synon realizimin e aktit institucional
Shembuj	<i>vërtetoj, pagëztoj, inauguroj, përuroj, shuguroj, pushoj (nga puna), shkarkoj, emëroj, shpall</i>
Expressive	Folje, që lidhen me një situatë, ku folësi jep shprehimisht një vlerësim
a)	
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim i diçkaje
Tipi i ndodhisë	I papërcaktuar
Referimi kohor	I papërcaktuar
Rolet e aktantëve	Të papërcaktuar
Qëllimi i folësit	Folësi do që Marrësi të mësojë që ai (folësi) e vlerëson përmbajtjen e aktit lokucionor: mirë, keq, disi
Shembuj	<i>Gjykoj, vlerësoj, lëvdoj, çmoj, mburr, kritikoj, fajësoj, shaj, akuzoj, rendis,...mburr, krekosem, tallem, tall, hungëroj....., qahem, ankohem.....</i>
b)	Folje, që lidhen me një situatë, ku folësi shpreh gëzim, zemërim, keqardhje
Përmbajtja propozicionale/reale	Njoftim, shprehje e diçkaje
Tipi i ndodhisë	I papërcaktuar
Referimi kohor	Kohë e shkuar
Rolet e aktantëve	Të papërcaktuar
Qëllimi i folësit	Folësi do që Marrësi të mësojë se ai përjeton një emocion (gëzim/hidhërim etj.) për shkak të asaj që thuhet në aktin lokucionor
Shembuj	<i>përgëztoj, uroj, shaj, mallkoj, më vjen keq, ankohem, qahem, ngushëlloj, gëzohem, ngazëllohem, kënaqem, vjell vrer, tërbohem (fig.), qortoj, dëshpërohem, bëj për dy pare (shaj)</i>

Krahas verba dicendi si shoqëruese ligjëratash, thëniesh autentike, përdoren dhe folje të tjera që bëjnë pjesë gjithashtu në grupin e foljeve të komunikimit. Të tilla janë:

foljet e perceptimit: *shoh, ndjej, prek, dëgjoj, shijoj*;  
folje të mendimit: *mendoj, besoj, di*  
folje aktive: *bërtas, qesh*

Në dallim nga verba dicendi tri grupet e përmendura nuk lidhen me ndonjë adresat. Dy grupet e para (foljet e perceptimit/verba sentiendi dhe foljet e mendimit/verba cogitandi) vendosin lidhje me thënien origjinale, ndërsa grupi i tretë nuk lidhet fare me të.

Shembuj:

Ai po vjen.                      Unë shoh (që) ai po vjen.  
Era këndon.                    Unë dëgjoj (që) Era këndon.

Andi (qesh): “Po unë nuk e kam shkruar atë letër.”

### XI.1.2.2 Jo gjithnjë them, them... Mundësi të shumta të shprehjes së një akti ilokutiv foljor

Në shkollë e kudo vihet re një tepri në përdorimin e disa foljeve në aktet ilokutive. E kam fjalën për përdorimin e stërshpeshtë, sidomos të foljes them, në ligjëratën e drejtë, në atë të zhdrejtë dhe në forma të tjera ligjëratash. P.sh.:

- Kisha frikë se mos kishe ikur, - i *thashë*.
- Nuk do t’ia falja kurrë vetes të ikja pa të lajmëruar, - më *tha*.
- Më thuaj, nëse kam ndonjë mundësi..., - i *thashë*.
- Në atë moment Sara filloi të qeshë dhe më *tha* se mundësitë ishin të shumta.<sup>422</sup>

Ose:

- Apo vijnë për t’u shëruar nga verbëria?- *thashë*.
- Nuk po të kuptoj, - *tha* ajo
- Ule zërin! – *tha* pastaj.
- Ç’drejtin qenka kjo që u prishka nga zërat, - *thashë* unë
- Shorti, - më *tha* ajo gjith’ duke buzëqeshur.

“Njëlloj si im bir që s’dinte nga t’ia mbante kur më tha qërohu nga shtëpia ime, *them* me vete”<sup>423</sup> ...

Në ligjërimin e folur, përdorimi rëndom i foljes *them* është dukuri më e përhapur, sepse ky ligjërim rrjedh shpejt e spontanisht dhe folësi e ka më të lehtë të mbetet tek i njëjti mjet për të dhënë qëndrimin e tij komunikativ ndaj përmbajtjes reale të ligjëratës së vet ose të cituar.

E shohim me vend që në këtë paragraf, përfshirë në kapitullin mbi foljet komunikative (performative, ilokutive), të sjellim një listë me folje të tilla, të cilat mund të përdoren në tipe të ndryshme ligjëratash për të shmangur monotoninë e përdorimit vetëm të së

---

<sup>422</sup> *Femra Moderne*, “Tregimi i jetuar”, Tiranë, 2002.

<sup>423</sup> *Gjarpëri i shtëpisë*, roman, Tiranë, 2005, f. 67.

njëjtës folje komunikimi, sidomos të foljes them. E bëjmë këtë hap duke menduar që do të jetë diçka dobiprurëse për mësimin e gjuhës dhe të letërsisë në shkollë dhe kudo ku jetet e specifikohet ligjërimi me indikatorë ilokutivë.

### **XI.1.3 Përfundime**

Koncepti i shkakësisë është nocion bazë në të gjitha reflektimet që lidhen me teorinë e njohjes ose me teori të tjera shkencore. Është fjala për shkakësi që lidhen me ne ose që nuk lidhen me ne. Shkakësitë që lidhen me ne janë ato që shfaqen e veprojnë në fusha sociale e që reflektohen në shkencat përkatëse. Skema e njohur shkak-pasojë takohet kudo në natyrë, ku shkakësia shfaqet me rigorozitetin e ligjit “shkaqe të njëjta sjellin pasoja të njëjta”. Në kuadrin e teorisë së njohjes ligji natyror i shkakësisë është më i kuptueshëm dhe më i shpjegueshëm, nëse do të ballafaqohet me shkakësinë racionale që shprehet me foljet e veprimit, komunikimit etj.

Kauzaliteti dhe intensiononi (shkakësia dhe qëllimshmëria) janë në fakt dy koncepte të ndryshme, por në kontekstet, ku shprehen veprime, mund të shfaqen si njëri ashtu dhe tjetri; ose njëri, ose tjetri.

Në raste të tilla një qëllim mund të shërbejë si arsye për realizimin e një veprimi, madje si shkak në lidhjen kauzale midis qëllimit dhe përmbushjes fizike të veprimit. Sapo shfaqen kontradikta midis interpretimit shkakor dhe qëllimor të veprimeve, rrugët e tyre ndahen.

Foljet e komunikimit si folje performative, që shënojnë kryerjen e një veprimi me anë të një shprehjeje gjuhësore, kanë tipare të përbashkëta me foljet e veprimit. Edhe ato përmbajnë në semantikën e tyre shkakësi implicite, shkakësi në kuptimin e gjerë të fjalës. Synimi/qëllimi që ato shprehin vlen si arsye për pasojën që rrjedh në aktin perlokutiv.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

### **Kreu XII Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Shkakësia është një ligj i përgjithshëm, universal dhe gjithëkohor. Ajo vepron në natyrë dhe në shoqëri. Është tepër domethënëse dhe sugjestionuese thënia (në gjuhën latine) e Leibnitz „Nihil est sine ratione“<sup>424</sup> (Asgjë nuk ndodh pa shkak). Duke qenë se është i gjithëgjendshëm në botën tonë, ai reflektohet dhe në letërsi, në veprat letrare që s’janë veç reagime ndaj realitetit. Po ta vështrojmë romanin e H. Böll-it „Ansichten eines Clowns“ në këtë pikëpamje, mund të themi se në përmbajtjen, në formën, në ligjërimin e përdorur, raportet shkakore shfaqen kudo duke të kujtuar dhe duke referuar në shkakësinë autentike të botës. Për më tepër romani shquhet për intensitetin e veçantë mendor-psikologjik. Kjo lidhet sidomos me mënyrën e konceptimit e të organizimit të materialit letrar. Kompozicioni i romanit është një gjetje gjeniale. I gjithë subjekti, me një informacion të dendur e të paanë, me vuajtje dhe emocione të thella e të fuqishme, deri shkatërruese, rrjedh në një kuadër kohor prej tri orë e gjysmë në një apartament në Bonn. Figura qendrore e romanit është Hans Schnier, me profesion kloun, bir i një familjeje të stërpasur. Prindërit e kanë gjetur me gjithëfarë mënyrash rrugën për te paratë, por rrugën dhe lidhjen me fëmijët e kanë humbur përfundimisht. Pasuria dhe paraja është qëllimi i parë dhe final. Nën këtë trysni skëterre ata shndërrohen në automatë dhe ngurtësohen shpirtërisht aq sa fëmijët përfundojnë rrugëve të fatit.

Hans Schnier nuk është vetëm një kloun i zakonshëm, mediokër, por dhe një demaskues i jashtëzakonshëm i shumë dukurive, personave dhe ngjarjeve të së shkuarës, kohës së luftës (të dytë botërore) dhe të pasluftës. Romani fillon me prezantimin e tij si një “flamur” disfatash. Ai ka humbur dhe profesionin, për shkak të plagosjes në gju, dhe të dashurën, Marien, me të cilin jetoj gjashtë vjet. Pasi na prezanton Hansin, autori i vihet punës për përshkrimin e rrethanave, ku u ngjizën, u shkaktuan dhe rrodhën humbjet e tij..... Ai vetë nuk vlerëson, nuk mban qëndrim. Këtë ia ka lënë lexuesit. Lidhur me kuptimin e konceptit kloun (Hans Schnier) G. Blöcker-i shprehet: „Kllouni është krijesë e kësaj bote dhe krijues i antibiotës, i vuajtur dhe triumfues. Ai është kundërshtar i falsitetit, përfaqësues i vërtetësisë radikale, ai e shokon shoqërinë me të vërtetën e thënë pa ndrojtje.“<sup>425</sup>

#### **XII.1 Shprehja e raporteve shkakore në ligjërimin e Böll-it**

Në rrjetin e marrëdhënieve të shumta, e lidhjeve, që pleksen dhe shpleksen, raportet shkakore edhe në subjektin e këtij romani zenë një vend qendror (si kudo në jetën njerëzore). Hans Schnier është objekt goditjesh të shumëfishta. Shkaqe nga më të ndryshmit zënë pritë në rrugët e tij të jetës, e goditin duke e lënë të braktisur në pasojat e tyre. Kjo shkakësi intensive shprehet me mjete, të cilat do t’i trajtojmë në sythet në vijim.

<sup>424</sup> Heidegger, M., *Der Satz vom Grund, Gesamtausgabe, II. Abteilung, Band 24*, Frankfurt am Main, 1997, f. 37.

<sup>425</sup> Blöcker, G., *Der Schriftsteller H. Böll, ein biographischer Abriss*, München, deutscher Taschenbuch – Verlag, 1985, f. 88.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

### XII.1.1 Ndërtime shkakore me lidhëza shkakore

Është fjala për shprehje eksplicite të marrëdhënieve shkakore. Në këtë rast ndërtimi shkakor përmban një pjesë kryesore dhe një të varur që fillon me lidhëzat *weil* (sepse), *da* (ngaqë), *denn* (meqë). P.sh.:

Wir frühstückten immer morgens mit den Mädchen in der Küche, *weil* es uns zu langweilig war...<sup>426</sup>(Ne hanim mëngjes gjithnjë në kuzhinë me vajzat e shërbimit, se për ne ishte krejt monotone...)

Ich brauche das Geld nämlich, *weil* ich nach Amerika fahren will.<sup>427</sup> (Mua më duhen paratë, se dua të shkoj në Amerikë.)

Das tust du jetzt nur aus Faulheit, und nicht, *weil* du von der Berechtigung abstrakter Ordnungsprinzipien überzeugt bist.<sup>428</sup> (Këtë e bën ti tani nga plogështia dhe jo se je i bindur për principet abstrakte të rregullit.)

Ich ging schliesslich auf Sommerfildsbalkon, *weil* ich das Gerede nicht mehr ertragen konnte.<sup>429</sup> (Më në fund dola në ballkonin e Sommerfild, se nuk mund t'i duroja më ato thashetheme.)

Ndërtimet me *weil* (sepse) janë shumë më të shpeshta nga ato me *da* (ngaqë) dhe *denn* (meqë). Kjo shpjegohet me faktin se autori/ ligjëruesi e thekson veçanërisht idenë e paraqitur si shkak:

...ich mir oft wie ein Unmensch vorkomme, *weil* ich den Feierabend nur Nummer vorführe.<sup>430</sup> (Shpesh unë dukem si jonjeri, sepse pushimin pas pune e jap vetëm si numër cirku.)

Pjesa e varur e paraprirë nga lidhëza *denn* shpreh vetëm një arsytim:

Sie konnte eigentlich nur für ihn kochen, ohne dauernd an mich denken zu müssen, *denn* das hat sie so selten für mich getan, dass es nicht unbedingt Verrat oder Hurerei sein würde.<sup>431</sup> (Në fakt ajo mund të gatuante vetëm për atë, pa iu dashur të mendonte vazhdimisht për mua, se ajo e kishte bërë këtë kaq rrallë për mua, sa që nuk mund ta quaje tradhëti ose kurvëri.)

Pjesa e nënrenditur e paraprirë nga *weil* (sepse) qëllon të vendoset dhe para pjesës kryesore, kështu shkakun e evidentohet dhe më shumë:

*Weil* mir daran liegt, die Sache so objektiv wie nur möglich zu halten.<sup>432</sup> (Sepse për mua është me interes që çështja të mbetet sa më objektive që të jetë e mundur.)

*Weil* sie dort nichts an mich erinnerte, war sie mit Züpfner nach Rom gefahren.<sup>433</sup> (Sepse atje asgjë nuk i sillte ndër mend personin tim, ajo shkoi me Züpfner-in në Romë.)

<sup>426</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 73.

<sup>427</sup> Po aty, f. 73.

<sup>428</sup> Po aty, f. 91.

<sup>429</sup> Po aty, f. 97.

<sup>430</sup> Po aty, f. 125.

<sup>431</sup> Po aty, f. 128.

<sup>432</sup> Po aty, f. 153.



## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

---

Ich hörte ihn draußen mit seiner Wirtin schimpfen, weil sie mich nicht reingelassen hatte.<sup>434</sup>(Unë dëgjoja si zihej me të zonjën e lokalit, meqë ajo nuk më kishte lënë të hyja brenda)

### XII.1.2 Ndërtime shkakore me parafjalë shkakore:

Und ich hatte ihn gern deswegen.<sup>435</sup> (Prandaj e kisha qejf atë ...)

Die Sache zwischen Züpfner und mir, wegen Marie, wäre durch ein Duell zu klären gewesen.<sup>436</sup> (Çështja midis meje dhe Züpfner-it, për shkak të Maries, ishte për t'u zgjidhur me duel.)

### XII.1.3 Folje psikologjike

Në këtë rast shkakësia është implicite, përmbahet në semantikën e foljes. Siç kemi thënë në paragrafin përkatës, shkak mund të jetë një person ose një objekt. Përjetuesi është gjithnjë një person. Foljet psikologjike dallohen për ngjyrimin e tyre emocional:

Ich hatte mich auf diesen Abend sehr *gefremt*, war todmüde und erwartete eine Art *fröhliche* Zusammenkunft, mit viel gutem Wein...<sup>437</sup> (Unë isha gëzuar shumë për këtë mbrëmje, isha i lodhur për vdekje dhe prisja një lloj takimi të gëzuar, me shumë verë të mirë...)

Në thënien e sipërcituar janë dy elemente që ndikojnë direkt në emocionalitetin që transmeton fragmenti: *sich freuen, fröhlich* (gëzohem, i gëzuar). Siç do të shohim dhe më poshtë, nuk mund të lihet pa analizuar edhe emocionaliteti që sjellin në ligjërim mjetet gjuhësore jofoljore, por që lidhen me foljen në mënyra të ndryshme. Në rastin tonë mbiemri *i gëzuar* ka prejardhje foljore, prejpjesore. Si i tillë ai ka në përmbajtjen e tij edhe elemente semantike të foljes nga e cila rrjedh. Atmosfera shkakore qarkon domethënien e shprehjes, nënkuptohet dhe receptohet lehtë. Lexuesi rrok midis rreshtash arsytën e gëzimit, madje në rastin tonë arsyeja shpjegohet edhe eksplicit.

Und ich spürte durch die sechs Kilometer lange Leitung, dass sie *zögerte*.<sup>438</sup> (Dhe unë e ndjeja përmes kabllit 6 km të gjatë se ajo nguronte.)

Folja psikologjike *zögern* (nguroj) përmban implicit një arsye të kësaj gjendjeje. Ligjëruesi nuk shpjegon më tej. Por për lexuesin është e qartë se një shkak bëhet pengesë.

Es war ihnen selbst so peinlich, dass sie später zynisch und snobistisch wurden, außer Züpfner, den die ganze Geschichte so *quälte*, dass er mich um eine Zigarette bat.<sup>439</sup> (Edhe atyre vetë u vinte shumë rëndë, që më vonë u bënë cinikë dhe snobë, përveç Züpfner-it, të cilin gjithë ajo histori e mundonte aq shumë, sa m'u lut mua t'i jepja një cigare.)

---

<sup>433</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 161.

<sup>434</sup> Po aty, f. 195.

<sup>435</sup> Po aty, f. 107.

<sup>436</sup> Po aty, f. 117.

<sup>437</sup> Po aty, f. 22

<sup>438</sup> Po aty, f. 38.

<sup>439</sup> Po aty, f. 23.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Ligjëruesi mund të jepte arsye, argumente për gjendjen e mjerueshme të Züpfner-it, argumente të llojit: ai vuante se nuk e duronte dot atë situatë. Arsyetime të tilla mungojnë në tekst, por lexuesi i mbledh ato në kontekst, midis rreshtash dhe në përmbajtjen e foljes *quälen* (mundoj, vuaj).

Kapitulli 24 i romanit paraqet një bisedë telefonike midis Hansit dhe të vëllait, Leos. Leo është mirëinformuar për gjendjen tejet të vështirë të vëllait. Ai i telefonon atij për t'i thënë:

„Hans, ich habe das Geld für dich.“ (Hans, unë kam para për ty.)  
„Wieviel?“<sup>440</sup> (Sa?) – „Oh, sagte er, „sechs Mark und siebzig Pfennige.“ (Oh,- tha ai, - gjashtë marka e shtatëdhjetë pfenigë.)

E cituam këtë fragment dialogu telefonik për të dhënë diçka nga sfondi tragjik i situatës. Se ndërsa Hansi është i braktisur i shpallur, Leo është gjithashtu i braktisur, edhe pse i pashpallur si i tillë nga familja. Ai, bir milionerësh, nuk ka asnjë marrëdhënie me paratë.

Por ajo që na intereson veçanërisht në këtë situatë është përshkrimi i gjendjes shpirtërore të Leos. Ai nuk mund të vijë dot tek i vëllai, se është vonë dhe nuk duhet të largohet nga konvikti. Kështu lind një tension, një komunikim i mundimshëm, se Hansi do të donte që ai të vinte. Leo vuan shumë nga ana e tij edhe për gjendjen e të vëllait, dhe për atë që nuk mund të shkojë dot tek ai. Vuajtja e Leos jepet vetëm me folje psikologjike. Asnjë ndërtim (eksplicit) shkakor, qoftë në formë fjalie, qoftë me grupe fjalësh! Folja që përdoret më rëndom është *seufzen* (psherëti):

Er *seufzte*, knurrte ein bisschen und sagte ganz langsam: „Scrutinium.“<sup>441</sup> (Ai psherëtiu, mermëriti pak dhe tha ngadalë: „Scrutinium“

Er *seufzte*, und ich konnte mir vorstellen, wie er den Kopf schüttelte...<sup>442</sup> (Ai psherëtinte dhe unë mund të parafytyroja si e tundte kokën.)

Jetzt *seufzte* er wieder, tief, unglücklich, lange.<sup>443</sup> (Ja ku psherëtiu prapë, thellë, gjatë, mjerueshëm.)

Mund të jepnim dhe shembuj të tjerë. Ky kapitull ka shtatë faqe dhe fjala *seufzen* (psherëti) është përdorur dy herë në faqe, nganjëherë dhe tre.

Ndërsa nervozizmi i Leos, që vjen e rritet me tensionimin e situatës, jepet implicit me foljen *hüsteln* (kollitem, me nervozitet):

Er schwieg, *hüstelte*, ich hatte seine Stimme nicht sofort erkannt.<sup>444</sup> (Ai heshtte, kollitej, unë nuk ia njoha menjëherë zërin.)

Ich hörte ihn *hüsteln*.<sup>445</sup> (E dëgjoja që kollitej)

<sup>440</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 288.

<sup>441</sup> Po aty, f. 290.

<sup>442</sup> Po aty, f. 291.

<sup>443</sup> Po aty, f. 293.

<sup>444</sup> Po aty, f. 288.

<sup>445</sup> Po aty, f. 289.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Madje në faqen 293 Hansi shpërthen: Offenbar hatte er wirklich nichts als *Seufzen* und *Hüsteln* gelernt . (Siç dukej ai nuk kishte mësuar gjë tjetër veç psherëtimës dhe kollitjes.)

Folja *hüsteln* përdoret më shpesh nga *seufzen*, sidomos nga fundi i kapitullit. Përdorimi i shpeshtë i këtyre dy foljeve psikologjike nuk prodhon aspak monotoni, por shërben si burim shprehësie dhe përbën një mënyrë të veçantë të prezantimit psikologjik.

Foljet psikologjike, siç është e natyrshme, përdoren shpesh në situata befasie dhe të tilla ka me shumicë në këtë roman:

Ich war selbst *erschrocken*. Ich hörte, dass meine Mutter aufschrie, dann *seufzte* sie.<sup>446</sup> (Edhe unë vetë u tremba. Dëgjova që nëna thirri, pastaj filloi të rënkojë.)

Ich *erschrack*, drehte mich um; eine hübsche Frau<sup>447</sup>... (Unë u tremba, u ktheva, një grua e bukur...)

Ich *schwitzte* vor Aufregung.<sup>448</sup> (Unë djersija nga turbullimi.)

Foljet psikologjike janë gjithnjë të pranishme në peizazhet retrospektive. Rrëfimi në roman rrjedh në dy plane kryesore, një plan ka të bëjë me momentin e ligjërimin, tjetri me rrëfimin retrospektiv të ndodhive që kanë ngjarë para momentit të ligjërimin. Edhe pse gramatikisht përdoret vetëm koha e shkuar për të shpalosur informacionin dhe emocionet e gjithfarshme, dallohet qartë momenti i ligjërimin nga e shkuara që vjen me retrospektivë dhe i bashkangjitet rrëfimit të figurës qendrore. Retrospektiva bëhet kështu një mjet letrar-artistik që i shërben fuqizimit informativ dhe shprehës të mesazhit. E shkuara e Hansit është, pothuaj, aq dramatike sa e tashmja e tij, madje më e trishtuar, vështruar me syrin e një të humburi. Ka shumë shkaqe dhe arsye që e bëjnë të shkuarën një barrë shpirtërore, një mbresë negative, të pashlyeshme. Për ta dhënë atmosferën e shkaqeve fatale që e bënë të shkuarën një ëndërr të keqe përdoren, ndër të tjera dhe folje psikologjike:

Marie war *entsetzt*<sup>449</sup>... (Maria u tmerrua)

Sie sah mich kopfschüttelnd an, *seufzte*, drehte sich wieder um und ging auf und ab. (Ajo më pa duke tundur kokën, psherëtiu, u kthye dhe filloi të ecte poshtë e lart.)

Ich warf mich in den Kleidern aufs Bett, schlief sofort ein, und als ich am Morgen wach wurde, war ich nicht *erstaunt* darüber, dass Marie gegangen war.<sup>450</sup> (Unë rashë në shtrat pa i hequr rrobat, më zuri gjumi menjëherë dhe, kur u ngrita në mëngjes, nuk u çudita që Maria kishte ikur.)

Sie haben uns alle schrecklich *enttäuscht*.<sup>451</sup> (Ju na keni zhgënjyer tmerrësisht).

Mich *ärgerte* das... Das *ärgerte* mich wieder<sup>452</sup>... (Kjo më nervozonte... Përsëri kjo më nervozonte...)

<sup>446</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 39.

<sup>447</sup> Po aty, f. 169.

<sup>448</sup> Po aty, f.187.

<sup>449</sup> Po aty, f. 46.

<sup>450</sup> Po aty, f. 97.

<sup>451</sup> Po aty, f. 100.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Edhe parafytyrimet e zymta skenash të mundshme bëhen shkak për vuajtje shpirtërore:

Mich *quälte* auch die Vorstellung, dass Züpfner Marie beim Zuschrauben der Zahnpastatuben zugeschaut hätte.<sup>453</sup> (Mua më mundonte dhe parafytyrimi që Züpfner-i do ta shikonte Marien kur hapte tubin e pastës së dhëmbëve)

Në roman është një paragraf i tërë ku Hansi (rrëfyesi) hyn qetësisht në botën e vdekjes duke e parafytyruar veten të vdekur. Vdekja bëhet shkak i reagimeve të forta psikologjike. Të gjithë miqtë e të njohurit vendosen para një prove të veçantë. Hansi rrëfen për reagimin e çdonjërit prej tyre. Meqë dukuria e vdekjes, e varrimit, e prehjes në varr shkakton ose provokon emocione të pazakonshme, sidomos pikëllim, në paraqitjen letrare-gjuhësore të saj nuk mungojnë foljet psikologjike. Shkaku i emocioneve lidhet jo vetëm me vdekjen vetë, por dhe me predispozitat e brendshme morale-shpirtërore të secilit prej pjesëmarrësve në ceremoninë mortore e me llojin e lidhjes ndaj të vdekurit. Folja *qaj* është ajo që përdoret më shpesh:

Meine Mutter wird *weinen* und behaupten<sup>454</sup>... (Nëna ime do të qajë dhe do të thotë...)

Kinkel wird *weinen*, aufrichtig und heiß.<sup>455</sup> (Kinkel do të qajë sinqerisht dhe me lot të nxehtë.)

Monika Silvs wird *schluzzen*, als wenn sie meine Witwe wäre.<sup>456</sup> (Monika Silvs do të dëneste, sikur të ishte vejusha ime.)

Karl und Sabine werden *weinen*, hemmungslos<sup>457</sup>... (Karl dhe Sabine do të qanin pa u ndrojtur...)

Edgar wird sich verpflichtet fühlen, die Tränen zu unterdrücken<sup>458</sup>... (Edgar do të jetë i detyruar t'i përmbajë lotët...)

### XII.1.4 Folje të veprimtimit

Po e fillojmë këtë paragraf me një thënie të Harras-it: „Midis arsyeve dhe veprimeve që i shprehin ato nuk ka lidhje empirike (që rrjedh nga eksperiencia), por një raport logjik, konceptor... Nëse ne japim shpjegime për veprimet tona, kjo do të thotë që veprimet tona në rrethana të caktuara janë të arsyeshme... Ne i quajmë arsyet e veprimeve tona shkaqe dhe me këtë kuptojmë që ne nuk do kishim bërë një veprim, po qe se nuk do të kishim një arsye, një qëllim ose një preferencë subjektive...“<sup>459</sup>

Po kaq domethënëse është dhe thënia në formë postulati e Davidson-it: „Arsyet, që japim për të shpjeguar veprimet tona, duhen marrë, konceptuar si shkaqe të tyre.“<sup>460</sup>

<sup>452</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 105.

<sup>453</sup> Po aty, f. 81.

<sup>454</sup> Po aty, f. 284.

<sup>455</sup> Po aty, f. 284.

<sup>456</sup> Po aty, f. 284.

<sup>457</sup> Po aty, f. 285.

<sup>458</sup> Po aty, f. 285.

<sup>459</sup> Harras, G., *Handlungssprache und Sprechhandlungen*, Berlin, New York, de Gruyter, 1983, f.79.

<sup>460</sup> Shih, Davidson, D., *Können Gründe Ursachen von Handlungen sein*, München, 2004, f. 10.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Siç jepet qartë në formulimet e mësipërme foljet e veprimit janë folje ndërvetore që përmbajnë shkakësi në kuptimin e tyre. Kjo shkakësi është e një lloji të veçantë, e llojit arsye (njerëzore). Foljet e veprimit përdoren në tekstet letrare me funksione të ndryshme. Funksioni kryesor është ai i paraqitjes autentike të botës dhe rrethanave njerëzore. Ato janë një rrugë nga hyjnë qëllimet dhe arsyet që i shoqërojnë bëmat e personazheve. Edhe nëse në tekst e në kontekst nuk jepet eksplicit shkakun ose arsyeja, mjafton folja për ta nënkuptuar atë. P.sh.:

Es war wieder im Wald ein Deserteur *erschossen* worden.<sup>461</sup> (Përsëri kishin pushkatuar në pyll një dezertor.)

Nach einer Stunde wurde ich in unser Wohnzimmer zum Verhör *geschleppt*.<sup>462</sup> (Pas një ore më zvarritën në dhomën e pritjes për të më marrë në pyetje.)

Paraqitja e materialit letrar në këtë roman të Böll-it ka një veçori specifike e të spikatur. Rrëfyesi, Hansi, i tregon ngjarjet dhe bëmat në formë kujtimesh, reflektimesh. Prej këtej rrjedh edhe fakti që në roman përdoren më tepër folje psikologjike, se folje veprimi. Në një formë të tillë paraqitjeje veprimi, bërja jepen, kryesisht, si përshtypje. Bëmat e dhëna në formë përshtypjesh, kujtimesh e humbin disi karakterin autentik-veprues. Folja *vras* e shembullit të parë e nënkupton shkakun e një veprimi të tillë, por veprimi vetë i përthyer në prizmin e kohës, kujtimit e rrëfimit humbet shumë (semantikisht) nga akti tragjik i pushkatimit.

Ndodh që fjalitë, të cilat kanë në përbërje folje të veprimit, përmbajnë implicit edhe një intension (qëllim), edhe një shkak. Qëllimi ka të bëjë me përfundimin e veprimit të synuar, ndërsa shkakun ka të bëjë me pikënisjen, tregon shkakun a motivin që të çon në fillimin e veprimit:

„Dabei habe ich so viel Geld für deine Erziehung *ausgegeben*.“<sup>463</sup> (Dhe unë kam dhënë aq shumë para për edukimin tënd.“)

Interpretimi: Dhashë shumë para se mendova të të edukoja.

Në korpusin tonë ka një skenë të vetme që rrjedh e gjallë në momentin e ligjërimin. Skenat e tjera, tërë episodet e paraqitura, rrjedhin ose si telefonata, ose si kujtime e përshtypje. Vetëm në një rast Hansi, i ngujuar në apartamentin e tij në Bon, takohet me një person konkret, me të jatin. Në këtë rast foljet e veprimit nuk e kanë më atë tisin subjektiv të bëmave të përpunuara e të bluara në mokrën e kujtimeve:

Er *goss* mir Sprudel *ein*, *hielt* mir sein Zigarettenetui *hin*, ich *nahm* eine, er *gab* mir Feuer, wir *rauchten*.<sup>464</sup> (Më hodhi ujë, më zgjati kutinë me cigare, unë mora një, ai më afroi çakmakun dhe ne filluam të pinim duhan.)

Folja *rauchen* (pi duhan) shfaqet shpesh në tregimin e kësaj skene. Një folje e tillë ndërvetore tregon veprim, por në rastin tonë (dhe në shumë raste të tjera në roman dhe në jetë) është sinonim i mërzisë, nervozizmit, gjendjes së paqetë dhe të tensionuar:

<sup>461</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 29.

<sup>462</sup> Po aty, f. 33.

<sup>463</sup> Po aty, f. 172.

<sup>464</sup> Po aty, f. 176.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Ich saß da neben Marie und *rauchte* vor Aufregung.<sup>465</sup> (Unë rrija atje, pranë Mariës dhe pija duhan nga emocioni.)

„Ja, sagte ich leise, *zog* an der Zigarette, *inhaltierte* tief, ich bin todkrank, aber nicht blind...“<sup>466</sup> (Po, thashë unë me zë të ulët, - thitha zigaren, thitha tymin thellë, - unë jam i sëmurë për vdekje, por jo i verbër.)

„Hat Mutter dir erzählt, dass ich hier bin?“ fragte ich schliesslich, als wir die zweite Zigaretten ansteckten, ohne ein Wort gesprochen zu haben.<sup>467</sup> („A të tregoi nëna që jam këtu?“ - pyeta unë më në fund, pasi po pinim cigaren e dytë pa thënë akoma asnjë fjalë.) (Kush jane foljet e veprimit?? Anstecken??)

Një procedurë interesante që vihet re në realizimin e kësaj skene është alternimi i pamjeve: njëherë personat bëjnë diçka konkrete, pas pak bien në mendime (pa përmendur dialogun e gjallë, me një vërtetësi fantastike). Para syve, mendjes dhe parafytyrimit tonë ndërrohen çastet: babai hedh ujë në gotë, pi ujë, ndez cigaren, shkon te dritarja dhe bie në mendime; e njëjta gjë ndodh me Hansin. Për ta dhënë plastikën e skenave, e çasteve të tilla, ligjërimi është i pasur me folje veprimi dhe folje psikologjike që alternohen. Veprimi dhe gjendja e dhënë nga folja psikologjike ndodh të shprehen në të njëjtën fjali:

Er *setzte sich*, *goß sich* Sprudel ein und *sah mich verwirrt an*.<sup>468</sup> (Ai u ul, hodhi ujë në gotën e tij dhe më pa mua i turbulluar.)

Ich *schlugte* Eier in die Pfanne und *versetzte mich in tiefe Melancholie*.<sup>469</sup> (Unë thyeja vezë në tigan dhe bija në një melankoli të thellë.)

Ich *gehe* in die Küche, *dricke* Mayonnaise, *halbire* Oliven und *fühle mich* verloren.<sup>470</sup> (Unë shkoj në kuzhinë, shtrydh majonezë, ndaj ullinj të përgjysmë dhe ndjehem i humbur.)

Ich *goß* kochendes Wasser in den Filter, während ich an das Haus dachte, das Züpfner sich hatte bauen lassen.<sup>471</sup> (Unë hidhja ujë të nxehtë në filtër dhe mendoja për shtëpinë që kishte ndërtuar Züpfner-i.)

Shoqërimet të tilla: një veprim + një mendim, ndjenjë a refleksion janë një dukuri e shpeshtë në tekstin letrar të Böll-it. Efekti i tyre është i padyshimtë. Ato transmetojnë një emocionalitet tejet intensiv, një atmosferë të dendur ndjesore, që i zbeh dhe i mjegullon veprimet konkrete. Lexuesit i mbetet në mendje jo aksioni konkret i ndarjes së ullinjve etj., por dëshpërimi i njeriut të stakuar nga realiteti konkret, për shkak të peshës së kujtimeve dhe reflektimeve. Kauzaliteti implicit i shprehur nga foljet e veprimit ka natyrë të ndryshme nga ai i dhënë me folje psikologjike. Këtë mund ta shpjegojmë me anë të një interpretimi parafrazor:

Pse *hedh* ujë në filtër? Që të bëjë kafe/ Se do të përgatisë kafe. (intension= kauzalitet)  
Pse *parafytyron* i mërzitur shtëpinë e Züpfner-it? Se ai i mori Mariën, të dashurën.

<sup>465</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 103.

<sup>466</sup> Po aty, f. 183.

<sup>467</sup> Po aty, f. 183.

<sup>468</sup> Po aty, f. 185.

<sup>469</sup> Po aty, f. 165.

<sup>470</sup> Po aty, f. 163.

<sup>471</sup> Po aty, f. 164.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Autori nuk jep eksplicit shpjegime e shkaqe të tilla, që çdo lexues i nxjerr vetë nga konteksti dhe nga semantika e foljeve që janë shkruar me shkronja të pjerrëta.

Mir wurde *übel*, weil ich mir vorstellte, wie Züpfner in einem römischen Hotel Marie beim Ankleiden *zusah*.<sup>472</sup> (Mua më vinte për të vjellë, kur parafytyroja, se si Züpfner-i në një hotel në Romë e shikonte Marien kur vishej.)

Shkakësia në këtë rast është e shenjuar dyfish: eksplicit me fjali të varur shkakore (*weil ich mir vorstelle*) dhe implicit me folje psikologjike (*übel werden*) e me folje veprimi (*zusehen*).

Në paragrafin mbi foljet e veprimit ne përmendëm disa raste foljesh, që edhe pse përmbanin në kuptimin e tyre një lëvizje ose një lloj lëvizjeje trupore, nuk ishin folje veprimi (fle, gogësisj, më hapet goja, teshtij). Një argument për mospërfshirjen e tyre në klasën e foljeve të veprimit është fakti që ato shënojnë procese të paqëllimshme reflektore, fiziologjike. Por ka te Böll-i një përdorim të veçantë të foljes *gähnen* (më hapet goja). Procesi shkaktohet jo vetëm nga lodhja, që normalisht e shkakton atë, por dhe nga mosaprovimi, nga mërzia që përjeton personazhi kryesor në një moment, gjatë takimit dramatik me të jatën. Për të paraqitur gjendjen e tij krejt të rrënuar autori përdor në mënyrë të përsëritur foljen *gähnen*. Ajo që i thotë i ati është e papranueshme për të, prandaj ai nuk e zotëron dot hapjen e gojës, që në këtë rast nuk ka të bëjë me refleksin biologjik, por me një reaksion emocional-shpirtëror:

Ich musste plötzlich *gähnen*.<sup>473</sup> (Papritur m'u hap goja.)

Und es tat mir leid, dass ich ausgerechnet jetzt *gähnen* musste.<sup>474</sup> (Dhe më erdhi singërisht keq që pikërisht në atë çast më hapej e më hapej goja.)

Mein *Gähnen* wurde fast zu einem Gähnkrampf.<sup>475</sup> (Hapja e gojës m'u bë sëmundje.)

Folja *gähnen* dhe pjesorja e emëruar *Gähnen* përdoren shtatë herë në dy faqe.

Autori përshkruan, nuk argumenton, nuk jep eksplicit shkaqe. Vetëm përdorimi i elementeve që përmendëm informon implicit për shkakun e gjithë asaj monotonie. Ndodh që veprimi i shprehur nga folja të shkaktojë një gjendje psikologjike:

...“Seit dieser Geschichte, wie du sie nennst, seh ich viel fern - es *macht mich* so schön *leer*. Ganz leer.“<sup>476</sup> („Që nga ajo histori, siç e quan ti, unë shoh shumë televizor – kjo më boshatis, më boshatis krejt.“)

<sup>472</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 162

<sup>473</sup> Po aty, f. 180.

<sup>474</sup> Po aty, f. 180.

<sup>475</sup> Po aty, f. 181.

<sup>476</sup> Po aty, f. 179.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

### XII.1.5 Fjalë që kanë lidhje prejardhjeje me folje psikologjike

Vetëm foljet psikologjike do të ishin një mjet i pamjaftueshëm për të dhënë krejt atmosferën emocionale në romanin e Böll-it. Lidhur ngushtë me to shfaqen dhe funksionojnë fjalë të tjera, që janë në lidhje derivacioni (formues- kuptimor) me foljet. Është fjala për emra, mbiemra, ndajfolje që përmbajnë në semantikën e tyre ngjyime të theksuara emocionale. Sikurse dhe foljet psikologjike ato shprehin dhe kauzalitet të fshehur, të nënkuptuar. P.sh.:

Mich selbst beim Essen zu beobachten war nur *traurig*, nicht *erschreckend*. (Të më shikoje mua kur haja ishte vetëm e trishtueshme, por jo tmerruese.)<sup>477</sup>

Të dy elementët e shenjuar me shkronja italike lidhen për nga kuptimi dhe fjalëformimi me foljet përkatëse *trauern*, *erschrecken* (trishtoj/vajtoj, tremb/tmerroj). Gjatë receptimit të tekstit lexuesi e merr me mend se gjendjet e caktuara nuk janë pa shkaqe. Vetë fjala me përmbajtjen e saj, por edhe konteksti ndihmojnë në rrokjen e shkakut që fshihet brenda tyre.

#### XII.1.5.1 Fjalë emërore

Er unterdrückte seinen *Ekel*, aber nicht überzeugend. (Ai përpiqej ta mposhtte neverinë e tij, por jo bindshëm.)<sup>478</sup>

Shkak për neverinë e manifestuar nga babai i Hansit ishte gjella, që po hante i biri dhe mënyra si po hante. Fjala *Ekel* bën pjesë në një familje semantike me *ekeln*, *ekelhaft*, *ekelerregend* (ngjall neveri, i neveritshëm, që ngjall neveri). Të tria fjalët përdoren në rrethanat, kur një shkak a motiv, prodhon gjendjen që ato shënojnë. Shkaku a motivi nënkuptohen.

Shembuj të tjerë, emra:

Meine erste Regung war immer noch nicht *Wut* oder *Verbitterung* oder gar *Haß*; meine leeren Augen füllten sich langsam mit *Mitleid*. (Reagimi im i parë nuk ishte ende tërbim ose hidhërim ose aspak urrejtje; sytë e mij bosh u mbushën ngadalë me mëshirë.)<sup>479</sup>

Duke shënuar emocione<sup>480</sup> fjalët e shenjura me shkronja të pjerrëta referojnë në sfonde shkakore që i kanë prodhuar emocionet.

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për emrat e përdorur në shembujt më poshtë:

<sup>477</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 175.

<sup>478</sup> Po aty, f. 174.

<sup>479</sup> Po aty, f. 198.

<sup>480</sup> Fjala emocion vjen nga latinishtja, përbëhet nga *ex* 'jashtë' dhe *motio* 'lëvizje/nxitje'. Emocioni është një proces psikik, që shkaktohet nga perceptimi i një objekti ose një situatë dhe manifestohet me ndryshime fiziologjike, me përjetime ndjenjësore subjektive. Shih më tej, Mees, U, „Zum Forschung der Emotionspsychologie- eine Skizze“, botuar në, *Emotionen und Sozialtheorie*, Frankfurt am Main, 2006, f. 104- 123.



## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Sie hatte eine fächerliche *Angst vor dem Staub*, den ich aufwirbelte, wenn ich auf der Bühne herumhopste. (Ajo kishte një frikë të tmerrshme nga pluhuri që ngrija, kur kërceja nëpër skenë.)<sup>481</sup>

Në thënien e cituar jepen madje, eksplicit, shkaku (nga pluhuri) dhe pasoja (frikë e tmerrshme). Por ngjyrimi i theksuar emocional i fjalëve që shënojnë pasojën lë të mendosh se përtej shkakut pluhur ka dhe shkaqe të tjera. Dhe vërtet, në vijim të tekstit jepet një shpjegim që mund të shkaktonte frikëra te tilla. Në atë sallë bëheshin takime të një mjekeje me nëna të reja, të cilat vinin atje me bebet e tyre. Pluhuri për bebet është vërtet shumë dëmsjellës.

Nicht einmal das Klingeln des Telefons weckte mich *aus meiner Dumpfheit*. (As edhe zilja e telefonit nuk po më zgjonte nga topitja ime.)<sup>482</sup>

Elementi *Dumpfheit* (topitje) është pasoja e rëndë që kanë sjellë tërë ato shkaqe që përshkruhen e analizohen në roman. Pasoja është një komponente e lidhjeve shkakore. Komponentja tjetër është shkaku. Edhe nëse shkaku nuk jepet eksplicit, pasoja e përmban atë implicit, ose, me shoqërim idesh, të kujton shkaku.

Er verdiente ganz gut, und alles, was sich zeigte, war eine ständige *Gereiztheit*, weil er sich ausrechnen konnte, dass er nie eine für ihn angemessene Wohnung würde bezahlen können. (Ai fitonte pothuaj shumë mirë, dhe gjithçka e dukshme, ishte një pezmatim, se ai mund të llogariste që kurrë nuk do të mund të paguante një shtëpi të përshtatshme për të.)<sup>483</sup>

Edhe këtu shkaku e pasoja përmbahen në të njëjtën thënie. Pasoja *Gereiztheit* (pezmatim/nervozizëm) rrjedh nga shkaku se ai (K. Edmonds), edhe pse fiton mirë, nuk është në gjendje të blejë një shtëpi të përshtatshme. Të dhëna së bashku, shkaku dhe pasoja, ndikojnë në ekspresivitetin e fragmenteve dhe të teksteve letrare. Nëse shkaku nuk do të shprehej eksplicit në thënie, në kontekstin e afërt ose jo të afërt, fjalë të tilla, që shënojnë gjendje psikologjike, gjithsesi e përmbajnë implicit idenë e shkakut, por të një shkaku të përgjithshëm. Se nuk mund të jetë dikush i pezmatuar, ose nervoz pa shkak (përrjashtuar rastet patologjike).

### **XII.1.5.2 Fjalë mbiemërore**

...nach der *ekelhaften* Anekdote..., die er uns erzählt hatte... (...pas anekdotës së neveritshme..., që ai na tregoi...)<sup>484</sup>

Mbiemrat mund të përdoren në bashkëvajtje me një emër, në funksion atributiv ose me foljen jam, në funksion predikativ. Në gjermanisht ata gjenden dhe në përdorime ndajfoljore, në raste të tilla në shqip bëhet fjalë për ndajfolje (sie singt schön- ajo këndon bukur etj). Në pikëpamje të shprehjes së kauzalitetit dy tipet e përmendura dallojnë njëri nga tjetri. Në përdorimin emër mbiemër, shpesh emri jep shkaku, mbiemri pasojën, p.sh.: *tödliche Verdrossenheit* (mërzi vdekjeprurëse). Elementi *Verdrossenheit* (mërzi) jep shkaku e pasojës *tödlich* (vdekjeprurëse).<sup>485</sup>

<sup>481</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 191.

<sup>482</sup> Po aty, f. 253.

<sup>483</sup> Po aty, f. 174.

<sup>484</sup> Po aty, f. 158.

<sup>485</sup> Po aty, f. 201.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

---

Ose:

Die *erstaunlichste* Erfahrung unserer Kindheit war die Erkenntnis, dass wir zu Hause nie richtig zu fressen bekamen.<sup>486</sup> (Eksperiencia më e çuditshme e fëmijërisë sonë ishte fakti, që ne në shtëpi asnjëherë nuk hëngrëm për të qenë.)

Eksperiencia shkakton çudinë.

Ose:

... und so musste er witzig sein. Eine *ermüdende* Existenz.<sup>487</sup> (... dhe kështu ai duhej të ishte shakaxhi. Një ekzistencë lodhëse.)

Ekzistenca prodhon lodhje.

Në shembullin e mëposhtëm mbiemri i përdorur *scheußlich* (i shëmtuar) del në funksion atributiv, por nuk i përket klasës së fjalëve për të cilën ne po flasim, fjalë që lidhen kuptimisht dhe në pikëpamje të prejardhjes me foljet psikologjike

Ein *scheußliches* Möbelstück, das irgendwie nach Schule aussah. (Një mobilie e shëmtuar që të kujtonte shkollën.) Në gjermanisht nuk ka ndonjë folje përgjegjëse psikologjike për *scheußlich*, ndërsa në shqip folja shëmtoj nuk është folje psikologjike. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për: eine *üppig* wuchernde Melancholie (një melankoli tejet e shtuar/e harlisur). Folja *harlisem* (rritem shpejt) nuk është psikologjike.

Shembull tjetër:

Er hatte sich immer als *begeisteter* Verehrer meiner Kunst erklärt, dass....<sup>488</sup>  
(Një admirues entuziast i artit tim, që...)

Me anë të këtij shembulli duam të shpjegojmë sa më poshtë: mbiemri *begeistert* (entuziast) shënon një gjendje emocionale të lidhur me një shkak, i cili jepet me *meine Kunst* (arti im), por jo me fjalën shoqëruese *Verherer* (adhurues). Kjo ka të bëjë me strukturën sintaksore-argumentore të fjalisë me foljen përgjegjëse psikologjike. Ajo kërkon dy argumente: kryefjalë- kundrinë/ veprues- pësues. Edhe mbiemrat që lidhen semantikisht me folje psikologjike duhet të nënkuptojnë dy argumente (veprues/pësues) që të përmbushin kushtin e fjalëve me kauzalitet implicit. Nëse fjala që i shoqëron nuk është veprues, atëherë ajo nuk mund të jetë shkak i gjendjes së shprehur nga mbiemri. Në rastin tonë *Verherer* (adhurues) nuk është shkak ose stimuli. Ajo përbën një njësi me mbiemrin, të dyja fjalët kanë semantikë të ngjashme dhe plotësojnë njëra-tjetrën *admirues entuziast*. I njëjti shpjegim vlen dhe për shembullin vijues:<sup>489</sup>

Mein *füchterliches* Leiden ist die Anlage zur Monogamie.<sup>490</sup> (Vuajtja ime e tmerrshme është prirja ime monogame.)

---

<sup>486</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 199.

<sup>487</sup> Po aty, f. 181.

<sup>488</sup> Po aty, f. 201.

<sup>489</sup> Shih, Krusche, D., *Kommunikation im Erzähltext* 1. Analysen, München, W. Fink Verlag, 1988 f. 27.

<sup>490</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 201.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Shkak i vuajtjes është monogamia, pasoja e monogamisë – vuajtja. Dy njësitë *füchterliches Leiden* (vuajtje e tmerrshme) plotësojnë semantikisht njëra-tjetrën dhe shënojnë, së bashku, pasojën.

Ka dhe mendime që ndërtime të tilla të interpretohen si vargje shkakore: monogamia prodhon vuajtje, vuajtja tmerr. Ose në shembullin e parafundit vargu i shkakësisë ka këtë formë: art- adhurim – entuziazëm.<sup>491</sup>

Mbiemrat me funksion predikativ e përmbajnë idenë e shkakësisë implicit:

Ich war vorkommen *erledigt, todmüde, hungrig*, hatte nicht einmal Zigaretten... (Unë isha i mbaruar, i lodhur për vdekje, i uritur.)<sup>492</sup>

Gjendjet e shprehura nga mbiemrat janë pasoja shkaqesh të nënkuptuara.

Er sagte leise, und doch ein bisschen gekränkt.<sup>493</sup> (Ai thonte me zë të ulët, por prapë pak i lënduar.)

Er schien über meinen Gesichtsausdruck erschrocken zu sein.<sup>494</sup> (Ai dukej i tmerruar nga shprehja e fytyrës sime.)

### XII.1.5.3 Fjalë ndajfoljore

Siç dihet, pas foljes jam në gjuhën shqipe përdoret një mbiemër predikativ, atje, ku në gjuhën gjermane përdoren ndajfolje predikative. Shumica e ndajfoljeve/mbiemrave të tillë të përdorur në tekstin e Böll-it janë mbiemra prejpjesorë, që mund të interpretoheshin dhe si pjesë e prediakatit (Zustandspassiv). Pavarësisht nga grupimi i tyre morfosintaksor (mbiemër/ndajfolje) ato janë elemente që shprehin veçori, që kanë ngjyrimë emocionale dhe referojnë me asociacion në shkaqe të ndryshme:

Über Fredebeul war ich *erschrocken*.<sup>495</sup> (Unë isha tmerruar nga Fredebeul.)

Ich hatte Mitleid mit ihm, es musste füchterlich für ihn sein...<sup>496</sup> (Unë kisha mëshirë ndaj tij, për të duhej të ishte e tmerrshme...) Etj.

Ka dhe raste ku elementi karakterizues nuk lidhet me foljen jam, por me folje të tjera, folje që kërkojnë zakonisht një gjymtyrë (plotës) predikative:

Sein Lachen klang *erleichtert*, und doch *ärgerlich*.<sup>497</sup> (Qeshja e tij tingëlloi e lehtësuar, por prapë nervoze.)

Ich fühlte mich, als läge ich besoffen und stickend in der Gosse...<sup>498</sup> (Unë ndjehesha sikur isha shtrirë i dehur dhe i qelbur në kanal.)

„Ich nehme an, Appetit“, sagte er kühl.<sup>499</sup> („Oreks, mendoj“, tha ai ftohtë.)

<sup>491</sup> Shih dhe, Teichmann, E., *Hapa në Universin e ligjërimin*, Tiranë, 2010, f. 68.

<sup>492</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 194.

<sup>493</sup> Po aty, f. 174.

<sup>494</sup> Po aty, f. 198.

<sup>495</sup> Po aty, f. 174.

<sup>496</sup> Po aty, f. 184.

<sup>497</sup> Po aty, f. 184.

<sup>498</sup> Po aty, f. 250.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

Funksion karakterizues ndaj foljes përmbushin dhe disa ndërtime me foljen në Partizip 1 në gjermanisht, të cilat përkthehen në shqip me një ndajfolje ose me formën përgjegjëse përcjellore, ose në mënyra të tjera:

Er wurde rot und sah mich *kopfschüttelnd* an.<sup>500</sup> (Ai u skuq dhe më pa duke tundur kokën.)

„Ich will dir gern dreihundert geben“, sagte er *weinend*.<sup>501</sup> („Me gjithë qejf do të jap 300“, tha ai duke qarë.)

Ich ging *achselzuckend* in die Diele.<sup>502</sup> (Unë shkova në korridor me supë të mbledhura.)

Edhe ndajfoljet, si dhe emrat e mbiemrat, që lidhen në njëfarë mënyre me foljet psikologjike, fshehin në përmbajtjen e tyre shkakësi. Kjo shpjegohet me ngarkesën e tyre emocionale. Si kontigjente, që rrezatojnë emocionalitet, ato nënkuptojnë me semantikën e tyre shkaqe, arsye që i prodhojnë këto emocione.

### XII.1.6 Përfundime

Në planin kuptimor-artistik të një veprë letrare ka vende bosh ose të papërcaktuara. Gjatë leximit, receptimit të veprës, bëhet dhe përcaktimi, plotësimi i vendeve bosh. Ky plotësim bëhet nga lexuesi në mënyrë të pandërgjegjshme nën veprimin sugjestionues të tekstit. Lexuesi lexon kështu midis rreshtave dhe plotëson intuitivisht semantikën implicite të tekstit. Pjesë përbërëse e semantikës implicite është dhe shkakësia e nënkuptuar, e lexuar jo në rrjeshtat, por midis rrjeshtave. Shkakësia e shprehur implicit të Böll-i është po aq e gjithëgjendshme sa ajo eksplicite, madje më shumë. Në kapitullin e mësipërm në paraqitëm shkurtimisht disa raste ndërtimesh shkakore të realizuara me përdorimin e lidhëzave dhe ndonjë mjeti tjetër gjuhësor. Por u ndalëm veçanërisht në dukurinë e shkakësisë implicite. Zbulimi i saj paraqet vështirësi llojesh të ndryshme si kategori semantike-filozofike që është. Së pari: kjo është një fushë pak e studiuar, së dyti: qëntimi i saj kërkon një punë tejet të kujdesshme, një lexim dhe interpretim tejet special. Së treti: në shumë shpjegime dhe interpretime duhet t'i drejtohesh filozofisë, të kërkosh vazhdimisht ndihmën dhe mbështetjen e saj.

Në romanin e Böll-it raportet shkakore të dhëna implicit përbëjnë përftesa interesante që e bëjnë tekstin më ndikues dhe lexuesin më aktiv e të interesuar. Në shtjellimin e mësipërm në kemi prezantuar dhe shpjeguar rastet e manifestimit të shkakësisë implicite, lokalizimin e saj në foljet psikologjike, foljet e veprimit, foljet performative-komunikative, në fraza emërore, mbiemërore, ndajfoljore. Këto tri grupet e fundit janë shprehëse të shkakësisë implicite, sidomos kur kanë lidhje kuptimore e derivuese me foljet kauzale. Studimi i shkakësisë implicite të shprehur me emra, mbiemra, ndajfolje është një dukuri tepër interesante, por shumë pak e studjuar.

Sigurisht jemi ndalur gjatë dhe në funksionet e kauzalitetit implicit në tekstin letrar të Böll-it. Nga mënyra e konceptimit dhe e prezantimit teksti letrar, në fjalë, mund të

<sup>499</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 257.

<sup>500</sup> Po aty, f. 201.

<sup>501</sup> Po aty, f. 199.

<sup>502</sup> Po aty, f. 208.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

klasifikohet i llojit psikologjik. Bota jepet e përrthyer në prizmin konceptues të klounit-Hans. Kështu në përmbajtjen e romanit mbizotërojnë përjetimet psikologjike ndaj aksionit. Kjo shprehet me një përdorim të dendur të foljeve ndërvetore që shënojnë gjendje psikologjike. Foljet psikologjike, emrat, mbiemrat, ndajfoljet me vlerë psikologjike, që kemi qëmtuar në hulumtimin tonë, kanë si funksion kryesor dhënien e emocionalitetit si komponent shumë i rëndësishëm në një tekst letrar. Duke shprehur shkakësi implicite këto elemente ndihmojnë dhe në planin racional, ku shpjegimet duhet të jenë logjike, ku duhen evidentuar lidhjet shkak-pasojë. Një funksion tjetër i foljeve psikologjike është ai paraqitës i personazheve.

Me anë të foljeve të veprimit, që shprehin kauzalitet implicit, synohet dhe autenticitet, spontanitet. Alternimi folje veprorë-folje psikologjike brenda një konteksti të ngushtë jep plastikën e skenave të përditshme.

Anliza të tilla mbi përdorimin e mjeteve, që shprehin kauzalitet implicit, ndihmojnë shumë në analizën tekstore, në receptimin e përmbajtjeve, në interpretimin e thellë të veprave letrare, ku letërsia dhe gjuhësia janë në unison.

### XII.2 Format e dhënies së ligjëratave të përdorura nga Böll-i

Në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të Heinrich Böll-it përdoren këto forma të dhënies së ligjëratave: ligjërata e drejtë, monologu i brendshëm, ligjërata e zhdrejtë dhe ligjërata e përjetuar. Format e veçanta dallojnë midis tyre nga mjetet e ndryshme shprehëse gjuhësore që aktivizojnë. Por të gjitha llojet e transmetimit të ligjëratave kanë të përbashkët tiparin semantik të referencës. Ato vendosin një lidhje varësie nga sinjalet e referimit. Në shumicën e rasteve funksionin e sinjaleve referuese e përmbushin foljet e komunukimit (verba dicendi, verba sentiendi, verba cogitandi ‘foljet e thënies, e perceptimit, e gjykimit’ ).<sup>503</sup> Përsa i përket vendosjes, foljet, sinjale të referimit, qëndrojnë pas thënies-ligjëratë, por mund të qëndrojnë dhe në fillim, ose të vendosen në mes të saj. Ja disa shembuj:

“Die Sache ist sehr dringend”, *sagte* ich.<sup>504</sup> („Çështja është shumë urgjente“, *thashë* unë.)

„Nein“, *sagte* ich, „seelisch. Eine rein seelische Angelegenheit.“<sup>505</sup> („Jo, *thashë* unë, shpirtërore, një çështje krejt shpirtërore.“

Ich *sagte*: „Schnier- Hans- Sie erinnern sich?“<sup>506</sup> (Unë i *thashë*: „Schnier – Hans, ju kujtohet?“)

#### XII.2.1 Sinjalet referuese

Sinjalet e përmendura foljore referojnë në situatën ligjërimore, ku thënia merr forcë ilokutive, kur përmbajtjes së saj i shtohet ndërhyrja, qëndrimi i folësit. Kështu, në pikëpamje semantike dallojmë klasa të ndryshme foljesh referuese:

- Sinjale foljore që shprehin vërtetim, konstatim: *them, sqaroj, njoftoj, pohoj, mendoj, besoj, siguroj* etj. Shembuj:

<sup>503</sup> Shih., Weinrich, H., *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Mannheim, Dudenverlag, 1993, f. 896.

<sup>504</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 85.

<sup>505</sup> Po aty, f. 85.

<sup>506</sup> Po aty, f. 186.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

„Schnier, sagte er, „lassen Sie doch das Vergangene vergangen sein.“<sup>507</sup> („Schnier, tha ai, lëreni pra të shkuarën të jetë e shkuar.“

„Ich verstehe dich nicht“, *sagte* ich müde, „was meinst du.“<sup>508</sup> („Nuk të kuptoj se çfarë mendon, thashë unë i lodhur.“)

- Sinjale referuese foljore që shprehin pyetje: *pyes, interesohe* etj.

“Was?” *fragte* ich, “was hast du gesagt?”<sup>509</sup> („Çfarë?“, pyeta unë, „çfarë the ti?“)

„Schicken?“ *fragte* er. „Willst du weggehen?“<sup>510</sup> („Ta dërgoj?“ pyeti ai. „Do të largohesh?“)

„Hier im Hotel?“ *fragte* ich müde.<sup>511</sup> („Këtu në hotel?“ pyeta unë i lodhur.)

- Sinjale referuese foljore që kërkojnë kryerjen e një veprimi: *kërkoj, urdhëroj, lutem* etj.

Ich *glaube*, er hätte mir sogar Geld gegeben, wenn ich ihn drum gebeten hätte.<sup>512</sup> (Unë besoj, që ai do të më kishte dhënë edhe para, po t’i isha lutur.) (Ligjëratë e zhdrejtë)

Ich war so wütend, dass ich sie *zwang*: „Steh auf, zieh die Schuhe an...!“<sup>513</sup> (Unë isha aq i nxehur, sa e detyrova atë: „Ngreu, vish këpucët...“)

Ich *bat* sie auch, mir doch genau zu erklären, was sie im Krankenhaus mit ihr gemacht hatten.<sup>514</sup> (Gjithashtu iu luta asaj të më tregonte tamam se çfarë kishin bërë ata me të në spital.) (Ligjëratë e zhdrejtë)

„Mein Gott“, *bat* mein Vater..., „sprich doch laut und deutlich und mach die Augen auf.“<sup>515</sup> („O zot“, lutej babai..., Fol pra me zë të lartë dhe hapi sytë.“)

Aber ich sprach so leise, dass er mich anbrüllte und mich *aufforderte*: „Sprich laut, was möchtest du.“<sup>516</sup> (Po unë fola aq nën zë sa ai bërtiti dhe kërkoi: “Fol qartë, çfarë do.“ ...Der Pfarrer ... hatte ihn mit ernster Miene und unter gewissen Drohungen *aufgefordert*, „dem unsittlichen Treiben ein Ende zu setzen“...<sup>517</sup> (Prifti, me një shprehje serioze dhe me një lloj kërcënimi i kërkoi atij tu jepte fund sjelljeve imorale.“

- Sinjalet referuese mund të japin informacion dhe mbi mënyrën se si është dhënë sekuenca ligjërimore e rimarrë: *pëshpëris, thërras*:

Und in meiner Angst *schrie* ich Herbert ins Gesicht: „Nazisschwein.“<sup>518</sup> (Dhe i frikësuar i thirra Herbertit mu në fytyrë: „Derr nazist.“)

<sup>507</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 113.

<sup>508</sup> Po aty, f. 94.

<sup>509</sup> Po aty, f. 73

<sup>510</sup> Po aty, f. 73.

<sup>511</sup> Po aty, f. 78.

<sup>512</sup> Po aty, f. 117.

<sup>513</sup> Po aty, f. 146.

<sup>514</sup> Po aty, f. 148.

<sup>515</sup> Po aty, f. 197.

<sup>516</sup> Po aty, f. 53.

<sup>517</sup> Po aty, f. 107.

<sup>518</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 32.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

---

„Herrgott, noch mal, Schnier“, *rief* er, „Sie können doch von mir als katholischem Priester nicht verlangen...“<sup>519</sup> („O zot, edhe njëherë po ju them Schnier“, thirri ai, „Ju nuk mund të kërkoni nga unë, si prift katolik...“)

...Und sich bei mir *flüsternd* über Nuttenmangel in Bonn beklagte.<sup>520</sup> (Dhe duke pëshpëritur më ankohej për mungesën e femrave të përdala në Bon.)

„Ja“, *rief* ich, „ich bins.“<sup>521</sup> („Po“, thirra, „jam unë.“)

„Ich bin kein Mann“, *wimmerte* sie...<sup>522</sup> („Unë nuk jam burrë“, qaravitej ajo...)

„Hallo, Schnier“, *dröhnte* es mir entgegen „reizend, dass Sie anrufen.“<sup>523</sup> (Halo, Schnier“, gjëmoi si kundërveprim, „mrekulli që telefononi.“)

Wir *flüsterten* nur immer wieder, dass wir uns nie, nie mehr trennen würden, „bis dass der Tod uns scheidet“ flüsterte Marie.<sup>524</sup> (Ne pëshpërisnim vazhdimisht, që kurrë, kurrë më nuk do të ndaheshim, „deri sa të na ndajë vdekja“, pëshpëriste Maria.)

- Si sinjale referuese mund të shërbejnë dhe folje që shprehin ndjenjë, *qesh, rënkoj* etj.

„Nicht ein Tropfen“, *lachte* er.<sup>525</sup> („Asnjë pikë“, qeshte ai.)

„Nein“, er *lachte* tatsächlich. „Nein. Der Unterschied ist sehr gross...“<sup>526</sup> („Jo“, ai qeshi me të vërtetë. „Jo. Ndryshimi është shumë i madh...“)

„Aber versteh mich doch“, *flehte* er.<sup>527</sup> („Po më kupto të shkretën“, përgjyrohej ai.)

„Aber ich will dir wirklich helfen“, sagte er weinend.<sup>528</sup> („Por unë dua vërtet të të ndihmoj“, tha ai duke qarë.)

„Schnier“, *lachte* er, „ich merke schon, was mit Ihnen los ist. Offenbar sind Sie so monogam wie ein Esel.“<sup>529</sup> („Schnier“, qeshi ai, „ unë e kuptoj mirë se ç’ndodh me ju. Siç duket ju jeni monogam si një gomar.“)

- Grupi i fundit i fjalëve referuese që kemi qëmtuar në tekstin e Böll-it janë foljet që shprehin qëndrimin subjektiv të folësit ndaj përmbajtjes së ligjëratës që rijepet: *teproj, gënjej, ndërpres* etj.:

„Meine Presse?“ *unterbrach* ich, „ich bin seit drei Monaten nur noch in der Provinz aufgetreten.“ („Shtypi për mua?“ e ndërpreva unë, „ që prej tre muajsh unë kam dhënë shfaqje vetëm në provincë.“)<sup>530</sup>

---

<sup>519</sup> Po aty, f. 154.

<sup>520</sup> Po aty, f. 83.

<sup>521</sup> Po aty, f. 53.

<sup>522</sup> Po aty, f. 75.

<sup>523</sup> Po aty, f. 111.

<sup>524</sup> Po aty, f. 197.

<sup>525</sup> Po aty, f. 148.

<sup>526</sup> Po aty, f. 154.

<sup>527</sup> Po aty, f. 294.

<sup>528</sup> Po aty, f. 294.

<sup>529</sup> Po aty, f. 159.

## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

---

„Ich habe keine Gegner“, *log* ich.<sup>531</sup> („Unë nuk kam kundërshtarë“, gënjeva unë.)

Ich habe etwas *übertrieben* als ich sagte: „Außer der Matte würde ich wohl noch tausend Mark im Monat brauchen.“<sup>532</sup> (Unë e teprava disi kur thashë: „Përveç shtrojcës më nevojiten edhe një mijë marka në muaj)

Të gjitha foljet komunikative, që shërbejnë si sinjale referuese përmbajnë në kuptimet e tyre shkakësi implicite. Veprimet e shprehura prej tyre shprehin qëllime, të cilat mund të interpretohen edhe si shkaqe (sipas tezës: intension = kauzalitet). Qëllimi/shkakësi është transmetimi i një mesazhi, paralajmërimi etj. „Fjalët e thëna më parë, që tani riprodhohen nga folësi a shkruesi, formojnë atë që quhet pjesa përmendëse, kurse fjalët e tjera, që shtohen nga riprodhuesi si fjalë hyrëse lidhur me fjalët e riprodhuara quhen pjesa lajmuese (ose ligjëratë e autorit)... Pjesa lajmuese ka si qëllim kryesor të informojë lexuesin ose dëgjuesin se atij po i tregohet diçka e thënë më parë... Përveç kësaj ajo mund të tregojë qëllimin e thënies...“<sup>533</sup>

### XII.2.2 Monologu i brendshëm

Një mënyrë tjetër e dhënies së ligjëratave në romanin „Ansichten eines Clowns“ të Böll-it është dhe monologu i brendshëm. Kjo mënyrë të shprehuri shërben për të dhënë përjetimet shpirtërore të personazheve pa komente dhe pa ndërhyrjen gjuhësore të riprodhuesit, rrëfyesit. Në romanin e Böll-it rrëfyeni është vetë figura qendrore e romanit, Hans Schnier. Në monologjet e brendshme ai riprodhon gjuhësisht momente, përjetime, ndodhi. Një veçori e kësaj pëftese të Böll-it është se këto përjetime janë herë reale, herë virtuale; herë janë reflektime të ndodhive të shkuara, herë janë fluturime fantazie, parafytyrime skenash të pajetuara. Ndërtimi gjuhësor i tyre nuk përmban elementet e domosdoshme të një ligjërate të drejtë ose të zhdrejtë: pjesën lajmuese dhe pjesën përmendëse.<sup>534</sup>

Ato rrjedhin si rrëfime ku shkruesi dhe përjetuesi identifikohen. Këtë mënyrë rrëfimi ne e kemi zbuluar dhe në një aspekt tjetër, në aspektin funksional artistik. Monologu i brendshëm i shtresohet momentit të ligjërimit duke prodhuar intensitet mendor-psikologjik. Mendimet dhe ndjenjat e intensifikuara veprojnë më fuqishëm te lexuesi. Kjo përftesë i jep tekstit dhe një karakter autentik e spontan. Para se ta ilustrojmë mendimin tonë me pjesë teksti nga romani i Böll-it, vlen të theksojmë se monologjet e brendshme përmbajnë si komponente semantike edhe shkakësi. Shkakësia këtu mund të jepet hapur me elementet e saj karakteristike, lidhëza, parafjalë etj., ose përmbahet implicit në elemente të caktuara dhe duhet zbuluar. Këtu shfaqet dhe roli i lexuesit si përbërës i veprës letrare. Ai e plotëson atë duke lexuar midis dhe përtej rreshtave.<sup>535</sup>

...ich leide nicht nur an *Melanchonie, Kopfschmerzen, Indolenz und der mystischen Fähigkeit*, durchs Telefon Gerüche *wahrzunehmen*, mein fächerlichstes Leiden ist die Anlage zur Monogamie; es gibt nur eine Frau, mit der ich alles tun kann...: Marie, und seitdem sie von mir weggegangen ist, lebe ich wie ein Mönch leben sollte, nur:

---

<sup>530</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 186.

<sup>531</sup> Po aty, f. 179.

<sup>532</sup> Po aty, f. 187.

<sup>533</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, II, Tiranë, 2002, f. 662.

<sup>534</sup> Shih, *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, II, Tiranë, 2002, f. 665.

<sup>535</sup> Shih, Krusche, D., *Kommunikation im Erzähltext 1. Analysen*, München, W. Fink Verlag, 1988, f. 15–18.



## **Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

ich bin kein Mönch. Und weil ich kein Mönch bin, leide ich noch mehr...<sup>536</sup> (... unë nuk vuaj vetëm nga melankolia, dhimbje e kokës, plogështia dhe aftësia mistike për të nuhatur erërat gjatë telefonimit, vuajtja ime më e tmerrshme është prirja monogame (monogamia); ka vetëm një grua me të cilën unë mund të bëj gjithçka...: Maria, dhe qëkur ajo është larguar nga unë, jetoj siç duhet të jetojë një murg, veç: unë nuk jam murg. Dhe meqë nuk jam murg, vuaj akoma më shumë...)

Me anë të foljeve psikologjike (leiden, wahrnehmen), emrave që shënojnë sëmundje dhe veçori psikologjike, ndërtimit me lidhëzën weil (sepse) jepen shkaqe të shumta që sjellin si pasojë atë gjendje të rënduar trupore-psikologjike të ligjëruesit. Në monologje të tilla ligjëruesi shprehet pa pengesa e komplekse, prandaj këto përftesa vlejné si shpjegime për shumë sjellje e manifestime morale-psikologjike të figurave. Në rrëfime të tilla jepet pse-ja e shumë veprimeve e qëndrimeve të personazheve.

Shembull tjetër:

Sicher würden sie eine Audienz bekommen, und der arme Papst, der sie mit meine Tochter und Züpfner mit mein guter Sohn anreden würde, würde nicht ahnen, dass ein unzüchtiges und ehebrecherisches Paar vor ihm kniete. Vielleicht war sie auch mit Züpfner nach Rom gefahren, weil sie dort nichts an mich erinnerte...<sup>537</sup> (Me siguri do të priteshin në audiencë dhe papa i shkretë, që do t'u drejtohej me bija ime dhe Züpfner-it biri im, nuk do ta merrte me mend që përpara tij po gjunjëzohej një çift imoral dhe shkelës kurore. Ndoshta ajo kishte shkuar në Romë me Züpfner-in, se atje nuk kishte asnjë kujtim me mua.)

Fragmenti projektohet në të ardhmen. Pjesa e parë e fragmentit është parafytyrim, pjesa e dytë (vielleicht...) është një hamendje që mund të jetë dhe e vërtetë. Kauzaliteti në këtë fragment ka të bëjë dhe me elemente të veçanta, si fjalia shkakore me weil (sepse) etj., dhe me kuptimin e përgjithshëm të fragmentit, që përbën një shkak psikologjik (ndër shkaqet e tjera).

Në paragrafin mbi foljet psikologjike kemi folur, ndër të tjera, edhe për fluturimet e fantazisë në sfera të imagjinuara. Kemi përmendur foljet psikologjike si mjete tepër efikase në paraqitje të tilla. Këto paraqitje shpesh kanë formën e monologjeve të brendshme.

Ligjërata e përjetuar nuk haset dendur në tekstin e Böll-it.

### XII.2.3 Përfundime

Të gjitha foljet komunikative, që shërbejnë si sinjale referuese mund të zëvendësohen me foljen *them*. Sigurisht, të zëvendësuar ato humbasin ngjyrimet karakteristike, për të cilat kemi folur. Jo vetëm në gjuhën shqipe, por dhe në gjuhët e tjera folja *them* është polisemike, zotëron një polisemi shumë të gjerë. Në të gjitha kuptimet e saj përmban shkakësi implicate. Veprimet e shprehura prej saj shprehin qëllime, të cilat mund të interpretohen edhe si shkaqe (sipas tezës: intension = kauzalitet). Këtë tezë mund ta shpjegojmë, siç kemi bërë dhe më lart, me anë të parafrazimit, duke u nisur nga fakti që nuk mund të thuhet diçka pa një qëllim/shkak. Qëllimi është transmetimi i një mesazhi. Në veprën „Gramatika e Gjuhës Shqipe, II“ çështja për të cilën sapo

<sup>536</sup> Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963, f. 21.

<sup>537</sup> Po aty, f. 161.

**Foljet ndërvetore në ligjërimin artistik. Mbi kauzalitetin implicit në romanin „Ansichten eines Clowns“ (Me syrin e një klouni) të autorit Heinrich Böll**

---

folëm trajtohet kështu: „Fjalët e thëna më parë, që tani riprodhohen nga folësi a shkruesi, formojnë atë që quhet pjesa përmendëse, kurse fjalët e tjera, që shtohen nga riprodhuesi si fjalë hyrëse lidhur me fjalët e riprodhuara quhen pjesa lajmuese (ose ligjëratë e autorit)... Pjesa lajmuese ka si qëllim kryesor të informojë lexuesin ose dëgjuesin se atij po i tregohet diçka e thënë më parë... Përveç kësaj ajo mund të tregojë qëllimin e thënies...“<sup>538</sup>

Monologu i brendshëm i shtresohet momentit të ligjërimin duke prodhuar intensitet mendor-psikologjik. Mendimet dhe ndjenjat e intensifkuara veprojnë më fuqishëm te lexuesi. Kjo përftesë i jep tekstit dhe një karakter autentik e spontan. Monologjet e brendshme përmbajnë si komponente semantike edhe shkakësinë. Shkakësia në këtë rast mund të jepet hapur me elementet e saj karakteristike, lidhëza, parafjalë etj., ose përmbahet implicit në elemente të caktuara dhe duhet zbuluar. Këtu shfaqet dhe roli i lexuesit si përbërës i veprës letrare. Ai e plotëson atë duke lexuar midis dhe përtej rreshtave.

---

<sup>538</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe, II*, Tiranë, 2002, f. 662.

### Përfundime të përgjithshme

Përfundimet tona mbi punimin e paraqitur po i grupojmë në tre blloqe tematike

#### 1. Shkakësia eksplicite (shkakësia e shprehur)

Një ndërtim shkakor, si në shqip dhe në gjermanisht, në kuptimin e ngushtë të fjalës, është një fjali e përbërë nga dy pjesë, njëra prej të cilave paraprihet nga një lidhëz ose nga një mjet tjetër lidhës shkakor që ia bashkangjit këtë pjesë pjesës tjetër. Këto dy pjesë janë në marrëdhënie shkakore. Në pikëpamje ontologjike dallohen disa lloje shkaqesh: shkak real, argument, shkak logjik.

Në rendin e pjesëve në fjalinë e përbërë shkakore gjuha shqipe dhe ajo gjermane paraqesin veçori të përbashkëta: pjesa e varur mund të vendoset para, pas dhe në mes të pjesës kryesore.

Lidhëza denn (meqë, sepse) është lidhëz bashkërenditëse. Në këtë kuptim, domethënë në pikëpamje sintaksore ajo nuk ka përgjegjëse në gjuhën shqipe. Në pikëpamje semantike ajo mund të përkthehet me se, sepse, meqë. Në të dyja gjuhët shprehja më e zakonshme e raporteve shkakore janë fjalitë e përbëra shkakore.

Në gjuhën shqipe ka më shumë lidhëza nënrenditëse se në gjuhën gjermane. Numri i madh i lidhëzave shkakore në gjuhën shqipe kanë si përgjegjëse në gjuhën gjermane një numër të kufizuar lidhëzash, kryesisht: *weil*, *da* (sepse). Për të ilustruar këtë mendim po japim disa shembuj:

I donte, *se* ishin trima. ,Er mochte sie, *weil* sie mutig waren.‘

Ndiejmë një farë kënaqësie, *pse* do të mundim të çlodhemi pak. ,Wir spüren eine Art Zufriedenheit, *weil* wir uns ein wenig werden ausruhen können.‘

*Meqë* kishte punë, nuk erdhi. ,*Weil* er zu tun hatte, kam er nicht.‘

Nuk u nis, *ngaqë* ishte i sëmurë. ,Er ging nicht weg, *weil* er krank war.‘

*Meqenëse* kërkohet, do ta bëjmë. ,*Da* es gefordert wird, werden wir es tun.‘

Në shqip (dhe në gjermanisht) grupit të lidhëzave shkakore të mirëfillta u shtohen dhe ato me origjinë kohore ose vendore: *si*, *pasi*, *mbasi*, *sa*, *posa*, *sapo* (*që*), *kur*, *tek*, *kurse*, *derisa*, *përderisa*, *qysh se* ...

Në gjuhën shqipe në pjesën kryesore të fjalisë shkakore që ndërtohet me anë të lidhëzave të sipërpërmendura nuk është i domosdoshëm përdorimi i fjalëve korrelative:

(*Prandaj*) nuk e mbaroi dot, *se* nuk kishte kohë.

Një grup të posaçëm në klasën e lidhëzave nënrenditëse shkakore të shqipes përbëjnë shprehjet lidhëzore të përbëra nga një grup parafjalor + një lidhëzë shkakore (*që/se*): *për shkak se*, *për arsye se* etj. Në shqip nuk ka lidhëza shkakore të markuara si në gjermanisht *zumal/ zumal da*(për më tepër).

Shumica e parafjalëve që përdoren në gjuhën shqipe për të shprehur marrëdhënie shkakore janë shprehje parafjalore në përbërjen e të cilave është i pranishëm një emër (për shkak të etj). Edhe pse me semanikë të dobësuar, emri ka ruajtur diçka nga kuptimi fillestar. Kjo gjë i bën parafjalët shkakore të gjuhës shqipe me një semantikë

më të qartë se ato të gjuhës gjermane. Shumica e parafjalëve shkakore në gjuhën gjermane janë fjalë të parme. Në gjermanisht parafjalët më të përdorshme, të cilat nuk kanë kuptime dytësore janë *wegen/ aufgrund*. Edhe parafjalët *aus* dhe *vor* përdoren shpesh, por kuptimi shkakor është vetëm një ndër kuptimet e tyre. Gjuha gjermane ka dhe parafjalë me kuptim shkakor dygjymtyrëshe *um...willen: um der Wahrheit willen* (për hir të së vërtetës), dhe parafjalë të pasvëna *halber* ,për shkak‘.

Në pikëpamje sintaksore parafjalët shkakore janë elemente më të integruara në fjali se p.sh. lidhëzat nënrenditëse.

Si në shqip dhe në gjermanisht ndajfoljet shkakore kanë vlerën e lidhëzave bashkërenditëse. Në të dyja gjuhët ato qëndrojnë në krye të fjalisë që bashkërendisin. Në gjermanisht pas ndajfoljes vjen direkt folja e fjalisë, në shqip nuk ndodh patjetër kështu, pas ndajfoljes që kryeson fjalinë mund të pasojë një emër ose ndonjë pjesë tjetër ligjërë. Gjuha gjermane ka në dispozicion një numër shumë më të madh ndajfoljesh shkakore se gjuha shqipe. Siç shihet dhe në tabelat përkatëse një ndajfoljeje të shqipes i përgjigjen disa në gjuhën gjermane.

Në pikëpamje sintaksore dhe komunikative këto ndajfolje dalin vetëm me funksion përfaqësues. Ato referojnë ose përfaqësojnë një përmbajtje të përmendur në fjalinë tjetër ose diçka të dhënë në situatë. Prandaj ato nuk mund të përdoren vetëm:

Javën e shkuar isha sëmurë, *prandaj* nuk erdha në leksion. ‚Letzte Woche war ich krank, *deshalb* kam ich nicht in die Vorlesung.‘

Për shkak të statusit special (janë të pranishme në fjalinë që shpreh pasojën dhe referojnë në fjalinë që shpreh shkakun) këto ndajfolje në disa gramatika të gjuhës gjermane trajtohen si lidhëza rrjedhimore, në disa të tjera si lidhëza shkakore.

Pjesëza *nämlich* në gjermanisht ndodh të përfshihet në klasën e ndajfoljeve lidhore, ndonëse ajo vetëm pjesërisht ngjet me to. Ndryshe nga ndajfoljet lidhore elementi *nämlich* nuk ka karakter referues.

Në tekstin letrar marrëdhëniet shkakore janë pjesë përbërëse e përmbajtjes tërësore të tekstit. Ato mund të jenë të shprehura gjuhësisht ose jo. Nëse folësi/shkrimtari e quan të rëndësishme ta drejtojë marrësin në një interpretim të caktuar të raportit shkakor, atëherë ai i formulon raportet në tekst. Edhe në tekstet letrare lidhjet shkakore eksplicite realizohen me mjete leksikore: *parafjalë, lidhëza, ndajfolje, pjesëza*. Parafjalët dhe lidhëzat kanë vlera sintaksore dhe semantike, ndajfoljet vetëm semantike-referuese.

Lidhjet shkakore mund të jenë *jo modale, dispozicionale ose modale* (epistemike, deontike). Raportet dispozicionale janë asnjëse, normale. Raportet modale janë të markuara. Realizimin e raporteve shkakore modale e favorizojnë katër faktorë sintaksorë-semantikë: dezintegrimi sintaksor (lidhja e dobët e pjesës shkakore me pjesën drejtuese), theksimi i njëres apo tjetres pjesë të fjalisë shkakore, përcaktimi/theksimi i shkakut, prania e treguesve të tjerë modalë në kontekst.

Në romanin e Kadarese përdoren këto lidhëza për të shprehur raporte shkakore: *sepse, se, ngaqë, që, përderisa, kur, pasi, pse*. Dendurinë më të madhe në përdorim e ka shkakorja *sepse*. Kjo lidhëz, ashtu si lidhëza *weil* (sepse) në gjermanisht është e aftë të shprehë raporte shkakore, ku shkakun, argumentin, arsytimin theksohen më fort se gjatë përdorimit të shkakoreve të tjera. Përveç kësaj, kjo lidhëz në gjuhën shqipe ka

ngjyrim libror. Përdorimi i dendur i kësaj lidhëze (katër herë më shumë se shkakorja se) krahas mjeteve të tjera gjuhësore, që janë tipike për ligjërimin libror, bëjnë që ligjërimi i I. Kadaresë të manifestojë nuanca të dukshme librore. Përkthyesit e romanit për të dhënë raportet shkakore përdorin, kryesisht, lidhëzat *weil, da, denn*. Në disa raste përdorin mjete të tjera lidhëse, si: pjesëza, lidhëza kohore me vlerë shkakore, ndonjë formulim paralel ku mungon lidhëza etj.

Në “Vepra” e Th. Mitkos lidhëza *përse* me kuptim shkakor ka pasur një diapazon të gjerë kuptimesh e përdorimesh. Sot ajo është mënjeluar krejt nga funksioni i dikurshëm lidhëzor shkakor dhe është specializuar si lidhëz për shprehje marrëdhënies kundrinore e kryefjalore dhe si ndajfolje qëllimi.

Sistemi lidhëzor që përdor Buzuku ka shumë afri me atë që përdorim sot. Te “Meshari” pamë lidhëza, që përdoren me të njëjtin funksion dhe të njëjtën formë edhe në shqipen e sotme, lidhëza, që sapo kanë filluar të përdoren dhe lidhëza, që sot shqipja nuk i ka. Lidhëza shkakore *përse* nuk përdoret më sot. Ndërsa lidhëza *qi* ka evoluar në formë, sot del në trajtën që.

Në veprën “Dhjata e re dhe psalme” përdoren këto lidhëza shkakore: *se, sepse, meqë, ngaqë, që, për shkak se, për arsye se*. Funksionet që përmbushin këto lidhëza shkakore janë reale/faktike (më shumë), epistemike dhe ilokutive (më pak). Fjalitë shkakore, në pjesën dërrmuese të rasteve, janë me pjesë të varur konstatuese. Fjalitë me pjesë të varur shkakore arsyetuese janë më të pakta.

Është interesant përdorimi i lidhëzave kohore me kuptim shkakor. Të tilla janë: *kur, pasi, sapo*.

Me vlerë shkakore dalin dhe lidhëzat rrjedhimore që përdoren në këtë tekst. Fjalitë që përmbajnë një pjesë të varur rrjedhimore mund të transformohen në fjali me pjesë të varur shkakore. Gjatë transformimit kemi ndryshime në strukturat sipërfaqësore. Strukturat e thella mbeten identike.

### 2. Shkakësia implicite (*shkakësia e nënkuptuar*)

#### 2.1 Vështrim i përgjithshëm

Foljet që shënojnë e paraqesin veprime, gjendje, ndodhi, relacione midis njerëzve ekzistojnë në të gjitha gjuhët e botës. Këto janë quajtur folje ndërvetore (interpersonale). Një veçori e përgjithshme e tyre është se ato informojnë për shkakun e projektuar në njërin nga dy aktantet, argumentet që kërkon folja, pa qenë nevoja për informacion tjetër. Disa folje ndërvetore, thjesht, e nënkuptojnë shkakësinë, pa e shprehur gjuhësisht. Ky fenomen quhet kauzalitet implicit.

Foljet ndërvetore ndahen në folje që shprehin veprim (folje veprorë) dhe folje që shprehin gjendje. Foljet e grupit të parë (*përsëritës, përgjigjem, shfajësohem* etj.) paraqesin veprime të rrokshme konkretisht. Ndërsa foljet që shprehin gjendje (*dashuroj, urrej, çudis, admiroj* etj.) lidhen me emocione, me procese mendore që nuk rroken konkretisht.

### 2.1.1 Shkakësia implicite në foljet psikologjike:

Foljet që shprehin gjendje ndahen më tej në dy tipa skematikë: stimul – përjetues (SP) dhe përjetues – stimul (PS) ( Stimulus – Experiencer SE, Experiencer – Stimulus ES). Në skemën SE foljet plotësohen nga një subjekt që luan rolin e stimulit, i cili shkakton një emocion ose një gjendje të gjymtyra objekt. Kjo gjymtyrë luan dhe rolin e përjetuesit. Folje të tilla janë: *befasoj, inatos, lodh* etj.

Skema ES paraqet simbolikisht ndërtimet ku folja kërkon një subjekt frymor, i cili përjeton një gjendje emocionale që i shkaktohet nga objekti i fjalisë. Ky objekt luan rolin semantik të stimulit, p.sh.: *dashuroj, urrej, admiroj* etj. Subjekti luan rolin e pësuesit.

Në grupin e foljeve ndërvetore veprare mund të bëhet dhe një ndarje e të dallohen brenda këtij grupi dy nëngrupe: nëngrupi veprues – pësues, VP (AP, Agent – Patient) dhe veprues – evokues, VE (AE, Agent – Evocator)

Ndërsa në grupin veprues – pësues veprimi i subjektit bie mbi objektin dhe ky e pranon atë në mënyrë pasive, në ndërtimet me folje që plotësohen me argumente që luajnë rolet veprues dhe reagues/evokues objekti nxit diçka te subjekti, p.sh.: *lavdëroj, kritikoj, korrigjoj* etj.

Eksperimentet, studimet në gjuhë nga më të ndryshmet, edhe në gjuhën tonë, kanë treguar që në shumicën dërrmuese të rasteve në konstruktet e skemave AP/VP (veprues – pësues), SE/VP (veprues – përjetues) roli i vepruesit (Agent) i caktohet nga folja subjektit.

Në ndërtimet me folje që kanë strukturën argumentore AE/VR (veprues – reagues), ES/ PS (përjetues – stimul) rolin e vepruesit/shkakut e luan objekti (plotësi në kallëzore, rrallë në dhanore).

Të gjitha foljet ndërvetore, ku përfshihen dhe ato psikologjike janë kauzative. Ka mendime që dhe në grupin e foljeve psikologjike dallojnë një nëngrup me folje kauzative dhe një të tillë pa folje shkakore. Gjatë hulumtimeve tona, gjatë ballafaqimit me literaturë autorësh të ndryshëm, nuk gjetëm ndonjë argumentim të shtjelluar bindshëm në favor të idesë që foljet psikologjike mund të jenë dhe jo kauzale. Ne mbështesim mendimin e përgjithshëm që: të gjitha foljet që shprehin gjendje psikologjike ose procese mendore janë kauzale. Ato përmbajnë kauzalitet implicit.

### 2.1.2 Shkakësia implicite në foljet e veprimit:

Përkufizimin më të goditur të termit veprim e ka dhënë Austin-i: „Një fillim i arsyeshëm, për të mos thënë një fillim i mençur, do të ishte shpjegimi se termi veprim ka po atë kuptim si në filozofi, një kuptim tepër abstrakt; ai përfshin tërë foljet me një subjekt njerëzor...”

Veprimi është aktiviteti i interpretuar si veprim. Me anë të interpretimit referojmë dhe në qëllimin e vepruesit. Për interpretime të tilla ka shumë mundësi paraqitjeje, përshkrimi.

Termet arsye dhe shkak janë të ndryshëm në kuptim. Arsyeja (Grund) është e lidhur me një subjekt që shpjegon, argumenton veprimin e tij për ta bërë atë të kuptueshëm, të pranueshëm. Pra, arsyeja është dukuri e botës njerëzore.

Ndërsa termi shkak ka të bëjë me botën fizike. Këtu shkakësia organizohet sipas ligjesh të përgjithshme. Dukuria arsye është objekt i hermeneutikës, teorisë së interpretimit, ndërsa dukuria shkak është objekt i shkencave të natyrës. Ndryshimin në fjalë e ka paraqitur në mënyrë proverbiale W. Dilthey, madje në shekullin XIX: Natyrën ta shpjegojmë, shpirtin ta kuptojmë.

Foljet e veprimit përmbajnë në semantikën e tyre (implicit) shkakësi të llojit arsye, racionalitet. Arsyet, që japim për të shpjeguar veprimet tona, duhen marrë, konceptuar si shkaqe të tyre.

### 2.1.3 Shkakësia implicite në foljet e komunikimit:

Në këtë grup përfshihen foljet performative që shprehin krahas veprimit dhe një qëllim a synim të folësit. Performativiteti është një bashkëveprim midis gjuhës dhe veprimit.

Foljet e komunikimit përdoren dhe luajnë një rol të rëndësishëm në ligjëratën e drejtë e të zhdrejtë. Të përdorura në pjesën lajmuese të ligjëratës së drejtë/ të zhdrejtë, ato kryejnë funksionin e sinjaleve referuese. Sinjalet referuese shprehin qëndrimin e riprodhuesit ndaj ligjëratës së riprodhuar, p.sh.: *them, konstatoj, njoftoj, përgjigjem, falenderoj, lutem, citoj, precizoj, përcaktoj, përjashtoj* etj.

Edhe foljet performative, si dhe foljet e tjera ndërvetore (psikologjike, të veprimit) fshihin brenda tyre kauzalitet, domethënë nënkuptojnë shkakësi.

Foljet e komunikimit si folje performative, që synojnë një ndikim mbi bashkëbiseduesin me anë të shprehjes foljore, kanë tipare të përbashkëta me foljet e veprimit. Synimi/qëllimi që ato shprehin vlen si arsye për pasojën që rrjedh në aktin perlokutiv.

### 2.2 Kauzaliteti implicit në romanin “*Ansichten eines Clowns*” („*Me syrin e një klouni*“) të H. Böll-it.

Foljet ndërvetore (psikologjike, të veprimit, të komunikimit) përdoren në tekstet letrare me funksione të ndryshme. Ato janë një rrugë nga hyjnë qëllimet dhe arsyet që i shoqërojnë bëmat e personazheve. Edhe nëse në tekst e në kontekst nuk jepet eksplicit shkak ose arsyeja, mjafton folja për ta nënkuptuar atë.

Në romanin e Böll-it raportet shkakore të dhëna implicit përbëjnë përftesa interesante që e bëjnë tekstin më ndikues dhe intrigues.

Kauzaliteti implicit i qëmtuar në romanin e Böll-it lokalizohet në foljet psikologjike, foljet e veprimit, foljet performative- komunikative, në disa fraza emërore, mbiemërore, ndajfoljore.

Teksti letrar i shkrimtarit H. Böll mund të klasifikohet i llojit psikologjik. Kështu në përmbajtjen e romanit mbizotërojnë përjetimet psikologjike ndaj aksionit. Kjo

shprehet me një përdorim të dendur të foljeve ndërveprare që shënojnë gjendje psikologjike.

Funksioni kryesor i foljeve ndërveprare në korpusin e analizuar është shprehja e emocionalitetit si komponent shumë i rëndësishëm në një tekst letrar.

Duke shprehur shkakësi implicite këto elemente ndihmojnë dhe në planin racional, ku shpjegimet e raporteve shkakore janë të domosdoshme.

Një segment tjetër i tekstit letrar, që përmban shkakësi implicite, është dhe monologu i brendshëm. Ky i shtresohet momentit të ligjërimit duke prodhuar intensitet mendor-psikologjik. Kjo përftesë i jep tekstit dhe një karakter autentik e spontan.

Monologjet e brendshme përmbajnë si komponente semantike edhe shkakësinë. Shkakësia në këtë rast mund të jepet hapur me elementet e saj karakteristike, lidhëza, parafjalë etj., ose përmbahet implicit në elemente të caktuara dhe duhet zbuluar. Këtu shfaqet dhe roli i lexuesit si përbërës i veprës letrare. Ai e plotëson atë duke lexuar midis dhe përtej rreshtave.

Hulumtimi dhe përshkrimi i kauzalitetit implicit dhe të mjeteve, që angazhon ai, në analizën e një teksti letrar, është një mënyrë interesante për zbulimin e materialit letrar, për receptimin e përmbajtjeve, për interpretimin e thellë gjuhësor-artistik të veprave letrare.

### *3. Koncepti filozofik mbi shkakësinë*

Principi kauzal ka një rëndësi të veçantë në perceptimin dhe konceptimin e botës nga njeriu. Ky princip bazohet në pranimin e një shkakut për çdo ngjarje. Nihil est sine Ratio (Leibnitz: Nuk ndodh asgjë pa një arsye, pa një shkak).

Principi kauzal ka gjetur në linguistikë një truall të përshtatshëm zbatimi. Teoritë dhe përshkrimet e ndryshme që merren me foljet psikologjike, të veprimit, ato komunikative etj. mbështeten dhe gjejnë justifikim në teza filozofike.

Koncepti huserlian mbi kauzalitetin mbështetet në teorinë fenomenologjike, sipas së cilës bota në raport me un-in vrojtues është një fenomen. Un-i e rrok atë me anë të ndërgjegjjes, e cila për Heidegger-in është realiteti i drejtpërdrejtë. Receptimi i botës nga ndërgjegjja i nënshtrohet rregullave kauzale, që mbështeten në eksperiencën njohëse të subjektit.

Heidegger-i është ndër përpunuesit më finë dhe më të bindshëm të teorisë së shkakësisë. Shpjegimi hajdegerian mbi shkakun e rikthyer ka dhe vlerën e një udhëzimi për çdo njohje e çdo hulumtim. Ky shpjegim përmban kornizën e përgjithshme të një akti njohjeje të zakonshme dhe të një njohjeje ose zbulimi shkencor. Un-i njohës qëndron para objektit, ose vendos para tij objektin, që do të njohë, duke i gjetur pse-në e ekzistencës. Heidegger-i e paraqet këtë si dialog midis objektit ekzistues dhe subjektit sositës. Në rrjedhën e dialogut, dikur „ndriçon“ shkakun dhe objekti bëhet i kuptueshëm. Shkakun quhet „i rikthyer“ se ai ka ekzistuar me objektin vetë edhe para momentit e procesit të njohjes. Ai rishfaqet gjatë njohjes.



Për të ilustruar principin kauzal Hume përdor dukurinë e përplasjes së dy bilave në një tryezë bilardoje. Bila lëvizëse prek bilën në qetësi e cila fillon dhe ajo të lëvizë. Zhvendosja hapësinore e bilës së dytë ndodh për shkak të bilës së parë lëvizëse. Është e qartë: pa “transferimin” e forcës nga objekti i parë tek i dyti, ky i fundit do të qëndronte në vend. Kështu, bila e parë është shkak për zhvendosjen e së dytës.

Platoni e formulon kështu ligjin e shkakësisë: „Çdo ndodhi ka në origjinë domosdoshmërisht një shkak.“ Ndërsa Kanti shprehet: „Të gjitha ndryshimet ndodhin sipas ligjit të lidhjes së shkakut me pasojën.“

Lewis-i e përshkruan raportin kauzal si një varësi shkakore të dy ndodhive, dy propozicioneve (që jepen me fjali pohore). Të dyja këto Lewis-i i vendos në një rrafsh të përbashkët. Marrëdhënia shkakore krijohet atëherë, kur midis këtyre madhësive ekziston një varësi e dyanshme. Lewis-i arsyeton:

“e është në varësi kauzale nga c, ... nëse varësia është e dyanshme...Nëse e nuk ekziston, edhe c nuk do të ekzistojë.

Formulimi i Lewis-it vlen vetëm për rastet kur dukuritë/ndodhitë ekzistojnë në botën reale. Përkufizimi i Lewis-it mbi varësinë kauzale të dukurive reale ka gjetur jehonë dhe ka ndikuar mendimin teorik gjuhësor. Teoria e tij është në bazën e konceptit lingvistik “Cause-Operators” që ka të bëjë me procesin e dekompozimit të kuptimeve foljore në përbërës semantikë.

*Problemi i seleksionit* është një çështje tjetër filozofike që lidhet me konceptimin e kauzalitetit. Një pasojë rrjedh rëndom jo nga një, por nga disa shkaqe. Mill-i është një nga filozofët e parë që janë marrë me këtë çështje. Në librin e tij ai thekson që shpjegimi i një raporti shkakor, zakonisht, mbështetet vetëm në kushtet, në arsytet e njohura dhe të kapshme nga njeriu. Një sërë shkaqesh të tjera mbeten në hije, të pazbardhura.

Talmy në punimet e tij mbi shprehjen gjuhësore të marrëdhënive shkakore dhe mbi semantikën e koncepteve kauzale merret posaçërisht me dukurinë e shprehjes së tyre në ligjërimi të ndryshme. Ai ballafaqon dy fusha përdorimi të konstrukteve shkakore: shkencat e natyrës dhe gjuhën e përditshme. Në shkencat e natyrës raportet shkakore vrojtohen me imtësi për të zbuluar të gjitha shkaqet dhe pasojat e mundshme, të gjitha lidhjet reciproke. Në ligjërimin bisedor ndodh që lidhja shkakore të paraqitet autonome, domethënë nuk jepet asnjë shkak.

Carnap shprehet që në shtjellimin e një lidhjeje kauzale shpallen shkaqe të ndryshme nga persona të ndryshëm. Kjo kushtëzohet nga interesat e ndryshëm të personave. Edhe Carnap vëren që në ligjërimin e zakonshëm, të përditshëm sasia e shkaqeve që prodhojnë një pasojë reduktohet.

Hilton propozon që shpjegimet e lidhjeve shkakore në ligjërimin bisedor të trajtohen në kuadrin e pragmatikës ligjërimore. Në ndërtimin e ligjërimin të përditshëm luajnë rol faktorë të tillë, si situata konkrete, folësi, dëgjuesi, informacioni sociokulturor i tyre, komunikimi.

Mendimi i Davidson-it , që është sot më i vlerësuar në fushën e teorisë së veprimit (filozofisë analitike), mbështetet në tezën: arsytet, që japim për të shpjeguar veprimet tona, duhen konceptuar si shkaqe të tyre.

## **Përfundime të përgjithshme**

---

Po e mbyllim paragrafin e përfundimeve me thënien-lapidar të Dilthey-it, ku formulohet në mënyrë tejet domethënëse dallimi midis shkakut në natyrë dhe karakterit racional të shkaqeve njerëzore-shoqërore: Natyrën ta shpjegojmë, shpirtin ta kuptojmë.

### Bibliografia

- Agolli, D., *Poezi*, Tiranë 1979.
- Austin, J. L., *Zur Theorie der Sprechakte*, Stuttgart, 1972.
- Aristoteles. *Die nikomachische Ethik*, Rowohlt's Enzyklopädie, Hamburg, 2006.
- Aristoteles, *Metaphysik*, Reclam, 1970, V. Buch, 1970.
- Behangel, O., *Deutsche Syntax*, II, Heidelberg, 1924.
- Belletti, A/ Rizzi, L., "Psychverbs and Theta-Theory", botuar në, *Natural Language and Linguistic Theory* 6, f. 293-352.
- Bierwisch, M., „Wörtliche Bedeutung – eine pragmatische Gretchenfrage“, botuar në, *Sprache und Pragmatik*, Lund, 1983.
- Blöcker, G., *Der Schriftsteller H. Böll, ein biographischer Abriss*, München, Taschenbuch-Verlag, 1985.
- Boetscher, W./ Sitta, H., *Deutsche Grammatik III. Zusammengesetzter Satz und äquivalente Strukturen*. Frankfurt a.M., 1972.
- Bondzio, W., *Die Stellung der Valenz im Rahmen der Satzstruktur*, Berlin, 1969.
- Böll, H., *Ansichten eines Clowns*, Köln, Verlag Kiepenheuer, 1963.
- Brown, R./Fish, D., "The psychological causality implicit in language", botuar në, *Cognition*, 14, f. 233-274.
- Brinkmann, H., *Die deutsche Sprache*, Düsseldorf, 1962.
- „Brock Haus Enzyklopädie“, Wiesbaden 1970, vëllimi i 10 –të.
- Buchholz, O./ Fiedler, W., *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987.
- Buchholz, O., „Kausalkonjunktionen in der heutigen albanischen literarischen Sprache“, botuar në, *Zeitschrift für Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung*, Band 35/H. 4; Berlin 1982, f. 383- 391.
- Büntig, K. D., *Einführung in die Linguistik*, Frankfurt 1971.
- Buscha, J., *Lexikon deutscher Konjunktionen*. Leipzig, 1989.
- Bußmann, H., *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart, Kröner Verlag, 2002.
- Bybee, J. L./ Fleischmann, S., *Modality in grammar and discourse*, Amsterdam, 1995.

## Bibliografia

---

- Collet, S., "A propos de quelques conjonctions causales", botuar në, *Nouveaux cahiers d'allemand* (Nancy), 1/3, 1983.
- Croft, W., "Case marking and the semantics of mental verbs", botuar në, *Semantics and the Lexicon*, Dordrecht, 1991.
- Das grosse Wörterbuch der deutschen Sprache, Bd. 6*, Mannheim/ Wien/ Zürich, 1981.
- Davidson, D., *Probleme der Rationalität*, Frankfurt am Main, Suhrkamp, 2006.
- Davidson, D., *Können Gründe Ursachen von Handlungen sein*, München, 2004.
- Demiraj, Sh., *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1986.
- Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe, II*, Tiranë, 1955.
- Dowty, D., "Thematic proto-roles and argument selection", botuar në, *Language*, 67/3, 1991.
- Dowty, D., *Word meaning and Montague grammar. The semantics of verbs and times in generative semantics and in Montague's PTQ*, Dordrecht, Kluwer Academic Publishers Group, 1977.
- Duden Grammatik, Band 4*, botuar nga, G. Drosdowski et al., Mannheim/Wien/Zürich: Bibliografisches Institut, 1984.
- Duden. Stilwörterbuch der deutschen Sprache. Die Verwendung der Wörter im Satz.* Mannheim. Münche, Zyrich, 1988.
- Dhjata e re dhe psalmet*, Tiranë, 1991.
- Eisenberg, P., „Der Kausalsatz ist nicht zu retten“, botuar në: *Praxis Deutsch* 20/118, 1993, f. 10-11.
- Eisenberg, P., *Grundriss der deutschen Grammatik. 3. überarbeitete Auflage*, Stuttgart, Metzler, 1994.
- Eisenberg, P., *Grundriss der deutschen Grammatik*, Stuttgart, 1989.
- Engel, U., *Syntax der deutschen Gegenwartssprache*, Berlin 2009.
- Engel, U., *Deutsche Grammatik*, München, Judicium, 2004.
- Engel, U., *Deutsche Grammatik. 3. korrigierte Auflage*. Heidelberg, Groos, 1996.
- Engel, U., *Deutsche Grammatik*, Heidelberg, 1988.
- Engel, U., *Semantische Relatoren (separat)*, Tübingen, Max Niemeyer Verlag, 1996
- Erben, J., *Deutsche Syntax. Eine Einführung*. Bern, 1984.
- Erben, J., *Deutsche Grammatik. Ein Abriss*. München, 1972.
- Erben, J., *Abriss der deutschen Grammatik*, Berlin, 1964.

- Femra Moderne*, “Tregimi i jetuar” Tiranë, 2002.
- Floqi, S. “Periudha me fjali të varur shkakore, I, II”, botuar në, *Studime filologjike*, 2, 3. Tiranë, 1966.
- Forstreuter, E /Egerer-Möslein, K. *Die Präpositionen*, 2., unv. Auflage Leipzig, 1980.
- Gabriel, G/ Janisch, P., „Kausalität“, botuar në, *Enzyklopädie, Philosophie und Wissenschaftstheorie, I-IV*, Stuttgart, Weimar 1995-1996, II, f. 372-376.
- Gaumann, U., „*Weil die machen jetzt bald zu*“. *Angabe- und Junktivsatz in der deutschen Gegenwartssprache*, Göppingen, Kümmerle, 1983.
- Gislimberti, S., *Deutsch-italienisch: syntaktische und semantische Untersuchungen*. Wilhelmsfeld, 1993.
- Gohl, Ch./ Günthner, S., „Grammatikalisierung von weil als Diskursmarker in der gesprochenen Sprache“, botuar në, *Zeitschrift der Sprachwissenschaft, Band 18, Heft 1*, Berlin, de Gruyter 1999, f. 39-75.
- Götze, L. /Hess-Lüttich, E.W.B., *Wahrig. Grammatik der deutschen Sprache*, Gütersloh/München, Wissen Media Verlag, 2002.
- Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Botim i Akademisë së Shkencave. Tiranë, 2002.
- Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Botim i Akademisë së Shkencave. Tiranë, 2002.
- Grimshaw, J., *The Structure of Argument Structure*, Cambridge/Mass, 1990.
- Gjarpëri i shtëpisë*, roman, Tiranë, 2005.
- Härtl, H., *Cause and Change. Thematische Relationen und Ereignisstrukturen in Konzeptualisierung und Grammatikalisierung*. Berlin, 2001.
- Härtl, H., “Mapping conceptual onto grammatical structures: The case of psych verbs”, botuar në, *Structural Aspects of Semantically Complex Verbs*, Frankfurt/New York: Lang, 2001, 191-217.
- Harras, G., *Handwörterbuch der Kommunikationsverben*, Teil I, Teil II, de Gruyter, Berlin/New York, 2004.
- Harras, G., *Handlungssprache und Sprechahndlungen*, Berlin, de Gruyter, 1983.
- Heidegger, M., *Die Frage nach der Technik, Gesamtausgabe, Band 7*, Frankfurt am Main, Klostermann, 2000.
- Heidegger, M., *Der Satz vom Grund, Gesamtausgabe, II. Abteilung, Band 24*, Frankfurt am Main, Klostermann, 1997.
- Helbig, G., „Der Begriff der Valenz als Mittel der Sprachbeschreibung und des

## Bibliografia

---

- Fremdsprachunterrichts“, botuar në, *Deutsch als Fremdsprache*, 1965, 1, f. 10-23.
- Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht. 8., neubearb. Auflage*, Leipzig, 2004.
- Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Leipzig, 2001.
- Helbig, G/ Buscha J., *Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Leipzig, 1984.
- Herweg, M., *Zeitaspekte. Die Bedeutung von Tempus, Aspekt und temporalen Konjunktionen*, Wiesbaden, Deutscher Universitäts-Verlag, 1990.
- Heuer, W., *Richtiges Deutsch*, Verlag NZZ, Zürich, 1985.
- Heyse, J.C.A., *Deutsche Grammatik*, Hannover, 1908.
- Hösselbarth, L., „Äquivalenzbedingte Anforderungen an der Konfrontation kausaler Konnektive“, botuar në, *Zeitschrift für Phonetik, Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung* 43/5. Berlin, 1990, f. 710-718.
- Hume, D., *Eine Untersuchung über den menschlichen Verstand*, Reclam, Philipp, jun. GmbH Verlag, 1968.
- Husserl, E., *Gesammelte Werke, Volume 36*, Berlin, 2003.
- Janish, N., *Werbesprache*, Tübingen, Narr Studienbücher, 2003.
- Jung, M., *Dilthey zur Einführung*, Junius Verlag, Hamburg, 1996.
- Kadare, I. *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Tiranë, 1981.
- Kadare, I., *General der toten Armee*. Übersetzt vom Oda Buchholz/Wilfried Fiedler. Deutscher Taschenbuch Verlag, 1990.
- Kailuweit, R., „Protorollen und Makrorollen“, botuar në, *Semantische Rollen*, Tübingen, 2005, f. 83-102.
- Kant, I., *Kritik der reinen Vernunft, Werkausgabe in 6 Bänden, Band 2*, Darmstadt, 1781/1983.
- Keller, R., „Das epistemische weil. Bedeutungswandel einer Konjunktion“, botuar në, *Sprachgeschichte und Sprachkritik*. Festschrift für Peter von Polenz. Berlin/New York: de Gruyter, 1993, f. 219-247.
- Keller, R., „Kollokutionäre Akte“, botuar në, *Germanistische Linguistik*, 1-2, 1977, f. 3-50.

## Bibliografia

---

- Krusche, D., Kommunikation im Erzähltext 1. Analysen, München, Wilhel Fink Verlag, 1988.
- Kutscher, S., *Kausalität und Argumentrealisierung. Rollensemantik der Psychverben*, Tübingen, 2009.
- Küper, Christoph, „Geht die Nebensatzstellung im Deutschen verloren? Zur pragmatischen Funktion der Wortstellung in Haupt- und Nebensätzen.“ *Nö: Deutsche Sprache* 19/2, f. 133-158.
- Lafe, E., „Lidhëzat te libri I shqip“, botuar në, *Studime Filologjike*, 1971/4.
- Lang, E., „Erklärungstexte“, botuar në, *Probleme der Textgrammatik.* , Berlin, 1976.
- Lang, E., *Studien zur Semantik der koordinativen Verknüpfung*. Berlin, 1977
- Leinfellner, E., „ Kausalität und Referenz: eine linguistische Analyse“, botuar në, *Semiotics unfolding 2.*, Berlin/New York, 1983, f. 1175-1182.
- Lewis, D., *Counterfactuals*, Harvard, University Press 1973.
- Mauss, E. /Bunge, S. A. /Gross, J. J., „Automatic emotion regulation“, botuar në, *Psychologie Social and Personality, Compas 1*, 2008, f. 146 – 167.
- Mees, U, „Zum Forschung der Emotionspsychologie-eine Skize“, botuar në, *Emotionen und Sozialtheorie*, Frankfurt am Main, 2006, f. 104- 123.
- Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Botimet Toena, Tiranë, 2008.
- Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë 2008.
- Meshari i Gjon Buzukut*, USHT, Tiranë 1968, I, II.
- Mill, S., *Buch III, Kapitel V*, Leipzig, 1874.
- Mitko, Th., *Vepra*, Tiranë, 1981.
- Motsch, W., „Sprache als Handlungsinstrument“, botuar në, *Neue Aspekte der Grammatikforschung, Band 19.Linguistische Studien des ZISW*, Berlin, Akademieverlag, 1987.
- Ndreca, M. *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*. Toena, Tiranë, 2007.
- Pasch, R., „Weil mit Hauptsatz – Kuckucksei im denn-Nest“, botuar në, *Deutsche Sprache*, 25/3, 1997, f. 252-271.
- Peyer, A., *Satzverknüpfungen: formale Möglichkeiten und inhaltlichen Kategorien. Ein Klassifizierungsversuch*. Lizentiasarbeit. Zürich, 1989.
- Pit, Marina, *How to express yourself with a causal connectiv*, Amsterdam, 2003.

## Bibliografia

---

- Platon. *Sämtliche Werke, Bd. 1*, Übersetzer Friedrich Schleiermacher, Taschenbuch, 2004.
- Primus, B., *Semantische Rollen. Kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag Winter, 2012
- Primus, Beatrice, *Kasusvariation bei psychischen Verben*. Tübingen, Gunter Narr Verlag, 2004.
- Primus, B., „Proto-roles and case selection in Optimality Theory“, botuar në: *Theorie des Lexikons, Arbeiten des Sonderforschungsbereichs 282, Nr. 122*, 2002.
- Primus, B., „Rektionsprinzipien“, botuar në, *Deutsch- kontrastiv*, Tübingen, 1999.
- Pusch, L., *Substantivierung von Verben mit Satzkomplementen im englischen und im Deutschen*, Frankfurt, Athenäum, 1988.
- Pusch, L., „Kausale Adverbialphrasen vom Typ aus/vor + NP“, botuar në, *Linguistische Perspektiven. Referate des VII. Linguistischen Kolloquiums Nijmegen (26-30 shtator 1972)*. Tübingen, 1973, f. 149-159.
- Rayfield, D., *Handlung. Analytische Handlungstheorie, Band 1*, Frankfurt/M, Suhrkamp, 1977.
- Redder, A., *Grammatiktheorie und sprachliche Handlung: ‚denn‘ und ‚da‘*. Tübingen, 1990.
- Rudolf, E., „Zur Problematik der Konnektive des kausalen Bereichs“, botuar në, *Grundelemente der semantischen Struktur von Texten. I. Konnektivausdrücke, Konnektiveinheiten*, Hamburg, 1982/1, f. 146 -244.
- Rudolph, U./ von Hecker, U., “Die Erklärung interpersonalen Ereignisse”, botuar në, *Zeitschrift für experimentelle Psychologie*, Band XLIV, Heft 2, 1997, f. 246-265.
- Rudolph, U./Fösterling, E., „Zur impliziten Kausalität in Sprache: Kriterien zur Selektion von Stimulusmaterial in Studien zur Verbkausalität“, botuar në, *Zeitschrift für experimentelle Psychologie*, 44, 1997/2, f. 293-304.
- Ryle, G., *Concept of Mind*, Reclam, 1969.
- Schmidhauser, B., *Kausalität als linguistische Kategorie*, Niemeyer, 1995.
- Searle, J.R., „Taxonomie illokutionärer Akte“, botuar në, *Searle*, Frankfurt, 1982.
- Searle, J.R., *Sprechakte*, Frankfurt, 1971.
- Simoni, Z., *Wörterbuch Deutsch- Albanisch*, Hamburg, Buske Verlag, 1997.
- Spörrle, M. /Barth, K. /Gerber-Braun, B./Fösterling, F: „Eine lexikalische und



- korpusbasierte Analyse“, 46. Tagung experimentell arbeitender Psychologen, München, April, 2004.
- Steinitz, R., „Zur Semantik und Syntax der urativer, inchoativer und kausativer Verben“, botuar në, *Linguistische Studien* 35, 1977, f. 85 – 129.
- Stojanova, N., *Linguistische Untersuchungen zum Ausdruck kausaler Beziehungen in der deutschen Gegenwartssprache unter besonderer Berücksichtigung der Strukturen und der Funktionen der denn-Sätze.*“ Diss. A, Sektion Germanistik/Literaturwissenschaft, Karl-Marx-Universität Leipzig, 1983.
- Sweetser, E., *From etymology to pragmatics*, Cambridge, University Press, 1990.
- Talmy, L., *Cognitive Semantics*, de Gruyter, Berlin, 2007.
- Teichmann, E., *Hapa në universin e ligjërit*, Tiranë, 2010.
- Tesniere, L., *Esquisse d'une Syntaxe structurale*, Paris 1953.
- Tesniere, L., *Elements de syntaxe structurale*, Paris 1959.
- Thim-Mabrey, Ch., „Zur Syntax der kausalen Konjunktionen weil, da und denn“, *Sprachwissenschaft* (Heidelberg) 7, 1982, f. 197-219.
- Uhmann, S., „Nur ein Sturm in Lexikonglas. Zur aktuellen Verbstellungsvariation in weil-Sätzen“, botuar në, *Wuppertaler Arbeitspapiere zur Sprachwissenschaft* 13, 1996, f. 1-26.
- Urmson, J.O., „Motives und Causes“, botuar në: *The Philosophy of Action*, Oxford 1973.
- Van Valin, R. D. /LaPolla R. J., *Syntax: Structure, meaning and function*. Cambridge, 1997.
- Vattimo, G., *Presentazione: Introduzione alla Metafisica*, Milano, Mursia, 1990.
- Winkler, E., „Syntaktische und semantische Eigenschaften von verba dicendi und ihre Bedeutung“, botuar në, *Studien zum Satzmodus I*, Akademie des Wissenschaften der DDR Zentralinstitut für Sprachwissenschaft, 1988.
- Wright, G. H. von, *Erklären und verstehen*, Fischer Verlag, 1974.
- Wackernagel, J., *Vorlesungen über Syntax der deutschen Sprache*, Band 2, Basel 1968.
- Weinrich, H., *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Mannheim, Dudenverlag, 1993.
- Wegener, H., „da, denn und weil – der Kampf der Konjunktionen. Zur Grammatikalisierung im kausalen Bereich“, botuar në, *Deutsche Grammatik in Theorie und Praxis*. Tübingen, Niemeyer, 2000, f. 69-81.

## Bibliografia

---

- Wegener, H., „Weil – das hat schon seinen Grund.“ Zur Verbstellung in Kausalsätzen mit weil im gegenwärtigen Deutsch, botuar në, *Deutsche Sprache* 21, 1993, f. 289-305.
- Wegener, H., „Syntaxwandel und Degrammatikalisierung im heutigen Deutsch? Noch einmal zu weil-Verbzweit“, botuar në, *Deutsche Sprache* 27, 1999, f. 3-26.
- Wegener, H., «Zum Bedeutungs- und Konstruktionswandel bei psychischen Verben», botuar në, *Deutsch kontrastiv. Studien zur deutschen Grammatik* 28. Tübingen, Stauffenburg 1999, f. 171-210.
- Wilske, L., „Sprachkommunikative Verben. Ein Versuch ihrer Umgrenzung und Systematisierung.“, botuar në, *Wissenschaftliche Zeitschrift der Pädagogischen Hochschule, K. Liebknecht, Potsdam*, 1986, H. 5, f. 741-748.
- Wolfgang, P., *Etymologisches Wörterbuch des Deutschen*, Berlin, 1989.
- Wunderlich, D., „Über die Argumente des Verbs“, botuar në, *Linguistische Berichte*, 97, Tübingen, 1985
- Zarnikov, A., *Einführung in die Linguistik*, Frankfurt am Main, Verlag Diesterweg, 1987.
- Zifonun, G. /Hoffmann, L./ Strecker B./ Ballweg, J., *Grammatik der deutschen Sprache*, Berlin /New York, de Gruyter, 1997.
- Burime nga interneti:
- <http://hypermedia.ids-manheim.de/pls/grammis>, 09. 07. 04.